

**ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS, KOMUNA E RAHOVECIT**

Doktoranti:

Ibrahim Kryeziu

Dorëzuar:

Universitetit Evropian të Tiranës

Shkollës Doktorale

***Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në (Ekonomi), me
profil (Ekonomi dhe zhvillim i qëndrueshëm), për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”***

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc.Oltjana Zoto

Numri i fjalëve: 60190

Tiranë, Janar 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky punim i doktoratës është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Këtë punim e kam kryer duke i respektuar standardet e njohura dhe të pranuar për studime dhe hulumtime. Si autor i punimit jam i ndërgjegjshëm dhe përgjegjshëm për detyrimet që kam gjatë përgatitjes së punimit të doktoratës, në kuptim të përdorimit të literaturës, referimeve, citimeve, etj.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Autori

ABSTRAKTI

Gjysma e dytë e shekullit të kaluar, është përcjell me një dinamikë të shpejtë të zhvillimit ekonomik. Dinamika e ndryshimit ka sjell deri te paraqitja e proceseve zhvillimore siç janë, revolucioni shkencore teknologjik, globalizimi, zhvillimin e ekonomisë së dijes etj. Shpërfaqja e këtyre proceseve shumë të rëndësishme është përcjell edhe me prezencën e krizave ekonomiko shoqërore të cilat kana kërkuar nga elitat intelektuale, politike dhe menaxheriale që të krijojnë politika që do të përballeshin me sfidat e kohës.

Njëra prej politikave globale e cila është ndërtuar në këtë periudhë kohore është koncepti i zhvillimit ekonomik lokal-ZHEL-i. Ky koncept është zhvilluar nga autor të ndryshëm, në fakt përvoja e veprimeve të vendeve të ndryshme i ka parapri ndërtimit të teorisë së ZHEL, një kontribut të veçantë në pasurimin e teorisë dhe praktikës së ZHEL-it e kanë dhënë edhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare siç janë Banka botërore - BB, bankat e ndryshme regjionale, politikat e organizatave siç janë Bashkimi Evropian, USAID etj. Vendet e ndryshme kanë filluar aplikimin e procesit të ZHEL-it në faza të ndryshme, vendet e BE-së, SHBA-të tanimë kanë një përvojë më të gjatë, derisa vendet të ish bllokuat socialist aplikimin e ZHEL-it e kanë filluar në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli.

Banka botërore zhvillimin e procesit të ZHEL-it e ndan në tri periudha kohore e cila fillon në fund të viteve të gjashtëdhjeta dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Kosova si një vend i cili procesin e tranzicionit e ka filluar tek pas çlirimit respektivisht pas vitit 1999, akoma është në fazan fillestare të aplikimit të këtij koncepti.

Aplikimi i konceptit të ZHEL-it kërkon ngritjen e kapaciteteve institucionale, profesionale dhe të legjislacionit, në këtë drejtim Kosovën e kanë ndihmuar dhe vazhdojnë ta ndihmojnë organizatat e ndryshme ndërkombëtare në veçanti USAID-i, Banka Botërore, BE-ja dhe shumë organizata të tjera.

Koncepti i ZHEL-it në Kosovë ka filluar të aplikohet në disa fusha në veçanti pas viti 2008, kur edhe formalisht është shpallur pavarësia e Republikës së Kosovës. Legjislacioni aktual i Kosovës për vetëqeverisjen lokale është një bazë e mirë për aplikimin e ZHEL-it, edhe pse ka nevojë për një pasurim të mëtejshëm të tij, meqë ZHEL-i është i lidhur ngushtë me procesin e decentralizimit të pushtetit.

ABSTRACT

The second half of the last century, was followed by a rapid dynamic of economic development. The dynamics of change has led to the appearance of development processes such as the technological revolution, globalization, the development of the knowledge economy, and ect. The outbreak of these very important processes is followed by the presence of social and economic crises, which are sought by intellectual, political and managerial elites to create policies that will faced the challenges of the time.

One of the global policies that is built in this period is the concept of local economic development - LED. This concept has been developed by different authors, in fact the experience of the actions of different countries preceded the construction of the LED theory, a special contribution to the enrichment of LED theory and practice has also been provided by various international organizations such as are the World Bank-WB, various regional banks, the policies of organizations such as the European Union - EU, USAID, etc.

Different countries have started to apply the LED process at different stages, so the EU countries and the USA already have a long experience in this field, while the former Bloc socialist countries application of LED's are beginning at the end of the last century and early this century.

According to the World Bank, developing of the LED process divides into three periods which begins in the late sixties in the passed century and continues to this day. Kosovo as a country that the transition process started after the liberation, respectively after 1999, is still in the initial phase of application of this concept.

The application of the LED concept requires the establishment of institutional, professional and legislative capacities, in this direction Kosovo has been assisted and continues to get assist from various international organizations, in particular from USAID, the World Bank, the EU and many other organizations.

The LED concept in Kosovo has started to apply in some areas especially after 2008, when the independence of the Republic of Kosovo was formally proclaimed. Kosovo's current legislation on local self-government is a good basis for the application of LED, although it needs further enrichment, since LED is closely linked to the decentralization process of power.

DEDIKIMI

Prindërve të mi të ndjerë dhe të gjithë atyre që nëpër shekuj janë sakrifikuar për lirinë, pavarësinë dhe ndërtimin e shtetit Shqiptar dhe Republikën e Kosovës.

FALENDERIME

Shpreh falënderimet e mia më të sinqerta për udhëheqësin shkencor të këtij punimi Prof. Dr. Oltiana Zoto, për bashkëpunim të sinqertë, për përkrahje dhe përkushtim profesional në konceptimin, punimin dhe përfundimin e temës.

Mirënjohje dhe falënderim edhe për stafin akademik dhe atë administrativ të UET-it, për përkrahje në punën time.

Një falënderim im veçantë për familjen time, e cila më qëndroi pranë duke më inkurajuar dhe përkrahur pa ndërprerë përgjatë këtij rrugëtimi.

Përmbajtja

Kapitulli I: Hyrja	14
1.1 Qëllimi i studimit	16
1.2 Identifikimi i problemit	18
1.3 Hipoteza kryesore dhe hipotezat ndihmëse	19
1.4 Rëndësia e studimit	21
1.5 Struktura e punimit doktoral	22
Kapitulli II: Metodologjia dhe Metodatat e kërkimit.....	24
2.1 Qasja metodologjike në objektin hulumtimor	24
2.2 Metodatat e aplikuar përgjatë punimit	25
2.3 Mundësit dhe kufizimet.....	26
KAPITULLI III: Shqyrtimi i literaturës	28
3.1 Konceptet bazë (Teoritë mbi Zhvillimin ekonomik lokal);.....	28
3.2 Historiku i Zhvillimit Ekonomik Lokal	32
3.3 Instrumentet (Politikat) e Zhvillimit Ekonomik Lokal.....	38
3.4 Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal;	42
3.5 Qëllimet e politikave të zhvillimit ekonomik dhe arsyeshmëria e angazhimit të Pushtetit Lokal.....	45
3.6 Koncepti dhe teoritë mbi vlerësimin e ndikimit.....	48
3.7 Përmbledhje e studimeve të autorëve të ndryshëm	52
3.8 Konkluzionet rreth teorive për ZHEL-in.....	56
KAPITULLI IV: Historiku i zhvillimit të Kosovës	57
4.1 Zhvillimi i Kosovës deri në qershor të vitit 1999.....	57
4.2 Zhvillimi i Kosovës nga qershori 1999 deri në shkurt të 2008	64
4.3 Zhvillimi i Kosovës nga 2008 e tutje	66
4.4 Ekonomia dhe ecuritë zhvillimore; Vështrim i përgjithshëm	67
<i>Treguesit kryesor makro-ekonomik dhe ecurit ekonomike.....</i>	<i>69</i>
<i>Vlerësim i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në Kosovë.....</i>	<i>74</i>
4.5 Korniza ligjore për qeverisjen lokale	76
<i>Qeverisja Lokale 1999-2008</i>	<i>77</i>
KAPITULLI V: Komuna e Rahovecit	82
5.1 Profili së Rahovecit i Komunës.....	82
<i>Vështrimi Gjeografik</i>	<i>82</i>

<i>Një Historik i shkurtër</i>	82
<i>Të dhënat demografike</i>	84
<i>Arsimi</i>	85
<i>Arsimi para fillor</i>	86
<i>Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar)</i>	87
<i>Arsimi i mesëm i lartë</i>	87
5.2 Struktura organizative dhe funksionale e Komunës.....	88
5.3 Buxheti Komunal, si instrument i zhvillimit.....	89
<i>Të hyrat e Komunës</i>	90
<i>Shpenzimet komunale</i>	97
5.4 Infrastruktura	99
5.5 Dokumentet zhvillimore strategjike Komunale	102
5.6 Sektori publik	107
<i>Organizimi Institucional i sektorit publik në fushën e ZHEL-it</i>	107
<i>Organizatat publike qendrore dhe lokale</i>	109
5.7 Ekonomia - Sektori privat	110
<i>Bujqësia dhe blegtoria</i>	110
<i>Industria prodhuese/përpunuese</i>	116
<i>Tregtia dhe shërbimet</i>	126
<i>Komuna-sektori publik dhe sektori privat</i>	134
<i>Sektori civilë</i>	144
3. Hulumtimi dhe analiza	148
<i>3.1. Sektorit publik-Komuna e Rahovecit, si njësi bazë e qeverisjes lokale</i>	149
<i>3.2. Sektori privat</i>	151
<i>3.3. Sektori civil (shoqëria civile)</i>	154
<i>3.4. Sektori civil (Banorët lokal)</i>	157
7. Vlerësimi i politikave/mekanizmave komunal (Mini parkut të biznesit/ industria) të aplikuara në mbështetje të sektorit privat;	167
<i>7.1. Përcaktimi grupit krahasues;</i>	167
<i>7.2. Profili i grupit krahasues (karakteristikat e grupeve të trajtimit dhe krahasimit).....</i>	168
<i>7.3. Vlerësimi i ndikimit të politikave/mekanizmave të aplikuar nga komuna ..</i>	170
8. Mënyra (Modeli) i organizimit të pushtetit lokal për ZHRL-in.....	179
<i>8.1. Mënyrat (Modelet) e organizimit të ZHEL-it nëpër vende të ndryshme..</i>	179

8.2.	<i>Mënyra aktuale e organizimit në Kosovë/Rahovec</i>	183
8.3.	<i>Modeli i organizimit të strukturës komunale i propozuar për të ardhmen 184</i>	
9.	Përfundimet dhe Rekomandimet	189
9.1.	<i>Përfundimet.....</i>	189
9.2.	<i>Rekomandimet</i>	193
Shtojca.....		195
III.	<i>Shënimet nga hulumtimi i opinionit;</i>	212
	<i>Forma e intervistës - Sektori privat.....</i>	212
	<i>Forma e Intervistës - Sektori Civil</i>	213
	<i>Forma e intervistës - Sektori publik.....</i>	215
	PYETËSORI ANKETUES	218
	<i>Rezultatet e anketimit hulumtues të banorëve të Rahovecit:</i>	221

LISTA E ILUSTRIMEVE

Figura 1: Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe vitit në (%) për vitet 2012-2015	71
Figura 2: Rrjeti hekurudhor në Komunën e Rahovecit;	102
Figura 3: Sipërfaqet e mbjella me hardhinë e rrushit në Kosova, para dhe pas luftës	112
Figura 4: Paraqet eksportin e verës në tregun e jashtëm nga viti 2007-2014;.....	124
Figura 5: Krahاسimi i numrit të bizneseve aktive sipas ASK-së dhe ATK-së.....	132
Figura 6: Bizneset e reja dhe të shuara përgjatë viteve 2010-2015 në Rahovec	133

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela 1: Programet zhvillimore të aplikuara nga qeveritë lokale dhe shtetërore në SHBA,	34
Tabela 2: Fazat/valët e zhvillimit ekonomik lokal-ZHEL-it.....	36
Tabela 3: Pesë fazat e procesit të planifikimit strategjik të zhvillimit ekonomik lokal	43
Tabela 4: Norma e shtimit të produktit shoqëror (GDP) në ekonominë e Kosovës	61
Tabela 5: Struktura e produktit shoqëror sipas lëmenjve të ekonomisë, Çmimet e vitit 1972.....	62
Tabela 6: Numri i të punësuarve në ekonominë e Kosovës	63
Tabela 7: Ndërmarrjet e regjistruara sipas numrit të punëtorëve – 2010.....	68
Tabela 8: Bruto produkti vendor me çmime reale për vitet 2008–2015, në Kosovë, (në mil. €).....	69
Tabela 9: Të dhënat mbi popullsinë, punësimin dhe të papunët, 2012-2015.....	71
Tabela 10: Numri i punëtorëve të regjistruar sipas sektorëve ekonomik në Kosovë.....	73
Tabela 11: Popullsia në komunën e Rahovecit sipas indeksit, (PZHK, 2013, 18)	85
Tabela 12: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale për periudhën 2016-2018, në €	91
Tabela 13: Baza tatimore për Komunën e Rahovecit për vitin 2016	95
Tabela 14: Shpenzimet buxhetore, Korniza Buxhetore Komunale, (sipas kategorive ekonomike), në €.	98
Tabela 15: Rrjeti rrugëve në komunën e Rahovecit.....	101
Tabela 16: Sipërfaqet me vreshta dhe prodhimi i rrushit në komunën e Rahovecit	112
Tabela 17: Sipërfaqet e mbjellura me drithëra për vitet 2015- 2016,në komunën e Rahovecit;	113
Tabela 18: Sipërfaqet e mbjellura me perimekulturë në vitet, 2015- 2016 në Rahovec;	114
Tabela 19: Sipërfaqet e mbjella me perimekulturë në Sera, 2015-2016, në Rahovec .	115
Tabela 20: Fermat sipas llojit dhe numri i krerëve në vitet, 2015-2016 në Rahovec*	115
Tabela 21: Ndërmarrjet shoqërore industriale, para dhe pas luftës në komunën e Rahovecit	117
Tabela 22: Ndërmarrjet/kompanitë për përpunimin e rrushit në komunën e Rahovecit	123
Tabela 23: Bizneset aktive sipas veprimtarive ekonomike në komunën e Rahovecit .	128
Tabela 24: Numri i bizneseve aktive në Komunën e Rahovecit, sipas sektorëve ekonomik	130
Tabela 25: Krahësimi i numrit të bizneseve aktive sipas ASK-së dhe ATK-së	131
Tabela 26: Mbështetja për kulturat bujqësore, në komunën e Rahovecit	136

Tabela 27: Bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike në Komunën e Rahovecit;	140
Tabela 28: Fermerët përfitues të granteve/subvencioneve komunale për Sera.....	142

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AZHK	Agjenda Zhvillimore Komunale
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim
CEFTA	Central European Free Trade Agreement
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDP/BPB	Bruto Produkti Vendor
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KK	Kuvendi Komunal
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkpunim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
THV	Të Hyrat Vetanake
UNMIK	Administrata e Përkohëshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Investim e Zhvillim

Kapitulli I: Hyrja

Zhvillimi ekonomik është procesi kompleks dhe si i tillë paraqet një sfidë , i cili është shtruar dhe trajtuar si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktikë nga shumë studiues të mendimit ekonomik dhe më gjerë. Si aspekti teorik ashtu edhe ai praktikë janë në funksion të ndërtimit të sistemit ekonomik dhe shoqëror të përshtatshëm , por domosdoshmërisht janë edhe në vartësi të këtij sistemi. Problematika e zhvillimit ekonomik shqyrtohet në të gjitha nivelet si në nivelin global ,në atë kombëtarë dhe në nivelin lokal. Nisur nga premisa e kompleksitetit, teoria ekonomike tenton të gjejë formën apo modelin më të përshtatshëm të zhvillimit të një vendi dhe më gjerë. Kështu, në këtë sens, Tood Buchholz nënvizon se zgjedhja është objekt i studimit të teorisë ekonomike, ajo nuk të mëson se çfarë duhet të zgjedhësh por thjeshtë na ndihmon të kuptojmë pasojat e zgjedhjeve tona. “Në nuk jemi më Eden. Bota nuk rrjedh prej qumështi dhe mjalti. Na duhet të zgjedhim midis ajrit më të pastër dhe makinave më të shpejta, shtëpive më të mëdha dhe parqeve më të mëdha, më shumë punë dhe më shumë pushime. Kjo na tregon se ne, nuk mund t’i kemi të gjitha në të njëjtën kohë” (Buchholz, 2007, 25). Natyra komplekse e zhvillimit ekonomik buron nga vet numri i madh i faktorëve që ndikojnë në këtë proces, dhe kjo e bën këtë proces me interes për të gjithë njerëzit të cilët kanë përgjegjësi të caktuara shoqërore. Gjatë gjithë historisë së zhvillimit, kanë lindur dhe janë aplikuar teori dhe praktika të ndryshme, në interes të një zhvillimi më të mirë dhe më të qëndrueshëm ekonomik.

Kështu, autorët e ndryshëm zhvillimin ekonomik e kanë përkufizuar si një proces i cili përcillet me një varg veprimesh duke shfrytëzuar burimet e ndryshme për të siguruar mjetet për jetesë më të mirë.

“Nocioni i zhvillimit mund të përkufizohet thjesht si një përmirësim gradual ose rritje nëpërmjet një seri të ndryshimeve progresive në të gjitha nivelet, e ndikuar kryesisht nga rezultatet e shkallës së zhvillimit të vendit. Prandaj, zhvillimi është një realitet fizik, gjendje e mendjes në të cilën është shoqëria, një proces ekonomik dhe institucional, për të siguruar mjetet për të arritur një jetë më të mirë (Todaro&Smith, 2006, 21).”

Nisur nga këto që thanë dhe nga veprimi i shumë faktorëve në këtë proces, zhvillimin e mendimit ekonomik e ka përcjellë tendenca për ndërtimin e teorisë dhe gjetjen e modelit

më të mirë dhe suksesshëm të zhvillimit. Dilemat e teorisë ekonomike rreth rolit të shtetit në procesin e zhvillimit ekonomik kanë qenë pjesë e tërë historikut të zhvillimit të mendimit ekonomik, kështu janë ndërtuar teoritë dhe praktikat e zhvillimit. Teoria klasike është baza e teorisë së veprimit të lirë të tregut e cila ka qenë bazë të gjitha shkollave të më vonshme që kanë avancuar premisat e kësaj teorie.

Gjysma e dytë të shekullit njëzetë dhe fillimi i shekullit njëzet e një, janë karakterizuar me dinamikë të shpejtë të ndryshimeve, aplikimi i teknologjisë moderne, shpejtësia e qarkullimit të informatave, ideve anekënd globit, e ka sjellë teorinë dhe praktikën ekonomike para një sfide të re. Ky proces i ndryshimeve të mëdha që quhet globalizim, ka shtyrë që shumë autor, studiues dhe ekspertë të profileve të ndryshme të merren me analizën e efekteve që ka shkaktuar në botë dhe ka ngjallur nevojën e përshtatjes së veprimeve tona karshi këtyre ndryshimeve.

Lidhur me efektin e globalizimit në zhvillimin e tërësishëm të globit do të shërbehemi me mendimin e disa autorëve ; Kështu Robert Zoellick, president, i Bankës Botërore globalizimin e përshkruan si :

“Globalizimi ofron mundësi të pabesueshme. Por akoma përjashtimi, bluan varfërinë, dhe dëmtimi i mjedisit krijojnë rreziqe. Ata që vuajnë më shumë janë ata që kanë më pak për të filluar popujt me-indigjene, gratë në vendet në zhvillim, të varfëritë rural, afrikanët, dhe fëmijët e tyre”(Todaro & Smith, 2012, 28).

Ndërsa Adrian Civici në librin mbi globalizimin shkruan: “Globalizimi, i parë në tërësinë tij nënkupton zhvillimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet njerëzve, ideve dhe informacionit, aktiviteteve ekonomiko-financiare e tregtare, atyre politike e kulturore në shkallë planetare”(Civici, 2009, 13).

Efektet e globalizmit kanë sjell në dyshim mjaftueshmërinë e veprimit të tregut në rregullimin e të gjitha rrjedhave të zhvillimit ekonomik, krejt kjo ka mobilizuar mendjen shkencore dhe veprimin praktik të gjejë formë të organizimit për t’ju përshtatur rrjedhës së proceseve zhvillimore.

Kështu roli dhe veprimi i qeverive kombëtare dhe i organizmave të tjerë është i domosdoshëm, në krijimin e politikave dhe strukturave që do të punojnë në shfrytëzimin e këtij trendi drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Përderisa roli i qeverive nacionale në procesin e zhvillimit është studiuar nga shume autorë, ekonomistë dhe shkencëtarë të fushave të ndryshme, roli i qeverive lokale në këtë proces është studiuar

më pakë, sepse ky rolë është i lidhur ngushtë me procesin e demokratizimit dhe decentralizimin e përgjegjësive nga niveli qendror tek ai vendor.

Zhvillimi ekonomik lokal është një koncept i cili ka filluar të aplikohet në vende të ndryshme të botës, kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit njëzet. Zhvillimi ekonomik lokal nuk ka pasur një aplikim dhe zhvillim të njëjtë nëpër vende të ndryshme, kështu disa vende kanë një progres më të madh në aplikimin e këtij procesi ndërsa disa të tjera çalojnë, krejt kjo është si pasojë e vetë proceseve zhvillimore nëpër të cilat kalojnë vendet e ndryshme.

Procesi i ZHEL-it është kompleksë dhe kërkon një qasje të disa partnerëve lokal, në këtë drejtim roli udhëheqës i takon pushtetit lokal i cili duhet të mobilizojë të gjitha potencialet për të krijuar kushte më të mira për jetë për komunitetin e tij.

Vetë nocioni i ZHEL-it, prezanton kompleksitetin e qasjes në realizimin e qëllimit dhe shumë dimenzionalitetin e veprimeve, përfshirjen e formave të veprimit në realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky punim ka për qëllim që ta paraqes procesin e ZHEL-it në Kosovë me theks të veçantë në komunën e Rahovecit. Në punim do të prezantohen të arriturat në aplikimin e konceptit të ZHEL-it duke e analizuar, infrastrukturën ligjore, institucionale, kapacitetet profesionale si dhe format konkrete të implementimit.

Komuna e Rahovecit do të jetë fokusi i hulumtimit, duke analizuar kapacitetet aktuale, format e organizimit dhe politikat dhe mekanizmat e aplikuar në procesin e ZHEL-it. Analiza e situatës në aplikimin e konceptit të ZHEL-it në komunën e Rahovecit dhe në nivel të Kosovës do të bëhet në krahasim me praktikën e aplikuar nga vendet e zhvilluara dhe në përputhje me udhëzimet e hartuara nga institucionet kredibile ndërkombëtare.

Në fund do të nxjerrim konkluzionet dhe do të jepen rekomandime të cilat besoj se do të jenë në shërbim të politikë bërësve lokal dhe qendror si dhe do të jenë në funksion të plotësimit të teorisë për konceptin e ZHEL-it.

1.1 Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor, i këtij punim doktoral, është i drejtuar në ofrimin e një modeli, respektivisht të një kornize të veprimit të qeverisë lokale dhe partnerëve të tjerë, në dobi të zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë në hapjen e vendeve të punës, në hapjen e bizneseve të reja dhe në qëndrueshmërinë e atyre ekzistuese në komunën e Rahovecit.

Paraprakisht, përgjatë këtij studimi do të analizohet forma aktuale e organizimit lokal në fushën e zhvillimit ekonomik, duke vlerësuar kapacitetet organizative, profesionale të qeverisë komunale në këtë fushë.

Modeli i propozuar, paraqet një kontribut teorik dhe praktik për procesin e zhvillimit ekonomik lokal, ndërsa në kuptim më të gjerë një kontribut në njohjen më të mirë të faktorëve që përcaktojnë zhvillimin ekonomik lokal, rolin dhe rëndësinë e partnerëve në këtë proces.

Qëllimi teorik-shkencor, i studimit është arritur përmes përshkrimit dhe shpjegimit shkencor të objektit të hulumtimit. Shpjegimi shkencor është përdorur për ta përshkruar problemin e kategorive, respektivisht të faktorëve të kërkimit si dhe, të kategorive të veçanta të përfshira në studim. Në këtë mënyrë është krijuar pasqyra për problematikën e zhvillimit ekonomik lokal, në vendet e ndryshme të botës si dhe në Kosovë, duke përdorur të arriturat hulumtuese dhe konceptet teorike në këtë fushë.

Për aplikimin e suksesshëm të konceptit të ZHEL-it, është e nevojshme analiza e kapaciteteve institucionale në nivelin lokal, përcaktimi i rolit udhëheqës të njërit nga partnerët lokal, që në rastin konkret, është qeveria lokale. Roli udhëheqës është me rëndësi për shkak të ndikimit që qeveria lokale ka në zhvillimin ekonomik dhe të mekanizmave me të cilët disponon për mbështetjen sektorit privatë. Nga rezultatet e analizës së procesit të zhvillimit ekonomik dhe nga njohuritë shkencore të autorëve të ndryshëm, propozohet modeli i cili përfshinë mënyrën e organizimit të faktorëve përgjegjës në realizimin e qëllimit të ZHEL-it. Modeli i propozuar do të shërbejë si bazë për aplikim përgjatë procesit të zhvillimit ekonomik lokal, nga partnerët lokal nëpër komunat e Kosovës, në veçanti në komunën e Rahovecit.

Qëllimet praktike, studimi para së gjithash i drejtohet shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë të këtij hulumtimi, respektivisht qeverive lokale në Kosovë, e në veçanti komunës së Rahovecit. Hulumtimi i bërë do ju shërbej vendimmarrësve në nivelin lokal dhe atë nacional, përgjatë krijimit dhe implementimit të politikave zhvillimore, e sidomos do të shfrytëzohen për krijimin e mjedisit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Ky hulumtim ka pasur për qëllim të vlerësoj rolin dhe rëndësinë që kanë të gjithë partnerët në zhvillimin ekonomik, të definoj rolin udhëheqës që, qeveritë lokale dhe nacionale kanë në krijimin e mundësive më të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Studimi

përmes hulumtimeve konkrete do të argumentoj përparësitë që ia sjellë zhvillimit ekonomik, veprimi i koordinuar dhe i përbashkët i të gjithë partnerëve lokal dhe më gjerë. Ky studim do të vlerësoj qasjen e qeverisë lokale dhe të partnerëve të tjerë lokal në procesin zhvillimor dhe format e aplikuara, duke nxjerrë konkluzione dhe duke bërë rekomandime për përmirësimet dhe ndryshimet e nevojshme, që duhet bërë në këtë segment.

1.2 Identifikimi i problemit

Zhvillimi ekonomik lokal është një mundësi e mirë për realizimin e rritjes së të ardhurave, punësimit dhe të mirëqenies socio-ekonomike për komunitetin lokal.

Përkundër rëndësisë dhe mundësive që ofron ky proces, ky koncept zhvillimor ka një aplikim relativisht të ri, edhe teoria ekonomike me vonesë ka filluar ta trajtojë këtë fenomen nga aspekti mendimit shkencor ekonomik.

Problematika e rritjes së ngadalshme ekonomike, të ardhurave të pamjaftueshme, nivelit të lartë të papunësisë, janë probleme që e përcjellin çdo komunë të Republikës së Kosovës përfshirë edhe Komunën e Rahovecit.

Përmes këtij studimi do të mundohem të ndikojë në rritjen e njohurive të udhëheqësve lokal, përmes argumenteve teorike dhe praktike për mundësitë që ofron aplikim i konceptit të ZHEL-i në ngritjen e shkallës së zhvillimit dhe krijimin e mundësive për punësim dhe mirëqenie socio ekonomike.

Niveli i decentralizimit, përgjegjësit në fushat e qeverisjes lokal, kërkesat e komunitetit, potencialet ekzistuese në sektorin privat dhe në sektorin e jo-profitabil, janë mundësi e mirë që duhet të shfrytëzohen në procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

Vetë koncepti i ZHEL-it, kërkon një bashkëveprim të partnerëve lokal në arritjen e objektivave zhvillimore; “Zhvillimi ekonomik lokal është i ndikuar ndoshta nga të gjitha aktivitetet e qeverisjes vendore. Megjithatë, politika e zhvillimit ekonomik lokal është përcaktuar zakonisht më ngushtësisht si aktivitete të veçanta, të ndërmarra nga grupe publike ose private, për të nxitur zhvillimin ekonomik.” (Bartik, 2003, 2).

Në përgjithësi përkundër mundësive që kanë pushtetet lokale përfshirë edhe komunën e Rahoveci, ato përballën me sfidat të cilat po e përcjellin zhvillimin e ekonomik lokal, ndër sfidat më të theksuara janë; mungesa e kapaciteteve profesionale, njohuritë e pa

mjaftueshme mbi konceptin ZHEL-in dhe mungesa e qasjes së përbashkët me partnerët e tjerë lokal.

Gjatë punës hulumtuese, do t'i identifikojmë, mangësitë, pengesat dhe mundësitë që përcjellin qeverisjen lokale, posaçërisht komunën e Rahovecit në procesin e ZHEL-it, krejt kjo do të bëhet me qëllim të ofrimit të një modeli të organizimi dhe veprimit në këtë fushë.

Punimi do të ofrojë argumente dhe përvoja nga autorë dhe vende të ndryshme, përvojat të cilat i janë aplikuar në proceset e zhvillimit ekonomik lokal nga qeveritë lokale dhe të njëjtat kanë rezultuar të suksesshme.

Pyetjet kërkimore të ngritura janë:

1. Korniza ligjore dhe institucionale aktuale në Kosovë dhe Rahovec, a i mundëson mjaftueshëm qeverisë lokale të mbështet zhvillimin ekonomik lokal-bizneset lokale?
2. Sa ka ndikuar përdorimi i “Mini Parku i Biznesit” dhe mekanizmave të tjerë në rritjen e të hyrave buxhetore dhe në punësim?
3. A disponon komuna me kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe organizative për aplikim të suksesshëm të ZHEL-it.

1.3 Hipoteza kryesore dhe hipotezat ndihmëse

Hipoteza kryesore e cila do të testohet përmes këtij hulumtimi është:

Korniza ligjore dhe institucionale e përshtatshme, veprimi i përbashkët i partnerëve lokal, nën udhëheqjen e qeveris lokale përmes politikave lokale zhvillimore, mekanizmave në dispozicion, ndihmon zhvillimin ekonomik, përmes hapjes së vendeve të punës, rritjes së të hyrave fiskale etj.

Sqarimi i Hipotezës

Ka disa faktorë që ndikojnë në suksesin e zhvillimit ekonomik lokal. Veçanërisht duhet të shqyrtohen ata faktorë, që kanë ndikim dhe të cilët janë nën autoritetin e pushtetit vendor. Duhet të theksohet se, jo të gjithë faktorët të cilët ndikojnë në procesin e zhvillimit ekonomik, janë në përgjegjësinë e qeverisë lokale dhe partnerëve lokal. Prandaj, objekt i studimit është roli i atyre faktorëve të cilët janë në mundësinë e ndikimi nga veprimet e komunës dhe partnerëve tjerë lokal. Gjatë analizës të secilit faktor ndikues, ne vlerësojmë rolin e secilit faktor veç e veç dhe të gjithëve së bashku, në zhvillimi ekonomik lokal.

Korniza ligjore dhe institucionale - ky faktor përmbledhë rregullativën ligjore nisur nga akti më i lartë Kushtetuta e deri tek rregulloret lokale që në një formë apo tjetër përcaktojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e autoriteteve lokale në procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

Korniza institucionale; nënkupton strukturat institucionale, të cilat janë të kualifikuara dhe përgjegjëse për të vepruar në drejtim të krijimit dhe implementimit të politikave lokale zhvillimore.

Ky faktor është përcaktues në rolin e qeverisë lokale në procesin e ZHEL-it, krijon mundësitë, përcakton përgjegjësitë dhe mundëson krijimin dhe aplikimin e mekanizmave të ndryshëm, në funksion të zhvillimit ekonomik, respektivisht, në forcimin e sektorit privat.

Partnerët lokal - janë qeveria lokale me sektorin publik, sektori privat dhe sektori civil/ jo përfitues, shkalla e organizmit, e bashkëpunimit dhe e koordinimit të këtyre partnerëve në procesin e krijimit të strategjive zhvillimore, përzgjedhjes së programeve dhe projekteve të zhvillimit ekonomik, do të jetë me shumë rëndësi në suksesin e procesit zhvillimor.

Spektori publik - nënkupton qeverinë lokale (qeverinë qendrore), arsimin publik, ndërmarrjet publike lokale dhe të gjitha agjencitë, zyrat që janë nën përgjegjësinë e autoriteteve publike.

Spektori privat - përfshin komunitetin e biznesit, bizneset ekzistuese, bizneset e reja, investitorët potencial etj.

Spektori civil/jo përfitues - përfshinë shoqërinë civile, asociacionet dhe shoqatat profesionale të cilat veprojnë në komunitetin lokal.

Teoria dhe praktika e deritanishme, nëpër shumë vende, ka dëshmuar se angazhimi i përbashkët i të gjithë partnerëve lokal në procesin e krijimit të dokumenteve strategjike zhvillimore, në përzgjedhjen e programeve dhe në përcaktimin e formave të mbështetjes, ka sjellë rezultate pozitive në suksesin e zhvillimit ekonomik, si në rritjen e punësimit, tërheqjen e investime të reja, mbajtjen dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

Hipotezat ndihmëse:

Hipoteza 1: Aplikimi “Mini Parku i Biznesit/Industrial” dhe mekanizmave të tjerë nga ana e pushtetit lokal në mbështetje të bizneseve, do të ndikoj, në hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të hyrave fiskale etj.

Hipoteza 2: Veprimi i përbashkët i partnerëve lokal, në krijimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore, përmes programeve të ndryshme promovuese, ndihmon zhvillimin ekonomik lokal.

Institucionet e sektorit publik ndikojnë dukshëm në zhvillimin ekonomik lokal, sepse ato janë përgjegjëse për formulimin e strategjive dhe politikave për zhvillim ekonomik lokal. Është me rëndësi që në procesin e hartimit të strategjive dhe politikave për zhvillim ekonomik lokal të kyçet edhe sektori civil dhe sektori privat.

Komuniteti lokal ka një numër të shoqatave të cilat janë të përqendruar kryesisht në aktivitetet, sportive, kulturo artistike, të gruas dhe bizneseve, aktivitete të cilat kanë një ndikim dhe mund të kontribuojnë në zhvillimin e ardhshëm.

Kjo do të rezultojë me një vlerësim më të mirë të mundësive të zhvillimit të qëndrueshëm lokal, të sektorëve të ndryshëm të cilët do të krijojnë rritje të mirëqenies ekonomiko-sociale të komunitetit lokal.

1.4 Rëndësia e studimit

Ky hulumtim do të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes dhe informimit të institucioneve të qeverisë lokale dhe të partnerëve tjerë, për rolin që këta kanë në zhvillimin ekonomik lokal. Punimi jep udhëzime për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimin më efikas i të gjithë partnerëve të zhvillimit ekonomik lokal. Prandaj, si i tillë punimi ka kontribut aplikativ. Mund të përdoret nga çdo njësi e qeverisjes vendore, sidomos në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Ky hulumtim do t'iu shërbejë institucioneve shtetërore, politikë bërësve, sektorit privat, donatorëve dhe agjencive zhvillimore, si një udhëzues përkitazi me potencialet ekzistuese dhe mundësitë që kanë qeveritë lokale për zhvillim ekonomik.

Rezultatet e këtij studimi, duke përfshirë rekomandimet do t'i dorëzohen, së pari komunës së Rahovecit, institucioneve përgjegjëse dhe, do të publikohet në revista shkencore vendore dhe në ato ndërkombëtare, për të tërhequr vëmendjen dhe ngritur vetëdijen për potencialin dhe mundësitë ekzistuese. Përveç kësaj, ky studim do të nxjerr konkluzione dhe do jep rekomandime që ndihmojnë politikë bërësit, me qëllim të përfshirjes së sektorit privat dhe shoqërisë civile në hartimin dhe implementimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal dhe për strategjitë sektoriale.

Hulumtimi do të ketë rëndësi të veçantë si shkencore ashtu edhe ekonomike për nivelin lokal dhe nacional, meqë hulumtime të natyrës së tillë në Kosovë janë kryer shumë pakë,

andaj ky punim studimor do të ketë një rëndësi shkencore në kontekst të procesit zhvillimor në Republikën e Kosovës. Hulumtimi i zhvillimit ekonomik lokal është mjaft i kërkuar në këtë kohë, jo vetëm në Kosovë por në të gjitha vendet, veçanërisht në ato me zhvillim të ulët, studimi do të jetë më shumë se i mirëseardhur për komunat e Kosovës dhe qeverinë qendrore.

Nga përvoja që unë kam në qeverisjen lokale, mendoj se hulumtimet shkencore në këtë fushë do të më ndihmojnë të nxjerrë përfundime që do t'i shërbejnë Komunave të Kosovës dhe partnerëve tjerë në hartimin, implementimin dhe vlerësimin e programeve që do të kontribuonin në rritjen, ekonomike, të punësimit dhe të mirëqenies për komunitetin lokal.

Rëndësia është edhe më e madhe kur dihet se Kosova gjithashtu edhe komunat po përballën me presionin e madh të papunësisë, të ardhurave të ulta dhe mungesës së investimeve të qëndrueshme në zhvillimin ekonomik/në fushën e bizneseve të qëndrueshme.

1.5 Struktura e punimit doktoral

Punimi doktoral është i punuar sipas formës standarde të hulumtimeve shkencore. Studimi është punuar në tetë kapituj, duke filluar me pjesën e hyrjes së punimit, pjesën e shqyrtimit të literaturës, historikun e zhvillimit në Kosovë, rastin studimor komuna e Rahovecit, shqyrtimin e modeleve të aplikuara dhe në fund, nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimet.

Kapitulli i parë, është hyrje e punimit i cili përmban, një përshkrim të problematikës, qëllimin e studimit, hipotezat dhe pyetjet kërkimore, metodologjinë e aplikuar përgjatë hulumtimit dhe rëndësinë e punimit.

Në kapitullin e dytë është sqaruar metodologjia e përdorur në punimin doktoral, duke paraqitur burimet e shfrytëzuara dhe metodat që janë aplikuar për testimin e hipotezave, vërtetimin teorisë ekzistuese mbi ZHEL-in.

Shqyrtimi i literaturës Kapitulli i tretë, fillon me studimet e kryera nga autorë dhe institucione të ndryshme lidhur me konceptin e zhvillimit ekonomik lokal-ZHEL-it, historikun e paraqitjes dhe fazat e zhvillimit të këtij koncepti, partnerët e përfshirë në këtë proces, instrumentet e ZHEL-it qëllimi dhe përfitimet nga ky proces, të paraqitura nga autorë dhe institucione të ndryshme kredibile ndërkombëtare.

Kapitulli i katërt përmban një historik të shkurtër të zhvillimit të Kosovës, ekonomisë së saj, të dhënat për zhvillimet e para luftës, zhvillimin ekonomik të pas luftës dhe kornizën ligjore në përgjithësi, por me një vështrim të veçantë në zhvillimin e kornizës ligjore për qeverisjen lokale dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Kapitulli pestë trajton rastin studimor - komunën e Rahovecit, duke filluar me profilin e komunës, duke vazhduar paraqitjen e zhvillimit të përgjithshëm në komunë, në sektorin ekonomik, sektorin civil, sektorin publik, zhvillimin e dokumenteve strategjike, të dhënat lidhur me të arriturat në fushat e ndryshme të zhvillimit të gjithmbarshëm. Ky kapitull prezanton edhe kornizën organizative të komunës, format e bashkëpunimit në mes të sektorëve dhe vlerësimin e kapaciteteve të sektorëve komunal.

Kapitulli i gjashtë përfshinë hulumtimin dhe analizën e bërë në komunën e Rahovecit, përmes metodës së intervistimit dhe anketimit. Intervistimi ka përfshirë të tre partnerët lokal, sektorin publik, sektorin privat dhe sektorin civil, ndërsa anketimi me pyetësorë është bërë me komunitetin lokal.

Kapitulli i shtatë, përfshinë përshkrimin vlerësimin e ndikimit të mekanizmit/programit “Mina parku të biznesit” në zhvillimin ekonomik lokal, respektivisht në rritjen e të ardhurave dhe punësimit në komunën e Rahovecit.

Kapitulli i tetë, përfshinë përshkrimin e modeleve të organizimit të pushtetit lokal në fushën e ZHEL-it të aplikuar nëpër disa vende, modeli/mënyra e organizimit të ZHEL-it në Kosovë dhe komunën e Rahovecit dhe modeli i propozuar për aplikim në të ardhmen në Kosovë dhe në komunën e Rahovecit.

Kapitulli i nëntë dhe i fundit, përmbledh përfundimet e hulumtimit, përgjigjet në pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura, vlerësimet për sektorin ekonomik, civil, modelin e aplikuar nga komuna dhe situatën me dokumentet zhvillimore. Në këtë kapitull janë dhënë edhe rekomandimet për përmirësimet e nevojshme, që do të duhej të bëhen për të pasur një aplikim të konceptit të ZHEL-it në mënyrë më efikase dhe gjithëpërfshirëse.

Kapitulli II: Metodologjia dhe Metodat e kërkimit

2.1 Qasja metodologjike në objektin hulumtim

Metodologjia si shkencë ndihmon të gjitha shkencat në fushën e hulumtimit. Metodologjia studion tërësinë e metodave, veprimeve, teknikave për hulumtimin e zhvillimeve, proceseve nëpër të cilat kalojnë fenomenet e ndryshme natyrore, shoqërore dhe teknike me një fjalë ndihmon në krijimin e njohurive të reja shkencore.

Autorët Ratko dhe Saša Zelenika, në punimin shkencor lidhur me metodologjinë theksojnë: “Në një kuptim më të gjerë, metodologjia është shkencë mbi tërësinë e të gjitha formave dhe procedurave me të cilat hulumtimi çon në njohuri sistematike dhe objektive shkencore apo disiplinë shkencore, në të cilën ekzaminohen në mënyrë kritike dhe në mënyrë eksplicite ekspozohen metodat e ndryshme, të përgjithshme dhe të veçanta shkencore, quhet metodologji, respektivisht, metodologjia është shkencë mbi metodat të cilat zbatohen në kërkimet shkencore, para ekspozimit të rezultateve të hulumtimeve të tilla (R&S.Zelenik, 2007,11).

Për realizimin e punimit janë përdorur si burimet parësorë ashtu edhe burimet dytësorë. Burimet parësorë konsistojnë në informacionet e marra nga institucionet e ndryshme publike në nivelin lokal, në nivelin qendror si nga qeveria dhe ministrit e ndryshme dhe nga botimet e ndryshme statistikore të leshura nga institucionet përgjegjëse, si dhe nga bisedat apo intervistat e ndryshme. Do të më duhet të theksoj vështirësinë shumë të madhe për sigurimin e burimeve parësorë si raportet për vlerësim, pastaj sigurimin e të dhënave për treguesit makro ekonomik në veçanti të treguesit për komunat.

Pjesa më e madhe e informacionit është marr nga burimet dytësorë, që përfshin literaturën dhe materiale të tjera të përpunuara, analizuar dhe përdorur nga studiues të tjerë. Materialet dytësorë janë trajtuar në mënyra kritike, duke synuar që përvojat e vendeve të tjera në fushën e ZHEL-it të krahasohen apo t’iu përshtaten situatave aktuale të mjedisit lokal Kosovar. Tek burimet dytësorë të informacionit do të përfshinim edhe informacionin e marr nga botimet apo konferencat e ndryshme të organizuara nga institucionet e ndryshme kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Në këtë grup të burimeve përfshihen edhe materialet e botuara nga organizatat e ndryshme mbi të arritura dhe sfidat e Kosovës në procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

Për trajtimin e çështjeve të veçanta respektivisht për vërtetimin e hipotezave të ngritura janë përdorur metoda të ndryshe të cilat më së miri kanë mundësuar grumbullimi dhe përpunimin e informatave të kërkuara.

2.2 Metodat e aplikuar përgjatë punimit

Metoda është mënyra e një veprimi të planifikuar dhe aplikuar për të arritur deri tek njohurit e kërkuara për një çështje të caktuar. Autori Milat Josip, metodën e kërkimit e definon si "rrugë, mënyrë e planifikuar e procesit (dhe e të menduarit) me të cilën shërbehemi për të arritur në njohje, për të zbuluar ose paraqitur të vërtetën" (Milat, 2005, 27).

Përgjatë hulumtimit shkencor janë aplikuar metodat që kryesisht përdoren në shkencat shoqërore, si metodat kualitative dhe kuantitative:

Qasja deduktive dhe induktive, është nisur nga teoritë ekzistuese mbi zhvillimin ekonomik lokal dhe rolin e qeverisë lokale të ndërtuar nga autorë të ndryshëm për ta vlerësuar, situatën në Kosova dhe komunën Rahovecit. Hulumtimi është bërë edhe në faktorët e veçantë të zhvillimit për ta vërtetuar se koncepti mbi ZHEL-in është një mundësi e mirë për ta fuqizuar zhvillimin ekonomik.

Intervista e strukturuar, është përdorur për ta testuar hipotezën kryesore, respektivisht për të grumbulluar informatat lidhur me disa prej variblave që e determinojnë ZHEL-in. Kjo metoda është aplikuar në testimin e tre partnerëve lokal, duke marrë opinionin e tyre për: kornizën ligjore, institucionale, mekanizmat e aplikuar në mbështetje të sektorit privat, bashkëpunimin e partnerëve kyç në procesin e ZHEL-it etj. Përzgjedhja e kampionit të përfshirë në intervistim është bërë sipas metodës "Përzgjedhje e qëllimshme".

Kampionimi i qëllimshëm - Kampionimi i qëllimshëm njihet edhe si marrje e mostrave të qëllimshme ose jo-probabilitetit. Kjo metodë e marrjes së mostrave përfshin përzgjedhjen qëllimore ose të qëllimshme të njësive të veçanta të universit për të krijuar një mostër që përfaqëson universin. Nga ana tjetër, në kampionin e gjykit, gjykimi i hulumtuesit përdoret për zgjedhjen e sendeve që ai e konsideron si përfaqësues të popullacionit, (Kothari, 2004, 15).

Metoda e anketimit përmes pyetësorëve, është aplikuar për të grumbulluar informata nga komuniteti lokal lidhur me bashkëpunimin e komunës me këtë komunitet, pastaj për

orientimet zhvillimore dhe qasjen e përbashkët në procesin e zhvillimit lokal. Përzgjedhja e kampionit të përfshirë në anketim është bërë sipas metodës “Përzgjedhja e rastit”.

Kampionimi i rastësishëm i thjeshtë - Ky lloj i marrjes së mostrave njihet edhe si mostrimi i rastit ose mostrimi i probabilitetit ku secili dhe çdo artikull i popullsisë ka një shans të barabartë të përfshirjes në mostër dhe secili prej mostrave të mundshme, në rast të universit të fundmë, ka të njëjtën probabilitet për t'u zgjedhur (Kothari, 2004, 15).

Modeli/Formati i Intervistave dhe pyetësorëve që janë aplikuar për ta marrë opinionin e respondenteve janë marrë nga autori (Josip Bošnjak, 2012). Pyetësorët dhe intervistat janë përshtatur natyrës së punimit.

Metoda krahasuese/komperative, është përdorur përgjatë ndërtimit të modelit të organizimit institucional të propozuar për komunën e Rahovecit dhe komunat e tjera të Kosovës. Modeli është ndërtuar duke studiuar fillimisht modelet e disa vendeve dhe duke bërë krahasimin me modelin ekzistues në Kosovë.

Metoda e analizës sintezës, është aplikuar në vlerësimin e kornizës ligjore dhe përshtatja e saj me nevojat zhvillimore.

Metoda e analizës statistikore, është përdorur në testimin e hipotezës ndihmese, respektivisht në vlerësimin ndikimit të mekanizmave lokal konkretisht në ndikimin e “parkut të biznesit/industrial” në rritjen e të hyrave fiskale dhe në punësim.

Në mënyrë të veçantë, janë përshkruar dhe shpjeguar rastet të veçanta, marrëdhënie të vendosura në mes tyre dhe marrëdhëniet shkakësore në kuadër të çështjes, dhe pastaj janë nxjerrë konkluzione të përgjithshme. Duke vepruar kështu, për shkak të një karakter plotësuese të kombinimit të metodave sasiore dhe cilësore, për ta verifikuar hipotezat.

2.3 Mundësit dhe kufizimet

Kufizimet në realizimin e këtij studimi lidhen kryesisht me mungesën e studimeve specifike të fushës, në veçanti në nivel të vendit. Për shkak të problemeve të tranzicionit me të cilat është përball Kosova dhe procesit të veçantë të zhvillimit në dekadat e fundit procesi zhvillimit ekonomik lokal është përcjell me mjaft pengesa, rrjedhimisht edhe me mungesë të studimeve të mirëfillta nga autorë të ndryshëm vendor.

Një kufizim tjetër lidhet edhe me mungesën e të dhënave të përpunuara lidhur me treguesit ekonomik, siç janë numri i saktë i të punësuarve, bizneseve aktive sipas veprimtarisë dhe tipit të organizimit, në veçanti mungesa e GDP-së për nivelin lokal, këto

kufizime kanë sjellë pengesa përgjatë hulumtimit të ecurive zhvillimore dhe krahasimit në përudha kohore.

Mangësitë në fushat e cekura më lart kana vështirësuar aplikimin e metodave shkencore për të pasur një hulumtim më gjithëpërfshirës, duke vlerësuar veç e veç secilën variabël që është pjesë e procesit të ZHEL-it në Kosova dhe në komuna e Rahovecit.

Një tjetër mangësi është edhe mungesa e matjes së performances, respektivisht mungesa e raporteve vlerësuese për politikën e aplikuar në mbështetje të sektorit privat, si në nivelin lokal ashtu edhe në at kombëtar, kjo ka vështirësuar matjen e efektit të politikave thanë ndryshe matjen e vlerësimit të ndikimit.

Përkundër këtyre kufizimeve të cekura më lartë, studimet e bëra nga autorë të ndryshëm në vendet e ndryshme të botes ka mundësuar që përgjatë hulumtimit të krijohet një pasqyrë e mirëfilltë lidhur me procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

Një mundësi shtesë janë studimet e bëra nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare si: Banka Botërore, Institutet të ndryshme hulumtuese, Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim, Bankat e ndryshme rajonale, kanë qenë me mjaft të rëndësi në njohjen me praktikën e vendeve të ndryshme në aplikimin e konceptit të ZHEL-it.

Edhe në nivelin e vendit, një mundësi të mirë për të bërë një hulumtim të mirëfilltë kanë shërbyer, dokumentet hulumtuese dhe udhëzuese të bëra nga disa prej organizatave ndërkombëtare si USAID, OSCE, UNDP, në pasqyrimin e gjendjes në zhvillimin e Kosovës dhe komunave të saj si dhe në hartimin e strategjive për zhvillimin e ardhshëm. Agjensioni i statistikave të Kosovës, Administrata tatimore e Kosovës, janë dy prej institucioneve që kanë ofruar mundësi për furnizimin me informatat e domosdoshme për analizë të procesit zhvillimor si për rastin konkret komunën e Rahovecit ashtu edhe për nivelin më të gjerë.

Në këtë punim janë shfrytëzuar edhe dokumentet strategjike dhe raportet e punuara nga ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në veçanti ato të Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal që asht përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e komunave në procesin e tyre zhvillimor.

KAPITULLI III: Shqyrtimi i literaturës

3.1 Konceptet bazë (Teoritë mbi Zhvillimin ekonomik lokal);

Zhvillimi ekonomik i një vendi apo regjioni, tanimë nuk është preokupim vetëm i njerëzve që merren drejtpërdrejtë me fushën ekonomike, pra i ekonomistëve, financierëve, bankierëve, menaxherëve por është një preokupim i një shtrese të gjerë të njerëzve si, politikanëve, ambientalistëve dhe njerëzve të niveleve dhe profileve të ndryshme.

Dinamika e zhvillimit, procesi i globalizimit, niveli i lartë i aplikimit të teknologjisë informative, mobiliteti i lartë i kapitalit njerëzor, kapitalit financiar, qarkullimi i mallrave dhe ideve, gërshetimi i kulturave dhe zakoneve të popujve nga i gjithë globi, kanë bërë që perspektiva dhe rreziqet e zhvillimit të jenë preokupim i një shtrese të gjerë.

Ne këtë sens, roli i institucioneve në të gjitha nivelet në kanalizimin dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik është bërë shumë i rëndësishëm. Pushteti lokal si hallka bazë e qeverisjes së një vendi ka një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim, përmes krijimit të kushteve të nevojshme për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Rolin në rritje të pushtetit në zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm e shohin edhe autorë të ndryshëm të cilët nuk janë marrë direkt me zhvillimin ekonomik lokal, për më tepër këtë e analizojnë në prizmin e trendit të globalizimit, pastaj në atë të kontekstit social dhe ekologjik, etj.

Natyra e zhvillimit ekonomik është një proces kompleks, meqë përmes këtij procesi bëhet harmonizimi ndërmjet kërkesave të pa kufizuara të njeriut në njërën anë, me burimet e kufizuar që ofron natyra në anën tjetër, pra kjo mos përputhje kërkon angazhim serioz të mendjes së njeriut për krijimin e një baraspeshe, respektivisht balansi në mesë të kërkesës dhe mundësive.

Zhvillimi ekonomik lokal është një koncept i cili përmbledhë të gjitha veprimet e partnerëve lokal, pushtetit lokal, komunitetit lokal të biznesit, grupeve të ndryshme shoqërore në drejtim të shfrytëzimit sa më të drejte dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe shoqërore ekonomike në interes të komunitetit lokal. Në këtë sens autorë të ndryshëm kanë analizuar rolin e pushtetit lokal në procesin e zhvillimit ekonomik.

Sipas shumicës së autorëve të cilët janë marrë me problemin e zhvillimit ekonomik lokal dhe rolit të pushtetit lokal në këtë çështje, është një pajtueshmëri se nuk ekziston një përkufizim i plotë dhe i pranueshëm për ZHEL-in.

Autorët e ndryshëm e kanë studiuar këtë proces në vende të ndryshme, duke hulumtuar procesin e ZHEL-it si një veprim të koordinuar në mes të partnerëve lokal të vendit dhe lokalitetit të caktuar, si një proces të cilin e përcjellin gjëra që janë të përbashkëta në të gjitha vendet, dhe si proces që bartë edhe specifikat e lokalitetit.

Në studimin e bërë nga Instituti Upjhon në Shtete e Bashkuara të Amerikës, autori Bartik, përdor këtë nocion lidhur me ZHEL-in: Zhvillimi ekonomik lokal mund të përkufizohet si rritje në "kapacitetin e ekonomisë lokale për të krijuar pasuri për banorët vendas." Rritje të tilla ndodhin në qoftë se burimet lokale, të tilla si puna dhe toka, janë përdorur më me produktivitet. Zhvillimi ekonomik mund të ndodhë përmes rritjes së vendeve të punës lokale, e cila shkakton punë të papunëve dhe të tokës që do të përdoret. Por zhvillimi ekonomik gjithashtu ndodh duke e zhvendosur punëtorin e punësuar dhe tokën për përdorim më produktivë, për shembull punë më të mira (Bartik, 2003,1).

Kurse në librin e tij mbi planifikimin e zhvillimit ekonomik, Edward J. Blakely (1994) e përcakton zhvillimin ekonomik lokal si "një proces përmes të cilit qeveria lokale dhe / ose grupet të bazuara në komunitet menaxhojnë burimet e tyre ekzistuese dhe hyjnë në marrëveshje të re partneriteti me sektorin privat, ose me njëri-tjetrin, për të krijuar vende të reja pune dhe stimuluar aktivitetin ekonomik në një definim - mirë zonës ekonomike" (Čapáková, 2005, 3).

Për Soňa Čapáková - Zhvillimi ekonomik lokal, në përgjithësi, përfaqëson një strategji të gjerë, në të cilën aktorët lokal dhe institucionet përpiqen që në mënyrë sa më të mirë t'i përdorin burimet lokale me qëllim të ruajtjes dhe për të krijuar vende të reja pune, si dhe forcimin dhe promovimin e aktiviteteve të biznesit (Čapáková, 2005, 3).

Autorët Blakely dhe Bradshaw , me elokuencë përmbledhën rëndësinë e nivelit lokal në ekonomi: " Zhvillimi ekonomik me bazë lokale dhe nxitja e punësimit ka më shumë gjasa të dëshmojnë të suksesshëm në qoftë se drejtohen në nivel lokal se sa në një nivel tjetër. Secili prej faktorëve që ndikon në ekonomi manifestohet në një mënyrë unike dhe ka pjesërisht shkaqe të ndryshme në secilin komunitet lokale. Zgjidhje për problemet lokale nuk do të jetë e suksesshme në qoftë se nuk synojnë grupe të veçanta dhe në qoftë se nuk janë të lidhura me tërë sistemin ekonomik rajonal"(Blakely&Bradshaw , 2002, 25).

Një grup autorësh nga Beogradi, Boris Begović, Zoran Vacić, Gordana Marković dhe Boško Mijatović, japin këtë definicion: Zhvillimi ekonomik lokal në kuptim të ngushtë, kuptohet si proces i planifikimit strategjik përmes partneritetit të pushtetit lokal, sektorit komercial privat dhe sektorit joqeveritar, i drejtuar në arritjen e investimeve të cilat do të sigurojnë rritje të lartë dhe afatgjate ekonomike të komunitetit lokal. Çdo strategji e zhvillimit ekonomik lokal doemos fokusohet në përparësit krahase të komunitetit lokal, në tregjet ekzistuese apo potenciale dhe në pengesat apo dobësitë e brenda komunitetit lokal, (Begović, 2006, 12).

Kurse Banka Botërore ka këtë përkufizim për ZHEL-in: Qëllimi i zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL) është për të ndërtuar kapacitetin ekonomik të një zone lokale për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë. Ky është një proces me të cilin partnerët publikë, të biznesit dhe të sektorit joqeveritar punojnë së bashku për të krijuar kushte më të mira për rritje ekonomike dhe gjenerim të punësimit, <http://web.worldbank.org/>, (marr me 25.08,2015).

Është me interes të ceket se roli i pushtetit vendor në procesin e zhvillimit ekonomik lidhet edhe me përparimin e proceseve demokratike dhe të decentralizimit. Kështu përparimi i këtyre proceseve e rrit rolin e qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendim-marrje dhe në krijimin e politikave zhvillimore.

Autorët, Francisco Alburquerque dhe Gabriel Aghón, në një artikull për zhvillimin ekonomik lokal dhe decentralizimin në Amerikën Latine shkruajnë: Përparimi i proceseve të demokratizimit dhe decentralizimit, me një rritje pasuese në funksionet e administratës publike lokale, i kanë detyruar ata që të janë përgjegjës për politikën dhe teknikat politike për të kërkuar qasje dhe propozime të përshtatshme për trajtimin e problemeve në rritje dhe kërkesat e popullsisë (Alburquerqu, 2004, 157). Ndërsa autori Vasilijević, në studimin e tij, konceptin e ZHELI-it e lidh me shfrytëzimin e përparësive krahasuese që ka mjedisi lokal. Thelbi i konceptit "lokale" në zhvillimin ekonomik është në bashkëpunimin e partnerëve në nivel lokal, si dhe përpjekjet në masën më të madhe që të jetë e mundur, të përfitojnë nga avantazhet krahasuese lokale - pozicioni gjeografik, trashëgimia kulturore dhe historike, cilësia e punës, përbërja etnike, potencialet ekzistuese ekonomike, gjendja e mjedisit jetësor, lidhjet infrastrukturore (Vasilijević, 2012, 12).

Përkufizimet që janë dhënë nga autorë të ndryshëm për zhvillimin ekonomik lokal, janë burim nga hulumtimet e bëra në vende të ndryshme, proceset e zhvillimit ekonomik lokal nëpër të gjitha vendet e studiuara kanë qenë të përcjella me situata të ngjashme por edhe me specifikat në zhvillimin e tyre.

Autori Bartik, përmes Institutit Upjohn, ka bërë hulumtim në zhvillimin ekonomik lokal në SHBA, nëpër vende-shtete të ndryshme, përkufizimi i tij ka një specifik i cili ZHEL-in e koncepton si rritje të kapaciteteve të ekonomisë lokale për të krijuar pasuri për të gjithë komunitetin lokal, ky nuk e specifikon veprimin e përbashkët të partnerëve lokal. Ndërsa Soňa Čapáková ka bërë hulumtim në vendet ish socialiste dhe hulumtimin e zhvillimit ekonomik lokal e ka fokusuar në ato vende ku ka pasur edhe probleme të tranzicionit dhe ndërtimit të sistemit të demokratik dhe ekonomisë së tregut, autorja ZHEL-in e sheh si një veprim strategjik të partnerëve lokal me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës dhe forcim të ekonomisë lokale.

Edhe banka botërore ka një përkufizim të tillë për ZHEL-in, pra si një veprim i përbashkët i partnerëve lokal publik privat dhe të shoqërisë civile në drejtim të krijimit të kushteve më të mira për jetë për komunitetin lokal.

Nga të gjitha përkufizimet e dhëna nga autorë dhe Banka Botërore mund të nxjerrim këtë përfundim: Se Zhvillimi ekonomik lokal është një proces i cili zhvillohet me ndryshime dhe ngjashmëri nga vendi në vend, është një veprim i përbashkët i partnerëve lokal, pushtetit lokal, komunitetit të biznesit dhe sektorit joqeveritar, për arritjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Pa dyshim, të gjithë autorët në hulumtimet dhe përkufizimet e tyre, rolin parësor ia japin pushtetit lokal në tërë këtë proces.

Autorët të cilët kanë bërë hulumtim në këtë fushë, i kanë prezantuar edhe të gjithë faktorët e tjerë të cilët pa dyshim se kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal, siç janë tregu, qeveria qendrore si dhe faktorët e tjerë që veprojnë pavarësisht ndikimit të partnerëve lokal.

Nga analiza e përkufizimeve të dhëna nga autorët e ndryshëm edhe pse nuk ka një përkufizim gjithëpërfshirës dhe të plotë, mund të konstatojmë se, nocionet e autorëve kanë këto elemente të përbashkëta:

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces që e rritë punësimin, rritë ekonomin lokale dhe mirëqenien ekonomike të komunitetit lokal.

ZHEL-i është një proces i cili mobilizon të gjithë partnerëve lokal në shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve lokale në interes të komunitetit lokal.

ZHEL-i është një veprim i koordinuar në mes të pushtetit lokal, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile në krijim e programeve zhvillimore ekonomike me bazë të gjerë.

3.2 Historiku i Zhvillimit Ekonomik Lokal

Zhvillimi ekonomik lokal, si çdo proces, ka një historik të paraqitjes dhe të zhvillimit. Është me interes të ceket se, koncepti i zhvillimit ekonomik lokal më herët është paraqitur si një proces praktikë, e më pastaj është bërë objekt i studimit të teorisë ekonomike. Studiuesit e ndryshëm të fushës së zhvillimit ekonomik, kanë filluar të merren me këtë problematikë, atëherë kur procesi ka kërkuar një qasje më të avancuar dhe me komplekse. Si shumë koncepte zhvillimore edhe ky i zhvillimit ekonomik lokal ka lindur dhe ka marrë karakterin e një procesi me rëndësi pas paraqitjeve të krizave dhe dështimeve që kanë pësuar kohë pas kohë mekanizmat e tregut. Kështu dështimi i tregut në periudhat e krizave ka kërkuar një qasje më komplekse dhe një involvim në proceset zhvillimore të qeverive të shteteve dhe më vonë edhe të qeverive lokale.

Është me interes të ceket se studimet dhe literatura shkencore, lidhur me implikimin e qeverive qendrore në proceset zhvillimore ka qenë e trajtuar dhe hulumtuar nga shumë autorë dhe në kohëra shumë më të hershme, kurse për rolin e pushtetit lokal në procesin e zhvillimit ekonomik e kemi një paraqitje më të vonshme, respektivisht në gjysmën e dytë të shekullit njëzet.

Në raportin final të botuar nga Bashkimi Evropian, i bërë nga një numër ekspertësh, paraqitjen e konceptit të zhvillimit ekonomik lokal e paraqet si në vijim: Zhvillimi lokal u shfaq gjatë viteve 1980 si një fenomen spontan, la pas rrjedhën e prapambetur të politikave jo efektive dhe të shtrenjta të ri-industrializimit të kryer pas krizës së naftës të viteve 1970. Ajo ka ofruar dy përgjigje për papunësinë në rritje në rajonet në gjendje të vështirë që vuajnë nga rënia e prodhimit apo industrive tradicionale, dhe premtimet e një të ardhme të re për zonat mbetur prapa, qoftë rurale apo urbane, (EU-Report, 2010, 34) . Zhvillimi ekonomik lokal ka edhe para historinë e paraqitjes, por koncepti i cili edhe sot e kësaj dite ka përdorim të gjere paraqitet nga viti 1960. Para historinë e paraqitjes së formave të ndryshme të zhvillimit lokal e hasim qysh në kohërat më të lashta. Sipas autorit Dušan,V: Me shekuj Qytetet (qytetet-shtete) kanë mobilizuar potencialet e tyre për t'i

shfrytëzuar përparësitë që i kanë pasur dhe në këtë mënyrë kanë përparuar rëndësinë tregtare të tyre, kanë përforcuar pozitën e pavarur (dominimin në rreth), respektivisht, kanë siguruar mirëqenien materiale të qytetarëve të tyre, (Vasiljević, 2012, 14).

Paraqitja dhe zhvillimi i konceptit të ri të ZHEL-it haset në etapa të ndryshme nëpër vende të ndryshme. Autorë që kanë studiuar këtë koncept kanë prezantuar këtë historik ashtu siç është zhvilluar nëpër ato vende. Kryesisht te të gjithë autorët, procesi i zhvillimit ka tri faza të zhvillimit. Procesi ZHEL-it edhe pse ka qenë vështirë të sistematizohet, megjithatë autorët të cilët janë marrë me hulumtimin e kësaj fushe, e kanë paraqitur zhvillimin e konceptit të ZHEL-it si në vijim.

Autori Bartik nga Instituti Upjohn, në studimet e tij rreth këtij koncepti, ka paraqitur zhvillimin e ZHEL-it në tri faza. Sipas këtij autori, faza e parë ka filluar në vitet e 30 të shekullit 20; Faza e dytë në vitet 70 dhe 80 kurse, Faza e tretë nga vitet e 90-ta deri më tani, (Bartik, 1993, 2, 3).

Historia moderne e programeve të zhvillimit ekonomik shtetëror dhe lokal fillon me përpjekjet e shteteve jugore, duke filluar me Misisipin, në vitin 1930, duke bërë tërheqjen e impianteve (fabrikave) degët prodhuese nga Veriu.

Gjatë viteve 1970 dhe 1980, programet e zhvillimit ekonomik lokal, janë zgjeruar me llojet e firmave dhe llojet e aktiviteteve që janë asistuar. Në vitet 1970 dhe 1980, e ashtuquajtura "vala e dytë" Programet në shënjestër për asistencë janë zgjeruar në, bizneset fillestare, bizneset e vogla, dhe bizneset ekzistuese. Koncepti i "Valës së tretë" është, qeveria në vend që drejtpërdrejt të ofrojë shërbime të zhvillimit ekonomik për bizneset e vogla dhe ekzistuese, qeveria inkurajon ofruesit e sektorit privat, në mënyrë ideale që veprojnë në një treg konkurrues, për të ofruar shërbime të tilla të zhvillimit ekonomik. Sipas qasjes në valën e tretë, qeveria ende do të jenë e përfshirë me zhvillimin ekonomik, sepse ajo do të japë disa subvencione dhe udhëzime për këta ofrues të shërbimeve të zhvillimit ekonomik private apo kuazi-privat.

Tabela 1: Programet zhvillimore të aplikuara nga qeveritë lokale dhe shtetërore në SHBA,

Një Tipologji e përbashkët e programeve të zhvillimit ekonomik lokal dhe shtetëror;	
“Vala e parë” Në shënjestër kryesisht tërheqja e impianteve (Fabrikave).	“Vala e., dytë” Në shënjestër kryesisht bizneset e vogla apo ato ekzistuese.
Marketingu zonës si lokacioni i degës impiantit; - Reklamimi i zhvillimit industrial, - Udhëtime marketingu për selinë e Korporatës. - Dhënia e informacionit në faqen e interneti për perspektivat	Programet e tregut të kapitalit; - Kryesisht financim-qeveritar i kredive apo programet kapitalit neto, - Mbështetja e qeverisë kryesisht për hua financiare nga sektori privat apo programet e kapitalit neto,
Stimulimet financiare; - Obligacionet e të hyrave industriale, - Zbritja e tatimit në pronë, - Lehtësime të tjera tatimore, - Sigurimi i tokës me çmime më poshtë-tregut, - Kredi direkte shtetërore.	Informacion / Edukimi për biznesin e vogël; - Ombudsman i biznesit të vogël / zyra për informim, - Klasat e kolegjit profesional(komunitetit) në fillimin e një biznesi, - Qendra të vogla të zhvillimit të biznesit, - Programet e trajnimit të ndërmarre sisë, - Inkubatorët e biznesit të vogël.
Stimulimet jo financiare ndaj impianteve të degëve; - Trajnimi i përshtatur industrial, - Ofrimi i përshpejtuar i infrastrukturës faqes specifike- interneti, - Ndihmë me rregullativë për problemet.	Hulumtimet dhe Teknologjia e Lartë; - Qendrat të përsosmërisë hulumtuese në lidhje-me biznesin në universitetet publike, - Parqet industrial te orientuar-hulumtime, - Aplikimi i grandeve kërkimore, - Transferin e programeve teknologjike / shërbimet e zgjerimit industrial.
	Asistenca e eksportit; - Informacione / trajnimi në atë se si të eksportoje, - Misionet e Tregtisë, - Financim të eksportit.

Burimi: Tabela e marrë nga studimi (Bartik, 1993, 4)

Në tabelën nr.1, autori ka bërë përmbledhjen e politikave/veprimeve ekonomike lokale, duhet të kihet parasysh se këto veprime i përshkruhen shteteve dhe qeverive lokale dhe jo qeverisë federale. Nga tabela e cila përshkruan veprimet e valës së parë dhe asaj të dytë të cilat kanë diferencat në format e qasjes në zhvillimin ekonomik lokal, vërehet se në fazën e parë dhe të dytë ka dallime në mekanizmat e aplikuar. Siç është cekur më lartë

vala e parë ka qenë e orientuar kryesisht në tërheqjen e fabrikave prodhuese, vala e dytë ka zgjeruar mbështetjen tek bizneset e reja, të vogla dhe atyre ekzistuese, vetë orientimi i programeve zhvillimore ka diktuar edhe format e mbështetjes.

Lidhur me evoluimin e zhvillimit ekonomik lokal pos autorëve të tjerë që kanë sistemuar fazat e zhvillimit nëpër vende të ndryshme, është me interes të paraqitet sistemimi që banka botërore i ka bërë historikut të zhvillimit konceptit të ZHEL-it.

Banka Botërore në një historik të shkurtër për ZHEL-in, <http://www.worldbank.org/> , A Brief History of LED (marrë me 01.09.2016), gjithashtu konceptin e zhvillimit ekonomik lokal e paraqet në tri valë/faza, sipas bankës botërore vala e parë ka filluar në vitet 1960 duke vazhduar zhvillimi deri më ditët e sotme. Çdo fazë ka veçorit dhe specifikat e saj, bënë aplikim të formave të reja të mbështetjes në zhvillimin ekonomik lokal, me një fjalë ZHEL-i ka një trend të avancuar në aplikim e konceptit të ZHEL-it dhe programeve zhvillimore.

Edhe pse ZHEL ka lëvizur nëpër secilën prej këtyre valëve/fazave, elementet e çdo vale/faze janë ende duke u praktikuar sot. Tabela në vijim përmbledh tri valët e ZHEL-it:

Tabela 2: Fazat/valët e zhvillimit ekonomik lokal-ZHEL-it

Tri Valët/Fazat e Zhvillimit Ekonomik Lokal		
Valët/Fazat	Fokusi	Mjetet
E parë: 1960 në fillim të viteve 1980.	Gjatë valës së parë fokusi ishte në tërheqjen e: ▪ Investime të lëvizshme prodhuese, tërheqjen e investimeve nga jashtë, sidomos në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ▪ Investime në infrastrukturë të rëndë (fortë).	Për të arritur këtë qytetet kanë përdorur: ▪ Grande masive, ▪ Subvencionimet e kredive zakonisht kanë për qëllim investimet e brendshme të prodhimi, ▪ Pushimin (pezullimin) e taksave, ▪ Subvencionimin e investimeve në infrastrukturë e rëndë (fortë), ▪ Tërheqja teknikës "low road" së shtrenjtë industriale.
E dyta: 1980 në mes të viteve 1990.	Gjatë valës së dytë fokusi lëvizi në drejtim të: ▪ Ruajtja/mbajtja dhe në rritje të bizneseve ekzistuese lokale, ▪ Akoma me një theks në tërheqjen e investimeve të brendshëm, por zakonisht kjo bëhej më shumë në shënjestër për sektorë të veçantë ose nga zona të caktuara gjeografike.	Për të arritur këtë qytete ofronin: ▪ Pagesat direkte për bizneset individuale, ▪ Inkubatorët e biznesit / hapësira pune, ▪ Këshilla dhe trajnime për firmat e vogla dhe të mesme, ▪ Mbështetje teknike, ▪ mbështetje bizneseve fillestare (start-up), ▪ Disa investime në infrastrukturën e rëndë (fortë) dhe të lehtë(butë).

E tretë: Fund të viteve 1990 e tutje.	Fokusi pastaj u zhvendos nga transfertet financiare drejtpërdrejt te firmat individuale në krijimin e të gjithë mjedisit afarist më të favorshëm për biznesin: Gjatë kësaj vale të tretë (dhe aktuale) të ZHEL, më shumë fokusi është vendosur në: ▪ Investime në infrastrukturën e lehtë, ▪ Partneritet publiko /private, ▪ Rrjetet dhe përdorimin (leveraging) e investimeve të sektorit privat për të mirën publike, ▪ Shënjestër e shtuar në tërheqjen e investimeve të brendshme për të shtuar avantazhet konkurruese të zonave lokale	Për të arritur këtë qytetet janë: ▪ Zhvillimin e një strategjie gjithë përfshirëse me qëllim rritjeje të firmave lokale, ▪ Ofrimin një klimë konkurruese lokale të investimeve, ▪ Mbështetjen dhe inkurajimin e rrjeteve dhe bashkëpunimit, ▪ Inkurajimin e zhvillimit të grupimeve të biznesit, ▪ Inkurajimin e zhvillimit të fuqisë punëtore dhe edukimin, ▪ Drejtpërdrejtë (ngushtësisht) targetimin (drejtimin) investimeve të brendshme për të mbështetur rritjen grupimeve, ▪ Mbështetjen e përmirësimeve të cilësisë së jetës.
---	---	--

Nga ajo që autorët e ndryshëm dhe Banka Botërore kanë bërë në sistemimin e historikut të aplikimit dhe evoluimit të konceptit të ZHEL-it, mund të sjellim disa konkludime; Zhvillimi ekonomik lokal si praktikë por veçanërisht si teori dhe koncept është relativisht një fenomen i ri, edhe pse autori Bartik e paraqet si fillim të aplikimit të ZHEL-it pjesën e parë të shekullit njëzet (vitet e 30), ndërsa banka botërore vitet e 60-ta të shekullit 20, të dyja këto japin me kuptua se procesi i ZHEL-it është i ri.

Zhvillimin e këtij koncepti e paraqesin si një procesi i cili ka kaluar dhe vazhdon të zhvillohet si një proces përmes zhvillimit në tri faza, edhe pse ky proces kalon nëpër faza-valë, ndarja në faza i procesit nuk është rigorozë, kështu elementet e njëres fazë aplikohen dhe kanë vlerë edhe në fazat e tjera. Secila fazë i ka karakteristikat e veta të cilat e identifikojnë dhe e veçojnë nga fazat e tjera. përmes fokusimit në ndërmarrjen e veprimeve konkrete dhe aplikimin e instrumenteve të ndryshme në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal.

Kështu, në fazën e parë vërehet fokusimi në tërheqjen e investimeve të jashtme në lëmin e prodhimit dhe të infrastrukturë së rëndë, gjithashtu edhe instrumentet e përdorura në këtë fazë janë kryesisht ato si, grantet investive, pezullimi i taksave dhe investimet në infrastrukturën e rëndë.

Faza e dytë veçohet për fokusim në ruajtjen e bizneseve ekzistuese dhe vazhdon edhe më tutje tërheqja e investimeve të brendshme, në këtë fazë aplikohen instrumentet si, ndërtimi i inkubatorëve të biznesit, mbështetja teknike e bizneseve, këshilla dhe trajnime për bizneset, mbështetje për bizneset fillestare dhe investimet në infrastrukturë të rëndë dhe të lehtë.

Në fazën e tretë vërehet tendenca e tërheqjes së investimeve të reja, përmes krijimit të ambientit më të favorshëm për biznes, inkurajimit të sektorit privatë në nxitjen e kryerjes së punëve publike për interesa të zhvillimit ekonomik lokal. Roli i qeverisë lokale sipas autorëve dhe bankës botërore duhet të jetë në koordinimin, udhëheqjen dhe lehtësuesit për aplikimin e programeve të ndryshme zhvillimore.

Pra ashtu siç është cekur edhe më lartë fazat e zhvillimit ekonomik lokal gjatë zhvillimit përkundër specifikave që kanë, nuk kanë një ndarje të rreptë, d.m.th. elemente respektivisht fokuset dhe instrumentet e një faze aplikohen edhe në fazat e tjera, krejt kjo varet nga vendi dhe ambienti ku procesi zhvillohet.

3.3 Instrumentet (Politikat) e Zhvillimit Ekonomik Lokal

Gjatë hartimit të politikave lokale zhvillimore, programeve të ndryshme të zhvillimit, pos përcaktimit të objektivave, përcaktimit të subjektit bartës, implementues dhe mbikëqyrës, çështje shumë e rëndësishme është edhe definimi i instrumenteve të zhvillimit.

Qeveritë lokale në procesin e zhvillimit ekonomik lokal, me qëllim të tërheqjes së investimeve të reja, të inkurajimit të bizneseve ekzistuese, të përkrahjes së bizneseve të vogla dhe atyre të mesme, përdorin instrumente të ndryshme zhvillimore.

Ashtu siç është prezantuar edhe në paraqitjen e historikut të ZHEL-it, gjatë procesit të zhvillimit janë aplikuar modele dhe instrumente të ndryshme me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara nga lidhshipi dhe nevojat e komunitetit. Në të tri fazat-valët e zhvillimit janë aplikuar instrumente të ndryshme, varësisht prej nivelit të zhvillimit dhe mundësive që kanë pasur në dispozicion.

Autorët e ndryshëm në studimet e bëra në fushën e ZHEL-it, kanë identifikuar instrumentet e ndryshme që janë aplikuar nga vendet e ndryshme në këtë proces, kështu : Sipas Bartik T, Instituti Upjohn, në një studim të bërë nga ICMA, është konstatuar se: Ndër programet më të zakonshme të zhvillimit ekonomik të mbështetur nga qeveritë lokale janë:

Stimujt e taksave, në shkallë qyteti ose në zona të caktuara janë listuar nga 66 për qind në të gjithë qeveritë vendore;

Programet e trajnimit fuqisë punëtore duke e përshtatur për nevojat e firmave individuale apo industri (63 për qind);

Fondet e kredisë të zhvillimit për bizneset (55 për qind);

Korporatat e zhvillimit (Themelimi i ndërmarrjeve për zhvillim) (53 për qind); dhe

Programet e ndërmarrjeve të vogla (Programet që mbështesin) (27 për qind), (Bartik,2003, 3).

Studimi nga ICMA, ka përfshirë zyrtarët përgjegjës nëpër njësitë lokale të vetëqeverisjes, respektivisht me krye shefat Administrativë të qyteteve dhe qarqeve nga të cilët ndër të tjera është kërkuar të jepen informata lidhur me format e mbështetjes së programeve të ZHEL-it. Po nga të njëjtit janë marrë edhe informatat për pengesat me të cilat më së tepërmi ballafaqohen qeveritë lokale në realizimin e programeve zhvillimore.

Ndërsa SOŇA ČAPAKOVÁ e cila ka studiuar praktikat e zhvillimit e ekonomik lokal në vendet e Evropës qendrore dhe lindore. Sipas këtij studimi autoritetet lokale përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve në punën e tyre të zhvillimit ekonomik lokal, të cilat mund të klasifikohen në pesë kategori të gjera:

Mjetet Financiare,

Mjetet të lidhura me pronën,

Marketingu,

Zhvillimi i Infrastrukturës dhe

Ofrimi i asistencës teknike dhe të informacionit.

Në studim është bërë një elaborim më i detajuar aplikimit të secilit instrumente në programet e ndryshme të zhvillimit ekonomik, duke dhënë detaje për mënyrën e aplikimit, pastaj për llojet e instrumenteve të përdorura në kudër të secilës kategori. Këto pesë kategori të instrumenteve të përshkruar janë përmbledhje e më tepër instrumenteve përbrenda çdo kategorie, p.sh., tek mjetet financiare përdoren; ulja e taksave,

subvencionimi financiar, subvencionim i kredive etj. Tek prona, dhënia e pronës me çmim më të ultë se çmimi i treguat etj., infrastruktura e rëndë dhe e lehtë etj.

Në një studim që ka bërë K.KOLLÁR, me titull Ekzaminimi i Instrumenteve të Zhvillimit Ekonomik Lokal, botuar në (HJICH) autori ka përmbledhë hulumtimet e disa autorëve në këtë çështje duke bërë prezantimin e studimeve rreth instrumenteve të ZHEL-it.

Strategjitë lokale të zhvillimit ekonomik, të cilat janë të përcaktuara nga Blakely dhe Bradshaw, përmbajnë mjetet e mëposhtme:

Mjetet e një strategjie të zhvillimit ekonomik me bazë-komunitare janë për shembull;

Krijimi i Agjencisë e ndërmarrjeve lokale,

Mbështetja e komuniteteve pakicë dhe në pozitë të pafavorshme përmes ofrimit të kredive,

Krijimin e trupave (Organeve) të zhvillimit të komunitetit,

Aktivitetet e marketingut.

Mjetet që i përkasin një Strategjie të Zhvillimit të Biznesit janë;

Inkubatorët, krijimi i zonave të ndërmarrjeve (biznesit),

Themelimi parqeve Industriale dhe parqeve teknologjike,

Mbështetja e R&D (Hulumtim dhe Zhvillim),

Qendrat për këshillim dhe mbështetje të aktiviteteve të biznesit,

Promovimi i e bizneseve të reja, ndërmarrësit,

Qendrat për Informim të bizneseve.

Strategjia e zhvillimit të vendbanimit ndër të tjera përfshin si në vijim;

Zhvillimin e infrastrukturës,

Zhvillimin e turizmit,

Zhvillimin e shërbimeve publike,

Përmirësimin e Strehimit,

Formimi zonës industriale, shpronësimi i tokave,

Thjeshtëzimin e legjislacionit,

Ndërtimi i qendrave tregtare.

Strategjia e zhvillimit të burimeve njerëzore përdor mjete të tilla si;

Ofrimi i trajnimeve profesionale që përmbush kërkesat e ndërmarrjeve,

Ofrimi i trajnimeve për të pa favorizuarit dhe për të pa punët afatgjatë,

Programi për Punonjësit me kohë jo të plotë dhe me ndërprerje për të lehtësuar në punësim të përhershëm,
Program për braktisësit e shkollës për të inkurajuar punësimin,
Trajnim profesional që përputhet me nevojat e sektorëve,
Themelimi i qendrës për të papunët dhe marrëveshja me tregun e punës, (Kollár, 2011,12).

Autori Bartik në hulumtimin e bërë për nevojën e mbështetjes së zonave të pafavorshme, në rritjen e punësimit ka propozuar tri forma të mbështetjes për zhvillimin e këtyre zonave: punimi propozon tre zgjidhje për të sjellë vende pune në zonat e vështira: programe të trajnimit për punë të përshtatur për bizneset dhe punonjësit, këshilla dhe shërbime të konsulencës përmes programit të Partneritetit në Zgjerim të Prodhimit dhe një pako grantesh për shërbimet lokale dhe pushimet tatimore përmes një program për Zonë të Fuqizuar të reformuar dhe të revitalizuar, (Bartik,2010, 2).

Nga paraqitja që autorët e ndryshëm i kanë bërë instrumenteve të aplikuara nga vendet të ndryshme në procesin e zhvillimit ekonomik lokal, Bartik prezanton praktikën në SHBA, SOŇA ČAPKOVÁ atë të vendeve të Evropës qendrore dhe lindore, pastaj K.KOLLÁR bënë një prezantim më gjithëpërfshirës, duke përmbledhë ato nga autorë të ndryshëm, kështu mundë të vlerësojmë se;

Të tre autorët që kanë paraqitur instrumentet e aplikuara në procesin e ZHEL-it, kanë prezantuar mjaftë ngjashmëri në aplikim të mjeteve zhvillimore. Kështu përderisa te Brtik është një prezantim i përmbledhur i instrumenteve duke filluar me ato financiare e deri tek mbështetjet që ofrohen në trajnim dhe themelim të qendrave për mbështetje të bizneseve.

Edhe dy autorët Blakely & Bradshaw që kanë bërë një elaborim më të gjerë kanë të përfshira edhe ato instrumente që i ka përfshirë në analizë Bartik, por siç shihet këta dy autorë kanë një fragmentim më të gjerë të mekanizmave zhvillimor.

Ndërsa Soňa Čapková, ka bërë një grupim në pesë kategori të cila gjatë elaborimit për secilën grup ka përafërsisht përfshirje të instrumenteve që i kanë përfshirë edhe autorët e lartë cekur.

Në një studim që kanë bërë dy autorë nga Serbia lidhur me zhvillimi ekonomik lokal, gjatë elaborimit të instrumenteve të mundshëm për aplikim për mbështetje të zhvillimit kanë potencuar katër instrumente, por dy nga ata janë që dallojnë nga autorët e më sipërm.

Zona për përmirësim të biznesit dhe zyra lokale për zhvillim ekonomik lokal- ZHEL. Zona e afarizmit të përmirësuar, ose BID (eng. business improvement district) është mjeti bashkëkohor i përmirësimit të vitalitetit ekonomik të bërthamës urbane të komuniteteve lokale. Koncepti i BID-t u krijua dhe u zhvillua në vitet shtatëdhjetë të shekullit të 20 në qytetet e Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara, (Belkić & Hrnjaz, 2010, 16).

Ndërsa lidhur me rolin e zyrës për zhvillim ekonomik lokal autorët e cekur më lartë kanë trajtuar formën e organizimit të zyrës së ZHEL-it në kuadër të administratës komunale, duke i vlerësuar përparësitë dhe të metat e formave të organizimit, duke dhënë këtë version: “Nëse kryetari i komunës e përdor të drejtën e tij ligjore për vendosjen e ndihmës të tij për zhvillimin ekonomik, ky ndër të tjera duhet të jetë lidhja të drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme në mes të Zyrës ZHEL-it dhe kryetarit të komunës. Përveç kësaj, shefi i zyrës së ZHEL duhet të jetë përgjigjes ndihmës kryetarit të komunës për zhvillim ekonomik për realizimin e qëllimeve të përcaktuara strategjike të ZHEL-it” (Belkić & Hrnjaz, 2010, 53) .

Kështu bazuar edhe në tabelën nr.2 të prezantuar në pjesën e historikut të ZHEL-it dhe në atë që këta autor kanë përmbledhur rreth instrumenteve të procesit të zhvillimit ekonomik lokal, mund të konkludojmë se Instrumentet e aplikuara të zhvillimit janë të shumtë, të cilët janë aplikuar nga vendet e ndryshme. Aplikimi i çdo instrumenti zhvillimor është varur nga situata, kushtet dhe rrethanat në të cilën janë gjendur partnerët e zhvillimit ekonomik lokal, pikësëpari pushteti lokal dhe partnerët e tjerë.

3.4 Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal;

Zhvillimi ekonomik lokal si një proces kompleks kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të partnereve lokal në krijim e një dokumenti strategjik zhvillimor. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është dokumenti bazë në procesin zhvillimor të çdo njësie të qeverisjes vendore, nga i cili duhet të burojnë programet e ndryshme zhvillimore.

Procesi i zhvillimit kërkon një qasje komplekse, për të përcaktuar vizionin për të ardhmen, kërkohet; vlerësimi i situatës ekzistuese ekonomike, kapaciteteve njerëzore, natyrore, teknike si dhe krahasimi me ecurit zhvillimore në regjion, në nivele vendi dhe më gjerë.

Planet strategjike zhvillimore janë udhërrëfyes të zhvillimit të qëndrueshëm për çdo qeveri vendore, krahas planeve të ndryshme zhvillimore, siç janë plani zhvillimor

komunal, planet zhvillimore urbane etj. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është dokumenti më gjithëpërfshirës për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik social. Me qëllim që strategjia të jetë më gjithëpërfshirëse, në hartimin e saj duhet të jenë të kyçur më shumë partnerë lokal si; Qeveria lokale, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile, puna e përbashkët e këtyre partnerëve, strategjisë i jep një përmbajtje më të plotë, duke i marrë parasysh nevojat ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Sipas bankës botërore planifikimi strategjik i ZHEL-it është - Idealisht, zhvillimi i një strategjie të ZHEL-it do të jetë një pjesë integrale e një procesi më të gjerë të planifikimit strategjik, për një nën rajon kombëtar, qytet, qytezë apo zonë rurale. Planifikimi efektiv strategjik siguron, që çështjet prioritare të adresohen dhe burimet e kufizuara të jenë mirë të targetuara. Prosesi i planifikimit pesë-hapësh i detajuar duhet jetë i përshtatur për t'u përmbushur, dhe të korrespondojnë me, proceset e tjera vendore të planifikimit, <http://www.worldbank.org> (marr me 09.09.2015) .

Në një manual të botuar nga Banka Botërore dhe fondacioni gjerman Bertelsmann Stiftung, është trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse Strategjia e planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal. Sipas këtij dokumenti strategjia e ZHEL-it është: Prosesi i planifikimit strategjik të zhvillimit ekonomik lokal zakonisht ka pesë faza të zhvillimit. Çdo faza është e përcjellë me një seri veprimesh që ndërmerren nga pjesëmarrësit në hartimin e strategjisë.

Tabela 3 : Pesë fazat e procesit të planifikimit strategjik të zhvillimit ekonomik lokal

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL PESE FAZAT PLANIFIKIMIT STRATEGJIK	
Faza 1: Organizimi i përpjekjes Faza 2: Vlerësimi i Ekonomisë Vendore Faza 3: Krijimi i Strategjisë	Faza 4: Zbatimi i Strategjisë Faza 5: Strategjia Rishikimit

Burimi: (Swinburn,Goga&Murphu, 2006, 4)

Gjithashtu, edhe autorë të tjerë çështjen e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal e kanë vlerësuar si një dokument shumë të rëndësishëm dhe të nevojshëm, për të kanalizuar zhvillimin ekonomik social të një njësie të vetëqeverisjes vendore. Kështu, në manualin me shembujt e praktikave më të mira të vendeve të Evropës Juglindore, e botuar nga fondacioni Friedrich Ebert Stiftung, zyra në Zagreb, autori Jakša Puljiz ka trajtuar

praktikat e vendeve të cekura më lartë, në planin e hartimit dhe implementimit të strategjisë së ZHEL-it, ku, ky manual e jep këtë shpjegim: Lidhja e procesit të zhvillimit ekonomik lokal me një dokument të programit zakonisht është një mënyrë e mirë për të vënë të gjitha çështjet e rëndësishme në një kornizë brenda së cilës të kërkojë mënyrën më të mirë për të maksimizuar mirëqenien e banorëve lokal. Megjithatë, hartimi dhe në veçanti zbatimi i strategjive zhvillimore lokale, nuk është një detyrë e lehtë. Shumica e njësive të qeverisjes vendore në Evropën Qendrore dhe Lindore ka filluar vetëm kohët e fundit përballet me hartimin e strategjisë dhe procesin e implementimit, në përputhje me qasjen pjesëmarrës moderne, (Friedrich Ebert Stiftung, 2005, 15).

Nga studimi që Soňa Čapáková i ka bërë vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm strategjinë e ZHEL-it; Hapi i parë për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal përcaktimin dhe implementimin e prioriteteve ekonomike është përpunimi i strategjive dhe programeve komunale për zhvillimin social dhe ekonomik. Këto strategji përshkruajnë kuadrin e zhvillimit ekonomik lokal dhe përcaktojnë prioritetet themelore dhe aktivitetet specifike për zbatimin e tyre. Autoritetet lokale marrin një rol udhëheqës në zhvillimin e tyre. Ekipet janë ngritur për të zhvilluar analizën e gjendjes aktuale sociale dhe ekonomike të komunave, anët e forta dhe të dobëta të zhvillimit, si dhe të përshkruajnë prirjet themelore, (Čapáková, 2005,31).

Një grup autorësh nga qendra për studime liberale-demokrate në studimin e bërë për nevojat e konferencës së përhershme të qyteteve dhe komunave, një rëndësi të veçantë i kanë kushtuar strategjisë së ZHEL-it. Këta autorë japin këtë shpjegim: Strategjia e ZHEL-it, pa dyshim, bëhet në bazë të përballjes reale me gjendjen e ekonomisë lokale, d.m.th., pikat e forta dhe dobësitë, si dhe mundësitë e hapura dhe kërcënimet e mundshme, po edhe në bazë të procesit të harmonizimit të mendimeve dhe duke respektuar interesat e të gjithë aktorëve (partnerëve) të skenës lokale ekonomike dhe politike. Është karakteristike se ky grup autorësh përcakton edhe komponentët përbërëse të strategjisë; Përmbajtja e strategjisë paraqet planin e veprimit të komunitetit lokal në fushën e zhvillimit ekonomik dhe përbënë disa komponentë të pa tejkalueshëm:

Vizioni,

Qëllimet,

Programet dhe

Projektet.,

Është, pra, një kombinim thelbësor i dy komponentëve: atë që aspirojmë dhe rrugën si të arrijmë atë, (Boris, Zoran, Gordana dhe Boško, 2006, 55).

Nga elaborimet e autorëve të ndryshëm, lidhur me strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal, mund të konstatojmë se: Strategjia e ZHEL-it është një dokument bazë, i cili vendos kornizat e zhvillimit të një njësie të qeverisjes lokale duke përfshirë, përshkrimin e situatës ekzistuese dhe përcaktimin e synimeve për të ardhmen. Në hartimin e këtij dokumenti duhet të kyçen, qeveria lokale, komuniteti i biznesit (sektori privat) dhe shoqëria civile (sektori jo profitabil). Qeveria lokale duhet të ketë rolin udhëheqës. Strategji e zhvillimit ekonomik lokal zhvillohet në faza, shumica e autorëve i kushtojnë rëndësi të veçantë fazës së implementimit dhe rishikimit të strategjisë, si një proces mjaft delikat. Nga të gjithë studiuesit e procesit të zhvillimit ekonomik lokal, strategjia është një dokument shumë i rëndësishëm, i domosdoshëm dhe i pa tejkalueshëm në adresimin dhe vlerësimin e nevojave të komunitetit lokal.

3.5 Qëllimet e politikave të zhvillimit ekonomik dhe arsyeshmëria e angazhimit të Pushtetit Lokal

Qeveritë lokale përmes investimeve në infrastrukturën publike, përmes mbështetjes së programeve/projekteve të ndryshme zhvillimore dhe përmes formave të ndryshme të stimulimit, ndihmojnë procesin e zhvillimit ekonomik lokal. Por jo çdo program apo projekt, të cilin mund ta mbështesë qeveria lokale, e arsyeton angazhimin e pushtetit lokal, sepse jo secili projekt i përmbush qëllimet e komunitetit lokal. Para aplikimit të instrumenteve/mekanizmave të zhvillimit dhe të targetimit të llojit të biznesit që do të mbështetët, duhet të kalkulohen përfitimet që sjellë stimulimi i biznesit konkret. Pothuajse të gjithë autorët që merren me studimin e ZHEL-it, pajtohen se mbështetja e programeve/projekteve zhvillimore duhet të rezultojë me rritjen e punësimit lokal, përfitimet fiskale, rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve, thjesht, duhet të përmbushë njërin nga këto qëllime.

Studiuesit e ndryshëm të kësaj fushe kanë bërë përcaktimin e qëllimeve parësore, të cilat duhet të arrihen përmes programeve të zhvillimit ekonomik lokal.

Autori Bartik Timothy 2003, në një studim të bërë për Institutin Upjohn, ku ka bërë rishikimin e kapitullit “Strategjitë për zhvillim ekonomik”, që është paraqitur në edicionin e katërt, ka elaboruar me shumë kujdes qëllimet e politikave zhvillimore,

përzgjedhjen e programeve, dhe identifikimin e benifiteve që sjellë mbështetja e ZHEL-it në tërësi dhe bizneseve individuale në veçanti. Autori gjatë shtjellimit të arsyeshmërisë së ZHEL-it, ka përcaktuar edhe qëllimet bazë të cilat duhet të përmbushën nga mbështetja e programeve të zhvillimit ekonomik lokal. Autori përcakton këto qëllime, (Bartik, 2003, 4,5):

Përfitimet Fiskale - Një arsyetim për subvencione publike të zhvillimit ekonomik është përfitimet e mundshme fiskale. Vende të reja pune do të rezultojnë në të ardhura të rritura, pagat, shitjes, dhe vlerat e pronës lokale, të cilat do të rrisin të ardhurat e taksave vendore. Disa qeveri gabimisht supozojnë se ky është efekti i vetëm fiskal i vendeve të reja, për shembull Michigan bën këtë në vlerësimin e efekteve fiskale të stimujve të saj tatimore. Një më e mirë - por ende si qasje - jo e plotë, përfshin edhe rritjen e shërbimeve publike dhe infrastrukturën që kërkohet direkt nga bizneset e reja apo të zgjeruara.

Shumica e studimeve sugjerojnë se në normat e rregullt të taksave, biznesi tipik gjeneron në mënyrë të konsiderueshme, më shumë të ardhurave tatimore shtetërore dhe lokale, se sa shpenzime publike që ajo kërkon, në një studim, \$ 1.70 në taksa për çdo 1 \$ në shpenzimet e kërkuara publike, (Bartik, 2003, 8).

Përfitimet e punësimit - Përfitimet e punësimit nga marrja e një pune të re për banorët lokal, janë pagat e paguara për atë punë, minus çfarëdo vlere e vendit për banor lokal në kohën e tyre ndërsa ishin të papunë, vlerë që ekonomistët e quajnë të personit "pagë rezervimit." Përfitimet e punësimit prej rritjes të punës lokale janë të konsiderueshme. Një rritje e punësimit prej 10 për qind në një zonë metropolitane rritë të ardhurat mesatare reale në zonën metropolitane me rreth 4 për qind për person. Gjysma e kësaj rritjeje reale e të ardhurave, ndodh për shkak se më shumë banorë lokalë gjejnë punë. Gjysma tjetër ndodh për shkak se disa punëtorë marrin pozicione më mirë - të paguara, (Bartik, 2003, 10).

Dështimit të tregut (zbutja) - Produktiviteti i bizneseve vendore mund të rritet në mënyrë efikase nëse mund të identifikojmë "dështimet e tregut", në të cilat, inputet për prodhimin e biznesit sigurohen në mënyrë joefektive, ashtu që këto impute nuk janë ofruar në mënyrë optimale, edhe pse një furnizim i tillë do të rriste produktivitetin më shumë se kostoja e imputit. Këto dështime në treg mund të përfshijnë:

Informacioni se si të përmirësohet produktiviteti i biznesit, veçanërisht informacioni themelor, mund të sigurohet në mënyrë të pamjaftueshme nga tregu privat.

Hulumtim dhe zhvillim në biznes, dhe në veçanti më themelore R & D.

Kapitali i biznesit mund të furnizohen në mënyrë të pamjaftueshme, për shkak se shumë rregulla në tregjet e kapitalit i pengojnë kredit për sipërmarrjet të biznesit.

Toka mund të mos ofrohet gjithmonë në mënyrë optimale për bizneset private, sepse përdorimi i tokës është i rregulluar rëndë nga zonimi dhe pronarët individual të tokave.

Trajnimi i punëtorëve mund të sigurohet jo mjaftueshëm nga bizneset për shkak të frikës se punëtori i trajnuar do të lëvizë te një tjetër punëdhënës.

Infrastruktura publike mund të jetë e nën-ofruar për bizneset-dhe-familjet pa ndërhyrjen publike. Rregullat e biznesit, siç janë ligjet mjedisore, mund të jenë joefikase në nivelin e përgjithshëm të rregullimit, fleksibilitetin e rregullimit në reagimin ndaj rasteve specifike, ose lehtësimin e bizneseve për të kuptuar rregulloret (Bartik, 2003, 12).

Përfitime të tjera dhe kostot - Përveç punësimit dhe përfitimet fiskale, dhe përfitimet nga tejkalimi dështimeve të tregut, përfitimet e tjera dhe kostot e zhvillimit ekonomik lokal meritojnë konsideratë. Zhvillimi ekonomik lokal zakonisht do të rrisë çmimet e strehimit lokal, pronarët e shtëpive të ndihmuar dhe pronarët e tokave të tjera lokale, por dëmton qiramarrësit. Zhvillimi ekonomik lokal mund të ketë efekte negative në mjedis, të tilla si rritja e ndotjes së ajrit ose të ujit ose probleme të mbeturinave të ngurta, humbjen e kënaqësive e hapësirave të gjelbërta, rritjen shtrirjes urbane, duke rritur bllokimet e trafikut, dhe efektet negative mbi "karakterin" e një vendi. Projektet e zhvillimit ekonomik lokal mund të modifikohen për të minimizuar këto efekte ose të kundërt e tyre. Përpjekjet e zhvillimit që kërkojnë të integrojnë çështjet e tilla mjedisore në planifikimin e politikave të zhvillimit ekonomik nganjëherë shkojnë nën etiketën e "zhvillimit të qëndrueshëm", (Bartik, 2003, 13).

Lidhur me dobëtë, respektivisht arsyeshmërinë e mbështetjes së programeve të zhvillimit ekonomik lokal, autori Dušan Vasiljević, në hulumtimet e tij të bëra nëpër studimet e autorëve të ndryshëm konstaton se: Përveç efekteve fiskale, përfitimi indirekt i programit të zhvillimit ekonomik lokal është në përmirësimin e cilësisë dhe vëllimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të ofruara për t'i shërbyer nevojave të ekonomisë. Një tjetër moment pozitiv, i cili shpesh anashkalohet, është efektet sociale të ballafaqimit me zhvillimin ekonomik lokal. Partnerët e ZHEL-it në thelb janë duke punuar në angazhimin e potencialeve të pa shfrytëzuar të zhvillimit të komunitetit lokal. Këto potenciale nuk duhet të jenë vetëm një pozicion i favorshëm gjeografik, ekzistenca e

burimeve minerale dhe të ngjashme. Potencialet e pashfrytëzuara mund të jenë njerëzit, të papunët, njerëzit me nevoja të veçanta, anëtarë të grupeve të marginalizuara që e kanë të vështirë për të gjetur vendin e tyre në tregun e punës., (Vaseljević, 2012, 90).

Është karakteristike se edhe autorët e tjerë në studimet e tyre për ZHEL-in, potencojnë se, qëllimet kryesore të programeve zhvillimore të cilat mbështeten nga qeveritë lokale janë, rritja e punësimit, përfitimet nga të ardhurat fiskale, zbutja e pasojave të dështimit të tregut, rritja e eksporteve etj. Por autori Bartik, ka bërë një analizë duke llogaritur përfitimet dhe kostot që kanë nga programet në realizimin e qëllimeve. Përmes modeleve ekonometrike ka provuar teoritë lidhur me përfitimet që komuniteti lokal ka nga mbështetja e programeve zhvillimore lokale me bazë në rritjen e eksporteve, ndikimi i tyre në rritjen e punësimit etj.

Nga analiza e studimeve të autorëve të ndryshëm mund të konkludojmë se:

Qëllimet thelbësore të politikave të ZHEL-it janë, rritja e punësimit për banorët lokal, rritja e të ardhurave nga taksat lokale, rritja e mirëqenies ekonomike të banorëve lokal dhe rritja ekonomike.

Duhet të bëhen analiza lidhur me koston dhe përfitimet që dalin nga programi konkret, duke përzgjedhur ato programe që përmbushin së paku njërin nga qëllimet thelbësore, p.sh. Hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e produktivitetit të punës, aplikimin e teknologjive të reja etj.

Çështja e përzgjedhjes së programeve zhvillimore kërkon një qasje serioze nga partnerët lokal, kërkon një analizë të gjerë lidhur me përfitimet dhe kostot që do ti prodhojë realizimi i programit.

Edhe në realizimin e këtyre qëllimeve, roli i qeverisë lokale duhet të jetë parësor, pra qeveria lokale duhet të koordinoj tërë procesin e hartimit dhe realizimit të programit. Rastet që i trajtojnë autorët e ndryshëm, veçanërisht Bartik në SHBA, japin argumente se angazhimi i pushtetit lokal, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile, janë të nevojshëm për realizimin e qëllimeve bazë të ZHEL-it.

3.6 Koncepti dhe teoritë mbi vlerësimin e ndikimit

Vlerësimi i ndikimit është një qasje komplekse në vlerësimin e programeve, projekteve dhe politikave, në përmbushjen qëllimeve të përcaktuara. Vlerësimi i ndikimit nuk është thjeshtë një prezantim i rezultatit, por është një proces i dëshmimit të arritjeve që

lidhen kryesisht me aplikimin e programit konkret. Vlerësimi i ndikimit duhet të dëshmoj se aplikimi i një programi ose politike ka rezultuar me arritje, të cilat nuk do të arriheshin në mungesë të aplikimit të atij programi. Atëherë çfarë është vlerësimi i ndikimit të një programi apo politike publike?

Vlerësimet janë periodike, vlerësime objektive të një planifikimi, të një programi ose projekti në vazhdimësi ose të përfunduar. Vlerësimet përdoren për t'iu përgjigjur pyetjeve specifike, shpesh të lidhura me projektimin, zbatimin ose rezultatet, (Gertler. 2016, 7).

Vlerësimet e ndikimit janë të lidhura me programet, projektet apo politikat e ndërhyrjes së qeverive në një fushë të veçantë, për ta parë përmbushjen e pritjeve.

Vlerësimet e ndikimit janë një lloj i veçantë i vlerësimit që kërkon të përgjigjet në një pyetje të veçantë dhe të efektshme: Cili është ndikimi (ose efekti shkakësor) i një programi në një rezultat të interesit? Kjo pyetje themelore përfshin një dimension të rëndësishëm shkakor. Fokusi është vetëm në ndikimin: domethënë, ndryshimet që i atribuohen drejtpërdrejt një programi, modaliteti programesh ose inovacionit të dizajnit, (Gertler, 2016, 8). Nevoja e vlerësimit të politikave dhe programeve të ndryshme publike të hartuara dhe aplikuar nga qeveritë lokale, nacionale dhe agjencitë e ndryshme ndërkombëtare, ka bërë që shumë autorë dhe institucione relevante ndërkombëtare të merren me hulumtimin e rasteve të shumta, për ta pasuruar sa më shumë njohuri shkencore për qasjen komplekse të vlerësimit të ndikimit.

Kështu, studiuesit e ndryshëm kanë prezantuar hulumtime të shumta të cilat ofrojnë njohuri lidhur me modelet e dizajnit të vlerësimit të ndikimit, metodat e aplikuar përgjatë vlerësimit të programeve të ndryshme, parimet të cilat duhet të respektohen përgjatë procesit të vlerësimit, sfidat që e përcjellin këtë proces etj.

Në një studim të kryer nga një grup autorësh për vlerësimin e ndikimit në praktikë, janë elaboruar në mënyrë shumë përmbajtjesore të gjitha çështjet, që janë të lidhura me procesin e vlerësimit të ndikimit të programeve dhe politikave të ndryshme publike, nëpër vendet e ndryshme. Është me interes se autorët vlerësimin e ndikimit e lidhin kryesisht me dy koncepte që janë pjesë përbërëse e proceseve në kryerjen e vlerësimeve të sakta dhe të besueshme të ndikimit; shkaktarin (efekti shkakësor) dhe kundërpërgjigjen, të një programi, duke e krahasuar me atë se çfarë do të kishte ndodhë nëse nuk ishte aplikuar programi konkret.

Vlerësimet e ndikimit përcaktojnë shkallën në të cilën një program - dhe vetëm ai program - shkaktoi një ndryshim në një rezultat (Gertler, 2016, 47).

Kundërpërgjigja është ajo që do të kishte ndodhur-çfarë rezultati do të ishte për një pjesëmarrës në program - në mungesë të programit (P) (Gertler, 2016, 48).

Për të arritur në një pasqyrë sa më të plotë të vlerësimit të ndikimit të një programi apo politike publike, autorët rekomandojnë respektimin e parimeve kyçe të procesit të vlerësimit të ndikimit. Autori Howard White në studimin e tij teoria bazë e vlerësimit të ndikimit, përmend gjashtë parime kyçe të procesit:

Gjashtë parimet kryesore të një vlerësimi të ndikimit të bazuar në teori janë:

1. Harta e zinxhirit shkakësor (teoria e programit),
2. Ta kuptoni kontekstin,
3. Parashikoni heterogjenitetin,
4. Vlerësimi rigoroz i ndikimit duke përdorur një kundërpërgjigje të besueshme,
5. Analiza faktike rigoroze,
6. Përdorni metodave të përziera, (White, 2009, 7).

Autori i studimit në fjalë sqaron secilin nga parimet kyçe duke filluar nga; harta e zinxhirit shkakësor e cila lidh imputet me rezultatin dhe ndikimet, konteksti nënkupton mjedisin shoqëror, politik dhe ekonomik në të cilën zhvillohet programi, kuptimi i kontekstit mundëson të kuptuarit edhe heterogjenitetin e mundshëm të ndikimit në program, vlerësimi rigoroz duke përdorur një kundërpërgjigje të përshtatshme është padyshim një komponentë kyçe, si dhe përdorimi i metodave të përziera që nënkupton metodat sasiore dhe cilësore janë parime që duhet të respektohen përgjatë vlerësimit të ndikimit të një programi.

Procesin e vlerësimit të ndikimit e përcjellin një varg të veprimeve të cilat janë të rëndësishëm për përgjigjen në pyetjen kryesore e cila do të jep përgjigje nëse një program është i suksesshëm, i njëjti duhet të aplikohet apo të vazhdohet, ose nuk i përmbush pritjet të përcaktuara. Pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit të ndikimit janë:

- ☐ Monitorimi i programit,
- ☐ Vlerësimi i procesit,
- ☐ Analiza e kosto-përfitimit dhe e kosto-efektivitetit të një programe.

Analiza e kosto-përfitimit vlerëson përfitimet e përgjithshme të pritshme të një programi, në krahasim me kostot totale të pritura. Analiza e kosto-efektivitetit krahason koston

relative të dy ose më shumë programeve ose alternativave të programit në duke arritur një rezultat të përbashkët, (Gertler, 2016, 18).

Çelësi i vlerësimit të ndikimit dhe konceptit të kundërpërgjigjes është gjetja/identifikimi i grupit të krahasimit, i cili do të mundëson që të nxirren rezultate të sakta për grupin e trajtimit. Grupi i trajtimit është grupi i cili është i përfshirë në program, ndërsa grupi krahasimit është grupi i cili nuk është i përfshirë në program.

Përzgjedhja e grupeve të tilla të krahasimit është thelbi i çdo vlerësimi të ndikimit, pavarësisht se çfarë lloji të programit po vlerësohet. Thjesht, pa një grup krahasimi që jep një vlerësim të saktë të kundërpërgjigjes, nuk mund të vërtetohet ndikimi i vërtetë i një programi. (Gaetler, 2016, 52).

Një vëmendje të shtuar autorët e ndryshëm i kanë kushtuar metodologjisë respektivisht qasjes së kryerjes së procesit të vlerësimit të ndikimit, duke analizuar metodat të cilat janë më të përshtatshme për nxjerrjen e rezultateve më të sakta dhe të besueshme si për menaxherët ashtu edhe për politik bërësit. Në mënyrë të veçantë, zgjedhja e një metode të vlerësimit të ndikimit përcaktohet nga karakteristikat operacionale të programit, veçanërisht burimet e saj të disponueshme dhe tri pyetje në lidhje me kontekstin operativ të një programi të caktuar:

- A ka programi juaj burime për t'i shërbyer të gjithë përfituesve të privilegjuar?
- A është programi juaj i synuar apo universal?
- A do të regjistrohet programi juaj për të gjithë përfituesit menjëherë ose në radhë?

Përgjigja për këto tri pyetje do të përcaktojë se cila nga metodat e paraqitura në vijim: caktimin rastësishëm, variablat instrumentale, regresioni i ndërprerjes, ndryshimi-ne-ndryshim, ose përputhja – j anë më të përshtatshme për kontekstin tuaj operativ, (Gertler, 2016, 39).

Për secilën nga metodat e caktuara, janë dhënë vlerësimet në lidhje me përparësitë, mangësitë dhe vështirësitë që i përcjellin duke dhënë kështu shembuj të ndryshëm të aplikimit të tyre në vlerësimin e programeve të caktuara në praktikë. Në studimin e bankës botërore të vlerësimit të ndikimit në praktik, autorët secilën nga metodat e cekura më lartë e kanë shqyrtuar në hollësi në kapituj të veçantë, duke përmbledhë: përparësitë e aplikimit të secilës metode veç e veç; rreziqet të cilat i përcjellin metodat e veçanta; dhe limitet që kanë secila metodë.

Është me interes të potencohet se pothuaj të gjithë autorët një rëndësi të veçantë i kushtojnë edhe aplikimit të metodave të përziera, si një mënyrë e mirë për zbutjen apo eliminimin e dobësive të metodave specifike.

“Përdorimi i një përzierje të metodave në monitorimin dhe vlerësimin, mund të rrisë standardin e vlerësimit (Gray, 2009). Ajo mund të sigurojë trekëndësim të vlerësimeve: Një metodë kompenson dobësinë e të tjerëve dhe siguron një kontroll të plotë mbi gjetjet e studimit të njëjtit fenomen (Bamberger dhe Segone, 2011). Kjo lejon komplementaritetin: Metoda të ndryshme mund të eksplorojnë elementë të ndryshëm të një programi dhe rezultatet e një metode mund të informojnë zhvillimin e ardhshëm. Përdorimi i metodave të përziera ndihmon në zbulimin e paradokseve, kontradiktave dhe perspektivave të reja. Së fundi, metodat e përziera mund të zgjerojnë vargun e një studimi për të përfshirë më shumë çështje, p.sh. Të kuptuarit kontekstual, dhe pjesëmarrësit përjetuan përvojë, si dhe ndryshimet në fenomenet e dukshme” (Roche&Kelly, 2012, 11).

Vlerësimi i ndikimit është një proces i pashmangshëm në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe politikave publike, është një mekanizëm i cili vlerëson intervenimin në politikat e caktuara duke e vlerësuar, koston dhe efektin e prodhuar. Pra, është një veprim mjaftë i rëndësishëm në vlerësimin e një politike publike të aplikuar në fusha të caktuara.

3.7 Përmbledhje e studimeve të autorëve të ndryshëm

Zhvillimi ekonomik lokal si proces/koncept zhvillimor ashtu siç kam cekur edhe më lartë edhe pse ka filluar më parë të aplikohet në pektikë në vendet e ndryshme dhe më pastaj të bëhet objekt i studimit të autorëve dhe institucioneve të ndryshme, gjatë kësaj periudhe ka zgjuar interesim të madh. Kështu institucionet dhe autorë të ndryshëm janë angazhuar në studimin e praktikave të aplikimit të ZHEL-it në vende të ndryshme me qëllim që këtij procesi të rëndësishëm t’i jepen edhe dimensionet e shkencës dhe teorisë ekonomike.

Fillimisht autorët Edward J. Blakely, Bradshaw dhe autorë të tjerë në studimet e tyre mbi zhvillimin ekonomik kanë bërë përkufizimin e ZHEL-it, duke parë këtë si një proces i cili ndihmon në rritjen ekonomike dhe të punësimit në nivelin lokal e njëkohësisht edhe atë nacional, sipas tyre; Zhvillimi ekonomik me bazë lokale dhe nxitja e punësimit ka më shumë gjasa të dëshmojnë të suksesshëm në qoftë se drejtohen në nivel lokal se sa në një

nivel tjetër. Secili prej faktorëve që ndikon në ekonomi manifestohen në një mënyrë unike dhe ka pjesërisht shkaqe të ndryshme në secilin komunitet lokal. Zgjidhje për problemet lokale nuk do të jetë e suksesshme në qoftë se nuk synojnë grupe të veçanta dhe në qoftë se nuk janë të lidhura me tërë sistemin ekonomik rajonal.

Këta dy autorë kanë dhënë një kontribut të madh edhe në përcaktimin e instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal, është interesantë së këta autorë instrumentet e zhvillimit e ekonomik lokal i klasifikojnë në katër grupe, duke vazhduar me nën ndarje të secilit grup të mjeteve/instrumenteve të ZHEL-it.

Instituti Uphjon në SHBA përmes autorit Timothy J. Bartik, në studimet e bërë në fushën e ZHEL-it ka bërë një analizë dhe hulumtim mjaftë të rëndësishëm, ky autorë pos kontributit në pasurimin e vetë konceptit të ZHEL-it, ka bërë edhe studime të rëndësishme në identifikimin dhe përcaktimin e fazave të zhvillimit të konceptit dhe të formave konkrete të mbështetjes të ZHEL-it.

Autori Bartik, çmohet edhe për atë se në punimet shkencore të vitit 1993, 2003 dhe 2010, arsyeshmërinë e aplikimit të ZHEL-it si një proces të domosdoshëm në zhvillimin bashkëkohorë ekonomik të një vendi e ka mbështet përmes aplikimit të matjeve ekonometrike dhe formave të tjera sasiore të hulumtimit, kështu punimet e tij ofrojnë të dhëna numerike të cilat tregojnë përfitimet dhe kostot e programeve të ndryshme lokale zhvillimore.

Kontributi këtij autori, padyshim, është edhe në përcaktimin e fushave të fokusimit dhe instrumentet e zhvillimit ekonomik lokal, pastaj në definimin e qëllimeve thelbësore të cilat duhet të i përmbushin programet/projektet e ZHEL-it për të gëzuar mbështetjen e pushtetit lokal etj.

Konsideroj se është njëri ndër autorët që në mënyrë praktike përmes studimit të rasteve konkrete në SHBA, si në rastin e Micingenit, Karolinës së Veriut etj, ka argumentuar se procesi i ZHEL-it është një mekanizëm që i duhet zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të një vendi, sipas këtij autori problemet me të cilat përballën qytetarët më së miri mund të zgjidhën në nivelin lokal, pa dyshim se autori ashtu si edhe të tjerët nuk e neglizhon ndikimin e qeverisë qendrore dhe të partnerëve të tjerë.

Ndërsa Soňa Čapková, nga Open Society Institute Budapest, ka bërë një studim shumë interesant në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ose vendet e ish-kampit socialist,

kjo autore ka bërë një vlerësim dhe analizë lidhur me problemet me të cilët janë përballur vendet ish socialiste gjatë fazës së tranzicionit dhe konsolidimit të shoqërisë demokratike, Posaçërisht janë me interes studimet e kësaj autore e cila pos që bënë një analizë për komplet tranzicionin dhe interesin e aplikimit të procesit të ZHEL-it, në përballjen dhe zbutjen e pasojave që shkakton ndryshimi i sistemit politik dhe ekonomik, në studim e saj bënë një analizë edhe për çdo vend veç e veç. Pra ky studim përmbledh edhe përvojat e vendeve të ndryshme të ish kampit socialist në aplikimi e procesit të ZHEL-it.

Kështu pjesa e parë e studimit shqyrton kontekstin e përgjithshëm që mbështetë mënyrat në të cilat qeveritë lokale në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë zhvilluar qasjen e tyre, pastaj janë hulumtuar efektet e ndryshimit në shoqëri dhe në zhvillimin ekonomik lokal, duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë te autoritetet lokale për t'u angazhuar në aktivitetet e zhvillimit ekonomik lokal.

Pjesa dytë vazhdon t'i hulumton politikat aktuale të zhvillimit ekonomik lokal në gjashtë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe t'i diskuton çështjet kryesore të cilat kanë lindur gjatë projekteve të reformës së pushtetit lokal. Kjo autore në këtë studim jep një kontribut edhe në përcaktimin e instrumenteve të ZHEL-it të cilët janë aplikuar apo që do të duhej aplikohen gjatë procesit të ZHEL-it në vendet e ndryshme.

Autori K. KOLLÁR, në një punim studimor që bënë lidhur me ekzaminimin e instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal, veçanërisht me një konsideratë për Vjenën, ky studim i botuar në Buletinin Hungarez të Kimisë Industriale HJICH, vol, 39 (1), pp-21-25(2011), bënë një analizë të instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal.

Është interesante se autori duke e studiuar rastin e Vjenës, bënë një përmbledhje të instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal që janë identifikuar dhe aplikuar nga autorë të ndryshëm. Besoj se ky studim kontribuon në mbështetjen si të hulumtuesve ashtu edhe të zbatuesve të ZHEL-it në, si burim mirë për përfitimin e njohurive të nevojshme.

Autorët Francisco Alburquerque dhe Gabriel Aghón, nga Institute of Economics and Geography, i Spanjës kanë bërë një studim për procesin e ZHEL-it në vendet e Amerikës latine, në rastin e tyre studimor, është bërë një hulumtim i specifikave të këtyre vendeve në këtë proces.

Në artikullin e tyre me titull "Zhvillimi ekonomik lokal dhe decentralizimi në Amerikën Latine" autorët vlerësojnë rëndësinë e procesit të zhvillimit ekonomik lokal në zhvillimin e tërësishëm të vendeve të Amerikës Latine. Gjithashtu sipas këtyre autorëve procesi i

decentralizimit është mjaftë me rëndësi për suksesin e ZHEL-it por decentralizmi nuk nënkupton vetëm decentralizmin fiskal por ai duhet të jetë më gjithëpërfshirës për t'i mundësuar qeverive lokale të kenë mundësi me mbështet zhvillimin ekonomik lokal, theksojnë këta autorë në këtë studim.

Edhe disa autor të regjionit, veçanërisht autori Dušan Vasiljeviq dhe disa të tjerë, kanë bërë studime të rëndësishme në fushën e ZHEL-it, p.sh. autori Dušan Vasiljeviq në librin “Zhvillimi ekonomik lokal, pse disa komuna përfitojnë ndërsa të tjerat humbin”, bënë një analizë për rolin që ka pushteti lokal dhe partnerët e tij në krijim e mirëqenies ekonomike për komunitetin lokal. Sipas këtij autori, tanimë është dëshmuar se nuk janë të mjaftueshme vetëm përparësitë gjeografike pasuritë natyrore, afërsia më korridoret e transportit, për të pasur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Kjo jep të kuptojmë se, pa një aktivizim të qeverisë lokale dhe partnerëve të tjerë, si komuniteti biznesit dhe sektori jo qeveritar, nuk mund të kemi një rritje ekonomike, punësim dhe një mirëqenie sociale.

Është i pa tejkaloreshëm roli i Bankës Botërore, në procesin e ZHEL-it, ky institucion shumë i rëndësishëm ndërkombëtar, është kontribuuesi më i madh në promovimin e këtij procesi. Përmes hulumtimeve, botimeve të broshurave, udhëzimeve dhe formave të tjera Banka Botërore ka dhënë dhe vazhdon të jep kontributin më të madh, jo vetëm në definimin dhe arsyetimin e ZHEL-it, por kontributi i këtij institucioni është shumë i madh përmes angazhimeve direkte në vendet e ndryshme të botës, veçanërisht në ato vende ku mungojnë kapacitetet vendore. Ekspertet e Bankës Botërore janë kontribuuesit më të mëdhenj, në ndërtimin e teorisë shkencore të ZHEL-it, sepse ata me veprimet praktike po e demonstrojnë suksesin e këtij procesi.

Edhe organizatat e tjera si USAID, UNDP, Komisioni Evropian (BE), janë kontribuues në afirmimin dhe fuqizimin e ZHEL-it, duke ofruar asistencë financiare, teknike dhe ekspertizë për vendet e ndryshme.

Veçanërisht, roli i këtyre organizatave është i pa zëvendësueshëm për vendet në zhvillim, vendet në tranzicion dhe atyre të dala nga konfliktet luftarake. Është me rëndësi të ceket se, Bashkimi Evropian përmes fondeve të para anëtarësimit në BE dhe programeve për zhvillim rajonal koherentë, po angazhohet në fuqizimin e rolit të qeverive lokale në bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

3.8 Konkluzionet rreth teorive për ZHEL-in

Zhvillimi ekonomik lokal si proces, është njëra prej fushave të zhvillimit ekonomik me të cilën janë marrë dhe vazhdojnë të merren autorë dhe institucione të rëndësishme, si në nivelin kombëtarë ashtu edhe atë ndërkombëtar. Nga ajo që autorët e ndryshëm kanë shkruar dhe kanë argumentuar përmes studimeve në sensin e shtjellimit, argumentimit të ZHEL-it deri më tani mund të nxjerrim këto përfundime: ZHEL-i është një proces zhvillimor i cili ka filluar të aplikohet në formën e konceptit aktual nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, edhe pse elementet e këtij procesi janë hasur edhe shumë më herët.

ZHEL-i është një proces kompleks i cili kërkon një qasje serioze të, qeverisë lokale dhe partnerëve të tjerë siç janë; sektori privat dhe ai jo fitimprurës (komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile), pa dyshim se rolin udhëheqës duhet ta ketë qeveria lokale. Hartimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal është i domosdoshëm, ky dokument duhet të jetë si një kornizë e cila do t'i përcaktonte, objektivat, afatet, partnerët dhe burimet e financimit të programeve/projekteve zhvillimore. Pos në hartim të këtij dokumenti strategjik, edhe në fazat e realizimit dhe mbikëqyrjes kërkohet një angazhim i qeverisë lokale dhe partnerët të tjerë. Dokumenti duhet t'i nënshtrohet një analize komplekse duke marrë parasysh të gjitha situata, pra duhet të përcillet me një SWOT analize.

ZHEL-i si proces apo koncept që sot vazhdon të aplikohet është zhvilluar nëpër faza, çdo fazë ka karakteristikat e veta të veçanta. Është një pajtueshmëri ndërmjet autorëve se përkundër ndarjes nëpër faza, zhvillimi nga faza në fazë nuk ka ndonjë ndarje strikte, shpesh elementet e një faze mundë dhe përdoren edhe në fazat e tjera.

Përpos decentralizimi i cili është kusht për suksesin e ZHEL-it, kërkohet që njësitë e qeverisjes lokal/pushteti lokal të ndërtoj kapacitete administrative, profesionale dhe ligjore për t'u marrë me këtë proces. Roli i qeverisë lokale në procesin zhvillimor nuk e zbeh rëndësinë e rolit të qeverisë qendrore, përkundrazi për të pasur një ZHEL të suksesshëm kërkohet edhe angazhimi i qeverisë qendrore, institucioneve regjionale përmes krijimit të strategjive të përbashkëta zhvillimore.

Zhvillimi ekonomik lokal tanimë është i pranuar nga pjesa dërmuese e autorëve dhe institucioneve të rëndësishme ndërkombëtarë, si një proces i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të çdo vendi.

KAPITULLI IV: Historiku i zhvillimit të Kosovës

4.1 Zhvillimi i Kosovës deri në qershor të vitit 1999

Territori i sotëm i Republikës së Kosovës ka një sipërfaqe prej rreth 11.000 km². Kufijtë e tanishëm janë të trashëguara nga kufijtë administrativë që i kishte me ndarjen territoriale administrative të ish-Jugosllavisë, të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Kosova ka një pozitë mjaftë të rëndësishme gjeostrategjike në Gadishullin Ballkanik. Kjo pozitë i krijon mundësi shumë të mirë për t'u lidhur me korridoret e rëndësishme të rajonit.

Kosova edhe pse është një vend i vogël, pozita e saj e mirë gjeografike, laramania dhe shumëllojshmëria e faktorëve si gjeologjik, të relievit dhe biodiversiteti shumë i pasur i kanë mundësuar të jetë vend me mundësi të mëdha për zhvillim: Në një hapësirë gjeografike aq të kufizuar, janë zhvilluar gati të gjitha kategoritë e relievit me forma të larmishme dhe gjithashtu me ndryshime të theksuara klimatike. Ndërrimet në elementet natyrore janë manifestuar edhe në tipat e tokave dhe vegjetacionit natyror, duke e bërë një peizazh specifik, (IPH, 2004, 10).

Kosova përgjatë historikut të zhvillimit ka pas një ecje shumë të veçantë, sepse vendi ka kaluar nëpër situata shumë interesante, të cilat kanë përcaktuar zhvillimin e përgjithshëm, shoqëror, ekonomik dhe kombëtar.

Autori Oliver Schmitt, duke përshkruar Kosovën, si hapësirë e veçantë, jep një përshkrim për zhvillimet e ndodhura gjatë kohës së mesjetës së hershme e deri në ditët e sotme. Sipas tij, territori administrativ me emrin Kosovë, është krijuar shumë vonë: në vitin 1877, kur Perandoria Osmane themeloi Vilajetin me emër të njëjtë, i cili përfshinë pjesë të mëdha të Republikës së sotme të Maqedonisë, dhe po ashtu pjesë të Serbisë dhe Malit të Zi. Pra, ky territor nuk përputhet me hapësirën dukshëm më të vogël të Kosovës së sotme, (Schmitt, 2012, 29).

Ndërsa autori Kurtesh Salihu, tiparet e veçanta të Kosovës në ish- Jugosllavi, ia atribuon një numri të faktorëve të cilët e kanë përcjellë zhvillimin . Autori kryesisht potencon, faktorët: kombëtar, ekonomik, gjeografik dhe historikë, sipas tij janë këta faktorët kryesorë që kanë qenë përcaktues të zhvillimit të autonomisë së Kosovës në kuadrin e ish -Jugosllavisë, (Salihu, 1984, 11,12,13).

Duke analizuar shkrimet e autorëve të ndryshëm si dhe burimet e ndryshme faktografike, shikuar nga këndvështrime të ndryshme, procesi i zhvillimi të Kosovës, është specifik dhe si i tillë ka karakteristikat që e veçojnë nga vendet e tjera..

Ekonomia: Kosova është një hapësirë gjeografike, e cila ka resurse të mëdha natyrore. Nëntoka është e pasur me xehe të ndryshme të metaleve dhe jo metaleve, kurse mbi toka është e pasur me një relief, i cili krijon mundësi për zhvillim qëndrueshëm ekonomik. Zhvillimi ekonomik nuk është në përputhje me resurset që ka kjo hapësirë gjeografike. Kosova vazhdon akoma të jetë një vend me papunësi të lartë, me të ardhura të ulëta për kokë banori, strukturë ekonomike të pa përshtatshme, me shkallë të lartë të varfërisë etj., me tregues tipik të vendeve me zhvillim të ulët ekonomik.

Autorë të ndryshëm që kanë trajtuar problemet zhvillimore të Kosovës, kanë konkluduar se, “Zhvillimi ekonomik i Kosovës, lidhur në aspektin kohorë prej Dardanisë ilire e deri më sot, ishte i kushtëzuar nga burimet e shumta të pasurive natyrore dhe nga lakmitë dhe interesat e pushtuesve për zotërimin e tyre”, (Studim, grup autorësh, 1997, 1). Ekonomisti Nuri Bashota, resurset natyrore të Kosovës i vlerëson si një mundësi të mirë për zhvillim të qëndrueshëm dhe dinamik. Sipas këtij autori, në territorin e Kosovës gjenden rezerva kolosale të resurseve të llojllojshme natyrore, si plumbit, zinkut, argjendit, arit, ferro nikelit, kromit, kadmiumit, volframit, boksitit, manganit qymyrit (linjtit), uraniumit, selenit, kuarcit, azbestit, kaolinit, bentonitit, talkut, tufit, argjilat, leucitit, haloizitit, dunitit, laporcit, gurit dekorativ dhe një varg metalesh të rralla që mund të fitohen nga zgura (shlaka) industriale në Trepçë dhe në shkretore të tjera, (Bashota, 2003, 11).

Siç shihet edhe nga autorët e cekur më lartë, resurset natyrore janë një burim i fuqishëm për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm për Kosovën. Nga shkenca ekonomike është e ditur se ekzistojnë teoritë të ndryshme, rreth rolit të pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik të një vendi. Njëra palë e mbështet konceptin se pasuritë natyrore luajnë rolin kryesor në zhvillimin e një vendi dhe pala e tjetër e cila vlerëson se mungesa e pasurive natyrore nuk është pengesë e zhvillimit. Përvoja nga zhvillimi i vendeve të ndryshme ka dëshmuar se nuk është e mjaftueshme që një vend të ketë pasuri natyrore për të qenë i zhvilluar, zhvillimit ekonomik i duhen edhe faktorë të tjerë mjaftë të rëndësishëm, kjo është dëshmuar në shumë vende të Afrikës dhe Azisë etj..

Zhvillimi i Kosovës që nga kohërat e lashta deri në gjysmën e dytë të shekullit njëzet ka qenë kryesisht e bazuar në këto burime natyrore dhe në shfrytëzimin e tyre në mënyrë

mjaftë ekstensive. Historiani i njohur Oliver Shchmit, zhvillimin ekonomik e përshkruan si në vijim: Deri në periudhën e vonshme shumica e banorëve të Kosovës merrej nga bujqësia. Veprimtaria bujqësore si në të gjitha vendet e rajonit kishte karakter vetë ushqyes dhe ishte shumë dobët e lidhur me tregun, nuk ishte e lidhur ose ishte dobët e lidhur me njohurit në lëmin e bujqësisë, në aplikimin e teknologjisë së avancuar të kohës. Kosova hynte në mesin e territoreve më të pazhvilluara, deri në shekullin 20-të bujqësia stagnoi kryesisht në nivelin teknik të mesjetës, (Shchmit, 2012,83).

Për pos bujqësisë dhe blegtorisë që ishin dega kryesore e ekonomisë së Kosovës deri në ditët e sotme, degë e rëndësishme ka qenë edhe xehetaria. Sipas po të njëjtit autorë, nga minierat e Novobërdës, Janjevës, Trepçës dhe maleve të Kopaonikut nxirrej argjend dhe plumb. Në mesjetën e vonshme Novobërda ishte ndër qytetet më të mëdha dhe më të pasura të Ballkanit, (Shchmit, 2012,83). Autori gjatë përshkrimit të veprimtarive ekonomike të cilat janë zhvilluar në kohën para moderne përmendë edhe tregtinë transitore si një degë mjaftë e rëndësishme e cila zhvillohej në drejtimin perëndim–lindje (Shkodër-Kosovë) dhe veri-jug (e ashtuquajtura rruga boshnjake; lidhja me Stambollin; deri në shekullin 17 kjo tregti me karvanë në pjesën më të madhe ishte në duart e tregtarëve Dubrovnikas. Një degë tjetër ishte edhe zeytari e cila ishte e koncentruar kryesisht në qytete, ndërsa në fshatra nuk zhvillohej me përjashtim të mullinjve dhe kovaçhanave, (Shchmit, 2012,83).

Edhe autori tjetër Muj Gjonbalaj, në librin e tij prezanton zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të asaj kohe duke potencuar: “Territori sotëm i Kosovës vlerësohej me shumë pasuri xehesh, begati bujqësore e blegtorale, në kuadrin e shtetit serb të mesjetës. Veprimtaria zeytare bëhet e njohur veçmas nga koha e mesjetës, me vendosjen e Sasëve në rrethinën e Mitrovicës, Janjevës dhe Novobërdës. Në vitin 1332, Bocardi shkruante se në Serbi (mendohej kryesisht në territorin e sotëm të Kosovës), kishte pesë miniera të arit po aq të argjendit dhe miniera të përziera me ari dhe argjend. Kosova ishte mirë e lidhur me qendrat tregtare të civilizimit të asaj kohe, siç ishin Dubrovniku, Selaniku dhe Kostandinopoja, (Gjonbalaj,1997,11).

Zhvillimi ekonomik i Kosovës nga kohërat e mesjetës së hershme e deri në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, kishte një dinamikë shumë të ngadaltë të zhvillimit, degë kryesore ishte bujqësia e cila bëhej në mënyrë mjaftë primitive, kurse degët e tjera veçanërisht

xehetaria shfrytëzohej për nxjerrjen e xehes dhe plasimin në treg në formë të lëndës së parë, e pa përpunuar.

Kosova hapat e parë në krijim e një ekonomie me strukturë të mirëfillta, me degë dhe sektor që filluan të bëjnë aplikim e metodave dhe teknikës së përpunuar në prodhim dhe fushat tjera ekonomike e filloj tek në pjesën e dytë të shekullit njëzet.

Ekonomia e Kosovës pas vitit 1945 - Përderisa për zhvillimin ekonomik para luftës së dytë botërore, më tepër është shkruar në kontekstin e përgjithshëm, sepse kanë munguar të dhënat e përpunuara qoftë nga autorë apo institucione përgjegjëse, për t'i shprehë ecurit e zhvillimit më tregues ekonomik, faza pas viti 1945 na mundëson për të parë këtë ecuri për mes treguesve ekonomik të përpunuar dhe prezantuar nga autore dhe institucione përgjegjëse.

Pas përfundimit të luftës së dytë botërore, Kosova fillojë një periudhë të re të zhvillimit. Ndryshimet ishin thelbësore në të gjitha fushat jetës, që nga vendosja e sistemit politik e deri tek ndërtimi i sistemit ekonomik (respektivisht modelit ekonomik), një koncept krejt ndryshe nga ai që ishte më parë edhe nga ai që e kishin vendet me ekonomi të zhvilluar të tregut. Zhvillimin ekonomik gjatë kësaj periudhe e ka përcjell fati i zhvillimeve politike nëpër të cilat ka kaluar vendi, respektivisht pozita juridiko politike e Kosovës në shtetin e ish Jugosllavisë.

Me të drejtë disa autorë në një studim të bërë nga Instituti ekonomik konkludojnë se: “Zhvillimi i ekonomisë së Kosovës në periudhën e pasluftës është i lidhur ngushtë me proceset dhe dridhjet politike në ish Jugosllavi, element konstituiv dhe faktor shtet formues i së cilës ishte edhe vetë Kosova” (Inst. Ek., 1997, 3).

Si do që të jetë, ekonomia e Kosovës, në këtë periudhë ka pësuar një ndryshim rrënjësor, duke ndërtuar një strukturë gjithëpërfshirëse ekonomike, me zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë, në kuptimin e kompleksitetit të saj. Zhvillimin e ekonomisë së Kosovës autorët e ndryshëm që e kanë studiuar këtë periudhë e ndajnë në tri nën periudha apo faza. Ndarja është bërë duke u bazuar në përkushtimin respektivisht në politikat zhvillimore të aplikuara në Kosovë nga ana e institucioneve përgjegjëse. Faza e parë përfshinë periudhën nga pas lufta deri në vitet e gjashtëdhjeta, e dyta nga vitet e gjashtëdhjeta deri në fund të viteve të tetëdhjeta dhe ajo pas viteve të tetëdhjeta deri në vitin 1999.

Struktura e ekonomisë së një vendi me tërë kompleksitetin e sajë, është faktorë shumë i rëndësishëm në ecurinë e zhvillimit, për këtë ne do të prezantojmë trendin e zhvillimit të

ekonomisë së Kosovës në këtë periudhë përmes treguesve makro ekonomik, për të parë reflektimin e saj në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit.

Autori, Ali Jakupi, në librin finalizimi si dimension i strategjisë së zhvillimit të Kosovës, thekson se: “Struktura ekonomike mund të trajtohet nga dy aspekte: 1. Nga ecuria dinamike dhe 2. Nga gjendja ekzistuese në kohë të caktuar. Me rastin e analizës së ecurive dhe gjendjes së strukturës ekonomike në një moment të caktuar, është e nevojshme të bëhen vlerësime në lidhje me nivelin e zhvillimit ekonomik, në mënyrë që të vështrohet, pastaj ndërrimi struktural nëpër etapa të zhvillimit, (Jakupi. 1985, 102).

Në vazhdim do të paraqitet shkalla e zhvillimit ekonomik të Kosovës, për mes treguesve makroekonomik, si produkti i brendshëm kombëtar (GDP), struktura e GDP-së, punësimi, struktura e punësimit sipas degëve ekonomike etj.

Produkti i brendshëm bruto (GDP) - Është njëri prej treguesve makroekonomik, përmes të cilit paraqiten ecuritë ekonomike të një vendi, kështu gjatë studimit të procesit zhvillimit ekonomik është i pa tej kalueshëm analizimi i këtij treguesi: Në fakt sa i përket të Kosovës, nga pas lufta e dytë botërore, hasim në matjen e zhvillimit përmes këtij indikator, kështu nga prezantimet që do të bëhen do të shohim trendin e zhvillimit përmes këtij dhe indikatorëve të tjerë.

Tabela 4: Norma e shtimit të produktit shoqëror (GDP) në ekonominë e Kosovës

Periudha kohore	Norma mesatare e shtimit vjetor
1948 – 1960	4,5
1961 – 1970	7,0
1971 – 1980	5,5
1981 – 1988	0,9
1948 – 1988	4,9

Sipas të dhënave të prezantuara nga studimi i Instituti Ekonomik, normat vjetore mesatare të shtimit dallohen nëpër disa periudha. “Norma më e madhe e produktit shoqëror (GDP-së) shënohet në periudhën e viteve 1961-1970, d.m.th. kur vihet në raport viti i kthesave në ekonomi, me vitin inicial të industrisë. Në periudhën e viteve 1971-1980, norma mesatare vjetore e shtimit është më reale, për shkak të funksionimit të kapaciteteve të reja, që bëhen bazë rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Ndërkaq, norma mesatare e viteve 1948-1960, prej 4.5% nuk është asgjë tjetër pos rezultat i raportit me bazë fillestare tepër të ulët, (Studim, grup autorësh, 1997, 5).

Siç është cekur edhe më lartë, çështjet e trendit dhe shkallës së zhvillimit të ekonomisë së Kosovës pas luftës s dytë botërore, respektivisht nga viti 1945, janë studiuar nga autorë të shumtë që e kanë analizuar këtë çështje përmes treguesve të ndryshëm. Kështu, pos që është paraqitur trendi i zhvillimit përmes së GDP-së, në nivel të përgjithshëm, kjo është bërë duke e analizuar edhe pjesëmarrjen e degëve të veçanta në GDP-në totale, që njëherit tregon edhe strukturën e ekonomisë Kosovare. Autori tjetër, Gjonbalaj, në një studim për Institutin Ekonomik, bënë një përshkrim analitik të GDP-së sipas , lëmenjve ekonomike dhe periudhave kohore, duke përfshirë edhe vitin 1995.

Tabela 5: Struktura e produktit shoqëror sipas lëmenjve të ekonomisë, Çmimet e vitit 1972

Lëmenjtë ekonomik/viti	1952	1962	1972	1982	1988	1995*
EKONOMIA GJITHËSEJ	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
SEKTORI PRIMAR	48.3	39.8	25.0	24.0	25.8	37.4
1) Bujqësia dhe Peshkataria	45.6	38.5	24.1	23.4	25.0	36.7
2) Pylltaria	2.7	1.0	0.6	0.5	0.5	0.6
3) Hidroekonomia	-	0.3	0.3	0.5	0.3	0.1
SEKTORI SEKONNDAR	32.5	41.0	54.0	50.3	52.8	28.3
1) Industria e Xehetaria	24.7	24.0	38.9	37.1	45.2	20.6
2) Ndërtimtaria	4.8	9.0	12.7	11.4	5.9	5.9
3) Zejtaria	3.0	8.1	2.4	1.8	1.7	1.8
SEKTORI TERCIAR	19.2	19.7	21.0	25.3	21.4	34.3
1) Komunikacioni e lidhjet	4.4	4.1	5.1	5.3	5.4	4.5
2) Tregtia	12.8	11.0	12.6	14.8	11.5	25.8
3) Hoteleri e Turizmi	-	2.1	2.0	2.3	1.9	4.5
4) Veprimtaria, Komunale banesore	2.0	2.0	1.3	1.6	2.6	1.5

Burimi: Përpunim i autorit; (Gjonbalaj, 1997, 24).

Vërejtje:* Për vitin 1995 struktura e produktit shoqëror është në çmimet e vitit 1990, (Gjonbalaj, 1997, 24)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.5, shihet trendi i rënies së pjesëmarrjes së sektorit primar në krijim e produktit shoqëror (GDP), të ekonomisë së Kosovës, nga 48,3 %, në vitin 1952 në 25.8%, në vitin 1988. Në të njëjtën periudhë shtim të pjesëmarrjes në krijimin e produktit shoqëror ka shënuar sektori sekondar, nga 32.5% në vitin 1952 në 52.8%, në vitin 1988, dhe sektori terciar nga 19.2%, në vitin 1952, në 21.4%, në vitin 1988.

Gjithashtu, edhe brenda sektorëve të ekonomisë, shihen trendët e rritjes, respektivisht, rënies së lëmenjve të caktuar të ekonomisë së Kosovës. Të dhënat për vitin 1995, paraqesin gjendjen pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe futjes së ekonomisë nën menaxhim të dhunshëm nga ana e organeve të Serbisë. Kjo situatë tregon trendin e çrregullimit të strukturës ekonomike, e cila ka qar në rënie e bruto produktit të brendshëm në lëmit si, industria nga sektori sekondar dhe shihet një rritje pjesëmarrjes së tregtisë në GDP-në.

Punësimi dhe struktura e punësimit sipas degëve të ekonomisë - Një tregues tjetër i rëndësishëm për paraqitjen e nivelit të zhvillimit ekonomik të një vendi, padyshim është edhe punësimi dhe struktura e tij. Në vazhdim do të prezantojë numrin dhe strukturën e punësimit në Kosovë, sipas periudhave kohore nga pas lufta e dytë botërore deri në vitet e nëntëdhjeta. Instituti ekonomik në një studim të bërë nga një grup autorësh, (Studim, grup autorësh, 1997, 18), në analizën që i ka bërë zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe mundësit për zhvillim të më tejme ka paraqitur edhe numrin dhe strukturën e të punësuarve nga viti 1952 deri në vitin 1988.

Tabela 6: Numri i të punësuarve në ekonominë e Kosovës

Vitet	1952	1955	1960	1970	1980	1988
Numri	38.000	43.376	71.249	100.082	178.000	231.748

Burimi: "Jugosllavia trideset godine posle oslobodjenja i pobede nad fašizmom" 1945-1975, SZS, Beograd, 1975, fq, 111; VSK, 1989, fq, 86, (Studim, grup autorësh, 1997, 18).

Nga tabela nr,6 shihet numri dhe trendi i të punësuarve në ekonomin e Kosovës. Nga ajo që prezantohet në tabelë dhe nga të dhënat që ofrojnë autorët, numri i të punësuarve ka një rritje të vazhdueshme me një trendë pozitivë. Është me rëndësi të ceket se në numrin e përgjithshëm të punësuarve, dominonë me mbi 70 % veprimtaria ekonomike.

Kështu në vitin 1955 nga 43.376 të punësuar, 73,4% i përkasin veprimtarisë ekonomike, kurse në vitin 1970 nga 100,082, veprimtarisë ekonomike i përkasin 68,9 %, në vitin 1980 nga 178,000 të punësuar 71,9 % i përkasin veprimtarisë ekonomike për të shkuar në vitin 1988 nga 231.748 në 75,21 % të punësuar në veprimtari ekonomike.

Autori tjetër (Gjonbalaj, 1997, 27) ka analizuar strukturën e të punësuarve sipas sektorëve, lëmenjve dhe degëve të ekonomisë, për të pasqyruar ndryshimet strukturore ekonomike, socio-ekonomike të popullsisë i cili është një tregues mjaftë i rëndësishëm për ta vlerësuar shkallën e zhvillimit ekonomik të një vendi.

4.2 Zhvillimi i Kosovës nga qershori 1999 deri në shkurtë 2008

Kosova pas një periudhe dhjetëvjeçare të okupimit klasik nga Serbia dhe një lufte rreth dy vjeçare, nga e cila pësoi shkatërrime material, ekonomike dhe viktima në njerëz, në qershor të vitit 1999, vendoset nën administrimin e Kombeve të Bashkuara sipas Rezolutës 1244.

Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur si UNMIK, nga qershori, filloj me ngritjen dhe ndërtimin fillimisht të administratës publike, duke vazhduar me ndërtimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore dhe ekonomike. Këshilli Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (Rezoluta, 1244,1999) autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm që të bëjë: Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve; d) Bajtjen e përgjegjësisë të veta administrative institucioneve që do të themelohen, duke mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes, (Rezoluta, 1244, 1999).

Kjo fazë karakterizohet me ndërtimin e institucioneve qeverisëse në nivelin lokal dhe atë qendror. Kështu në vitin 2000 u formuan institucionet e qeverisjes lokale të dala nga procesi i zgjedhjeve lokale, ndërsa në vitin 2001 janë themeluar institucionet qendrore të qeverisjes, të ashtuquajtura “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes-IPVQ” , Kuvendi , Qeveria dhe Presidenca e Kosovës.

Në fushën e zhvillimit ekonomik, është faza e rindërtimit, themelimit të bazës institucionale dhe ligjore për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe tranzicioni.

Kosova ishte vendi i fundit ish socialist i cili po futej në procesin e transformimit të sistemit politiko- juridik dhe atij ekonomik. Procesi i tranzicionit në këtë rast ka qenë i veçantë, i cili burimin e ka në vet mënyrën e administrimit dhe situatën e rëndë socio-ekonomike të shkaktuar nga konflikti dhe okupimi klasik dhjetë vjeçar. Administrata e UNMIK-ut së bashku me Qeverinë e Kosovës në këtë fazë kanë ndërtuar, infrastrukturën ligjore edhe atë institucionale, janë krijuar politika të cilat mundësojnë zhvillimin e sektorit privat, tregun të lirë, tregtinë e jashtme etj.

Në këtë fazë të tranzicionit në Kosovë kujdes i veçantë i është kushtuar krijimit të kushteve për ekonomin e tregut të lirë, konkurrencës së lirë dhe tregtisë së jashtme. Në të gjitha dokumentet shtetërore, Rregulloret e UNMIK-ut që kishin fuqinë e ligjit të aprovuar, promovohet, mbrohet dhe sanksionohet konkurrenca e lirë, gjegjësisht cenimi i konkurrencës së lirë. Po ashtu, gjatë kësaj kohe janë themeluar institucionet që promovojnë dhe garantojnë konkurrencën e lirë dhe ekonominë e tregut të lirë, (Shatri, 2016, 64).

Tranzicioni në fushën ekonomike ka qenë njëra ndër sfidat kryesore të administratës së UNMIK-ut dhe të Institucioneve qeverisëse IPVQ të Kosovës, posaçërisht sfidues ka qenë procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Sfidues dhe i veçantë ka qenë, për shkak të së drejtës mbi pronën, meqë statusi i Kosovës ishte akoma i pa përcaktuar. Përkundër sfidave dhe pengesave të hasura nga Serbia dhe faktorët e tjerë ky proces ka filluar dhe është përmbyllur në një masë të madhe gjatë kësaj periudhe. Këto dhe problemet e tjera më të cilat është përballur Kosova kanë ndikuar që administrata ndërkombëtare në Kosovë dhe Institucionet qeverisëse vendore të përcaktohen për modelin e privatizimit sipas Spin-of.

Këto rregulla dhe modeli i aplikuar në Kosove janë përpiluar me qëllim që privatizimi të mund të realizohet pa pengesë nga kërkesat e ndryshme pronësore-këtu mendohet nga kërkesat që vinin nga Serbia, e cila Kosovën e konsideronte pjesë të veten, kurse pronën e Kosovës, si pronë të saj. Kjo, në aspektin ndërkombëtar fuqizonte administratën e OKB-së në Kosovë nga përgjegjësia eventuale, meqë Kosova ende nuk e kishte te zgjedhur Statusin e saj politik, (Shatri, 2016, 70).

Pra kjo periudhë e zhvillimit të Kosovës, identifikohet me, formimin e institucioneve qeverisëse, rindërtimin bazës ekonomike dhe sociale, krijimin e bazës ligjore dhe

institucionale , tranzicionin ekonomik dhe shoqëror dhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.

4.3 Zhvillimi i Kosovës nga 2008 e tutje

Përfundimi i administrimit të UNMIK-ut dhe fillimi i qeverisjes së vendit nga institucionet qeverisëse kombëtare, është faza kur zënë fill krijimi i politikave të pa ndikuara nga pengesat që shkaktoheshin si pasojë e statusit të pa definuar.

Shpallja e pavarësisë me 17 shkurt 2008, dhe aprovimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës bëri që Qeveria dhe institucionet e tjera relevante, karshi angazhimit në arritjen e mbështetjes nga sa më shumë shtete në arenën ndërkombëtare, punuan edhe në përgatitjen e politikave zhvillimore për sektorë të ndryshëm shoqërore dhe ekonomik. Plani Ahtisarit ishte dokumenti bazë i parimeve të deklaratës për shpalljen e pavarësisë. Në bazë të këtij plani (Planit të Presidenti Martti Ahtisaari) dhe duke u thirrur në Rezolutën 1244, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Kostarika dhe Afganistani ishin vendet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës, të përcjella nga Shqipëria, SHBA-të, Britania, Gjermania dhe Franca. Kushtetuta e Republikës u miratua më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008, kur edhe u bë transferimi i plotë i kompetencave prej UNMIK-ut në institucionet vendore, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Kosova> (marrë me 15.12.2016).

Shpallja e pavarësisë së vendit dhe njohja nga shumica e shteteve më të fuqishme dhe me demokraci të zhvilluar, bëri që institucionet fillojnë të kenë qasje edhe nëpër institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, siç janë, procesi i përgatitjes për anëtarësim në BE, anëtarësimi në BB, FMN, BERZH, si dhe qasja në organizatat e ndryshme regjionale si CEFTA, bashkëpunimet e ndryshme në evenimentet regjionale me rëndësi.

Deri më tani është arritur anëtarësimi i Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa mundësia e anëtarësimit në OKB pritet të ndodhë në të ardhmen. Po ashtu, qeveria ka shpallur synimin për integrim në Bashkimin Evropian dhe Aleancën Veri-Atlantike, NATO, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Kosova>, (marrë , me 15.12.2016).

Republika e Kosovës është e përkushtuar në rrugëtimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në këtë drejtim, në vitin 2015, ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ndërmjet autoriteteve të BE-së dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës: Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-

Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 30 tetor 2015, përmes Vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, <http://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit>, (marrë me datë, 15.12.2016).

Anëtarësimi në institucionet të rëndësishme ndërkombëtare dhe nënshkrimi i MSA-së si dhe proceset e tjera në fushën e integritetit Evropian, kanë bërë që Kosova si një shtet i vogël dhe me ekonomi të pa zhvilluar të merr përgjegjësi dhe obligime ndërkombëtare të cilat i krijojnë mundësi dhe sfida në procesin zhvillimor.

4.4 Ekonomia dhe ecuritë zhvillimore; Vështrim i përgjithshëm

Kosova si vendi më ri, përpos sfidave të shumta në fushën e njohjeve nga shtetet e ndryshme të botës dhe të anëtarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare, është edhe vendi me ekonomi më të pa zhvilluar në Evropë, me numër të madh të pa punëve, me deficit të madh tregtar dhe nivel të lartë të varfërisë. Sipas vlerësimeve të bankës botërore Kosova është vendi me ekonomi më të varfër në rajon: Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim, për shembull, nga Maqedonia me 37% dhe Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektor shumë të vogël të eksportit, dhe me mungesë të energjisë. Bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori llogariten në 3,520 \$, dhe kështu Kosova radhitet në vendin e 93-të në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, (USAID, 2014, 2).

Vështruar nga këndi sektorial, struktura ekonomike e Kosovës, dominohet nga sektori i tregtisë, si për nga numri i bizneseve aktive ashtu edhe për nga numri i të punësuarve në këtë sektor, kurse sektori i prodhimit vazhdon të mbetet akoma me shkallë më të ulët të pjesëmarrjes. Nëse e shikojmë nga këndi i madhësisë, ndërmarrjet ekonomike-bizneset, dominohen nga mikro bizneset, të cilët kanë një përqindje shumë të lartë në numrin e

përgjithshëm të bizneseve të regjistruara dhe aktive. Në tabelën e më poshtme do të prezantohen ndërmarrjet e klasifikuara sipas madhësisë.

Tabela 7: Ndërmarrjet e regjistruara sipas numrit të punëtorëve – 2010

Klasifikimi sipas Madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i Ndërmarrjeve	Përqindja në total
Mikro	1 - 9	102,070	98.37
Të vogla	10 - 49	1,406	1.35
Të mesme	50 - 249	221	0.22
Të mëdha	250 e më shumë	58	0.06
Gjithsej		103,755	100.00

Burimi: ARBK

Kriteri për kategorizimin e ndërmarrjeve sipas madhësisë në NVM sipas ligjit nr.03/L-031, është numri i punëtorëve i cili është i ndryshëm nga kriteret që përdoren në vendet e BE-së, ku përpos numrit të punëtorëve merret edhe qarkullimi vjetor.

Në kuptim të zbërthimit të sektorëve, NVM-të kryesisht janë të përqendruara në: tregti me pakicë (rreth 50%); transport, deponim dhe distribucion (14%); produkte ushqimore, pije dhe duhan (9%); si dhe hotele dhe restorante (9%). Sipas Indeksit të Politikave për NVM 2009, shpërndarja sektoriale ka mbetur stabile me kalimin e kohës, (MTI, 2010, 17).

Kosova vazhdon të ketë bilanc tejet negativ në tregtinë e jashtme. Pothuaj se në të gjitha produktet ekziston një dominim i importit, kurse eksporti vazhdon të mbetet simbolik dhe i pa rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Prosesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, në veçanti i atyre industriale, nuk ka arritur qëllimin e duhur lidhur me gjenerimin e punësimit dhe rritjen e eksporteve të produkteve Kosovare në tregun e jashtëm. Nga një raport i vlerësimit të procesit të privatizimit, sfidat dhe problemet kryesore të procesit të bërë nga GLPS&BIRN, të financuar nga zyra e BE-së në Prishtinë, në vitin 2015 është vlerësuar se: NSH-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës deri në konflikt. Pavarësisht nga sfidat e shumta, ato kanë mbetur një burim i rëndësishëm potencial për zhvillimin ekonomik pas-luftës. Kjo është portretizuar më së mirë nga ri-fillimi i suksesshëm i prodhimit nga disa NSH-ve gjatë viteve të para pas luftës. Megjithatë, nga rreth 500 NSH-ve të privatizuara, raste të

suksesshme janë jashtëzakonisht të rralla dhe vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve janë aktualisht funksionale dhe për të ruajtur aktivitetet origjinale, (GLPS&BIRN, 2016, 64).

Treguesit kryesor makro-ekonomik dhe ecurit ekonomike

Ekonomia e Kosovës që nga pas lufta në vazhdimësi ka një përmirësim të treguesve makro-ekonomik, por ky përmirësim nuk është treguar i mjaftueshëm për të pasur një zhvillim i cili kishte me reflektuar në një ekonomi stabile dhe te qëndrueshme.

Ekonomia ka vazhduar me normën e rritjes prej 3-5% për afro një dekadë gjer në vitin 2011. Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS) përlogaritë se gjatë këtij trevjeçari (2013-2015) ekonomia do të rritet në mesatare për 4,7 %, që është norma më e lartë mesatare në mesin e ekonomive të Evropës Juglindore, Megjithatë ritmi i rritjes fare nuk mjafton për të pasur efekte të dukshme në varfëri dhe papunësi, (USAID, 2014, 2).

Nga të dhënat e ofruara për ecurinë e BPV, nga ASK, për vitet 2008 deri në vitin 2015, shihet një rritje permanente nga viti në vit. Publikimi i ASK-së ofron të dhëna për BPV, të prezantuar përmes dy qasjeve, sipas aktiviteteve ekonomike dhe sipas qasjes në shpenzime.

Tabela 8: Bruto produkti vendor me çmime reale për vitet 2008–2015, në Kosovë, (në mil. €)

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
BPV	3,882.8	4,069.6	4,402.0	4,814.5	5,058.7	5,326.6	5,567.5	5,807.0
BPV/Për capita	2,258	2,329	2,480	2,672	2,799	2,935	3,084	3,277
Bpv/norma e rritjes	4.5	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2	4.1

Burimi ASK, 2016.

Nëse e shikojmë strukturën e BPV, nga qasja e pjesëmarrjes së aktiviteteve ekonomike në totalin, vërehet se pjesëmarrja më e madhe është nga; tregtia, prodhimi, bujqësia e pasuar me ndërtimtari e kështu me radhë. Në publikimin e ASK-së lidhur me pjesëmarrjes në strukturën e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike nga viti 2008 deri në vitin 2015, jepet kjo pasqyrë: Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi, nga 14,8 në 10,3, Industria

nxjerrëse, nga 3,1 në 2,0, Industria përpunuese, 11,1 në 10,8, Furnizimi me energji elektrike, me gaz, nga 2,1 në 3,3, Furnizimi me ujë, nga 0,5 në 0,8, Ndërtimtaria , nga 6,6 në 6,8, Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave , nga 11,6 në 12,3, Transporti dhe magazinimi , nga 3,3 në 3,6, Hotelet dhe restorantet , nga 0,6 në 1,0, Informimi dhe komunikimi, 0,8 në 1,9, Aktivitetet financiare dhe te sigurimit, nga 3,3 në 3,7, Afarizmi me pasuri të patundshme, 11,0 në 8,6, Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknik, nga 1,1, në 1,6, Aktivitetet administrative dhe mbështetëse , nga 0,2 në 0,6, Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social, 11,1 në 7,8, Edukimi, 2,6 në 4,0 , Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale, nga 0,9 në 1,9, Art, zbavitje dhe rekreacion, nga 0,1 në 0,4, Shërbime tjera, nga 0,0 në 0,2 si dhe tatimet në produkte, nga 15,2 në 17,9 %, (ASK, 2016, 6).

Krahas BPV, shkalla e papunësisë/ punësimit është një tregues i rëndësishëm i ecurive ekonomike të një vendi. Ky tregues paraqet kapacitetin ekonomik të një vendi në shfrytëzimin e faktorëve në interes të rritjes ekonomike, rënia apo rritja e këtij treguesi shfaqë trendin zhvillimor. Papunësia së bashku me BPB-në, paraqet treguesin kryesor të nivelit të përdorimit të kapaciteteve dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Nëse shkalla e papunësisë është rritur në një vend, kjo tregon se ky vend ka ngecur ekonomikisht dhe nuk është në gjendje të shfrytëzojë kapacitetet prodhuese në dispozicion në rrugën e saj më të mirë të mundshme, pra, duke shkaktuar uljen e standardit të jetesës së popullsisë, (Ukaj&Dragusha, 2013, 122).

Shikuar nga prizmi i shkallës së papunësisë, Kosova konsiderohet një vend me shkallë të lartë të papunësisë, rrjedhimisht me shkallë të lartë të varfërisë si dhe me pjesëmarrje të lartë në strukturën e të papunësuarve të gjeneratës së re.


Tabela 9: Të dhënat mbi popullsinë, punësimin dhe të papunët, 2012-2015

Nr.	Popullsia sipas strukturës	2012	2013	2014	2015
1	Popullsia e përgjithshme e vlerësuar	1,807,126	1,811,372	1,811,521	1,757,843
2	Popullsia në moshë pune, 15 – 64 vjeç	1,189,019	1,191,630	1,202,489	1,176,147
3	Persona jo aktivë, 15 – 64 vjeç	750,476	708,436	702,238	733,432
4	Fuqia punëtore (persona aktivë), 15 – 64 vjeç	438,544	483,193	500,251	442,716
5	Të punësuar, 15 – 64 vjeç	302,844	338,364	323,508	296,940
6	Të pa punë, 15 – 64 vjeç	135,700	144,829	176,743	145,776

Burimi, ASK, 2012-2015 (tabela e punuar nga autori)

Tabela nr. 9 paraqet trendin e ecures së punësimit dhe të lëvizjes së parametrave të tjerë të popullsisë në Kosovë, për katër vitet 2012-2015. Të dhënat në tabelën e më sipërme janë rezultat i të dhënave të përpunuara nga anketimi i fuqisë punëtore, të kryera nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës mbështetur nga Banka Botërore dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës. Trendi i ecures së shkallës së punësimit sipas viteve, do ta shohim edhe për mes grafikut në vijim:

Figura 1: Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe vitit në (%) për vitet 2012-2015



Burimi: ASK- AFP, 2012-2015

Shkalla e punësimit përgjatë viteve 2012 – 2015, e prezantuar në tabelën nr. 9 dhe në figurën nr. 1, tregon një nivel mjaftë të ultë, si për nga numri i të punësuarve ashtu edhe në përqindjen e përfshirjes së të punësuarve në numrin e popullsisë së aftë për punë. Shkalla e punësimit është e llogaritur në proporcion me popullsinë e aftë për punë. Llogaritja për vitin 2015:

$$\text{Popullsia e punësuar} = \frac{\text{Popullsia e punësuar}}{\text{Popullsia e aftë për punë}} \times 100 = \frac{296,940}{1,176,147} \times 100 = 25,24\%$$

Nëse e shohim trendin e punësimit për këto katër vite, vërejmë një lëvizje interesante e cila nga një trend i ngritjes që është nga viti 2012 në vitin 2013 respektivisht nga 25,6 në 28,4, viti 2014 dhe viti 2015 kanë një tendencë të uljes së shkallës së punësimit në 26,9 dhe 25,2. Përpos marzhës së gabimit që mundë të jetë si pjesë e anketimit, ky trend i rënies së shkallës së punësimit mund të jetë i afektuar edhe nga proceset zgjedhore të viteve 2013 (zgjedhjet lokale) dhe 2014 zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe me krizën e krijimit të institucioneve pas procesit zgjedhor. Për më tepër nëse e shikojmë me vëmendje vërehet se rënia e (treguesve) numrit të popullsisë së përgjithshme është për 53,678 veta, pastaj zvogëlim i numrit në të gjithë treguesit përfshirë edhe numrit të papunëve që është zvogëluar për 39,967 punë kërkuar. Siç dihet pas një ngërçi për afër gjashtë muaj të formimit të Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, nga Kosova kanë ikur, sipas vlerësimit të mediave, rreth 70 mijë veta, kryesisht të riinj dhe të reja. Andaj, mendoj se njëra ndër arsytet e rënies së shkallës së punësimit është edhe emigrimi masiv i popullatës së zhgënjyer. Nëse e shikojmë edhe BPV në tabelën e më sipërme e vërejmë se, viti 2014 është viti kur rritja e këtij treguesi është më e ulët që nga viti 2008 (vetëm, 1.2%), që mund të konkludojmë se, zgjedhjet dhe ngërçi institucional ishte ndër faktorët kryesor që ka reflektuar në rënien e BPV dhe të shkallën e punësimit.

Shkalla e punësimit, në mënyrë më të saktë mund të shihet nga informatat që lëshon administrata tatimore e Kosovës-ATK, meqenëse ky institucion është përgjegjës për mbikëqyrjen e sektorit të ekonomisë nga këndi i implementimit të politikës fiskale. Informatat nga ky institucion japin pasqyrë të ndryshme nga ajo që ofron ASK-ja përmes anketimit të fuqisë punëtore.

Tabela 10: Numri i punëtorëve të regjistruar sipas sektorëve ekonomik në Kosovë

Nr.	AKTIVITETET – VEPRIMTARIT	2013	2014	2015
0	Mungon aktiviteti	82,360	83,344	67,282
1	Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	1,322	1,345	1,725
2	Industria nxjerrëse	4,543	4,621	4,139
3	Industria përpunuese	19,842	20,742	21,710
4	Furnizimi me rrymë, gas, avull dhe ajër	8,604	8,575	8,343
5	Furnizimi me ujë; Kanalizimi;	2,262	2,297	2,421
6	Ndërtimtaria	14,452	12,946	15,088
7	Tregtia me shumicë dhe pakicë	41,496	44,832	49,391
8	Transporti dhe magazinimi	7,825	8,235	8,500
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6,344	7,071	8,194
10	Informimi dhe komunikimi	4,946	5,522	6,157
11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	8,869	8,599	9,997
12	Aktivitetet e patundshmërisë	467	507	739
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	4,541	4,996	5,796
14	Shërbimet administrative dhe mbështetëse	2,257	2,333	2,985
15	Administrimi publik dhe Sigurimi social	4,092	4,188	17,470
16	Arsimi	3,293	3,475	3,849
17	Aktivitetet e shëndetit të njeriut	2,542	2,783	3,229
18	Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	1,401	1,378	1,720
19	Aktivitetet e tjera shërbyese	6,733	7,086	7,394
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	-	-	-
21	Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare	2,038	1,930	1,672
50	Persona fizik	4,580	4,753	3,687
TOTALI:		234,810	241,558	251,489

Burimi, ATK, 2017

Të dhënat nga tabela nr. 10, mbi numrin e të punësuarve në ekonomi sipas sektorëve ekonomik janë nga ATK-ja, këto të dhëna në parim paraqesin pjesën e të punësuarve që

i kryejnë të gjitha obligimet ligjore ndaj ATK-së, respektivisht institucioneve qeveritare. Nëse i krahasojmë të dhënat e ATK-së me ato të ASK-së për vitet 2013, 2014 dhe 2015, atëherë e shohim një dallim të madh, numri të punësuarve nga anketimet e fuqisë punëtore nga ASK-është dukshëm më i lartë se ato që paraqet ATK-ja. Si do që të jetë, nga këto të dhëna vërehet një rritje punësimit nga viti në vit nga 7000 deri në 10000. Kjo ngritje mundë të jetë edhe si pasojë e legalizimit të punëtorëve të cilët kanë punuar në mënyrë ilegale ose në të zezën.

Vlerësim i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në Kosovë

Kosova përgjatë gjithë historisë së zhvillimit, që nga mesjeta e hershme dhe deri në krijim e shtetit të pavarur, kishte një zhvillim të veçantë, i cili reflekton karakteristikat politike, etnike, e gjeostrategjike. Kosova e kohës së mesjetës dhe deri në vitet e pesëdhjeta, pas luftës së dytë botërore, ishte vend kryesisht agrar, me një prezencë simbolike të zejeve të ndryshme tradicionale dhe krejt kjo e zhvilluar në formë mjaftë ekstensive/primitive. Pas viteve të pesëdhjeta, ashtu edhe siç shihet në treguesit makroekonomik BPV dhe struktura e formimit të tij, fillon zhvillimi i sektorëve tjerë ekonomikë: industria, xehetaria, ndërtimtaria, tregtia dhe shërbimet, të cilët shkojnë duke e rritë pjesëmarrjen në strukturën e BPV, respektivisht dominimin në këtë strukturë.

Deri më 1950, Kosova ishte vend tipik agrar, pa industri të zhvilluar, ku bujqësia merrte pjesë me 70 % në BPV. Si pasojë e politikës diskriminuese e koloniale të Jugosllavisë së parë Kosova ishte lënë jashtë çdo procesi të industrializimit dhe zhvillimit ekonomik e social. Gjatë 1971-1980, Kosova e realizoi shkallën më të lartë të rritjes ekonomike dhe të ndryshimeve cilësore në strukturën e prodhimit. Sistemi ekonomik e politik në ish-Jugosllavi u decentralizua, kurse pozita kushtetuese e Kosovës u avancua dhe u bë e barabartë me republikat tjera. Në këtë periudhë u realizuan projekte të rëndësishme në industri dhe infrastrukturë ekonomike, (MMPH. 2010, 58).

Nga viti 1999 deri më sot Kosova ka bërë një përparim substancial në ndërtimin e institucioneve demokratike, në konsolidimin e proceseve zhvillimore ekonomike, në ndërtimin e sistemit të ekonomisë së tregut të lirë, në ndërtimin e politikave dhe institucioneve përgjegjëse për drejtimin dhe mbështetjen zhvillimit socio ekonomik. Procesi i tranzicionit është zhvilluar në kushte dhe rrethana të posaçme të cilat kanë reflektuar edhe në proceset kryesore të tranzicionit, si privatizimi i ndërmarrjeve

shoqërore, qasja në tregun e jashtëm, qasja në institucionet e ndryshme ndërkombëtare etj. Ky proces deri në vitin 2008, është udhëhequr apo fjalën përfundimtare e ka pas administrata e Kombeve të Bashkuara apo siç është quajtur UNMIK-u.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore i filluar në vitin 2003, nuk i ka përmbushur pritjet e qytetarëve të Kosovës, ky proces është bërë pa vlerësimin paraprak të vlerës së aseteve dhe mundësive për qasje në treg etj. Metodologjia e aplikuar në procesin e privatizimit nuk ka siguruar që procesi i privatizimit të sjellë benefite për ekonomin dhe fuqinë punëtore të angazhuar në ato ndërmarrje.

Në procesin e transformimit të ekonomive të tyre, vendet në zhvillim kanë miratuar përgjithësisht privatizimin si një strategji për ta stimuluar aktivitetin ekonomik. Në Kosovë, procesi i "privatizimit masiv" dhe vendimi për ta zgjedhur atë si qasje kryesore për t'i trajtuar sfidat ekonomike të Kosovës nuk është bazuar në karakteristikat e veçanta ose në një analizë të thellë të ekonomisë. Në fund të fundit, privatizimi konsiderohet se e ka dëmtuar në vend që ta përmirësoj kapacitetin e prodhimit të Kosovës, dhe rrjedhimisht prosperitetin e saj ekonomik,(GLPS&BIRN, 2016, 64).

Republika e Kosovës përkundër të arriturve që janë evidente në të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe në fushën e zhvillimit ekonomik, akoma vazhdon të jetë vendi me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë, me shkallë të lartë të varfërisë dhe me një ekonomi jo të qëndrueshme.

Në strukturën ekonomike sipas madhësisë së ndërmarrjeve, kur e shohim tabelën e nr.7, e vërejmë se dominojnë bizneset mikro, të cilat e përbëjnë mbi 95% të bizneseve, kurse bizneset e vogla të mesme janë në përqindje simbolike, të mëdhatë është një numër krejt simbolik. Përkundër një rritje permanente të BPV, Kosova vazhdon të mbetet vendi me shkallën më të lartë të papunëve, aq më keq Kosova ka edhe shkallën më të ultë të popullsisë aktive/fuqisë punëtore më të ultë në regjion me vetëm 37% në vitin 2015, deficit i madh tregtarë vazhdon të mbetet problem serioz i ekonomisë së vendit. Sipas një raporti të bankës botërore treguesit zhvillimor botëror 2012; Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim për shembull nga Maqedonia me 37% dhe Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektor shumë të vogël të eksportit, dhe me mungesë të energjisë. Bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori

llogariten në 3,520 \$, dhe kështu Kosova radhitet në vendin e 93-të në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, (USAID, 2014, 2).

Bazuar në situatën ekonomike dhe në kërkesat që dalin para qeverisë së Kosovës së pari nga qytetarët e vetë dhe pastaj edhe nga institucionet ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës dhe ministritë e veçanta kanë zhvilluar një numër të strategjive zhvillimore, si në nivel të përgjithshëm/kombëtar ashtu edhe në nivele sektoriale. Këto strategji i kanë përcaktuar objektivat dhe i kanë adresuar një varg problemesh me të cilat përballet ekonomia e vendit, strategjitë e kanë kuptimin vetëm nëse ato do të implementohen nga bartësit e tyre.

4.5 Korniza ligjore për qeverisjen lokale

Qeverisja lokale në Kosovë është e mbuluar me një kornizë ligjore me bazë të gjerë. Edhe pse është një shtet i ri, Kosova ka ndërtuar një sistem të qeverisjes lokale të bazuar në standarde që kërkohen nga konventat/kartat ndërkombëtare mbi vetëqeverisjen lokale. Kushtetuta e Kosovës si akti më i lartë juridik i vendit, ka të inkorporuar në vete standardet më të avancuara të qeverisjes lokale. Kështu, vetëqeverisja lokale në mënyrë mjaft precize përfshihet në aktin më të lartë juridik të vendit, (Kushtetuta, kap.X),” E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohej dhe rregullohet me ligj. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale, (Kushtetuta, 2008, 47).

Është me interes të theksohet se jo të gjitha vendet çështjen e respektimit të standardeve më të avancuara të qeverisjes lokale respektivisht kartën Evropiane e kanë të përfshira në kushtetutë, ajo që e ka Kosova është një garanci shtesë për ndërtimin dhe fuqizimin e një qeverisje lokale me një shkallë të lartë të autonomisë.

Në ndërtimin e qeverisjes lokale në Kosovë ka ndikuar e dhe pakoja e Ahtisarit (PA), e cila është e përfshirë edhe në Kushtetutën e Kosovës; Dispozitat e kushtetutës, të cilat përcaktojnë shtyllat kryesore të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, janë të bazuara kryesisht në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (KEVL) dhe në kërkesat që dalin nga Pakoja e Ahtisarit (PA). Kërkesat e PA kanë ndikua në masë të madhe në përcaktimin e disa standardeve shtesë të sistemit të VQL e që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përgjegjësitë e komunitetit serb. Korniza ligjore këto të drejta i ka sanksionuar me dispozita të përgjithshme dhe të veçanta dhe që kanë ndikuar në krijimin e dallimeve pozitive ndërmjet qytetarëve në favor të komunitetit serb, (Manuali, 2013, 12).

Përpos kushtetutës si akti më i lartë juridik, qeverisja lokale është e mbuluar dhe me një numër të ligjeve të cilët krijojnë bazën e funksionimit të pushtetit lokal. Korniza ligjore e qeverisjes lokale mundët të klasifikohet në dy kategori.

Kategorinë e parë e përbëjnë ligjet të ashtuquajtura bazike e që janë: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L- 040, Ligji për Financat e Pushtetit Lokale Nr. 03/L-049, Ligji për Kufijtë Administrativ Nr. 03/L-041. Ligji për Zgjedhjet Lokale Nr. 03/L-072, Ligji për Bashkëpunim Nder-komunal Nr. 04/L-010 dhe Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144, ligje këto të sponzoruar nga MAPL-ja, (Manual, 2013, 61) Përpos ligjeve organike të cilët kanë vendosur bazat e qeverisjes lokale, janë edhe një numër i madh i ligjeve të cilët mbulojnë/plotësojnë gamën e përgjegjësiave të pushtetit lokal në fusha specifike, siç janë: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e ambientit etj.

Qeverisja Lokale 1999-2008

Qershori i vitit 1999 është fillimi i krijimit të strukturës qeverisëse në Kosovë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Ashtu siç është theksuar edhe në kapitullin për Kosovën, bazë e krijimit dhe funksionalizimit të jetës publike dhe institucionale në këtë fazë ishin Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB, nr. 1244, Korniza Kushtetuese e Kosovës dhe një duzinë e rregulloreve të UNMIK-ut.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjes së Administratës së UNMIK-ut fillimisht, organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal është rregulluar me Rregullore të UNMIK – ut, që kishin fuqi ligjore. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi

vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës ishte akti i parë rregullativ me fuqi ligjore që vendosi themelet e një sistemi të vetëqeverisjes lokale demokratike dhe në shërbim të qytetarëve në shtetin e Kosovës. Me këtë rregullore themelohet baza juridike e sistemit të vetëqeverisjes lokale në përputhje me parimet dhe praktikatat demokratike evropiane.

Nga viti 1999 e deri në vitin 2010, janë nxjerrë shumë rregullore të UNMIK me fuqi ligjore, ligje organike, ligje sektoriale dhe udhëzime administrative, të cilat i kanë dhënë një autonomi gjithnjë e më të madhe pushtetit lokal në Kosovë, (Manual, 2013, 8). Ashtu siç vërehet edhe nga shumë vlerësime që janë bërë nga institucione të ndryshme, periudha e administrimit të Kosovës nga UNMIK-u kishte ndërtuar një infrastrukturë ligjore mjaftë të kompletuar në rrafshin e qeverisje lokale. Andaj nëse e shikojmë nga këndi i legjislacionit mundët të konstatojmë se, qeverisja lokale në këtë fazë është ndërtuar mbi parimet e një qeverisje; demokratike, transparente dhe llogaridhënese.

Qeverisja Lokale 2008 dhe në vazhdim

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, funksionimi i shtetit ashtu edhe qeverisja lokale, tanimë bazoheshin në kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kështu kushtetuta e Republikës e aprovuar me datë 09 prill të vitit 2008 ka vendosur bazën ligjorë të rregullimit shtetëror dhe ka mundësuar krijimin e infrastrukturës ligjore për qeverisjen lokale. Kushtetuta si akti më i lartë ligjorë i vendit në kapitullin e dhjetë në nenin 123 dhe 124, përcakton në vija të trasha mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të pushtetit lokal, (Kushtetuta, 2008, 47).

Është me interes të theksohet se derisa është hartuar dhe derisa ka hyrë në fuqi Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 04/L-040, si bazë për qeverisje në një fazë tranzitore është aplikuar rregullorja nr. 2007/30, e cila kishte qenë edhe bazë për zgjedhjet lokale të mbajtura në fund të vitit 2007, në të cilat Kryetari i komunës për herë të parë zgjedhjet drejtpërdrejtë nga qytetarët.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në kreun e parë e përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror. Po sipas këtij ligji, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve

në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore, (Ligji Nr., 03/L-040, 2008, 2, 4).

Komunat në Kosovë, kanë një shkallë të gjerë të autonomisë lokale, Kështu sipas ligjeve bazë mbi bazën e të cilëve funksionojnë, komunat ushtrojnë një gamë të gjerë të përgjegjësi në disa fusha të rëndësishme të jetës. Kompetencat që i ushtrojnë Komunitat në Republikën e Kosovës, ndahen në tri grupe: Kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara.

Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjisllacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) zhvillimin lokal ekonomik,
- b) planifikimin urban dhe rural,
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin,
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit,
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal,
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale,
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale,
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit,
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut,
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor,
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijnor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale,
- l) banimin publik,
- m) shëndetësinë publike,

- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë,
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike,
- q) turizmit,
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira,
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër, (Ligji, Nr., 03/L-040, 2008, 17).

Komunat ushtrojnë edhe kompetenca të deleguara; Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- a) shënimet kadastrale,
 - b) regjistrimin civil,
 - c) regjistrimin e votueseve,
 - d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin,
 - e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve),
 - f) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria, (Ligji, Nr, 03/L-040, 2008, 18),
- Kompetencat e zgjeruara i ushtrojnë vetëm komunat të banuara me shumicë nga komuniteti Serbë, Disa komuna, për të cilat jepet shpjegim më poshtë, kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenet që vijojnë, (Ligji, Nr, 03/L-040, 2008, 19).

Nisur nga përshkrimi i mësipërm lidhur me kompetencat e komunave, në Republikën e Kosovës, mund të konstatojmë se: Komunat në Kosovës kanë tri nivele të kompetencave, kompetencat vetanake apo burimore përfshijnë një spektër të gjerë të shërbimeve që komunat janë përgjegjëse për të ju ofruar qytetarëve, drejtpërdrejtë dhe pa mundësi të krijimit të pengesave ligjore apo administrative. Kompetencat e deleguara janë disa prej kompetencave që u takojnë nivelit qendror por për të qenë më afër qytetarit, për tu kryer më shpejtë dhe me efikasitet ju janë deleguar komunave. Komunat për kompetencat e deleguara do të përfitojnë edhe burime shtesë financiare, të njëjtat kompetenca dikasteri

kompetent qendror mundet në çdo moment me i tërheq nëse komuna nuk tregon rezultat në kryerjen e këtyre shërbimeve.

Kompetencat e zgjeruara janë ekskluzivisht të ndara për komunat në të cilët në shumicë jetojnë qytetarët e komunitetit serbë, dhe ato përfshijnë, arsimin superior, shëndetësinë sekondare dhe pjesëmarrjen në përzgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore. Këto përgjegjësi janë ofruar komunitetit serbë me qëllim të integritetit të plotë në sistemin e Republikës së Kosovës, deri më tani efekti ka qenë jo sa duhet i kënaqshëm, duhet theksuar se kompetencat shtesë janë produkt i pakos së Ahtisarit.

Komunat në Republikën e Kosovës, sa i përket infrastrukturës ligjore kanë një bazë mjaftë të gjerë të mundësive në krijimin e kushteve për jetë më të mirë për qytetarët e vetë. Po kështu mundë të themi se edhe në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, komunat kanë përgjegjësi dhe mundësi ligjore të konsiderueshme për të qenë aktiv dhe suksesshëm. Edhe pse mundë të konsiderojmë se Kosova ka një bazë ligjore të përshtatshme për funksionim të qeverisjes lokale në të gjitha fushat përfshirë edhe atë të ZHEL-it, ky legjislacion ka nevojë për kompletim dhe harmonizim me aqu-communitare. Qeveria e Republikës së Kosovës në strategjinë për qeverisjen lokale 2016-2026, ka të paraparë një plotësim të këtij legjislacioni, “Ndryshimet në legjislacion duhet të bëhen në frymën e standardeve integruese që në qendër ka zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e aftësisë së Komunave për të thithur sa më shumë fonde dhe për të ulur papunësinë; dhënies së mundësive komunave për të marrë kredi me norma të ulëta të interesi; zvogëlimin e TVSH-së në produkte dhe mundësimin e lehtësive për taksat dhe tatimet për bizneset lokale etj.” (MAPL, 2016, 30).

Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale, duhet të krijoj mundësi për komunat që të krijojnë mundësi për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm për komunitetin lokal.

KAPITULLI V: Komuna e Rahovecit

5.1 Profili i Komunës së Rahovecit

Vështrimi Gjeografik

Territori i komunës së Rahovecit përfshinë një sipërfaqe prej 278,1* km², me 35 vendbanime ku jetojnë 74,519, (56 208 sipas regjistrimit të vitit 2011) banorë, me një dendësi prej 267 (202 sipas regjistrimit të vitit 2011) banorë në një km². Ky territor ka një pozitë të mirë gjeografike dhe përfshin pjesën qendrore dhe jugore të Rrafshit të Dukagjinit. Shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë lindore gjeografike, (Osmani, 2003, 15).

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, ka një pozitë mjaftë të volitshme, kështu ka një lidhje të mirë me qytetet kryesore të Kosovës, veçanërisht të Dukagjinit.

Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km; në Veri-Lindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km; në Jug-Lindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe të Mamushës; në jug me Komunën e Prizrenit 35 km, dhe në perëndim me komunën e Gjakovës 23 km. Komuna e Rahovecit është larg nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 67 km. Ekzistojnë lidhje të mira komunikacioni në mes komunave. Në Lindje të komunës kalon magjistrerja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren-Klinë-Pejë-Fushë Kosovë, (PZHK, 2013, 17).

Komuna e Rahovecit ka një relief karakteristik, duke përfshirë lokalitetet fushore, kodrinore dhe malore, që e bënë të përshtatshëm për zhvillimin e kulturave bujqësore të nduardurshme. Komuna e Rahovecit karakterizohet me këto tri lloje të terrenit: rrafshët-luginor 80,6 km² ose 29,17%, kodrinor me 162,2 km² ose 58,70% dhe malor me 33,5 km² ose 12,13%. Bazuar në lartësinë mbi detare e cila është prej 310 m deri në 920 m dhe pozitën gjeografike, klima që dominon është klima kontinentale me ndikim mesdhetar, (Osmani, 2003, 15).

Një Historik i shkurtër

Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës. Në bazë të hulumtimeve arkeologjike mund të konkludojmë se në territorin e komunës së Rahovecit janë zbuluar

disa fakte arkeologjike, të cilat tregojnë se këto vise janë përplot me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire (E. Çershkov). M. Krasniqi në punimin e tij mbi Rahovecin thekson se përveç këtyre epitafeve, pllakave të mermerit në ngastrën e fshatit Reti, është gjetur edhe një pllakë e thyer nga koha Romake ku është skalitur teksti "...et Sitae F(ilio) sumi cor(niculario) c(o) hor(tis) pri(mae)Dardanorum V(i) ixit an(nis) XXX b(ene) m(erenti) P(osuit)". Dy mbishkrimet e para janë familjare dhe nuk tregojnë se çka kanë qenë ata për të cilët janë ngritur këto përmendore, ndërsa nga përshkrimi i tretë i pllakës së thyer, shihet se ajo është e ngritur "i Siti të birit Sume flamurtarit të kohortës së parë të Dardanëve". Me rastin e gërmimit të terrenit më 1953 kur është ndërtuar bodrumi i verës në Rahovec, gjithashtu është gjetur një numër sendesh arkeologjike (dy qypa të mëdhenj, njëri nga këto ka vëllimin 400 litra, monedha metali, maje të shtizave, elefanti i bronzës e tjera për të cilin mendohet se ka prejardhjen nga epoka e hershme romake (M. K.). Në afërsi të Rahovecit në Bërnjakë supozohet të jetë vendbanimi nga periudha Romake, që më vonë ka qenë i ndarë në dy vendbanime: Bërnjaka e Ulët dhe Bërnjaka e Epërme. Edhe gjatë mesjetës, në shek. XIV (me 1348), Rahoveci përmendet si vend i cili kufizohet me disa fshatra përreth, si territor vreshtar. Po i cekim disa vendbanimet të cilat përmenden e këto janë : Shtavica, Bërnjaka, Krusha, Kobillogllava, Babindoli, Hoça, Maja e Shkadrumit, Bjeshka e Shkozës (M. K.). Po ashtu Rahovecin mund ta gjejmë edhe në hartat e vjetra të vitit 1689. Në pjesën e dytë të shekullit XVIII, Rahoveci përmendet si qytezë, në vitin 1770 si qytezë "Ravac" por ka edhe emra të tjera që gjinden në harta të vjetra si që janë : Rahuaz, Rahuiz, Rahova, Ravaz, Rahovce etj., ndërsa në vitin 1911 për herë të parë shkruhet në hartë si Orahovac sipas J. Cvijiqit, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Rahoveci>, (marrë me 07.03.2016).

Edhe si njësi administrative, Rahoveci ka një historik relativisht të hershëm dhe të gjatë të krijimit dhe të zhvillimit. Mirëpo, shtrirja territoriale dhe nivelet e statusit administrativë, kanë ndryshuar gjatë kohës, në varësi nga zhvillimet politike. Sipas librit të (Vitošević, 1996, 3), në të cilën autori hulumton Rahovecin në aspektin antropogjeografik, ai e prezanton zhvillimin e tij në këtë mënyrë: Në ekzistencën e gjerë tanishme, kufijtë administrativë disa herë janë ndryshuar. Nga nëntori i vitit 1912 deri në mars të vitit 1955, (42 vite) Rahoveci ka qenë qendër e rrethit të Podrimës, njërit nga më të mëdhenjve në Mbretërinë Jugosllave me rreth 580 km², 17 komuna, 68 vendbanime

25,500 banorë dhe me 3,800 amvisëri, ndërsa në vitin 1913 595 km², 107 fshatra, 17 fshatra të vegjël dhe 34 551 banorë. Në këtë kohë kufijtë e rretheve kanë ndryshuar tre herë.

Nga 1955 deri në vitin 1995 (kur është shuar rrethi i Podrimës dhe i është bashkangjitur rrethit të Prizrenit), pra 40 vite, ka ekzistuar komuna e Rahovecit dhe gjatë kësaj periudhe dy herë iu kanë ndryshuar kufijtë komunal, (Vitošević, 1996, 3).

Të dhënat demografike

Popullsia, struktura sipas moshës, struktura kualifikuese dhe struktura urbane janë faktorë domethënës për nivelin e zhvillimit ekonomik shoqëror të një vendi. Pos të tjerash lëvizjet mekanike të popullsisë kanë tendencë të zhvillimit në drejtim të bartjes së popullsisë së aftë për punë, drejte vendeve dhe regjioneve më të zhvilluara. Parë në këtë kontekst edhe popullata e Rahovecit gjatë historisë ka përjetuar trendet e zhvillimit që janë kushtëzuar nga shume faktorë, duke filluar nga ata politikë, fetarë, ekonomikë, të sigurisë etj. Pozita e Kosovës ka qenë e tillë që shtetet që kanë sunduar në këto treva, kanë tentuar që në forma të ndryshme ta deformojnë qëllimshëm pasqyrën e popullsisë vendore të Kosovës, në këtë rast edhe të Rahovecit.

Popullsia dominuese në territorin e Komunës së Rahovecit, kanë qenë shqiptarët, ndërsa nëpër disa vendbanime kanë jetuar edhe pakica serbe, malazeze dhe ajo rome. Nga të dhënat e marra nga burimet e ndryshme, sipas autorëve, gjatë sundimit turk, regjistrat mbi numrin e popullsisë janë evidencuar vetëm sipas përkatësisë fetare, gjë e cila nuk jep një pasqyrë të qartë për përfaqësimin etnik. Rreth numrit të popullsisë, në territorin e Komunës së Rahovecit, të dhënat më të besueshme janë ato të gjysmës së dytë të shekullit njëzet.

Sipas (PZHK, 2013,18), Që nga viti 1948 e deri më sot komuna e Rahovecit ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Rahoveci kishte 20287 banorë, ndërsa në vitin 2010 ka rreth 71522 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare), numri i popullsisë është rritur për më shumë se tri herë.

Tabela 11: Popullsia ne komunën e Rahovecit sipas indeksit, (PZHK, 2013, 18)

Vitet	Nr. Popullsisë	Indeksi Bazik	Indeksi Vargor
1948	20 287	100	100
1961	26 763	132	132
1971	35 188	173	131
1981	46 396	228	132
1991*	59 625*	294*	128*
2010*	71 522*	353*	120*
2011	56 208	277	79

Tabela nr. 11, pasqyronë trendin e zhvillimeve demografike, respektivisht numrin e banorëve të Rahovecit nga viti 1948 deri në vitin 2011. Të dhënat për numrin e banorëve të vitit 1991, nuk pasqyrojnë situatën reale për dy arsye: sepse regjistrimin e këtij viti e kanë bojkotuar pjesëtarët e Komunitetit Shqiptarë, dhe të dhënat kanë statusin e vlerësimit dhe së dyti në këtë regjistrim pos territorit aktual të Komunës janë përfshirë edhe një numër i vendbanimeve të Komunës së Malishevës, e cila Komunë nuk është njohur nga organet e dhunshme të Serbisë në Kosovë, pas suprimimit të Institucioneve të Kosovës në vitin 1990.

Të dhënat e vitit 2011, janë të dhëna zyrtare të marra nga (Vjetari Statistikor, 2015,38), të cilat kanë dalë nga regjistrimi i këtij viti, si të tilla munden të krahasohen me ato të vitit 1981, i cili është regjistrimi i fundit zyrtarë nga ish Jugosllavia në të cilën kanë marrë pjesë edhe Shqiptarët e Kosovës me Institucionet e tyre. Edhe të dhënat e ofruara nga Jusuf Osmani në librin mbi Rahovecin, paraqet të dhëna të njëjta me ato të PZHK-së, autori, për më tepër, të dhënat i ka marrë nga regjistrimet zyrtare dhe të njëjtat i ka verifikuar nga zyrtarët kompetentë Komunal, duke zbritur numrin e popullsisë e atyre vendbanimeve që nuk janë në kufijtë administrativë të komunës së Rahovecit pas luftës së vitit 1998/1999, (Osmani, 2003, 50).

Arsimi

Arsimimi i një shoqërie është njëri nga treguesit i cili më së miri tregon nivelin e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të një vendi. Arsimi, ndikon dhe ndikohet nga

zhvillimi socio-ekonomik, ndikohet edhe nga faktorë të tjerë si; kultura, religjioni, politika etj. Është indikative të potencohet se, pas një zhvillimi të hovshëm të arsimit në Kosovë pas viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, vitet e nëntëdhjeta, kanë sjellë një situatë shumë të veçantë të organizimit dhe të zhvillimit të arsimit si në Kosovë ashtu edhe në Komunën e Rahovecit. Ri-okupimi i Kosovës nga Serbia ishte një goditje e rëndë për të gjithë sektorët e jetës në vend, arsimi si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit dhe emancipimit të popullit ishte atakuar me tendencë të shkatërrimit dhe të shkombëtarizimit. Sipas legjislacionit aktual, komunat e Kosovës janë përgjegjëse për organizimin e arsimit në të katër nivelet, parashkollor, fillor të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë. Pas vitit 2000 (pas luftës), institucionet Kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatuar për një vit nga 8 sa ishte, në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasat I–V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X–XII/XIII). Numri i objekteve shkollore gjithsej është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 846 punëtorë, prej të cilëve janë 710 mësime/ndërmësues. Numri i nxënësve është gjithsej 14526, që do të thotë se kemi një raport prej 20.4 nxënës/mësime/ndërmësues, (PZHK, 2013, 28).

Arsimi para fillor

Arsimi para fillor në komunën e Rahovecit është i organizuar, kryesisht bashkërisht me arsimin fillorë, kështu sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë Komunale për Arsim (Informata, 2016), mësimi parashkollorë në vitin shkollor 2015/2016, zhvillohet në; Nga 28 shkolla dhe 7 paralele të ndara që aktualisht funksionojnë, paralelet parashkollore janë aktive në 25 shkolla dhe në një paralele të ndarë, kurse në tri shkolla dhe 7 paralele të ndara nuk janë aktive. Në komunën funksionon edhe një Çerdhe e Fëmijëve „ Tulipanët “ në të cilën kanë qasje fëmija prej moshës, 2-5 vjeçare. Numri i nxënësve në

parashkollorë është 827, duke i përfshirë edhe 44 fëmijë që e frekuentojnë çerdhen, (Informata, 2016).

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar)

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, sipas ligjit tanimë është obligativ dhe i njëjti sipas (informatës, 2016), zhvillohet në 28 shkolla amë dhe në 7 paralele të ndara (satelite), nga ky numër në dy shkolla mësimi zhvillohet në gjuhën serbe (në Rahovec dhe Hoçë të Madhe). Arsimi fillor zhvillohet nga klasa e parë deri në të pestën, kurse i mesmi i ulët nga e gjashta deri në klasën e nëntë, kryesisht këto dy nivele zhvillohen nëpër shkolla të njëjta dhe pashkëputshëm. Ne këtë nivel mësimet i ndjekin 8437 nxënës, përfshirë edhe 93 nxënës të komunitetit serbë që mësimet i zhvillojnë në gjuhën e tyre.

Arsimi i mesëm i lartë

Arsimi i mesëm i lartë, zhvillohet nga klasa e dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë, dhe në drejtimet shkencore edhe klasa e trembëdhjetë. Në komunën e Rahovecit, sipas të dhënave të marra nga DAK-u (Informata, 2016), ky nivel i arsimit zhvillohet në pesë shkolla të mesme dhe atë: SH.M. „Xhelal Hajda-Toni“ në Rahovec; SH.M.P. „Selajdin Mullabazi-Mici“ në Rahovec, SH.M. „Ukshin Hoti“ në Krushë të Madhe; SH.M. „12 Maji“ në Ratkovc dhe SH.M. „Në Gjuhën Serbe“ në Rahovec. Është me rëndësi të potencohet se vetëm SH.M. „Xhelal Hajda – Toni“ është me drejtimet shkencore dhe shoqërorë pa programe profesionale, kurse shkollat e mesme në Ratkovc dhe Krushë të Madhe janë shkolla në të cilat zhvillohen programe të përziera d.m.th. Shkencorë, shoqërorë dhe profesional, ndërsa SH.M. „Selajdin Mullabazi – Mici“ në Rahovec është kryesisht shkollë profesionale, për shkollën e mesme në gjuhën serbe nuk ka shënime në informatën zyrtare të Drejtorisë Komunale të Arsimit-DAK.

Në këto shkolla të mesme mësimet i vijnë: Sh.M.L. „Xhelal Hajda – Toni“ ka gjithsejtë 31 paralele, 1006 nxënës; Sh.M.L. „Selajdin Mullabazi – Mici“ ka gjithsejtë 382 nxënës, Sh.M.L. „Ukshin Hoti“ ka gjithsejtë 524; Sh.M.L. „12 Maji“ në Ratkovc numëron 561, nxënës, kurse për Shkollën e mesme në gjuhën serbe nuk ka shënime. Sipas informatës në fjalë në shkollimin e mesëm mësimet i vijnë gjithsejtë 2488 nxënës në të gjitha shkollat dhe në të gjitha profilet arsimore, (DKA-Informata, 2016).

5.2 Struktura organizative dhe funksionale e Komunës

Funksionimi dhe organizimi i komunave në Republikën e Kosovës është e përcaktuar me ligjin bazë mbi vetëqeverisjen lokale të komunave, nr. 04/L-040. Përpos që ligji përcakton funksionet dhe strukturën organizative të komunave, çdo komunë është e obliguar që ta nxjerrë Statutin dhe akte të tjera nën ligjore të cilat më saktësisht i përkufizojnë përgjegjësitë dhe strukturën organizative të Komunës. Komuna e Rahovecit është e organizuar në drejtori komunale, sektor dhe zyre. Organet kryesore të komunës janë:

Kuvendi komunal, të cilin e përbëjnë 31 anëtarë/kuvendarë, të cilët zgjedhën me mandat katër vjeçar drejtpërdrejtë nga qytetarët. Për funksionim më të mirë të Kuvendit formon edhe komitete komunale, të cilët e ndihmojnë Kuvendin në punën e tij. Aktualisht Kuvendi i ka funksionale tri komitete: Komitetin për politikë dhe financa -KPF; Komitetin për komunitete-KKK, të cilat sipas ligjit janë obligative dhe Komitetin për shërbime publike, si komitet konsulltativ.

Kryetari i komunës, funksionon përmes zyrës, ndërsa ndihmohet nga drejtorët e drejtorive. Zyra e kryetarit të komunës përbehet nga: Zyrtari për protokoll, zyrtari për përfaqësim, zyrtari çështje ligjore dhe zyrtari për marrdhënje me publikun. Zyra e auditorit të brendshëm dhe zyra e prokurimit publik (Statuti, 2010, 63).

Administrata komunale është e organizuar nëpër drejtori dhe sektorë. Drejtoritë udhëhiqen nga drejtorët të cilët emërohen nga Kryetari i komunës dhe kanë mandat politik, po aq sa ka edhe kryetari. “Administrata Komunale organizohet në drejtori. Çdo drejtori komunale menaxhohet nga

drejtori. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës” (Statuti, 2010, 64).

Drejtoritë komunale; Numri, emërtimi dhe përgjegjësitë e drejtorive komunale përcaktohen me statutin e komunës, komuna e Rahovecit është e organizuar në 12 drejtori komunale, emërtimi drejtorive sipas statutit është: Drejtoria për administratë, drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, drejtoria për arsim, drejtoria për financa dhe buxhet, drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedis, drejtoria për gjeodezi, kadastrë dhe prona, drejtoria për shërbime publike, drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural. drejtoria për inspektim, drejtoria për kulturë, rini dhe sport, drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim dhe zyra komunale për komunitete dhe kthim (Statuti, 2014, 65/5).

5.3 Buxheti Komunal, si instrument i zhvillimit

Qeverisja lokale, zhvillimi, shkalla e autonomisë në ushtrimin e përgjegjësi, gama dhe cilësia e shërbimeve të ofruara është e lidhur ngushtë me buxhetin. Buxheti është mekanizmi më i rëndësishëm në zhvillimin e autonomisë lokale. Si një mekanizëm i rëndësishëm s' veçantë par pushtetin lokal buxheti është studiuar nga këndvështrime të ndryshme, si nga ai decentralizimit, përmirësimit të shërbimeve ashtu edhe nga këndi i ZHEL-it.

Autori K.Kollar në një studim të bërë rreth instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal përmbledhë teoritë dhe hulumtimet e disa studiuesve të cilët kanë identifikuar instrumentet e aplikuara në praktikën zhvillimore të vendeve të ndryshme, në këtë studim paraqet autorët, Linder dhe Peters, Çapkova, të cilët ndër instrumentet e zhvillimit ekonomik lokal një vend të rëndësishëm i kushtojnë edhe financave, respektivisht buxhetit të njësive lokale, si atij të taksave dhe atij të subvencionimit (Kollar, 2011, 22). Edhe autori Bartik në studimin e tij të bërë për projektin Hamolton, paraqet format financiare respektivisht, lehtësirat tatimore dhe subvencionet që qeveritë shtetërore dhe lokale mund të përdorin për hapjen e vendeve të reja të punës në zonat e pavolitshme, (Bartik, 2010, 16).

Shumica e studimeve empirike theksojnë një lidhje pozitive midis dy faktorëve që bëjnë vendet e zhvilluara. Piriou-Sall (1998) dhe Thiessen (2003) gjejnë një lidhje pozitive midis dy variablave në rastet e Shteteve të Bashkuara dhe të OECD, respektivisht. Piriou-Sall madje përfundon se "ndërkohë që decentralizimi ka ila, ajo ka shumë virtyte dhe ia vlen të ndiqet "(1998: 3). Shumë studime madje tregojnë se suksesi i procesit të decentralizimit është pasojë jo vetëm i dizajnit të modelit të decentralizimit, por, ndoshta më e rëndësishmja, karakteristikat e vendit, dhe sidomos për ekzistimin e institucioneve të forta dhe efektive në të gjitha nivelet e qeverisë (Dabla-Norris, 2006).

Nga studimet e të gjithë autorëve dhe dokumentet strategjike të lëshuara nga institucionet kredibile ndërkombëtare, buxheti është mekanizmi kyç i funksionimit të shtetit dhe i njësive lokale të qeverisjes. Rëndësia e këtij mekanizmi shtrihet në të gjitha fushat e përgjegjësi të qeverisë lokale, nisur nga cilësia dhe sasia e shërbimeve të ofruara, cilësia e infrastrukturës, pastaj në cilësinë e arsimit, shëndetësisë dhe deri tek zhvillimi ekonomiko- social.

Rëndësia e buxhetit për funksionimin dhe zhvillimin e një vendi apo njësie të qeverisjes vendore shihet edhe nga vetë përkufizimi. Buxheti paraqet një planë të shpenzimeve dhe të hyrave për një periudhë të caktuar kohore, “Buxheti i qeverisë është një përmbledhje ose plani i të ardhurave dhe shpenzimeve të destinuara të asaj qeverie. Ekzistojnë tri lloje të buxhetit të qeverisë: buxheti operative apo aktuale, buxheti kapital apo i investimeve, dhe të hollat ose buxhet i rrjedhës së parasë”, <https://en.wikipedia.org/wiki/Budget> (marrë me, 28.06.2016).

Çështja e përgjegjësisë fiskale për komunat e Kosovës është e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligjet bazike, (ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe ligjin mbi financat e pushtetit lokal), këto ligje kanë përcaktuar mënyrën e krijimit dhe shpenzimit të buxhetit, duke përcaktuar edhe burimin e të hyrave për Komunat.

Komunat kanë buxhetet dhe financat e tyre për financimin e kompetencave të tyre. Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake; grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; donacioneve dhe të hyrave të tjera. Buxheti dhe financat komunale rregullohet me Ligjin për financat lokale. Kërkesat thelbësore për menaxhimin publik financiar dhe përgjegjshmëri, të përcaktuara në legjislacionin qendror, zbatohen për të gjitha komunat, (Kushtetuta, 124, 2008).

Buxhetit është plani vjetor i komunës i cili përcakton të hyrat dhe shpenzimet, të cilët duhet t’i mundësojnë kryerjen e të gjitha shërbimeve dhe punëve në interes të qytetarëve.

Të hyrat e Komunës

Pjesë e rëndësishme e buxhetit të komunës janë të hyrat. Ashtu siç është theksuar edhe më lartë të hyrat komunale janë të garantuara më kushtetutën e vendit, ndërsa llojet e të hyrave janë të përcaktuara me ligjet e veçanta, si ligji mbi financat pushtetit lokal dhe ligjet e tjera pozitive.

Burimet financiare të një komune, përbëhen nga (i) të hyrat vetanake të komunës të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, (ii) grandet operative, (iii) grandet për kompetencat e shtuara, (iv) transferet për kompetencat e deleguara, (v) grandet e jashtëzakonshme, (vi) ndihma financiare të Republikës së Serbisë dhe (vii) huamarrjet e komunës (ligji, nr.03/L-049).

Komuna e Rahoveci si çdo komunë tjetër e Kosovës, në përputhje me ligjin mbi financat e pushtetit lokal dhe ligjet tjera është e obliguar ta nxjerrë rregulloren komunale mbi

“Taksat, tarifat, ngarkesa dhe gjobat komunale”, kjo rregullore e bënë përcaktimin e llojit dhe lartësinë e të hyrave komunale në përputhje me kushtet dhe mundësitë ekonomike të komunës.

Korniza afatmesme buxhetore-KAB-i 2016-2018 e paraqitur në tabelë, prezanton llojin e të hyrave buxhetorë të komunës së Rahovecit.

Tabela 12: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale për periudhën 2016-2018, në €

Komuna RAHOVEC	Grandet dhe THV – 2015 (këtë vit)	Grandet dhe THV – 2016 (vitin e 1)	Grandet dhe THV – 2017 (vitin e 2)	Grandet dhe THV – 2018 (vitin e 3)
	në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
BURIMET E TË ARDHURAVE				
GRANTET	10.339.687.00	10.204.240.00	10.281.374.00	10.374.158.00
Granti i Përgjithshëm	4.332.840.00	4.008.459.00	4.085.593.00	4.177.377.00
Granti i Arsimit	4.413.520.00	4.866.855.00	4.866.855.00	4.866.855.00
Granti i Shëndetësisë	1.328.926.00	1.328.926.00	1.328.926.00	1.328.926.00
Shtesa sipas qarkores buxhetor 2015/02 për arsim	264.401.00			
Liçensat për lojëra zbavitëse, pijë alkoolike, reklamime, shpallje etj.	181.000.00	189.000.00	204.000.00	206.000
Funksionimet me makina me monedha ose me lojëra dh të ngjashme	181.000.00	189.000.00	204.000.00	206.000.00
Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit	90.000.00	92.000.00	95.000.00	102.000.00
Lejet për ndërtim dhe konstruktime	90.000.00	92.000.00	95.000.00	102.000.00
Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	55.000.00	56.000.00	57.000.00	62.000.00
Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	25.000.00	26.000.00	27.000.00	30.000.00
Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit	30.000.00	30.000.00	30.000.00	32.000.00

Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	34.000.00	36.000.00	38.000.00	42.000.00
Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	12.000.00	14.000.00	14.000.00	16.000.00
Inspektimi i ambientit	12.000.00	12.000.00	12.000.00	13.000.00
Inspektimi i ndërtimit, shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit	10.000.00	10.000.00	12.000.00	13.000.00
Shfrytëzimi i pronës Komunale	67.000.00	73.000.00	77.000.00	80.000.00
Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	67.000.00	73.000.00	77.000.00	80.000.00
Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	12.000.00	14.000.00	14.000.00	16.000.00
Inspektimi i ambientit	12.000.00	12.000.00	12.000.00	13.000.00
Inspektimi i ndërtimit, shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit	10.000.00	10.000.00	12.000.00	13.000.00
Shfrytëzimi i pronës Komunale	67.000.00	73.000.00	77.000.00	80.000.00
Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	67.000.00	73.000.00	77.000.00	80.000.00
Pagesat në lidhje me Automjetet	135.000.00	146.000.00	143.000.00	142.000.00
Lejet e automjeteve				
Parkimi në parkingun publik i pajisur me garazhim apo hapësira tjera				
Regjistrimi i automjeteve	135.000.00	146.000.00	143.000.00	142.000.00
Certifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	100.014.00	113.014.00	131.014.00	132.500.00
Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekjes,martësës,shkëmbimit	100.014	113.014.00	131.014.00	132.500
Të tjera				
Tatimi ne Prone	320.000.00	330.000.00	340.000.00	360.000.00
Pagesat e tatimit ne prone	320.000.00	330.000.00	340.000.00	360.000.00

Të ardhurat tjera	3.000.00	5.000.00	6.000.00	2.000.00
Pagesat tjera	3.000.00	5.000.00	6.000.00	2.000.00
Në totali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	985.014.00	1.040.014.00	1.088.014.00	1.128.500
Dënimet në komunikacion, të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	54.000.00	58.000.00	59.000.00	67.000.00
Gjoha te gjykatave				
Nen totali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	54.000.00	58.000.00	59.000.00	67.000.00
Totali I Administratës komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	1039.014.00	1.098.014.00	1.147.014	1.195.500.00
TË ARDHURAT NGA ARSIMI				
Çerdhet	10.000.00	10.000.00	10.000.	10.000.00
Mësimi joformal				
Totali – Arsimi	10.000.00	10.000.00	10.000.00	10.000.00
TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA				
Shëndetësia primare	50.000.00	50.000.00	50.000.00	50.000.00
Të tjera				
Totali - Shëndetësia	50.000.00	50.000.00	50.000.00	50.000.00
TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I+II+III):	1.099.014.00	1.158.014.00	1.207.014.00	1.255.500.00

Burimi: KAB, 2016-2018

Në tabelën nr.12, vërehet se të hyrat në buxhetin e komunës së Rahovecit vazhdojnë të dominohen me 90% nga grantet e qeverisë së Republikës, gjë e cila funksionimin e komunës në të gjitha fushat e bënë të varur nga shuma e ndarjeve që bënë qeveria përmes formulave tashmë të elaboruara më lartë. Ashtu siç është theksuar në ligjin mbi financat e pushtetit lokal edhe nga tabela shihet se të hyrat e komunës janë nga: të hyrat vetanake dhe grantet operative të ndara nga qeveria qendrore, të hyrat e komunës janë:

Granti i përgjithshëm - nënkupton mjetet financiare që u jepen komunave për t'i përdorur ato me qëllim të përmbushjes së kompetencave komunale. Këtu kemi të bëjmë me një grand operativ të një qëllimshëm, shuma e të cilit duhet të jetë së paku 10 % e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore, duke përfshirë të hyrat nga shitja e pasurive,

të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara, dhe të hyrat nga huadhënia. Qëllimi i kësaj shume ka qenë që të ofrohet një shkallë e arsyeshme e stabilitetit të hyrave komunale, duke marrë parasysh mundësinë e banorëve për të pasur qasje në shërbimet publike dhe që të sigurohet një ndarje adekuate e mjeteve për komunitetet jo shumicë në komunat përkatëse.

Granti specifik për arsim - përdoret për mbulimin e shpenzimeve për ofrimin e një standardi minimal të shkollimit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Formula caktohet nga Komisioni i Grandeve bazuar në numrin e arsimtarëve dhe studentëve të regjistruar. Për këtë formulë merret parasysh edhe planprogrami, shkollimi për nevoja speciale, shpenzimet operative, normat e madhësisë së klasave dhe lokacioni i objekteve shkollore. Granti specifik për shëndetësi - po ashtu aprovohet nga Komisioni i Grandeve. Ai ndahet për t'i mbuluar shpenzimet për ofrimin e një standardi minimal të kujdesit primar shëndetësor. Formula e këtij granti bazohet në moshën dhe strukturën gjinore të popullsisë së regjistruar tek ofruesit e shëndetësisë primare si dhe në numrin e personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta shëndetësore.

Të hyrat vetanake - janë çdo e hyrë të cilën komuna e mbledh/grumbullon apo e realizon në përputhje me ligjin mbi financa e pushtetit lokal (file:///C:/Users/HP/Downloads/Manuali-i-Qeverisjes-Lokale_15%20(2).pdf,marrë me 07,07.2016).

Tatimi në pronë - konsiderohet e hyra kryesore vetanake e komunave në Kosovë, dhe i njëjti vlerësohet se në të ardhmen do të jetë burimi kryesor i financimit të komunave. Duke u nisur nga rëndësia që ka dhe që pretendohet të ketë edhe në të ardhmen, përcaktimi i këtij tatimi në komuna bëhet veçantë dhe në një mënyrë mjaftë të sofistikuar. Tatimi në pronë çdo vit caktohet nga komuna për mes hartimit dhe aprovimit të rregullores e cila përcakton, bazën, vlerën, normën dhe zonat tatimore. Ligji mbi tatimin në pronën e paluajtshme i obligon komunat në vendosjen dhe administrimin me tatimin në pronë: “Secila komunë duhet të jetë përgjegjëse për funksionet e mëposhtme në administrimin e tatimit mbi pronën sa i përket pronës që është në juridiksionin e saj, siç është:

- menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën dhe futja e të dhënave në bazën Qendrore;

- vlerësimi i pronës;

- vjelja dhe vjelja e detyruar e tatimit mbi pronën;
- ankesat administrative; dhe
- përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit (Ligji, nr.03/L-204).

Për shkak të rëndësisë që kanë të hyrat nga tatimi në pronë për komunat, pos ligjit janë edhe një dyzinë e dokumenteve të tjera që e rregullojnë këtë lloj të hyrave, duke filluar nga vendosja standardeve deri tek ngritja e strukturës institucionale në kuadër të komunës, me të gjitha kapacitetet e nevojshme. Komuna është e obliguar që çdo vit ta bëjë, evidentimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave të reja. Për tatimin në pronë çdo vit nga komuna duhet të përgatitet dhe të aprovohet rregullorja komunale, e cila duhet të reflektojë ndryshimet në bazën dhe vlerën tatimore dhe implikimet buxhetore.

Tabela 13: Baza tatimore për Komunën e Rahovecit për vitin 2016

SHFRYTËZIMI I PRONËS	ZONA	ÇMIMI NË € PËR m ² ; 2016	KOEFICIENTI 2016
Rezidenciale – Banesat	I	220,00	0,15%
	II	220,00	0,15%
Rezidenciale – Shtëpitë	I	220,00	0,15%
"	II	180,00	0,15%
"	III	150,00	0,15%
"	IV	130,00	0,15%
Komerciale –	I	410,00	0,17%
„	II	370,00	0,17%
„	III	340,00	0,17%
„	IV	250,00	0,17%
Industriale –	I	270,00	0,16%
„	II	270,00	0,16%
„	III	250,00	0,16%
„	IV	180,00	0,16%
Pronat e braktisura për të gjitha zonat	Për të gjitha Zonat	50,00	0,15%
Bujqësore	I	70,00	0,15%
„	II	70,00	0,15%
„	III	70,00	0,15%
„	IV	70,00	0,15%
Pronat tjera - garazhet jo komerciale	Për të gjitha Zonat	70,00	0,15%
Qendrat sportive	Për të gjitha Zonat	90,00	0,17%
Pishinat	Për të gjitha Zonat	90,00	0,17%

Përpos tatimit në pronë komuna mbledhë edhe një numër të tarifave, ngarkesave dhe gjobave, të cilat grumbullohen/derdhen në llogarinë e komunës pranë departamentit të thesari.

Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale, janë pjesë e të hyrave lokale të cilat komuna i mbledhë nga personat fizik dhe juridik në territorin e vetë. Këto të hyra komuna i realizon nga shërbimet të cilat ju ofron qytetarëve dhe subjekteve juridike, lloji dhe lartësia e këtyre përcaktohet me rregulloren komunale për Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale.

Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat që aplikojnë organet ndaj personave fizik dhe personave juridik në emër të kompensimit të punës, shërbimeve komunale dhe marrjen e vërtetimeve, dokumenteve zyrtare (janë të hyra në buxhetin e komunës që arkëtohen nga detyruesit e caktuar me këtë rregullore do të zbatohen në tërë territorin e komunës së Rahovecit) dhe përfshijnë:

- Lëshimi i dokumenteve zyrtare,
- Dhënia e pëlqimeve të punës,
- Dhënia e lejeve në lëmin e ndërtimeve, përdorimit dhe prishjes së objekteve,
- Shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe me qira e tokës bujqësore,
- Rregullimi i tokës ndërtimore,
- Dhënia me qira e pronës dhe ndërtesave të komunës,
- Dhënia në shfrytëzim e objekteve (hapësirave) dhe teknikës komunale të destinuar për manifestime, aktivitete kulturore dhe sportive etj.
- Shërbimet gjeodezik edhe kadastrale.
- Regjistrimi i të drejtave të pronësisë, posedimit, hipotekave, servituteve, qiramarrjes dhe përkueseve,
- Regjistrimi i pronësisë së automjeteve motorike,
- Parkingu dhe rimorkimi i automjeteve,
- Shërbimet në shëndetësi, arsim dhe inspektimet,
- Ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe lejeve për punë profesionale,
- Shfrytëzimi i burimeve natyrore,
- Gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale,(Rreg. 2015, 1, 2).

Tabela e cila përmbledhë të gjitha të hyrat që realizon komuna e Rahovecit dhe rregullorja komunale për taksa , tarifa, ngarkesa dhe gjoba më së mirë prezantojnë llojin dhe shumënvlerën e çdo lloji të hyrave si nga grantet ashtu edhe nga të hyrat vetanake.

Të hyrat vetanake të prezantuara në rregulloren komunale janë llojet e të hyrave lokale që komuna e Rahovecit i realizon, nga të gjitha të hyrat vetanake, nga tabela shihet se tatimi në pronë është e hyra kryesore i cili merr pjesë me rreth 30% në totalin e të hyrave vetanake.

Shpenzimet komunale

Buxheti komunal shpenzohet përmes programeve funksionale dhe kategorive ekonomike. Rregullat e shpenzimit të buxhetit komunal janë të përcaktuara me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ligjin mbi prokurimin publik dhe me aktet nën ligjore të miratuara nga ministria e financave, departamenti i thesarit dhe komisioni i pavarur i prokurimit publik.

“Të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, gjatë ushtrimit të një aktiviteti ose pranimi të një detyrimi, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfshin ose ndikon në shfrytëzimin e parave ose burimeve publike, duhet të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi, nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo është lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji” (Ligji Nr. 03/L-48, 2008, 9).

Tabela në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2015, planifikimi për vitin e ardhshëm 2016 si dhe projeksionet-vlerësimet për vitet 2017-2018.

Tabela 14: Shpenzimet buxhetore, Korniza Buxhetore Komunale, (sipas kategorive ekonomike), në €.

	Përshkrimi	2015	2016(plani)	2017 (vlerësimet)	2018 (vlerësimet)
1.	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	11.438.701	11.362.254	11.488.388	11.629.658 8
1.1	Të hyrat vetanake	1.099.014	1.158.014	1.207.014	1.255.500
1.2	Grantet dhe transferet qeveritare	10.339.687	10.204.240	10.281.374	10.374.658
2.	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	9.774.525	11.362.354	11.488.388	14.502.468
2.1	Shpenzimet rrjedhëse	7.707.9915	8.113.039	7.70.991	7.085.602
	Pagat dhe mëditjet	6.606.8002	7.046.288	7.068.602	7.068.602
	Mallrat dhe shërbimet	656.191	656.251	666.277	672.450
	Shpenzime komunale	295.000	270.500	273.168	280.150
	Subvencionet	150.000	140.000	150.000	150.000
2.2	Shpenzimet Kapitale	3.730.710	3.249.215	3.330.341	3.458.456
	SUFICIT / DEFICIT	0			

Burimi: KAB, 2016-2018

Tabela nr. 14, përmbledhë shpenzimet e buxhetit të komunës sipas kategorive ekonomike, për vitin 2016, 2017 dhe 2018. Për vitin 2016 shpenzimet buxhetore janë të planifikuara, ndërsa për dy vitet në vijim, çështja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, janë projeksion apo vlerësim dhe të njëjtat mund të ndryshojnë në vitet në vijim.

Është me interes që të analizohen shpenzimet nga aspekti kategorive ekonomike, për ta parë pjesëmarrjen e kategorive ekonomike në totalin e buxhetit të komunës. Ashtu siç është e paraqitur në tabelën nr. 14, buxheti i komunës shpenzohet përmes katër kategorive ekonomike.

Pagat dhe Mëditjet – Gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet 6.54 % si rezultat i vendimit të qeverisë për pagesën e stazhit të punës dhe kontributit për sigurimin shëndetësor . Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2016-2018 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 0.8 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rritja me e lartë prej rreth 8% në këtë kategori pritet të ndodhë gjatë vitit 2016, si rezultat i implementimit të legjislacionit sekondar që ka të bëjë me reformën në administratën publike, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të rritet

ndjeshëm. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt 59.99 %.

Mallrat dhe Shërbimet - kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është zvogëluar për 1.00 % nga viti 2015 në vitin 2016, edhe pse kemi rritje të konsiderueshme të shpenzimeve të kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale shkollave, pagesat për ndriçimet publike, pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj.), rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të objekteve të reja). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 vite të ardhshme pritet të jetë mesatarisht 8.00 %.

Subvencionet - Në 2015 subvencionet që do të ofrohen janë për bujqësi, shëndetësi (shpërndarja e iliqeve shtesë nga lista esenciale që shpërndanë MSH si dhe ndihmë për shërim jashtë vendit bazuar në kërkesat e deponuara), kulturë, rini, sport dhe arsim(bursat). Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2016-2018 mesatarisht do të jetë 1.00 %.

Investimet Kapitale - Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë zbritje në vitin 2016, për 12.91 % krahasuar me vitin 2015 si pasojë e rritjeve të pagave dhe zvogëlimin e grandit të përgjithshëm. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja në investimet kapitale, nga buxheti i komunës do të përmirësohet nga viti 2017, mirëpo edhe në vitin 2016 do të jetë më e ulët nga aktualja. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2016 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: 31.00 % (KAB-i 2016-2018).

5.4 Infrastruktura

Infrastruktura publike është faktori shumë i rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të çdo vendi, nga niveli dhe kualiteti i së cilës varen: zhvillimi ekonomik, zhvillimi demografik i popullsisë si dhe kualiteti i arsimit, i shëndetësisë dhe në përgjithësi standardi jetësor i komunitetit.

Në studimin e bërë për infrastrukturën dhe zhvillimin ekonomi lokal, autorët Rives dhe Heaney japin këtë përkufizim për infrastrukturë dhe për rolin e saj në zhvillimin e një komuniteti:

Infrastruktura përbëhet nga lehtësitë thelbësore brenda një komuniteti të caktuar që mbështesin proceset themelore të sistemit social-ekonomik brenda komunitetit. Rrjeti i infrastrukturës përbëhet nga sistemet e projektuara për të lehtësuar lidhjet ndërmjet njësive ekonomike, në të gjithë hapësirën, të tilla si autostrada, hekurudha dhe kanalet. Rrjeti i Infrastrukturës mund ose nuk mund të gjendet brenda një komuniteti të caktuar; ajo është distanca nga ose qasja në rrjet, që është faktor relevant, (Rives and Haeney, 1995, 60).

Edhe nga ky përkufizim për infrastrukturën dhe ndikimin e tij në zhvillimin e një komuniteti, shihet se zhvillimi socio-ekonomik është i lidhur ngushtë me zhvillimin e infrastrukturës në kompleksitetin e tij.

Infrastruktura rrugore - rrjeti dhe kualiteti i rrugëve, janë tregues dhe faktor me shumë ndikim në zhvillimin përgjithshëm shoqëror. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit, i mundëson që të kalojnë rrugë të rëndësishme të cilat i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas me pjesë e tjera të vendit si dhe me nivel ndërkombëtar.

Brenda kufijve administrative të komunës janë të shtrira gjithsej 297.6 km rrugë të gjitha kategorive. Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shume të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (te klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato te pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbëhet nga:

Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)

Rruge regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xërxe

Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec – Xërxe

Rruge lokale janë (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve).

Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike) (PZHK, 2013,103).

Tabela 15: Rrjeti rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
1	Rrugë magjistrale	6.2	2.1
2	Rrugë regjionale	64.3	21.6
3	Rrugë Urbane	30.6	10.3
4	Rrugë lokale	114	38.3
5	Rrugë e pa kategorizuar	82.5	27.7
Total		297.6	100

Burimi PZHK.2013

Si nga tabela ashtu edhe nga të dhënat e paraqitura më lartë, shihet se komuna e Rahovecit ka një rrjet rrugor cili mundëson qasje nëpër të gjitha qendrat e rëndësishme të vendit edhe në ato ndërkombëtare. Rruga magjistrale dhe rrugët regjionale R-107, R-117 dhe R-110 i mundësojnë qendrës komunale dhe qendrave sekondare lidhje të drejtpërdrejt me qendrat e rëndësishme, Prizrenin, Gjakovën dhe Kryeqytetin Prishtinën. Ndërsa rruga regjionale R-111, qytetit të Rahoveci ia mundëson qasjen në autostradën “Ibrahim Rugova”, me një distancë për vetëm 15 km, përmes së cilës komuna e Rahovecit për vetëm 3 orë arrin në Tiranë dhe në bregdetin shqiptar, kurse për më pak se një orë në Prishtinë.

Kjo qasje e lehtë e shpejtë dhe me standarde të larta, i mundëson komunës së Rahovecit të ketë qasje në treg, si për plasimin e prodhimeve të veta ashtu edhe për furnizim me produkte të nevojshme për komunitetin.

Rrjeti hekurudhor - është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional, i cili zhvillohet në linjën Fushë Kosovë – Klinë - Prizrenin - kalon nëpër territorin e komunës së Rahovecit. Vija hekurudhore kalon direkt nëpër 12 fshatra të komunës së Rahovecit, përkatësisht kanë qasje direkte në këtë rrjetë, fshatrat, (Mrasor, Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhe, Xërxe, në komunën kadastrale të Bellacerkës, Celinë dhe Krushë e Madhe). Është me rëndësi të theksohet se, në këtë vijë hekurudhore bëhet transporti i mallrave dhe udhëtarëve. Stacioni kryesor që shfrytëzohet veçanërisht për transport të mallrave, është në fshatin Xërxe dhe shfrytëzohet nga kompanitë e dy

komunave Gjakovës dhe Rahovecit, (distanca Xërxe-Gjakovë është 13 km dhe Xërxe-Rahovec 10 km).

Figura 2: Rrjeti hekurudhor në Komunën e Rahovecit;



Burimi PZHK 2013

5.5 Dokumentet zhvillimore strategjike Komunale

Komunat, sipas ligjeve bazë të cilët përcaktojnë përgjegjësitë e vetëqeverisjes lokale, janë të obliguara që të hartojnë/zhvillojnë dokumente strategjike zhvillimore, për komunën në tërësi dhe për sektorë të veçantë të jetës socio ekonomike.

Dokumentet strategjike zhvillimore duhet të përmbledhin një, përshkrim dhe vlerësim të kapaciteteve ekzistuese dhe duhet të përcaktojnë orientimet zhvillimore për të ardhmen.

Komuna e Rahovecit ka të punuara disa dokumente strategjike zhvillimore siç janë:

Agjenda e zhvillimit komunal – AZHK, e cila është punuar nga Komuna, UNMIK-u dhe UNOPS-i, në vitin 2002 (AZHK, Konkluzë, 2002).

Strategjinë e zhvillimit lokal – SZHL, e cila është punuar nga BDPA në bashkëpunim me HCL-Consultants rural development dhe financuar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, në vitin 2009,(SZHL, 2009).

Plani zhvillimor komunal – PZHK, i cili është punuar nga “Data GIS Consulting”, në bashkëpunim me komunën, në vitin 2013, (PZHK, 2013).

Draft plani për mobilitet i komunës, i punuar nga Komuna dhe projekti DEMOS i financuar nga HELVETAS Swis Intercooperation, i punuar në vitin 2015. (Vendimi, Nr.01-674).

Draft Plani rregullues i hollësishëm, “Qendra e vjetër e qytetit”, i punuar në vitin 2015. Agjenda zhvillimore komunale-AZHK - Është dokumenti i parë strategjik i punuar pas luftës, respektivisht pas fillimit të funksionimit të administratës lokale.

Ky dokument është punuar nga ekspertet lokal, të administratës së UNMIK-ut dhe me mbështetjen e UNOPS-it. Agjenda zhvillimore komunale, ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e komunës, sepse është punuar në kohën kur nuk kishte në dispozicion të institucioneve lokale dhe qendrore pothuajse asnjë dokument/informatë të besueshme lidhur me gjendjen ekonomike, sociale në përgjithësi.

Qëllimi i këtij dokumenti ishte që t’ia mundësoj qeverisë komunale që të ketë një pasqyrë më të saktë lidhur me gjendjen, nevojat, prioritetet dhe sfidat me të cilat përballeshin banorët e komunës. “Objektivat e këtij dokumenti janë të trefishta: për të siguruar një referencë të shpejtë të qasjes në pasqyrat e gjëra sektoriale dhe nevojave prioritare; të sigurohet një program bazë për rehabilitimin dhe zhvillimin e iniciativave për UNMIK-un, donatorët bilateral dhe multilateral, organizatave qeveritare dhe joqeveritare dhe mbajtësit tjerë; dhe të shërbejë si mjet planifikues pasi që ajo kombinon prioritetet për sektorë dhe temën e artikuluar nga spektri i gjerë i udhëheqjes së Komunës së Rahovecit”, (AZHK, 2002, 5).

AZHK-ja një kontribut të madh e jep edhe në paraqitjen e gjendjes në sektorin e zhvillimit ekonomik, për më tepër ky dokument ofron të dhëna për ekonominë e Rahovecit, duke e bërë një prezantim të sektorëve të veçantë të ekonomisë, ndërmarrjeve ekonomike të veprimtarive të ndryshme. Të dhënat edhe pse janë të punuara nga ekipet profesionale të angazhuara, bazuar në vlerësime personale, prapëseprapë kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, kur dihet se janë bërë menjëherë pas luftës, përmes kontakteve direkte

me zyrtarët përgjegjës të bizneseve, duke prezantuar informata të cilat janë kontinuitet nga zhvillimet në ekonominë e para luftës.,

Strategjia e zhvillimit lokal - SZHL - Dokumenti, strategjia e zhvillimit lokal është financuar nga zyra ndërlidhëse e Bashkimit Evropian me seli në Prishtinë dhe është aplikim i konceptit LEDAR në Kosovë. LEADER + është iniciativë e BE-së që aplikohet për të mbështetur projektet e zhvillimit rural të iniciuara nga niveli lokal. Programi LEADER (një akronim në kuptimin frëng, lidhje ndërmjet veprimeve për zhvillimin e ekonomisë rurale) është një iniciativë e Bashkimit Evropian për të mbështetur projekte të zhvillimit rural të filluara në nivel lokal, me qëllim për të rigjallëruar zonat rurale dhe për të krijuar vende pune.

LEADER-I u zhvillua nga 1991-93, LEADER - II nga 1994-99, dhe LEADER + nga 2000-2006.

Në periudhën e programimit aktual (2014-2020), metoda LEADER është zgjeruar për të mbuluar jo vetëm pjesë rurale, por edhe atë bregdetare (FARNET) dhe zonat urbane nën flamurin e Zhvillimit të udhëhequr nga Komuniteti Lokal (CLLD), marrë nga (https://en.wikipedia.org/ë iki/LEADER_programme, me datë 24.11.2016).

Qëllimi i kësaj strategji ka qenë ngritja e kapaciteteve lokale, për të punuar në zhvillimin e mjediseve rurale në bazë të parimeve dhe praktikave të aplikuara në Bashkimin Evropian. Strategjia ka përcaktuar qartë synimet të cilat duhet arritur për të mundësuar arritjen e qëllimit kryesor “ringjalljen e zonave rurale dhe për të krijuar vende pune”.

Synimet strategjike të Strategjisë së zhvillimit lokal janë:

1. Ngritja e kapaciteteve njerëzore
2. Zhvillimi i infrastrukturës rurale dhe bujqësore
3. Zvogëlimi i shkallës së papunësisë
4. Ruajtje e qëndrueshme e mjedisit dhe traditës
5. Ngritja e kapaciteteve lidhur me prodhimin dhe përpunimin bujqësorë
6. Themelimi i grupeve me interes, (SZHL 2009, 2).

Kjo strategji është e afërt me konceptin më të ri të zhvillimit ekonomik lokal, pasi që në procesin zhvillimor e përfshinë komunën, komunitetin lokal dhe shoqërinë civile, si partner në krijimin dhe zhvillimin e projekteve të cilat garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kjo është lëvizja e parë drejt prezantimit të qasjes Leader+ në Kosovë dhe objektivi kryesor është përzgjedhja dhe përgatitja e partnerëve përkatës lokal (GLV) për të eksperimentuar me zbatimin e një pilot faze sipas parimeve themelore të nismës Leader+ dhe provizioneve sipas udhëzimeve të tij, (SZHL, 2009, 11).

Plani zhvillimor komunal-PZHK - Është dokumenti kryesor strategjik multi-sektorial i zhvillimit të komunës. PZHK-ja është punuar nga një kompani profesioniste “Data GISconsulting” në bashkëpunim me ekipin profesional të komunës dhe në mbikëqyrje të lidërshiptit komunal për periudhën kohore 2013-2023. PZHK-të janë dokumente strategjike zhvillimore të zonave urbane dhe rurale të një komune dhe janë bazë e zhvillimit të dokumenteve të tjera sektoriale.

Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare, (Ligji Nr, 04/L-174, 2013, 13).

Plani zhvillimor komunal, është punuar në pesë kapituj, duke filluar me: I. Profilin e zhvillimit hapësinor Komunal, II. Vizioni parimet dhe caqet, III, Korniza e zhvillimit hapësinor të komunës, IV. Strategjitë dhe veprimet për zbatim dhe V. Dispozitat për zbatim.

Profili i zhvillimit hapësinor komuna - Në këtë kapitull ose “fazën e parë” ashtu siç shkruhet në planë, bëhet një përshkrim i detajuar i gjendjes së përgjithshme në komunë. Faza e parë fillon me sqarimet e nevojshme për sistemin e planifikimi hapësinor të Kosovës, rolin dhe natyrën e planit zhvillimor komunal, përfituesit, vendimmarrësit duke vazhduar me pozitën gjeografike të Rahovecit, zhvillimet demografike, çështjet sociale, vendbanimet dhe shfrytëzimi i tokës, karakteristikat fiziko-gjeografike dhe mjedisi, zhvillimi ekonomik, infrastruktura fizike lëvizshmëria dhe shërbimet publike, kapacitete investive, vlerësimi i gjendjes në komunë, sfidat e identifikuar dhe potencialet lokale të identifikuar.

Vizioni parimet dhe caqet - Është faza e dytë apo kapitulli i dytë, që përmbledhë në mënyrë të strukturuar, vizionin, parimet dhe caqet për komunën e Rahovecit, duke filluar me: Planin hapësinor të Kosovës, vizionin për komunën e Rahovecit, parimet e përgjithshme të zhvillimit, qëllimet afatgjate të zhvillimit dhe prioritetet strategjike.

Korniza e zhvillimit hapësinor të komunës - Në këtë fazë/kapitull, plani paraqet orientimet dhe trendët e zhvillimit të komunës së Rahovecit si në kontekstin lokal, atë regional dhe nacional, duke filluar me: Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor dhe struktura e zhvillimit hapësinor.

Strategjitë dhe veprimet për zbatim - Plani zhvillimor komunal, në këtë fazë ka punuar në zhvillimin e strategjive përmes të cilave do të bëhej implementim i planit dhe realizimi i objektivave/synimeve të përcaktuara, duke zhvilluar ato si në vijim: Strategjia e zhvillimit social dhe administratës, strategjia e zhvillimit të vendbanimeve dhe ndërtimeve me plan, mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi racional, strategjia e zhvillimit ekonomik dhe strategjia e zhvillimit të infrastrukturës.

Dispozitat për zbatim - Kjo është faza e fundit e planit zhvillimor komunal, në të cilën jepen orientimet për secilin sektor të komunës, në zbatimin e strategjive dhe në arritjen e objektivave të përcaktuara në planë, duke propozuar forma dhe burime konkrete, filluar me: Dispozitat e përgjithshme, detyrat dhe masat për zbatimin e planit, kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e komunës, kushtet për rregullimin e hapësirës, zhvillimi i vendbanimeve dhe ndërtimet e tjera jashtë tyre, zhvillim social dhe administratë efikase, mjedis i pastër dhe atraktiv, zhvillimi ekonomik i komunës, kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës dhe dispozitat përfundimtare.

Komuna ka në zhvillim edhe dokumente të tjera, të cilat janë të fokusuara në fusha specifike si, draft, plani për mobilitet, draft plani komunal për banim, draft plani komunal për hapësirat publike dhe draft plani rregullues i hollësishëm të cilët priten që të finalizohen në periudhën e ardhshme.

Nga analiza e planeve ekzistuese, SZHL dhe PZHK, mund të konkludojmë se, këto dy dokumente strategjike, janë të punuara në mënyrë profesionale, kanë të zhvilluar një strukturë të kënaqshme, duke trajtuar me mjaftë kompetencë, nevojat, sfidat, mangësitë dhe i kanë të përcaktuar qartë objektivat. Problem në vete mbetet se asnjëri nga dokumentet e zhvilluara nuk ka vazhduar të jetë bazë e punës së mëtejme e qeverisë komunale.

SZHLja për kundër formimit të GLV-ve, Këshillit Ekzekutivë, Bordit të Drejtorëve, trajnimit të tyre, identifikimit të projekteve dhe krijimit të formave standarde të zhvillimit të projekteve, nuk ka vazhduar me punë pas përfundimit të projektit.

PZHK-ja është dokumenti më gjithëpërfshirës zhvillimor, ka një mori informatash dhe projektesh të punuar, në formë mjaftë profesionale, duke trajtuar çdo element të rëndësishëm, por i njëjti nuk merret për bazë gjatë punimit të buxhetit dhe kornizës afatmesme buxhetore.

Mendoj se komuna duhet të ndërtoj kapacitete për implementimin e këtyre dokumenteve strategjike zhvillimore dhe njëkohësisht duhet të krijoj edhe strategji të tjera sektoriale të zhvillimit siç janë: arsimi, shëndetësia, ekonomia, bujqësia etj.

5.6 Sektori publik

Organizimi Institucional i sektorit publik në fushën e ZHEL-it

Organizimi institucional, respektivisht forma dhe mënyra e organizimit të sektori publik në fushën e zhvillimit ekonomik lokal është një çështje shumë më rëndësi. Mënyra e organizimit dhe format e veprimit të këtyre institucioneve ndikon direkt në suksesin zhvillimit të konceptit të ZHEL-it. Këto institucione kanë një rolë kryesisht mbështetës të sektorit privatë, përmes krijim të kushteve për zhvillim dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme.

Organizimi, menaxhimi dhe udhëheqja e përpjekjeve për ZHEL, kërkon zgjedhjen e opsioneve institucionale. Varësisht nga madhësia e qeverisë lokale urbane dhe situatave specifike lokale mundësit e krijimit të ekipit ZHEL-it, një departament në zyrën e qeverisë lokale apo një organizatë të veçantë (duke përfshirë institucionet ekzistuese) duhet të jetë dhe të zgjidhet. Megjithatë për të filluar me ZHEL-in një ekip duhet të krijohet në Bashki ose brenda një organizate partnere dhe ky ekip fillimisht duhet të menaxhoj procesin e planifikimit strategjik, (FUPI, 2006, 21).

Në kuadrin e administratës komunale si organe që në një formë apo tjetër janë të lidhura me procesin e zhvillimit ekonomik, janë: Drejtoria komunale për zhvillim ekonomik, drejtoria komunale për financa dhe buxhet dhe drejtoria për bujqësi dhe zhvillimi rural. Si organe të nivelit qendror të cilat kanë përfaqësitë në komunë dhe që janë të lidhura me zhvillimin ekonomik lokal janë, zyra e punësimit dhe qendra për punë sociale.

Drejtoria për financa dhe buxhet - “Drejtoria për buxhet dhe financa ushtron përgjegjësitë që ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i buxhetit, financave, ekonomisë dhe zhvillimit: Bënë përgatitjet e projektit të Buxhetit në procedurën e propozimit nga kryetari i Komunës për miratim në Kuvend. Është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe

raporteve financiare periodike dhe vjetore. Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën) nga lëmi i tatimit në pronë, taksave dhe gjobave komunale. Mban evidencën e të hyrave buxhetore nga të hyrat vetanake të Komunës”.

Drejtoria për zhvillim ekonomik - “ Kjo Drejtori do t’i ushtroj përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore: Harton projektin e Planit strategjik zhvillimor të Komunës. Harton plane për shfrytëzimin e burimeve ekonomike brenda Komunës. Është përgjegjëse për krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Është përgjegjëse për bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, mistritë e tjera dhe donatorët, rreth koordinimit të punëve dhe aktiviteteve për zhvillimin ekonomik të Komunës. Kryen edhe punët tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e ekonomisë dhe të zhvillimit. Koordinon punët e tjera në bashkëpunim me komunitetet e interesit.

Drejtoria për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural - ” Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, si vijon: Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë. Kujdeset të siguroj që tokat bujqësore të shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore. Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat për ruajtjen e Fondit të pyjeve. Monitoronë ndihmat veterinare dhe përkujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake. Bënë mbrojtjen e resurseve pyjore në territorin e Komunës së Rahovecit dhe kujdeset për rregullimin dhe mbrojtjen e bimëve. Kryen edhe punët tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë dhe zhvillimit rural”, (Statuti, 2010, 18, 21).

Nga përshkrimi i përgjegjësive të parapara me statut dhe me ligjet bazike, drejtoritë në fjalë por jo vetëm këto kanë një gamë të gjerë të përgjegjësive, por shtrohet pyetja sa dhe si i ushtrojnë këto përgjegjësi. Përgjegjësitë për zhvillim ekonomik edhe pse janë të ndara në tri drejtori, megjithatë DZHET është përgjegjëse dhe ka rolin e lidershit në këtë fushë. Përkundër që kësaj drejtorie kohëve të fundit i është deleguar përgjegjësia e regjistrimit të bizneseve, (Zyra për regjistrim të bizneseve është në lidhje të drejtpërdrejtë me ARBK-në dhe me DKZHET), kjo drejtori vazhdon të mos ketë informatat e nevojshme për punën dhe procesin afaristë të bizneseve në Komunë. Ushtrimi i

përgjegjësi në lëmin e zhvillimit ekonomik lokal në komunë lenë shumë për tu dëshiruar.

Organizatave publike qendrore dhe lokale

Funksionimi i organizatave publike si në nivelin lokal ashtu edhe në atë nacional, është i përqendruar kryesisht në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët, subjektet juridike përfshirë institucionet publike dhe bizneset. Organizimi dhe funksionimi i këtyre organizatave është shumë më rëndësi për zhvillimin socio ekonomik të komunës, sepse cilësia dhe mjaftueshmëria e këtyre shërbimeve determinon edhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komunës.

Është me interes të potencohet se ofrimi i shërbimeve publike vazhdon të bëhet nga organizatat që operojnë në nivel nacional, regjional dhe lokal. Organizatat të cilat kanë organizim nacional ofrojnë shërbime të karakterit strategjik dhe të njëjtat shërbime ofrohen për të gjithë qytetarët, institucionet dhe bizneset e vendit. Organizatat të cilat ofrojnë shërbime publike me karakter regjional, janë të organizuara në nivel regjioni dhe shërbimet e tyre ofrohen për qytetarët, institucionet dhe bizneset e dy ose më tepër komuna. Organizata që ofrojnë shërbime publike për qytetarë, institucione dhe biznese të komunës janë organizata lokale publike.

Organizatave publike nacionale - Posta dhe Telekom i Kosovës, ofron shërbimet postare dhe të telekomunikacionit, njësi e PTK-së, është e vendosur në qendrën komunale, kurse zyrat e veta i ka të shpërndara në; Krushë të Madhe, Ratkovc dhe Hoçë të Madhe. Viteve të fundit shërbimet e telekomunikimit ofrohen edhe nga disa operatorë të tjerë siç janë, Ipko, Kujtesa etj. Por këta operatorë edhe pse kanë të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të territorit të komunës nuk e kanë të vendosur një formë të organizuar të menaxhimit dhe mbikëqyrjes në qytet apo në ndonjë vendbanim të komunës.

Korporata energjetike Kosovës – KEK-u tani KEDS-i, është organizatë publike e cila ofron shërbimin strategjik për banorët dhe bizneset e Rahovecit dhe të gjithë vendit, bënë furnizimin me energji elektrike. Kjo organizatë ka të ndërtuar në fakt të trashëguar një strukturë të organizuar, ka njësinë në Rahovec, trafo stacionet në qytet dhe në Xërxe. Kjo organizatë tani është e privatizuar, e njëjta punon me strukturë të njëjtë të organizimit. Furnizimi me energji elektrike vazhdon edhe më tej të mos jetë i kënaqshëm.

Organizatave publike regjionale - Këto organizata funksionin e vetë e ushtrojnë në një apo më shumë komuna, një organizatë e tillë në komunën e Rahovecit është organizata e

ujit të pijes Hidrosistemi “Radoniqi” me selinë bazë në Gjakovë, njësia në Rahovec. Kjo ndërmarrje publike bënë furnizimin me ujë të pijes të 2/3 të ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve publike në territorin e komunës së Rahovecit. Sistemi i ujësjellësit të Radoniqit e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe fshatrat, Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Dejn, Nushpalë, Sopniq, Potoçan i Epërm, Potoçan i Poshtëm, Reti e Ulët, Vrajak dhe Nagavc dhe tash se fundi fshatrat Dabidol, Cifllak, Kramovik, Polluzhë. Në këtë sistem kanë qasje 74500 banorë ose 83 % të popullatës të përgjithshme në komune (PZHK.2013,122).

Organizatat publike lokale - Këto organizata funksionin e vetë e ushtrojnë brenda territorit të një komune, në rastin konkret Ndërmarrja “Ambienti”. Kjo kompani publike e bënë pastrimin, bartjen dhe deponimin e mbetjeve urbane. Kjo ndërmarrje ofron shërbim për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet publike në qytetin e Rahovecit dhe në disa vendbanime.

Përpos kësaj organizate sipas ligjit për ndërmarrjet publike statusin e organizatës publike lokale e gëzon edhe stacioni i autobusëve në Rahovec. Ky stacion tani shërben kryesisht si një organizatë që ju ofron shërbime ndërmarrjeve për transport të udhëtarëve dhe qytetarëve të cilët e shfrytëzojnë transportin publik.

5.7 Ekonomia - Sektori privat

Bujqësia dhe blegtoria

Rahoveci njihet si regjion në të cilën dominon veprimtaria bujqësore e cila konsiderohet si shtyllë e zhvillimit ekonomik të kësaj komune. Popullata e Rahovecit, kudo që haset çmohet për traditë në kultivimin e hardhisë së rrushit dhe në prodhimin e kulturave të tjera bujqësore, siç janë të gjitha llojet e drithërave, perimekulturë etj. Nga vlerësimet e bërë në të gjitha dokumentet strategjike zhvillimore të komunës të punuara pas luftës ashtu edhe në ato të para luftës, konsiderohet se pjesa dërmuese e popullsisë së kësaj komune merret me bujqësi.

Kështu në agjendën zhvillimore të komunës së Rahovecit të punuar nga UNOPS-i në bashkëpunim me grupin komunal punues, konstatojnë se: Bujqësia është aktiviteti themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Afro 65% e popullatës është vlerësuar të sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore sipas Komunës, (Agjenda, 2002, 10).

Bujqësisë si veprimtari kryesorë në ekonominë e Rahovecit, e konstaton edhe plani zhvillimor komuna i punuar nga kompania "Data GIS Consulting" dhe ekspertet komunal vlerësohet se: Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimekulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar të sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 - 3,000 €, (PZHK, 2013, 86).

Bujqësia

Pozita gjeografike, përbërja pedologjike e tokës, klima dhe faktorë të tjerë kanë bërë që bujqësia të jetë njëra ndër veprimtaritë kryesore ekonomike në territorin e komunës së Rahovecit. Rajoni i Komunës së Rahovecit përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe përbëhet prej tri terreneve të ndryshme: luginave (29.17%), kodrave (58.7%) dhe maleve (12.13%). Të reshurat vjetore në Rahovec arrijnë në 765 mm dhe temperatura mesatare e ajrit është 11.8 C, (AZHK, 2002, 7).


Regjioni i Rahovecit mbetet prodhuesi më i madh i rrushit të gjitha llojeve, sipërfaqet më të mëdha shtrihen në territorin e kësaj komune, gjithashtu edhe kultivimi i perimekulturave është i koncentruar në këtë regjion. Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese. Popullata e komunës së Rahovecit ka traditë të lashtë në kultivimin e rrushit dhe verës. Në këtë treve rrushi kultivohet që nga koha ILIRE para më se 2000 vitesh, (PZHK, 2013, 85).

Vlerësimet që dalin nga dokumentet zhvillimore të komunës, vlerësojnë se pjesa dërmuese e popullsisë së komunës veprimtari primar e ka bujqësinë. "Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtarë. Toka e punueshme prej total cca 14000 Ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.", (PZHK, 2013, 86).

Prodhimi i rrushit/Vreshtaria - Edhe pas luftës së fundit në vendin tonë, vazhdon të mbetet veprimtari më i rëndësishëm në bujqësinë dhe ekonominë e Rahovecit. Prodhimi i rrushit në periudhën e para luftës ishte një aktivitet ekonomik i rëndësishëm edhe në disa regjione të tjera të vendit, pas luftës së fundit kjo veprimtari ekonomike është e koncentruar kryesisht në komunën e Rahovecit edhe në atë të Suharekës.

Një vlerësim të tillë e potencon edhe Strategjinë e sektorit të vreshtarisë dhe verëtarisë e punuar nga MBPZHR për periudhën 2016-2021, sipas së cilës prodhimi rrushit është në masën prej mbi 70%, i koncentruar në komunën e Rahovecit. Shih grafikun më poshtë:

Figura 3: Sipërfaqet e mbjella me hardhinë e rrushit në Kosova, para dhe pas luftës



Burimi: MBPZHR, 2016

Kjo ka sjellë deri te situata momentale ku më shumë se 72% e vreshtave të Kosovës ndodhen në komunën e Rahovecit. Komuna e Suharekës është po ashtu një zonë e rëndësishme për prodhimin e rrushit dhe verës, gjithashtu edhe në zonën vreshtare të Prizrenit ekziston një numër i konsiderueshëm i sipërfaqeve me vreshta, (SSVV. 2016, 20).

Tabela 16: Sipërfaqet me vreshta dhe prodhimi i rrushit në komunën e Rahovecit

Nr.	Lloji i Rrushit	Sipërfaqe (ha) 2016	Sipërfaqe (ha) 2015	Prodhimi ton/ha	Prodhimi në total (ton)
1	Rrush i tryezës	439,60	420,50	16 t	7,033.60 t
2	Rrush për verë	1.833,56	1.785,55	13 t	23,836.28 t
		2.273,16	2.206,05		30,869.88 t

Burimi: DBZHR, 2016

Nga tabela nr. 16, shihet se hardhia e rrushit ka filluar të kultivohet në sipërfaqe të reja dhe me një dominim të rrushit industrial apo të verës ashtu siç quhet në zhargonin e përditshëm.

Nëse e krahasojmë sipërfaqen në të cilën kultivohet/prodhohet rrushi gjatë këtij viti respektivisht me 2016 që është 2273, 16 ha. me sipërfaqen e cila është e evidentuar në PZHK, e që është 2168 ha, rezulton se për 4-5 vite e fundit janë shtuar sipërfaqe të reja në 105,16 ha.

Prodhimi i drithërave - është një veprimtari me rëndësi në bujqësinë e komunës së Rahovecit. Në sipërfaqet e tokave bujqësore prodhohen shumica e llojeve të drithërave pothuajse të gjitha me një dominim të grurit dhe misrit.

Tabela 17: Sipërfaqet e mbjellura me drithëra për vitet 2015- 2016,në komunën e Rahovecit;

Nr.	Lloji i kulturës – drithërave	Sipërfaqe,(ha) 2016	Sipërfaqe,(ha) 2015	Prodhimi Ton/ha	Prodhimi në total (ton)
1	Grurë	2.400,34	1.484,22	4,60 t	11.041,56 t
2	Misër	2.056,20	1.237,00	10,00 t	20.562,00 t
3	Tërshërë	740,00	500,00	1,10 t	814,00 t
4	Elb	4,11	3,10	1,80 t	7,39 t
5	Sojë	20,00	11,00	1,50 t	30,00 t
	Totali	5.220,65	3.235,32		

Burimi, BPBZHR, 2016

Prodhimi perimeve/perimekultura; Është një veprimtari mjaftë dominuese në komunën e Rahovecit. Perimet e të gjitha llojeve të prodhuara në regjionin e Rahovecit janë të njohura në tregun e vendit atë regjional dhe më gjerë. Rahoveci është i njohur në tregun e vendit dhe më gjerë.

Tabela 18: Sipërfaqet e mbjellura me perimekulturë në vitet, 2015- 2016 në Rahovec;

Nr.	Lloji i kulturës Perimekulturës	Sipërfaqe (ha) 2016	Sipërfaqe (ha) 2015	Prodhimi Ton/ha	Prodhimi në total(ton)
1	Specat	1.420,14	1.400,20	35,00 t	49.704,90 t
2	Domate	18,00	18,00	45,00 t	810,00 t
3	Patate	456,00	500,00	40,00 t	18.240,00 t
4	Lakra	180,00	175,00	15,00 t	2.700,00 t
5	Qepë	490,00	480,00	45,00 t	22.050,00 t
6	Hudhra	10,00	8,00	1,10 t	11,00 t
7	Spinaq	5,60	5,20	5,50 t	30,80 t
8	Shalqinj	378,00	375,00	50,00 t	18.900,00 t
9	Tranguj	6,35	6,15	30,00 t	190,50 t
	Totali	2.964,09	2.967,55		

Burimi, DBPZHR, 2016

Prodhimi i perimeve në serë - Aplikimi i metodologjisë bashkëkohore në prodhimin e kulturave bujqësore, përmes përdorimit të arriturave shkencore është një formë e cila ka filluar të përdoret nga bujqit e Rahovecit. Prodhimi në serë i perimeve është në rritje, kjo mënyrë i ka përparësitë në krahasim me prodhimin tradicional të kulturave bujqësore siç janë: Prodhimi në sasi më të madhe, kualitet më i mirë dhe ruajtja nga dëmtimet që shkaktohen nga kushtet atmosferike etj.

Tabela 19: Sipërfaqet e mbjella me perimekulturë në Sera, 2015-2016, në Rahovec

Nr.	Vendbanimi/Fshati	Sipërfaqe 2016	Sipërfaqe 2015	Kultura
1	Ratkoc	2,80	2,30	Perime
2	Dejn	3,24	2,90	Perime
3	Çifllak	4,60	3,90	Perime
4	Radostë/Malsi e Vogës	1,96	1,75	Perime
5	Xërxe	1,20	1,00	Perime
6	Krushë e Madhe	4,30	3,95	Perime
7	Rahovec	1,60	1,30	Perime
8	Bellacërkë/Fortesë	2,20	1,85	Perime
9	Të tjera	3,66	3,45	Perime
10	Totali	25,56	22,40	

Burimi, DBPZHR, 2016

Blegtoria dhe shpezrtaria - Një aktivitet tjetër i rëndësishëm në ekonominë e Rahovecit është edhe blegtoria dhe shpezrtaria. Zhvillimi i kësaj veprimtarie ekonomike në komunën e Rahovecit zhvillohet kryesisht në ambientet e mbyllura, “Stalla”, veçanërisht pjesa e Gjedheve-Lopëve qumështore, viçave për majmëri, pulave vojse dhe brojlerëve, ndërsa delet dhe dhitë, më tepër zhvillohen në ambiente të hapura në fomën klasike.

Gjendja momentale në këtë veprimtari të ekonomisë së Rahoveci, do të pasqyrohet në tabelën e më poshtme:

Tabela 20: Fermat sipas llojit dhe numri i krerëve në vitet, 2015-2016 në Rahovec*

Nr.	Lloji i Fermës	Nr. Fermave 2016	Nr. Krerëve 2016	Nr. Fermave 2015	Nr. Krerëve 2015
1	Lopë qumështorë	275	2560	272	2592
2	Viçat (për majmëri)	6	160	6	165
3	Dele	35	6689	36	6275
4	Dhi	4	491	4	524
5	Bletë	78	4804	63	4528
6	Pula vojse	7	49900	9	71100
7	Brojlerë	1	5800	1	6000

Burimi. DBPZHR, 2016

*Sqarim, Sipas kriterëve të MBPZHR, Fermë konsiderohet, ajo e cila ka minimumin e krerëve si: Pesë (5) krerë lopë qumështorë, 20 viça për majmëri, 30 dele, 20 dhi, 30 kosherë bletë, 2000 pula vojse dhe 2000 brojlerë.

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë padyshim se është njëra ndër veprimtaritë më të rëndësishme për ekonominë e Rahovecit, si për nga pjesëmarrja në produktin e përgjithshëm vendor ashtu edhe për punësimin e një numri të konsiderueshëm të fuqisë punëtore dhe si një burimi rëndësishëm i të ardhurave për familjet e tyre. Të dhënat e prezantuar në tabelarët lidhur me sipërfaqet dhe rendimentet e prodhuara janë burim i DBPZHR, të cilat janë marrë nga fermerët që gjenden në listën e përfituesve të grandëve subvencionuese të MBPZHR.

Nëse i shikojmë me kujdes tabelat në të cilat prezantohen të dhënat me sipërfaqet dhe sasi të prodhuara të kulturave bujqësore, vërehet trendi i ndryshimit respektivisht rritjes së sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore dhe rrjedhimisht edhe rritja e sasisë së prodhuar.

Viteve të fundit nga MBPZHR e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kanë filluar të subvencionohen bujqit përmes pagesave direkte për sipërfaqe prodhimin e kulturave bujqësore.

Industria prodhuese/përpunuese

Industria prodhuese/përpunuese në Rahovec, ka një zanafillë jo shumë të hershme, fillet e saj janë në gjysmën e dytë të shekullit njëzet. Industria e parë është e lidhur kryesisht me fushën e bujqësisë respektivisht me përpunimin e rrushit dhe prodhimin e verës dhe rakisë.

Fillimi i viteve të gjashtëdhjeta të shekullit njëzet është periudha kur në Rahovec, vendosen bazat e përpunimit të rrushit dhe të fillimit të kalimit nga përpunimi tradicional i rrushit dhe i prodhimit të verës e rakisë në prodhimin industrial me metoda dhe teknologji bashkëkohore.

Metoda moderne e vreshtarisë në këtë anë ka qenë e shfaqur që nga krijimi i kompleksit të parë të punishtes gjigante të verës "Rahovec" në vitin 1953, (Agjenda, 2002, 12).

Ndërtimi i këtij bodrumi, ka ndikuar në rritjen e sipërfaqeve me vreshta si dhe janë shtuar edhe llojet/varietetet e rrushit duke e rritë dominimin e sorteve industriale apo siç quhet

ndryshe rrushi i verës, kështu vreshtaria së bashku me industrinë e verës u bënë shtylla kryesore e zhvillimit të ekonomisë së Rahovecit.

Përpos industrisë së përpunimit të rrushit, në vitet e gjashtëdhjeta e kanë zanafillën edhe disa uzina prodhuese të cilat për afro një gjysmë shekulli kanë qenë shtylla kryesore e punësimit dhe zhvillimit për banorët e komunës së Rahovecit. Industria për përpunimin e grurit, prodhimin e miellit, bukës dhe pjekurinave “Sillosi” në Xërxe, është një tjetër gjigant i zhvillimit i cili është themeluar dhe ka filluar me punë në vitin 1969, ka qenë njëra ndër fabrikat më të mëdha në prodhimin e miellit me kapacitete të bluarjes prej 200 tonë në 24 orë etj. Industria e masave plastike “18 Nëntori” në Rahovec dhe njësinë në Xërxe, ishte një shtyllë tjetër e rëndësishme e zhvillimit të Rahoveci dhe të vendit në tërësi, kjo industri ka startuar me punë në vitin 1959, me kapacitet të prodhimit prej 7500 tonë. Pos këtyre tre gjiganteve të prodhimit, në komunën e Rahovecit kanë afaruar edhe disa industri/uzina më të vogla siç janë, “Termosistemi”, “Ekoplasti” dhe “1Maji”, të cilat gjithashtu kishin një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, përmes programeve shumë atraktive të prodhimit. Termosistemi merrej me prodhimin e këmbyesve të nxehtësisë, Ekoplasti me përpunimin e mbetjeve plastike “riciklimin e mbeturinave plastike”, kurse 1Maji me prodhimin e materialit ndërtimor “pallakave të mermerit”.

Tabela 21: Ndërmarrjet shoqërore industriale, para dhe pas luftës në komunën e Rahovecit

STATUSI I FABRIKAVE “SHTETËRORE” NË RAHOVEC 2001										
Fabrika	Produktet	Viti i themelimit/ Fillimi i Punës	Para konfliktit			Dëmet gjatë Konfliktit (EURO)	Pas Konfliktit			Vlera e Kapitalit (prona) (EURO)
			Prodhimi	Shitja (EURO)	Të punësuar		Prodhimtaria Aktuale	Punëtorët që punojnë aktualisht	Punëtorët që nuk punojnë por që janë kompensuar pjesërisht	
NBI RAHOVEC	Prodhimi i verës dhe rrushit	1953	10 milionë litra verë 30-40,000 tonë rrush	12.5 milionë	850	5 milionë	3 milionë litra	450	60	141.5 milionë
Sillosi	Prodhimi i grurit, miellit dhe i makaronave	1969	Nuk është në dispozicion	3,75 milionë	520	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion	360	0	37.5 milionë
18 NËNTORI	Përpunimi i lëndëve plastike	1959	7500 tonë	3.9 milionë	650	1 milionë	3500 tonë	182	150	12.5 milionë
TERMOSISTEMI	Nxemësit, ftohësit, kolektorët solar	1988	Nuk është në dispozicion	1 milionë	110	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion	60	0	Nuk është në dispozicion
EKOPLASTI	Reciklimi i mbeturinave plastike	1986	1500 tonë	0.4 milionë	55	Nuk është në dispozicion	500 tonë	35	0	1.5 milionë
1MAJI	Materiali Ndërtimor	1975	Nuk është në dispozicion	0,25 milionë	250	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion	60	0	0,6 milionë

Burimi, AZHK, 2002

Industria e cila ishte shtyllë e zhvillimit ekonomik të Rahovecit para luftës, gjatë procesit të privatizimit ka qenë mjaftë atraktive për investorët e ndryshëm, kështu që edhe sot vazhdon të jetë mjaftë aktive dhe një faktorë shumë i rëndësishëm i zhvillimit në nivel të komunës dhe vendi.

Privatizimi i ndërmarrjeve në komunën e Rahovecit - Procesi i privatizimit është me shumë rëndësi për zhvillim ekonomik të vendeve në tranzicion, në këtë sens ky proces është i rëndësishëm edhe për zhvillimin ekonomik lokal. Si rrjedhojë ky proces ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të komunës së Rahovecit, veçanërisht në zhvillimin e industrisë përpunuese.

Privatizimi në Kosovë është specifik dhe i veçantë në krahasim me vendet e tjera, si për nga forma ashtu edhe për nga modelit të aplikuar. Privatizimi është bërë përmes aplikim të modelit të SPIN-of – it (të rregullt dhe atij special në raste të caktuara), mënyrë kjo që i ka karakteristikat e veta. *UNMIK-u dhe Shtylla e IV-të* për vazhdimin e procesit të privatizimit zgjodhën një model të veçantë për Kosovën. Ky model ishte njohur si SPIN-of dhe një variant i tij “SPIN-of special”. Sipas kësaj metode, AKM-ja nga NSH ekzistuese (*ose në emër të tyre*) themelon një ose më shumë shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuara. Këtyre shoqërive të reja ua bart të drejtat mbi pronat e NSH si dhe fitimet nga to. Ndërmarrja e Re posedon aksionet e ndërmarrjes shoqërore. AKM posedon të drejtën që këto aksione t’ia shes, ose të ia tjetërsoj ndërmarrjes së Re (*ose ndërmarrjeve*) të reja. Të ardhurat nga shitja e aksioneve ruhen në një Fond të Mirëbesimit, pranë AKM-së, për interesa të pronarëve të NSH dhe kredituesve (*nëse ka pasur*). Duhet sqaruar se, ndërmarrja shoqërore e mbetur, ka marrë në barrë të saj edhe problemet nga e kaluara. Në fakt, pas bartjes së aksioneve ajo është përgatit dhe është likuiduar, sipas një procedure të veçantë. Kjo formë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është aplikuar në Kosove. Kurse ndërmarrjet publike dhe pronat shtetërore nuk janë privatizuar, por kanë mbetur nën administrimin e UNMIK-ut (AKM-së), (Shatri, 2016, 70).

Procesi i privatizimit në komunën e Rahovecit, është zhvilluar përmes aplikimit të metodës së Spin-off it të rregullt dhe Spin-off it special. Procesi i privatizimit në ekonomin e Rahovecit, është bërë duke aplikuar nga AKM-ja, format e transformimit të ndërmarrjeve ekzistuese shoqërore në ndërmarrje të reja dhe metodës së privatizimit, që është vlerësuar më e përshtatshme dhe më me interes. Kështu, Spin-off special është

përdorur për privatizimin e ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve, që janë vlerësuar se janë atraktive dhe kanë mundësi që të vazhdojnë aktivitetin afaristë/prodhues edhe pas privatizimit. Nisur nga këto premisa, NBI “Rahoveci” dhe ndërmarrja e re Mulliri Sillosi në Xërxe, janë privatizuar përmes metodës së Spin-off it special.

Mulliri Sillosi SH.P.K. - Ndërmarrja e re Mulliri Sillosi SH.P.K gjendet në Xërxe, në rajonin bujqësor të Rahovecit. Me një kapacitet për bluarje prej 200 tonësh në ditë dhe një kapacitet të siloseve prej 55,000 tonësh grurë, është mulliri më i madh në Kosovë. Fabrika për prodhimin e brumërave dhe biskotave të njelmëta, përfshinë një sipërfaqe totale prej 4,58 hektarësh, e privatizuar në valën e katërt, me datë 11 janar 2005.

Ndërmarrja e Re Veraria dhe Vreshtaria Rahovec SH.P.K. përbëhet prej verarisë më të madhe dhe kompleksit të vreshtarisë në Kosovë, përfshirë prodhimin, deponimin dhe pajisjet për mbushje për venë të kuqe dhe të bardhë dhe pije alkoolike dhe rreth 900 hektarë vreshta (prej të cilave 300 hektarë nuk janë në prodhim), e privatizuar në valën e 8b, me datë 22 shkurt 2006 , <http://kta-kosovo.org/>, (mars më, 03.11.2016)

Ndërmarrjet e tjera prodhuese dhe tregtare janë privatizuar përmes aplikimit të metodës së Spin-off it të rregullt. Përmes këtij modeli janë privatizuar ndërmarrjet prodhues:

Ndërmarrja “Termosistem” në valën/raundin e parë të privatizimit me 03 shtator 2003.

Ndër. e Re Ekoplast L.L.C. (Rahovec) është fabrika e vetme për riciklimin e masave plastike në Kosovë. Operon në 1.381-m² sipërfaqe të fabrikës me 5 hektar vend, 3 km larg nga qendra e qytetit të Rahovecit (Regjioni i Prizrenit). Gjithashtu e ka teknologjinë e prodhimit të gypave të plastikës për sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit, e privatizuar në valën/raundin e katërt, me datë 11 janar 2005.

Ndërmarrja e Re Administrata/Bodrumi i vjetër SH.P.K. është njëra ndër verëtaritë më të vjetra në regjion, përfshinë sipërfaqe toke prej 2.29.51 ha, me tri ndërtesa të ndara të administratës me rreth 50 zyre. Bodrumi i vjetër përfshin depon dhe objektet për prodhimin e verës për 3,8 m litra verë, 2 reparte për pranimin e rrushit, peshoren që peshon deri në 10 tonë dhe, gjashtë tanqe për ruajtjen e verës nga çeliku, me kapacitet prej 25 vagonë për njësi., e privatizuar në valën e 10 me datë 08 shkurt 2006.

Ndërmarrja e Re “1 Maji” Xërxe Mermeri dhe Beton Sh.P.K. - për ndërtim përfshin lokacionin e prodhimit të NSH-së, në një sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht 55 hektarë 04 ari e 42m² (550,442 m²) në fshatin Xërxe. Ndërmarrja e re përfshinë asete produktive për prodhimin e mermerit, betonit dhe prodhimeve të betonit (shtylla për vreshta, blloka

të betonit etj). Po ashtu, përfshinë edhe asetet prodhuese për eksploatimin e zhavorrit nga lumi Drini Bardhë, e privatizuar në valën e 17, me datë 06 shator 2006.

Ndërmarrja e Re “1 Maji” Rahovec, Drejtoria Sh.P.K. - përfshinë zyrat dhe oborrin e NSH-së në një sipërfaqe të përgjithshme rreth 03ari e 28m², në qendër të Rahovecit, privatizuar në valën e 21, me datë 07 shkurt 2007.

Ndërmarrja e Re Podrima – Depo Rahovec Sh.P.K. - gjendet në pjesën atraktive të qytetit të Rahovecit, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 0,13,50 ha (13 ari & 50 m²). Kjo Ndërmarrje Subsidiare përfshinë Depon në Rahovec, me një sipërfaqe prej përafërsisht 502 m², është privatizuar në valën e 22, me datë 07 mars 2007.

Ndërmarrja e Re Podrima – Shitoret Rahovec Sh.P.K. - gjendet në pjesën atraktive të qytetit të Rahovecit, përfshin një Kompleks të Shitoreve. Kjo Ndërmarrje Subsidiare përfshin 4 shitore në Rahovec, me një sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht 541.5 m², është privatizuar në valën e 25, me datë 20 qershor 2007.

Ndërmarrja e Re Podrima Rahovec – Shitoret në Qendër Sh.P.K. - gjendet në qendër të qytetit të Rahovecit, përfshin një Kompleks të Shitoreve. Kjo Ndërmarrje Subsidiare përfshin 5 shitore në Rahovec me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 368.8 m², e privatizuar në valën e 26, me datë 18 korrik 2007.

Ndërmarrja e Re 18 Nëntori në Rahovec SH.P.K. është një përpunuese e plastikës e specializuar në prodhimin e qeseve plastike dhe plastikës me metër, për shfrytëzuesit industrial dhe shtëpiak, një seri të gjerë të pjesëve plastike, shisheve dhe kutive, gjithashtu edhe orendive.

Ndërmarrja e Re 18 Nëntori Xërxë Alfa SH.P.K. në fshatin Xërxë ka prodhuar pjesë për bateri duke përdorur teknologjinë e injektimit. Megjithëse tani fabrika punon me kapacitet minimal, kjo njësi për prodhimin e baterive mund të jetë një bazë ideale për prodhues ekzistues të plastikës për krijimin ose zgjerimin e aktiviteteve të biznesit të tyre aktual.

Ndërmarrja e Re 18 Nëntori Xërxë Beta SH.P.K. me 1,720m² së bashku me një pjesë të oborrit të mbuluar, është e përshtatshme për rifillimin e aktiviteteve të saja origjinale ose për shndërrimin në një numër përdorimesh komerciale (prodhim, hapësirë për depo, etj). Toka në pjesën e prapme të pronës mund të përdoret për qëllime komerciale ose private. Të privatizuara në valën e 8 me datë 18 tetor 2005. <http://kta-kosovo.org/>, (marrë me, 03.11.2016).

Procesi i privatizimit në komunën e Rahovecit, mund të vlerësohet relativisht i suksesshëm për kundër asaj që ka ndodhur me shumicën dërmuese të privatizimeve në nivel vendi. Ky vlerësim bazohet në rezultatet të cilat janë treguar nga përfituesit respektivisht nga kompanitë fituese në këtë proces dhe nga vazhdimi i aktivitetit të ndërmarrjeve të reja. Kështu në një analizë që i është bërë procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë nga GLPS & BIRN është konstatuar se: Nga ana tjetër, vetëm tetë nga 26 NSH-ve të shitura përmes spin-off special doli të jenë të suksesshëm, që do të thotë se ato arritën të plotësojnë kushtet e caktuara. Tetë tregimet e suksesshme të privatizimit të nxitura nga AKP-ja janë "Ferronikeli", "Klllokoti", "Vineyard Stone Castle", "Hotel Theranda", "Trofta", "M & Sillosi", "Birraria e Pejës dhe" "Hotel Nora", (GLPS&BIRN, 2016,29).

Analiza e procesit të privatizimit në ekonominë e Rahovecit, mund të shikohet nga dy perspektiva:

1. Nga perspektiva e interesit të ofertuesve gjatë procesit të privatizimit dhe vazhdimi i programit të njëjtë prodhues më pastaj dhe,
2. Rëndësia e këtyre ndërmarrjeve në zhvillimin ekonomik të Komunës së për nga kontributi në të ardhurat ashtu edhe në punësim.

Nëse e shikojmë nga perspektiva e interesit të shprehur nga ofertuesit në këtë proces, mund të konkludojmë se në përgjithësi në privatizimin e ndërmarrjeve prodhuese në Rahovec ofertuesit kanë qenë serioz dhe me programe konkrete të cilët kanë vazhduar në prodhimin e produkteve të njëjta me tendencë në pasurimin e produktit.

Këto ndërmarrje pas procesit të privatizimit vazhdojnë të jenë bartësit kryesorë ose shumë të rëndësishëm të zhvillimit si në punësim edhe përmes eksportit të produkteve në tregun e jashtëm.

Industria prodhuese/përpunuese, pas privatizimit - Përfundimi i procesit të privatizimit ka bërë që të eliminohen pengesat që ndërmarrjet shoqërore i kishin në qasjen në treg si në atë të plasimit të produkteve ashtu edhe në tregun financiar. Kështu këto ndërmarrje më ngadalë filluan të bëhen pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Rahovecit por edhe të vendit. Rahoveci vazhdon të ketë nivelin më të lartë të zhvillimit të industrisë së përpunimit të rrushit, kjo industri është dominuese ashtu siç është dominuese edhe vreshtaria, sipas draft Strategjisë së sektorit të vreshtarisë dhe verëtarisë në nivel vendi, janë këta prodhues:

Aktualisht në Republikën e Kosovës operojnë 23 kompani të licencuara nga MBPZHR që merren me përpunimin e rrushit dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera, nga ky numër 17 kompani operojnë në Komunën e Rahovecit, (SSVV, 2016, 30). Përpos që numri më i madh i kompanive të licencuar për përpunim të rrushit janë në territorin e Komunës së Rahovecit, por edhe bartësit kryesorë të prodhimit të verës dhe produkteve të tjera të rrushit janë në komunën e Rahovecit, kështu sipas një vlerësimi të MBPZHR, bartës të prodhimit dhe eksportit janë:

Bartës të prodhimit janë tre kompani:

“Stone Castle Vineyards & Winery” Sh.p.k – Rahovec

NTP “ Haxhijaha”– Rahovec

“Agrokosova – Holding” Sh.p.k. – Suharekë.

Njëkohësisht këto kompani janë edhe eksportuesit kryesorë të verës, por kjo nuk do të thotë se kompanitë e tjera nuk janë të rëndësishme si në prodhimin ashtu edhe në eksportin e verës dhe produkteve të tjera të rrushit. Në territorin e komunës së Rahovecit operojnë kompani/bodrume të kapaciteteve të ndryshme, si në ato të grumbullimit ashtu edhe në ato të përpunimit, kështu kapacitetet më të mëdha të grumbullimit të rrushit dhe të prodhimit të produkteve të rrushit i ka “Stone Castle” dhe Bodrumi i vjetër “Haxhijaha”, ndërsa të tjerët kanë kapacitete më të vogla.

Tabela 22: Ndërmarrjet/kompanitë për përpunimin e rrushit në komunën e Rahovecit

Nr.	Emri i Kompanisë/Ndërmarrjes	Vendi	Kapaciteti	Nr. Punëtorëve
1	“Stone Castle Vineyards&Winery”	Bërjak	43.5 mil/litra	250
2	NTP”Haxhijaha”- Bodrumi i Vjetër	Rahovec	5 mil/litra	34
3	NTP. “Muja”- Eko vena	Rahovec	100.000/litra	6
4	Shpk “ Rahoveci”- NBT	Rahovec	100.000/litra	6
5	Shpk. “Biopak” – Iliria	Rahovec	100.000/litra	20
6	NTP “ Agro-alf”- Shulina	Rahovec	100.000/litra	6
7	NTP “ Rahvera”	Rahovec		
8	NTP “ Daka”	Rahovec	50.000/litra	4
9	N.T.SH. “BAHHA”	Rahovec		
10	NTP “ Sefa”	Rahovec	60.000/litra	
11	“ Kosova Wine”. Sh.p.k	Rahovec		
12	N. P.T “ Altini”	Rahovec		
13	P.T.P “Hočanska Vina”	Hoçë e Madhe		
14	"Sunny Hills "Sh.p.k.	Rahovec		
15	“ Tradita” sh.p.k	Rahovec		
16	T.P.P. " Vinarija Manitašević”	Hoçë e Madhe		
17	NPT “ Astro Vera”	Rahovec		


Burimi, MBPZHR, 2016

Nisur nga informatat e prezantuara më lartë të cilat janë të vërtetuara edhe nga draft strategjia e sektorit të vreshtarisë dhe verëtarisë së MBPZHR, mund të konkludojmë se prodhimi i rrushit dhe produkteve të tij, verërat dhe pijet alkoolike, janë veprimtaria më e rëndësishme në ekonominë e Rahovecit dhe sektor me rëndësi edhe në nivel vendi. Për më tepër, ky sektor është i rëndësishëm edhe në fushën e tregtisë së jashtme respektivisht, produktet e rrushit, verërat dhe pijet e tjera, janë mallra që eksportohen në tregun rajonal, evropian dhe në SHBA.

Republika e Kosovës, nga viti 2007 deri në vitin 2014, ka realizuar eksport në 28 shtete. Eksporti më i madh është realizuar në këto shtete:

Serbi --- 13,289,071 litra
 Gjermani – 6,194,042 litra
 Kroaci --- 9,090,383 litra
 Maqedoni – 2,809.194 litra
 Slloveni – 2,881,026 litra, (SSVV, 2016, 32).

Figura 4: Paraqet eksportin e verës në tregun e jashtëm nga viti 2007-2014;



Burimi, MBPZHR, 2016, 32

Sipërfaqet me vreshta në komunën e Rahovecit, përbëjnë rreth 70% të sipërfaqes së përgjithshme në nivel vendi dhe, nga 23 kompani të licencuara për prodhimin e verës që operojnë në Kosovë, 17 janë nga Rahoveci, Nga kjo mund të konstatojmë se, prodhimtaria e rrushit dhe e verës është veprimtaria kryesore në ekonominë e komunës së Rahovecit. Për më tepër, rëndësia e kësaj industrie është edhe më madhe pasi që, këto prodhime janë pjesë e rëndësishme e eksportit në vende të ndryshme të regjionit, të BE – se dhe në tregun e SHBA-ve. Vendi si Kosova, me një deficit të lartë tregtarë, e bënë edhe më të rëndësishëm këtë sektor për zhvillimin ekonomik në tërësi.

Industria e përpunimit të grurit/prodhimit të miellit “M&SILLOSI”, është një fabrikë tjetër e rëndësishme, e cila zhvillon aktivitetin në territorin e komunës së Rahovecit, respektivisht në fshatin Xërxe. Kjo fabrikë është trashëgimtare e ish ndërmarrjes shoqërore “SILLOSI”, dhe e njëjta vazhdon me prodhimin e miellit, i cili plasohet kryesisht në tregun e brendshëm dhe në atë rajonal.

“M&Silloi” është njëra nga fabrikat më serioze të prodhimit të miellit në rajon. “M&Silloi” e udhëheq tregun kosovar me shërbime me shumicë dhe pakicë dhe me furra buke, me një linjë të plotë të miellit me cilësi të lartë. Përveç shitjeve të brendshme në Kosovë, si prodhues kryesor i miellit të grurit në rajon, kjo fabrikë eksporton edhe në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi. Tani, kjo korporatë, nën brendinë “M&Silloi”, punëson mbi 90 punëtorë që angazhohen për përmbushje të nevojave unike të konsumatorëve dhe fermerëve, <http://msilloi.com/rreth-nesh/>, (marrë me 30.12.2016).

“Osa-Termosistem”, me seli në Bërrjakë të Rahovecit, është një prodhues i këmbyesve termik, vitrinave, kolektorëve solar, ftohësve vertikal dhe horizontal. Kjo fabrikë prodhimet e veta i shet në tregun e brendshëm, atë rajonal dhe Evropian. Fabrika “Osa-Termosistem” është pasuese e ndërmarrjes shoqërore “Termosistemi”, e cila po vazhdon me sukses programin e prodhimit të ish fabrikës, me një zgjerim dhe pasurim të produktit. Sipas informatës së dhënë nga Pronari edhe menaxheri kryesor i fabrikës, prodhimet e kësaj ndërmarrje kanë depërtuar në tregun rajonal, Serbi, Slloveni dhe atë Evropian: Zvicër etj. Aktualisht në këtë fabrikë punojnë 56 punëtorë të profileve të ndryshme.

Ndërmarrja “Pista-Ekoplast”, është një fabrikë që zhvillon aktivitet të veçantë, që ka të bëjë me riciklimin e masave plastike, e cila është trashëgimtare e ish ndërmarrjes “Ekoplast”.

Ndërmarrja “Ekoplast” posedon hapësirë prej 6 hektarëve tokë, 2400 m² hapësira prodhuese, me një teknologji në gjendje të gatshme për riciklimin e masave plastike me kapacitet 10.000 tonë në vit. Kompania “Pista-Ekoplast” i ka të punësuar 25 punëtorë të profileve të ndryshme, duke përfshirë menaxhmentin, ekspertët në lëmin e termoplasteve dhe kuadrin tjetër profesional.

Po ashtu, vlen të ceket se programi i riciklimit i kompanisë është unik në Kosovë, dhe rrallë gjendet në Ballkan dhe më gjerë, <http://pista-ekoplast.com/rreth-nesh/>, (marrë me 30.12.2016).

Kompania “Fetoshi” me seli në fshatin Xërxe, është njëra ndër bizneset më të suksesshme në komunën e Rahovecit dhe më gjerë. Kjo kompani ka filluar me tregti në vitin 1990. Për t’u zgjeruar më vonë edhe me programe të tjera, siç është ai i prodhimit të styroporit. Në vitin 2002 kompania “Fetoshi” arriti të hap fabrikën më moderne për prodhim të Styroporit me teknologji të avancuar Gjermane. Të arriturat e kompanisë vazhduan edhe më tutje ku në vitin 2007. duke parë kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve për produkte

nga Styropori , bëri zgjerimin e prodhimtarisë duke investuar në fabrikën e re për prodhim të Styroporit të quajtur “EURO FAT” e cila posedon teknologji Gjermane, saktësisht “ErlenbachMachine” dhe ndodhet në objektin e (ish Ndërmarrjes “18 Nëntori” në fsh. Xërxe), <http://fetoshi.com/per-ne/>, (marrë me datë, 30.12.2016).

“Frigo-Star”, është një ndërmarrje e specializuar e cila prodhon pajisje për ftohje dhe klimatizim, selia është në Xërxe. Kjo fabrikë ka të punësuar 20 punëtor. Prodhimet e veta përveç se në tregun vendor i eksporton edhe në vendet e regjionit, Mali i Zi, Shqipëri etj. Kooperativa e grave fermere “Krusha e Madhe”, është një biznes i themeluar nga gratë të cilat kanë humbë burrat gjatë luftë. Kjo kooperativë zhvillon aktivitet që lidhet me prodhimet bujqësore që janë të njohura dhe traditë në kultivim nga Krusha e Madhe dhe fshatrat për rreth. Kooperativa “Krusha” bën përpunimin dhe konservimin e 12 llojeve të perimeve. Recetat janë prodhime shtëpiake tradicionale me përbërës natyral. Prodhimet cilësore përfitohen nga perimet vendore të prodhuara nga bujqit e vyeshëm të Krushës së Madhe dhe rrethinës. Kooperativa “KRUSHA” aplikon teknologji bashkëkohore, e dizajnuar për cilësi dhe siguri të ushqimit. Kooperativa arrin të përpunojë deri në 200 ton në vit, me tendencë të shtimit të prodhimtarisë vjetore, <http://rahovecpress.com/kooperativa-bujqesore-e-grave-krusha>, (marrë me datë, 04.01,2016).

Industria prodhuese/përpunuese, është një sektorë shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Rahovecit. Ashtu edhe siç shihet nga analiza e këtij sektori, zhvillimi i industrisë prodhuese është kryesisht i orientuar në shfrytëzimin e burimeve vendore dhe të traditës në prodhimin e kulturave bujqësore, nisur nga kjo dominuese është industria e cila lëndën e parë e ka me bazë bujqësore.

Njëkohësisht Industria prodhuese në Rahovec është bartës i eksportit të prodhimeve në tregun e jashtëm dhe shtylla kryesore e punësimit.

Tregtia dhe shërbimet

Tregtia me shumicë dhe pakicë - Është veprimtaria ekonomike me pjesëmarrje të rëndësishme në ekonominë lokale të komunës së Rahovecit. Sipas të dhënave të marra nga burimet e ndryshme si, komuna, ARBK, ASK dhe ATK-ja, del se numri më i madh i bizneseve aktive në komunën e Rahovecit, sipas veprimtarive ekonomike, janë ndërmarrjet që merren me tregti me shumicë dhe pakicë me pjesëmarrje prej 42,13% në

strukturën ekonomike të komunës. Në territorin e komunës së Rahovecit, përpos bizneseve vendore tregtare, operojnë edhe disa prej ndërmarrjeve të mëdha tregtare ose ndryshe quhen Qendra tregtare, siç janë, Qendra tregtare “ETC” dhe “Superviva” në Rahovec dhe “Superviva” në Xërxe. Në përgjithësi nëse e shikojmë nga prizmi madhësisë së ndërmarrjeve, ky sektor është i dominuar nga ndërmarrjet mikro, përpos ndërmarrjes tregtare “Xeni Comerc”, e cila disponon edhe qendër tregtare “QTX” në Xërxe dhe, mund të themi se, për nga numri i të punësuarve dhe qarkullimi është ndërmarrje e mesme.

Shërbimet si sektorë i ekonomisë lokale - kanë një pjesëmarrje të rëndësishëm në strukturën ekonomike si për nga numri i bizneseve ashtu edhe për nga numri i të punësuarve dhe kontributi në buxhetin komunal. Shërbimet dominuese, vazhdojnë të mbeten, shërbimet hoteliere, gastronomisë, bizneset që merren me punë ndërtimore, transportuese etj.

Regjistrimi i bizneseve bëhet në Agjencinë për regjistrim të bizneseve – ARBK, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë - MTI. Ky shërbim viteve të fundit është dekoncentruar duke u bartë në zyra të veçanta për regjistrim të bizneseve nëpër komuna. Këto zyra janë në menaxhim dhe mbikëqyrje direkte nga ARBK-ja dhe, të njëjtat, kanë komunikim edhe me institucionet e qeverisjes lokale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK, nga viti 2004, çdo tre muaj bënë publikimin e informatave lidhur me regjistrin e bizneseve. Informatat e publikuara nga ASK-ja për bizneset janë të dhëna të përpunuara dhe të njëjtat prezantojnë, gjendjen ekzistuese, numrin e bizneseve të reja, numrin e bizneseve të shuara etj. Të dhënat mbi regjistrin e bizneseve të prezantuara në publikimet e ASK-së përmbajnë: Shpjegimet mbi metodologjinë, përkufizimet, definicionet për terminologjinë dhe nocionet e përdorura. Në këto publikime bizneset janë të prezantuara sipas: Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE, kjo nomenklaturë është përkthim dhe përshtatje e Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të Komunitetit Evropian (NACE Rev.2.), sipas madhësisë së ndërmarrjeve, sipas statusit legal, sipas komunave, bizneset e reja të regjistruara dhe bizneset e shuara brenda periudhës etj.

Tabela 23: Bizneset aktive sipas veprimtarive ekonomike në komunën e Rahovecit

Nr.	Veprimtarit ekonomike	Numri i bizneseve aktive nëpër Vite					
		2010	2011	2012	2013	2014	2015
1.A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	45	51	73	101	117	142
2.B	Xehetari dhe gurëthyes	29	30	33	33	34	36
3.C	Prodhim	215	236	264	297	320	337
4.D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	1	1	1	1	1	1
5.E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	0	0	0	0	0	1
6.F	Ndërtimtari	91	102	125	151	165	170
7.G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	764	836	903	959	995	1030
8.H	Transport dhe ruajtje	116	127	134	139	145	149
9.I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	171	198	224	247	268	278
10.J	Informacion dhe komunikim	0	0	0	0	4	4
11.K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	4	4	5	5	6	7
12.L	Aktivitete të patundshmërisë	45	58	72	80	81	81
13.M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	0	0	0	0	4	12
14.N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	0	0	0	0	3	3
15.O	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	0	0	0	0	0	0
16.P	Arsim	6	6	6	6	6	9
17.Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	20	20	22	25	25	27
18.R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0	0	0	0	3	7
19.S	Aktivitete të shërbimeve tjera	83	98	122	133	143	151
	Totali	1590	1767	1984	2177	2320	2445

Burimi, ASK,2016

Tabela nr. 23, paraqet të dhënat mbi numrin e bizneseve për komunën e Rahovecit sipas ASK-së nëpër vite, duke filluar nga viti 2010 deri në vitin 2015. Bizneset janë të

paraqitura sipas llojit të veprimtarisë të grupuara sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike-NVE, e cila është në përputhje me nomenklaturën e komunitetit evropian NACE Rev.2. Nëse e shikojmë tabelën në kontekstin e trendit të zhvillimit të bizneseve nëpër vite, atëherë vërehet një rritje e numrit të bizneseve nga viti në vit, ndërsa nëse e shikojmë në kontestin e llojit të veprimtarive atëherë vërehet se veprimtaritë kryesore apo dominuese në vitin 2015 janë: tregtia me shumicë dhe pakicë dominon me 42,13% e pasuar nga prodhimi me 13,78%, akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim, me 11,37% ndërtimi me, 6,95%, transporti dhe ruajtje me 6,10% , bujqësi, pylltari dhe peshkatori me 5,81%, ndërsa veprimtaritë e tjera kanë një pjesëmarrje të ulët, me përjashtim të veprimtarisë aktivitete të shërbimeve të tjera, e cila ka një përqendrim prej 6,18%. Por në këtë grup janë të përfshira disa shërbime, të cilat nuk janë shumë të specifikuara, aq më tepër kur nga shtatori 2014 ka ndryshuar edhe nomenklatura e veprimtarive ekonomike dhe, në këtë grup janë përfshirë shumë biznese që ndoshta edhe mund ta kenë vendin në shërbimet e tjera. Ndërsa në vitin 2010 kjo strukturë dominuese ka këtë pjesëmarrje në numrin total të bizneseve: tregtia me shumicë dhe pakicë me 48,05%, prodhimi me 13,52%, akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 10,75%, ndërtimi me 5,82%, transporti dhe ruajtja me 7,30%, bujqësi, pylltari dhe peshkatori me 2,65% dhe aktivitete të shërbimeve të tjera me 5,22%.

Ndërkohë numri i bizneseve aktive dhe struktura e tyre sipas veprimtarive nga të dhënat që ofron ATK-ja dallon nga ajo që ofron ASK. Numri bizneseve aktive, sipas të dhënave të ATK-së, është dukshëm më i vogël se ai i ofruar nga ARBK-ja.

Tabela 24: Numri i bizneseve aktine në Komunën e Rahovecit, sipas sektorëve ekonomik

Nr.	AKTIVITETET – VEPRIMTARIT	2010	2011	2012	2013	2014	2015
0	Mungon aktiviteti	21	24	26	28	33	44
1	Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	28	28	33	49	64	88
2	Industria nxjerrëse	22	23	24	24	25	27
3	Industria përpunuese	131	143	162	188	213	234
4	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër	2	2	2	2	2	2
5	Furnizimi me ujë; Kanalizimi;	4	5	5	5	5	6
6	Ndërtimtaria	57	62	78	99	109	116
7	Tregtia me shumicë dhe pakicë	440	497	543	602	643	691
8	Transporti dhe magazinimi	25	28	31	41	46	51
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	59	74	87	107	124	139
10	Informimi dhe komunikimi	16	20	21	23	27	30
11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	4	6	6	6	7	7
12	Aktivitetet e patundshmërisë	1	1	1	1	1	1
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	31	36	39	43	49	56
14	Shërbimet administrative dhe mbështetëse	4	5	7	10	12	12
15	Administrimi publik dhe Sigurimi social	1	1	1	1	1	1
16	Arsimi	6	6	6	6	6	8
17	Aktivitetet e shëndetit të njeriut	16	16	17	19	19	21
18	Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	4	7	10	11	16	23
19	Aktivitetet e tjera shërbyese	53	58	63	69	80	89
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	-	-	-	-	-	-
21	Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare	-	1	1	1	1	1
TOTALI:		925	1,043	1,163	1,335	1,483	1,647

Burimi, ATK, 2017

Tabela nr. 24, paraqet numrin e bizneseve aktive sipas sektorëve ekonomik nëpër vite në Komunën e Rahovecit, sipas të dhënave me të cilat disponon ATK-ja. Trendi e bizneseve aktive është rritës nga viti në vit, ashtu siç ishte edhe sipas të dhënave që ofron ASK-ja por, dallimi respektivisht ndryshimi, ekziston sa i përket numrit të bizneseve. Kjo,

paraqitet për shkak se ATK-ja në bazën e të dhënave kryesisht i evidenton vetëm bizneset të cilat deklarojnë detyrimet tatimor.

Nëse e bëjmë një krahasim të pjesëmarrjes së sektorëve të veçantë në strukturën e bizneseve të komunës së Rahovecit sipas të dhënave të ASK-së dhe ATK-së, nga viti 2010 në 2015 atëherë mund të vërehet tendenca e rënies së përqindjes së pjesëmarrjes në totalin e bizneseve aktive e ndërmarrjeve tregtare për 5,92% sipas ASK dhe 5,62% sipas ATK, ndërmarrjet prodhuese apo industria përpunuese ka një trendë të njëjte tek të dhënat e dy agjencioneve me një rritje shumë të lehtë prej 0,26% sipas ASK kurse prej 0,05% sipas ATK, kurse ndërtimi ka një rritje në pjesëmarrje prej 1,23% sipas ASK kurse 0,88% sipas ATK, bujqësia, pylltaria dhe peshkataria kanë shënuar një rritje prej 3,16% ASK ose 2,98% sipas AKT-së. Është indikative edhe pse në pjesëmarrje të ulët rritja për ofro 100% e bizneseve, që ofrojnë aktivitete shërbyese financiare nga 4 në 2010 në 7 në 2015. Nëse dëshirojmë të bëjmë një krahasim në mes të dhënave të ASK-së dhe të dhënave të ATK-së, do të shohim një ndryshim sasior, nga informatat e dy institucioneve kredibile kombëtare:


Tabela 25: Krahasimi i numrit të bizneseve aktive sipas ASK-së dhe ATK-së

Burimi i të dhënave	Bizneset aktive në Komunën e Rahovecit nëpër vite					
Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të dhënat sipas ASK-së	1590	1767	1984	2177	2320	2445
Të dhënat sipas ATK-së	925	1043	1163	1335	1483	1647
Ndryshimi në total	665	724	821	842	837	798
Ndryshimi në përqindje	58.18	59.03	58.62	61.32	63.92	67.37

Burimi, ATK, 2017

Edhe përmes grafikut mund të vërehet ndryshimi i bizneseve aktive në komunën e Rahovecit nëpër vite.

Figura 5: Krahasimi i numrit të bizneseve aktive sipas ASK-së dhe ATK-së




Burimi, ATK, 2017

Si nga Tabela nr. 26, ashtu edhe nga grafiku nr. 5, vërehet se ndryshimi në numrin e bizneseve aktive sipas të dhënave të ASK-së dhe ATK-së është evident, kjo për shumë arsye. Njëra prej arsyeve kryesore është sepse, ATK-ja të dhënat i bazon nga deklaratimet që bizneset bëjnë për detyrimet tatimore dhe e dyta qëndron në atë se bizneset që shuajnë veprimtarinë, janë të detyruar ta njoftojnë ATK, kurse ARBK-në shpesh nuk e njoftojnë. Mirëpo, nëse e shikojmë me vëmendje vërehet se, me kalimin e viteve po rritet përqindja e bizneseve aktive që janë të evidentuara në ATK-ë, përderisa në vitin 2010 sipas ARBK-së 58,18% e bizneseve aktive ishin aktive edhe në ATK-ë kjo përqindje në vitin 2015 është rritur në 67,36%. Kjo shihet edhe nga grafiku ku prezantohen bizneset e reja dhe ato të shuara nga viti 2010-2015, vërehet tendenca e rritjes së numrit të bizneseve që pushojnë veprimtarinë gjë e cila, jep me kuptuar se ka filluar që edhe ARBK-ja të njoftohet kur një biznes e pushon veprimtarinë.

Një çështje tjetër me rëndësi është edhe trendi i regjistrimit të bizneseve të reja dhe shuarjes së bizneseve ekzistuese nëpër vite, të cilin mund ta shohim në grafikun-figurën në vijim. Ecuritë e këtij treguesi mundë të shfrytëzohen si një pasqyrë e ecurive ekonomike në komunën e Rahovecit përgjatë periudhës raportuese.

Figura 6: Bizneset e reja dhe të shuara përgjatë viteve 2010-2015 në Rahovec



Burimi ASK, 2016

Grafiku nr. 6, paraqet bizneset e reja të regjistruara dhe bizneset e shuara përgjatë periudhës 2010-2015, është evidente se numri më i madh i bizneseve të regjistruara është në vitin 2012, nga ku fillon edhe të rritet dhe numri bizneseve të shuara, Edhe pse nuk mundë të konkludohet me saktësi se ky trendë i shuarjes është i saktë për këto vite, sepse ato mund të kenë ndodhë në vitet e më hershme por të shlyhen viteve të fundit, prapë se prapë trendi bizneseve te reja në rënie dhe i atyre të shuara në rritje është një tregues që ambienti i të bërit biznes ka nevojë për përmirësim.

Nga analiza e bërë regjistrit të bizneseve aktive në komunën e Rahovecit, sipas të dhënave të ARBK-së dhe ATK-së vërehet qartë se sektorët dominues në ekonominë lokale janë, tregtia me shumicë dhe pakicë me 41,95%, prodhimi apo industria përpunuese me 14,21%, pastaj shërbimet për akomodim dhe ushqim me 8,14%. Ndërsa, një prezencë në rritje vërehet te sektori i bujqësisë e prodhimit me 5,34% dhe e ndërtimit me 7,04%. Gjithashtu, është indikative se shërbimet profesionale kanë një prezencë në vitet e fundit në veçanti sektori i aktiviteteve financiare, aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike si dhe aktivitet e tjera shërbyese, që është një tregues i mirë në përmirësimin e strukturës së ekonomisë lokale.

Struktura aktuale ekonomike dhe tendencat zhvillimore drejt ndryshimit të kësaj strukture në të ardhmen, mund të jenë treguesit më të mirë për orientimin e qeverisë lokale, në krijimin e kushteve për zhvillim dhe për mbështetje sektorëve që rrisin punësimin, të

ardhurat dhe ndikojnë zhvillim të qëndrueshëm, siç vlerësohet se janë: prodhimi, bujqësia dhe shërbimet profesionale.

Komuna-sektori publik dhe sektori privat

Zhvillimi i ekonomisë lokale është i ndikuar në masë të caktuar edhe nga mbështetja e sektorit publik respektivisht qeveria lokale ajo qendrore dhe agjencionet e ndryshme publike. Nisur edhe nga teoritë e ndryshme ky sektor luan një rolë shumë me rëndësi në krijim e mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, përmes përdorimit të instrumenteve të ndryshëm në mbështetje të bizneseve lokale. Ashtu siç e përcaktojnë qëllimin e ZHEL-it autorë dhe organizata të ndryshme edhe në studimin e bankës për zhvillim të Afrikës së jugore theksohet se : Qëllimi i ZHEL është për të ndërtuar kapacitetet ekonomike të një zone lokale për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë. Ai është një proces me të cilin partnerët e sektorit publik, të biznesit dhe jo-qeveritare punojnë së bashku për të krijuar kushte më të mira për rritjen ekonomike, gjenerimin e punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm si një e tërë, (Sibisi, 2009, 5).

Për arritjen e qëllimit të ZHEL-it qeveritë lokale dhe ato qendrore, pos të tjerash përdorin metodat dhe instrumentet të cilat në mënyrë më të mirë ju mundësoj në arritjen e qëllimit, duke mos dëmtuar veprimin e tregut të lirë. Autori K. Kollár, në studimin e tij ka bërë një përmbledhur të shkurtër të instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal, të specifikuar nga autorë të ndryshëm. Nga kjo përmbledhje vërehet një grupim i instrumenteve të cilët janë aplikuar në vende të ndryshme, me pretendime për të mbështet ZHEL-in; Në këtë punim kam bërë një përmbledhje të shkurtër të instrumenteve të zhvillimit ekonomik lokal në bazë të rishikimit literaturës. Sistemet rregullatore dhe organizative të vendeve janë mjaft të diferencuara, por në rastin e mjeteve të zhvillimit ekonomik të përdorura nga akterët lokal, situata nuk është e njëjtë, ato janë shumë të ngjashme, (Kollár, 2011, 24).

Mbështetja e sektorit privatë respektivisht zhvillimi i ekonomisë lokale, në komunë mundë të trajtohet përmes dy niveleve, mbështetja nga qeveria qendrore dhe nga qeveria lokale.

Qeveria qendrore zhvillimin ekonomik kryesisht e mbështet përmes politikave fiskale dhe zhvillimore, strategjive sektoriale etj. Përpos këtyre politikave viteve të fundit MBPZHR, ka përgatitur planin për bujqësisë dhe zhvillim rural, të cilët përfshijnë edhe masa për

mbështetje të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në vitin 2007 është aprovuar plani për bujqësi dhe zhvillim rural nga qeveria e Kosovës, i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar në vitet 2009 dhe 2013, duke përfshirë edhe masa shtesë, të cilat janë në përputhje me politikat e BE-së për bujqësi dhe zhvillim rural.

Ndryshim i rëndësishëm në versionin fillestar të PZHRB 2007-13 është edhe përfshirja e masave të përkrahjes së drejtpërdrejtë, e cila korrespondon fuqishëm me masat e Shtyllës së I të Politikave të Përbashkëta Bujqësore të BE-së (PPB). Përfshirja e kësaj pjese ishte e domosdoshme për ta përshtatur PZHRB-në 2007-13 në një kornizë gjithëpërfshirëse dhe të kompletuar të politikave, duke pasqyruar masat e zbatuara të përkrahjes nga Shtylla I dhe II e PPB-së, (MBPZHR, 2010, 3).

Mbështetja nga qeveria qendror, MBPZHR - Nisur nga rëndësia që sektori i bujqësisë ka në zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe me qëllim të përgatitjes së këtij sektori për t'u bërë konkurrentë në tregun e jashtëm rajonal dhe më gjerë, MBPZHR ka përgatitë dhe implementuar programin për pagesat direkte për kulturat e ndryshme bujqësore.

Objektiv i yni primar në angazhimet tona ditore është zhvillimi i bujqësisë, fuqizimi i fermerëve tanë dhe rritja e konkurrueshmërisë së produkteve tona bujqësore në rajon dhe më gjerë, (MBPZHR. 2015, 7).

Programi për bujqësi dhe zhvillim rural – programi i pagesave direkte i MBPZHR i vitit 2016 është i përgatitur në mënyrë mjaftë detaje duke përcaktuar: Përfituesit e mundshëm, kushtet për përfitim, çmimin për njësi, mënyrën e aplikimit, mënyrën e pagesës dhe shumën buxhetore për çdo sektorë dhe totalin e buxhetit i cili përfshin shumën prej 23,000,000.00 €, . Për drithëra, perime, pemë pagesa direkte bëhet për sipërfaqe, duke i përcaktuar kushtet, sipërfaqen minimale të nevojshme dhe çmimin, për përfituesit e sektorëve shtazëve dhe shpezëve, pagesa bëhet për kokë dhe numrin minimal të krerëve të nevojshëm kurse për bletë pagesa bëhet për kosherë etj, (MBPZHR, 2016,).

Sektori i bujqësisë vlerësohet dominues në ekonominë e Rahovecit, si i tillë është përfitues direkt i subvencionimeve që jepen nga MBPZHR, përmes programit të pagesave direkte. Bujqësia e Rahovecit është e njohur veçanërisht në sektorin e vreshtarisë dhe në atë të perimekulturës, për të cilat prodhime bujqësore është dominuese në tregun e brendshëm dhe në eksportet jashtë vendit.

Tabela 26: Mbështetja për kulturat bujqësore, në komunën e Rahovecit

Nr.	Spektori/kultura e mbështetur	Njësia/sipose Krerë	Kriteri minimal	Çmimi për njësi	Totali i sekt/produktit në njësi	Shuma e përfituar për sektor/në €
1	Drithëra/Gruri,	Ha	2,00 ha	150,00 €/ ha	2.400,34 ha	316,051.00 €
2	Drithëra/Misër	Ha	1,00 ha	159,00 €/ha	2.056,20 ha	308,430.00 €
3	Elb	Ha	1,00 ha	100,00 €/ha	4,11 ha	411.00 €
4	Perime/produkt	Ha	0,50 ha	300,00 €/ha	2.964,09 ha	889,227.00 €
5	Vreshta	Ha	0,10 ha	1,000,00 /€ha	2.273,16 ha	2,273,160.00 €
6	Lopë/qumësht	Krerë	5 krerë	70,00 €/kr.	2.560 kr	179,200.00 €
7	Dele	Krerë	30 krerë	15,00 €/kr	6.689 kr	100,335.00 €
8	Dhi	Krerë	20 krerë	15,00 €/kr	491 kr	7,365.00 €
9	Bletë	Kosherë	30 kosherë	15, 00 /kosh.	4.804 kosh	72,060.00 €
10	Pula/Vojse	Copë/Pulë	2000 copë	0,50 €/copë	49.900copë	24,950,00 €
11	Gjedhe dhi/Therje	Krerë	Thertore	30,00 €/kr		

Punim, Autori**

* Në programin për pagesat direkte të MBPZHR, në sektorin e perimeve janë të përfshira 25, kultura ndërsa në këtë tabelë janë të përfshira vetëm ato kultura/perime për të cilat janë siguruar të dhënat nga DBPZHR e komunës gjithsejtë 9 kultura, shih Tab. nr. 15.

** Tabela është punuar në bazë të dhënave nga Programi për pagesat direkte i vitit 2016 i MBPZHR, kolonat për kriteret/kushtet minimale dhe çmimi për njësi ndërsa kolonat, Spektori/kultura e mbështetur, totali i sektori/produktit në njësi janë marrë nga tabela nr. 15. Shuma e përfitimit sipas, sektorëve është një përlllogaritje e autorit e cila nuk është domosdoshmërisht e saktë.

Nga tabela nr. 26 e cila është punuar në bazë të informatave të marra nga MBPZHR dhe DBPZHR, shihen përfitimet që bujqit nga komuna e Rahovecit marrin nga subvencionet qeveritare të cilat kanë për qëllim fuqizimin e sektorit, rritjen e rendimentit dhe të cilësisë. Komuna/qeveria lokale dhe zhvillimi ekonomik lokal - Zhvillimi i sektorit privat/ekonomik është i afektuar nga veprimet e pushtetit lokal. Mbështetja e sektorit nga komuna bëhet përmes formave të ndryshme, duke filluar nga ofrimi i shërbimeve bazë për të cilat është përgjegjëse e drejtpërdrejtë deri tek mbështetja përmes krijimit të

lehtësirave për fillimi dhe zhvillimin e bizneseve për banorët lokal dhe për investorët e huaj. Përgjatë elaborimit të kësaj çështjeje në kapitujt dhe paragrafët e më sipërm kemi dhënë teoritë dhe praktikën e veprimit të pushtetit lokal në format e bashkëpunimit dhe të mbështetjes së sektorit privatë, në këtë pjesë do të shohim se si po zhvillohet ky bashkëveprim në komunën e Rahovecit.

Komuna e Rahovecit, përveç shërbimeve administrative, investimeve në infrastrukturën publike, organizimit të arsimit fillor dhe të mesëm, shërbimeve dhe punëve tjera që kryhen dhe ofrohen për banorët dhe bizneset lokale, ka bërë edhe disa veprime të cilat direkt afektojnë biznesin privatë. Format respektivisht instrumentet që komuna ka përdorur në mbështetje të zhvillimit të sektorit privatë kryesisht mund të grupohen në tri:

1. Organizimi i evenimenteve për promovim të prodhimeve vendore;
2. Ofrimi i hapësirave publike (mini parku ii biznesit/industrial-MPB) për zhvillim të biznesit; dhe
3. Subvencionim të bizneseve.

1. Organizimi i evenimentit “Festa e vjeljes së rrushit” - Organizimi i këtij manifestimi është iniciuar dhe udhëhequr nga komuna e Rahovecit. Ideja për organizimin e këtij evenimenti është dhënë nga lidhësi i atëhershëm i komunës në bashkëpunim me një pjesë të prodhuesve të rrushit dhe verës. Qëllimi i organizimit ka qenë promovimi dhe afirmimi i rrushit dhe prodhimeve të tij si: Prodhime cilësore, si pjesë e traditës dhe kulturës qindra dhe mijëra vjeçare, kontakti drejtpërdrejtë i vizitorëve nga brenda dhe jashtë vendit me prodhuesit dhe përpunuesit e rrushit etj.

Ky festival është organizuar nën patroanatin e Komunës dhe MBPZHR, në bashkëpunim me prodhuesit e rrushit dhe të verës, në veçanti me prodhuesit më të mëdhenj, gjatë ditës (tani 3 ditëve) së mbajtjes së evenimenti është bërë ekspozimi i të gjitha llojeve të rrushit, verërave, rakisë nga të gjithë prodhuesit. Vizitorët kanë pasur mundësi t’i shijojnë dhe të furnizohen me këto prodhime. Në vitet në vazhdim përpos ekspozimit të rrushit edhe prodhimeve të tij, ka filluar edhe ekspozimi i prodhimeve të tjera bujqësore, për të cilat është e njohur komuna e Rahovecit. Festivali me qëllim që të jetë sa më atraktivë për vizitorët është pasuruar edhe me ngjarje të tjera kulturore dhe artistike. Viteve të fundit është shtuar në masë të madhe rëndësia e këtij festivali, për këtë arsye tani organizimi zgjatë tri ditë dhe vizitohet nga njerëz dhe biznese të vendit dhe të jashtëm.

Festa e vjeljes së rrushit tani “Hardhfest” ka dy vjet që është bërë me format të ri dhe që po mbahet në Rahovec, duke arritur nivelin e organizimeve më të rëndësishme në Kosovë.

Me riformatizimin e festës së vjeljes së rrushit, duke u quajtur “HardhFest” dhe me sloganin “Për Kokërr t’ Qefit”, me rritjen e aktiviteteve, festivali arriti të fuqizohet dhe të ndërkombëtarizohet, kështu duke sjellë këtë vit mbi 32 mijë të pranishëm nga Kosova dhe vendet e ndryshme të botës, në festë dhe Rahovec. Ndërsa, ekipi i “HardhFest” tashmë ka nisur përgatitjet për edicionin “HardhFest 2017”, i cili do të jetë me përmasa edhe më të mëdha se sa ky edicion, gjithnjë me përkrahjen e partnerëve tanë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, <http://www.kosovapress.com/sq/>, (marrë me datë. 10.01.2017).

Në një informatë të lëshuar nga Drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm, festa e rrushit është organizuar për herë të parë në vitin 2003, organizator kanë qenë Komuna, NBI. “Rahoveci”, MBPZHR dhe Presidenca e Kosovës. Nga ky vit evenimenti është bërë tradicional dhe është organizuar çdo vit me datë 07, shtator, pjesëmarrja në këtë “Festë të rrushit” është rritura nga viti në vit për të arritur në 29500 në vitin 2016, (BBPZH, 2017). Mendoj se qëllimi për të cilin është iniciuar dhe është organizuar “Festa e vjelës së rrushit” është arritur, ngase: numri i vizitorëve përgjatë 3 ditëve, struktura e pjesëmarrësve nga vendi dhe jashtë, pjesëmarrja e prodhuesve vendor, vazhdimi i prodhimit të rrushit dhe verës me tendencë rritjeje janë tregues se qëllimi është arritur.. Vetëm një përlllogaritje e thjeshtë do të tregonte përfitimet e këtij evenimenti:

Nga 32 mijë vizitorë: nëse 10 mijë marrin nga një shishe verë ose një paketim me rrush, do të ishte kjo llogari vetëm për rastin:

Verë ose raki: $10.000 \times 3,00 = 30.000.00 \text{ €}$,

Rrush: $10.000 \times 3,50 = 35.000.00 \text{ €}$. Ose përfitimet për sektorët e tjerë, shërbimet hoteliere dhe gastronomisë etj. Numri prej 32 mijë vizitorëve është 50%, i banorëve të komunës së Rahovecit.

2. Ofrimi i pronës publike për zhvillim të biznesit (mini parku i biznesit/industrial) - Një formë e mbështetjes së zhvillimit të bizneseve në komunën e Rahovecit që është aplikuar përgjatë disa viteve është shfrytëzimi i hapësirave/objekteve publike për qëllime të zhvillimit të bizneseve dhe tërheqjes së investimeve. Komuna e Rahovecit pas luftës së fundit, ka trashëguar disa lokale, objekte dhe një hapësirë të veçantë të urbanizuar për zhvillim të aktiviteteve biznesore. Meqë këto hapësira menjëherë pas lufte ishin pa pronar faktik, komuna përmes mekanizmave lokal qeveritar së pari i ka marrë në menaxhim dhe pastaj ju ka ofruar bizneseve për shfrytëzim. Nga një informatë që është lëshuar nga

drejtoria komunale për ekonomik zhvillim dhe turizëm – DEZHT, ofrohen shënime për numrin llojin e bizneseve që i shfrytëzojnë këto hapësira. Me qëllim që të merren të dhëna më të sakta rreth punës, veprimtarisë numrit të punësuarve dhe çështjeve të tjera është bërë kontakti i drejtpërdrejtë me bizneset që shfrytëzojnë disa prej këtyre hapësirave. Përzgjedhja është bërë në baza të kriterëve të përcaktuara, nisur nga; kohë gjatësia e shfrytëzimit, madhësia e biznesit dhe kontributi në ekonomin lokale dhe buxhetin komunal.

Bizneset e vendosura në hapësirën ekonomike “Mini Parkun e Biznesit” në Xërxe-Rahovec;

Komuna e Rahovecit edhe pse në vitet e mëparshme ka ndarë një hapësirë për ta bërë zonën industriale, edhe sot e kësaj dite nuk ka arritur ta bëjë një gjë të tillë. Gjithashtu nuk ka të ndërtuar inkubator të biznesit i cili kishte me i ndihmuar bizneset fillestare. Është interesant të potencohet dhe analizohet shfrytëzimi i hapësirës së kompletuar ekonomike në fshatin Xërxe e cila fillimisht është marrë në menaxhim nga komuna dhe më pastaj ju është ofruar bizneseve për zhvillimin e aktiviteteve afariste. Sipërfaqja totale e “Mini Parkut të Biznesit” në Xërxe është 36452 m², nga e cila 8000 m² është sipërfaqe e mbuluar (ndërtuar për aktivitete afariste), 28452 m² janë sipërfaqe e hapur, komplet sipërfaqja është e urbanizuar dhe i ka të instaluar rrjetin e kompletuar të energjisë elektrike, ujin e pijes, kanalizimin dhe është e kyçur në rrugën regjionale dhe hekurudhën përmes së cilës lidhet me tregun e brendshëm dhe të jashtëm, (Komuna, 2002). Pos kësaj hapësire për qëllim të njëjtë janë dhënë në shfrytëzim edhe disa objekte të trashëguara nga komuna, me qëllim të zhvillimit të sektorit privat. Në vazhdim do të analizojmë aktivitetin e këtyre bizneseve, rolin e tyre në zhvillimin e komunës, në punësim dhe kontributin në buxhetin Komunal;

Tabela 27: Bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike në Komunën e Rahovecit;

N r	Emri i Firmës	Sipërfaqja në m ²	Tatimi në pronë në €	Taksa komunale në €	Qiraja në €	Nr. i punët.	Investimet kapital e në €	Invest. Në objekt, në €
1	“Metal Servis”	166	80,33	216,00	996.00	4	150.000,00	4,000.00
2	“Agro Celina”	2250	1,032.75	108,00	0.00	8 + 22	420,000.00	30,000.00
3	“Frigo Star”	1464	632,45	450,00	6,680.16	20	350,000.00	20,000.00
4	“Eurofood”	2358	1,082.33	450.00	13,031.28	20		42,518.00
5	“Moderne” Park Hotel Plaza	2508 m 2170 j	1,748.08	809.00	10,800.00	11+10	0.00	2,628,792.00
6	“Ura e Shenjt”	772	195,16	180,00	4,650.00	10+8		1,800,370.00
7	Mowenpick	6400	62,73	67,00	2,640.00	10	18,850.00	
8	“Xeni Commerce”		512,00		6,427,20	5		
	Totali:		5,345.83	2,280.00	45,224.64	68 + 40	938,850.00	4,525,680.00

Burimi. DZHET&Bizneset, 2016

Tabela nr.27, është punuar nga autori duke i përmbledhë të dhënat nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit si dhe informatat e grumbulluara nga shfrytëzuesit e hapësirave/objekteve publike përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Të dhënat lidhur me sipërfaqen në shfrytëzim, tatimin në pronë, taksen komunale dhe qiranë janë marrë nga data baza e DZHET, ndërsa të dhënat për numrin e punëtorëve, investimet në objekt dhe teknologji janë marrë nga kontakti i drejtpërdrejtë me pronarët/menaxherët e kompanive shfrytëzuese. Nisur nga koncepti i zhvillimit ekonomik lokal, nga ajo që studiuesit e ndryshëm kanë identifikuar në praktikat e shumë vendeve, qëllimet kryesore tek ZHEL janë: hapja e vendeve të reja të punës, tërheqja e investimeve, fuqizimi i bizneseve ekzistuese, rritja e të ardhurave buxhetore, mund të konstatojmë se disa prej qëllimeve janë përmbushur, punësimi dhe të ardhurat buxhetore.

3. Subvencionimi i bizneseve dhe fermerëve - Kjo formë e mbështetjes së sektorit privatë ka filluar të aplikohet nga komuna përgjatë viteve të fundit dhe është fokusuar në mbështetje të mikro bizneseve dhe fermerëve të vegjël.

Mbështetja e bizneseve përmes granteve, Ndarja granteve është e bërë nga Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe turizëm, kanë përfituar 27 biznese, vlera totale e grantit është 9,000.00 €, ndërsa shumat e përfituara nga bizneset janë, 300,00, 350,00 dhe 400.00 €, (DZHET, 2014,).

Ndarje e grandeve për këtë kategori të bizneseve është bërë nga Komisioni i formuar nga Kryetari Komunës. Komisioni është përbërë nga anëtarë profesionistë të administratës komunale, të cilët e kanë përpiluar listën e bizneseve përfituese të grandeve; Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë, 03.12.2014, ka bërë shqyrtimin dhe verifikimin e të gjithë aplikacioneve (për Ekonomitë familjare, bizneset të vogla dhe të mesme), që kanë aplikuar për mbështetje nga Drejtoria për Ekonomi, zhvillim dhe turizëm. Nga gjithsejtë tridhjetë e tre (33) aplikues, janë përzgjedhë njëzet e shtatë (27) përfitues në lëmi si: Ekonomi familjare, Biznese të vogla dhe të mesme, duke u bazuar në përmbushjen e kriterëve të parapara në thirrjen e datës: 29.10.2014, (Raporti, nr.4606, 2014).

Subvencionimi i fermerëve - Një mbështetje tjetër në formën e dhënies së grandeve nga komuna është bërë edhe për fermerët e vegjël. Komuna përmes DBPZHR-së, është e angazhuar në rritjen e prodhimeve bujqësore, në ngritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së këtij sektori në tregun vendorë dhe atë të jashtëm. Për ta arritur këtë qëllim kjo drejtori në planin e punës ka të përcaktuara objektivat dhe instrumente për arritjen e këtyre objektivëve. Drejtoria për BPZHR, për vitin 2017 ka paraparë, rritjen e kapaciteteve prodhues, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies, rritjes ekonomike dhe të punësimit e që do të realizohen përmes:

Shërbimeve këshillimore,

subvencionim të fermerëve,

implementimit të projekteve kapitale në bujqësi,

zbatimin e projekteve të donatoreve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetareve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore, (DBPZHR, Pl. i punës, 2017).

Siç shihet edhe nga plani i punës për vitin 2017, format e mbështetjes së sektorit të bujqësisë janë të formave të ndryshme, ndër to është edhe subvencionimi i fermerëve. Përgjatë viteve 2015 dhe 2016 nga kjo Drejtoria janë ndarë mjete buxhetore për bashkëfinancim të fermerëve në këto shuma:

Tabela 28: Fermerët përfitues të granteve/subvencioneve komunale për Sera

Nr.	Vitet	Nr. Fermerëve përfitues	Sipërfaqja e serës	Vlera e paguar nga Komuna
1	2014	37	37x150 = 5550 m ²	43,956.00 €
2	2015	35	35x150 = 5250 m ²	29,334.00 €
3	2016	93	93x150 = 13950 m ²	76,571.55 €
4	Totali	165	165x150 = 24750 m ²	149,861.55 €

Burimi, DBPZHR, 2017

Nga tabela nr. 28, vërehet se numri i fermerëve përfitues të granteve për ndërtimin e serave për kultivimin e perimeve është rritur nga 37 në vitin 2014, në 93 fermerë në vitin 2016. Kushti apo kriteri për përfitimin e grantit ka qenë që sera të ketë një sipërfaqe prej 150 m² apo 1,5 ari, si dhe financimi është bërë me bashkë financim në mes të komunës dhe fermerit. Komuna e Rahovecit në vitin 2016 dhe 2017 subvencionimin e Fermerëve e bënë përmes projektit ndërtimi i serave me bashkëfinancim, ku 75% të shpenzimeve i mbulon Komuna gjersa 25% Fermeri përfitues i serës. (DBPZHR, 2017).

Vlerësim i efektit të mbështetjes në zhvillim dhe punësim - Efekti i këtij bashkëpunimi në zhvillimin socio-ekonomik do të vlerësohet duke u bazuar në konceptin e ZHEL-it, i cili është, stimulimi i aktiviteteve ekonomike, hapja e vendeve të reja të punës dhe ngritja mërqinje sociale.

Ky bashkëveprim në mes të komunës dhe sektorit privat duhet të shikohet dhe vlerësohet në bazë të efekteve/rezultateve të arritura. Meqë nuk ka një raport të vlerësimit nga MBPZHR dhe Komuna si dy mbështetësit kryesor, unë do të provoj ta bëj një vlerësim nga të dhënat që janë në dispozicion:

Stimulimi: Përmes subvencioneve dhe granteve;

Subvencionimi është aplikuar kryesisht në sektorin e bujqësisë përmes pagesave të drejtpërdrejta dhe granteve konkurruese efekti:

MBPZHR ka ndarë për vreshtarë nga 1,000.00 € për hektar, pastaj nga 150.00 €, për mbjelljen e drithërave, për perime 300.00 € për hektarë.

Vreshtaria: 1850 ha x 1,000.00 = 1,850,000.00 €, vlera e përfituar nga fermerët.

Sipërfaqet e reja, 67,11 ha x 1,000.00 = 67.110.00 €, ka shtuar vlerën e sektorit të vreshtarisë.

Prodhimi i drithërave: $3500 \text{ ha} \times 150.00 \text{ €} = 525,000.00 \text{ €}$, vlera e përfituar nga fermerët.

Përfitues indirekt 17 bodrumet për prodhimin e verës dhe pijeve alkoolike.

Stimulimi përmes grandeve për fermer nga Komuna:

Komuna ka ndarë grande kryesisht në mbështetje të fermerëve të vegjël në ngritjen e mini fermave dhe mikro bizneseve;

Fermerët e vegjël: Në vitin 2014; 37 fermer kanë përfituar 43,956.00 €;

Në vitin 2016; 93 fermer kanë përfituar 76,571.55 €, nga Komuna dhe participimi nga fermerët ka qenë, 25,523.85 € ose në tërësi vlera e shtuar është 102,095.40 €.

Festivali i rrushit “Hardhfest”: Ky eveniment ka organizim tradicional;

Vizitorë në vitin 2016, 32000 veta ose rreth 50% e numrit të banorëve rezident të Rahovecit..

Përfitues të drejtpërdrejtë, prodhuesit e rrushit, bodrumet, ndwrsa indirekt kanë përfituar bizneset e tjera të komunës..

Ofrimi e hapësirave të urbanizuara/objekteve publike për zhvillim të biznesit:

Bizneset shfrytëzuese; Shtatë biznese/ndërmarrje; 3 prodhuese, 3 hoteliere dhe 1 grumbulluese e prodhimeve bujqësore, efektet e arritura:

Vendet e punës, 63 me kohë të plotë dhe 40 me angazhim sezonal;

Të hyrat nga taksat dhe tatimet komunale, në vlera prej, 45,911.27 €;

Vlera e shtuar e aseteve publike/komunale (Investimet në objektet publike); 4,525,680.00 €;

Përfitues indirekt, qindra bujq, të cilët përmes dy organizatave “Agro Celina” dhe “Eurofood”, bëjnë shitjen e prodhimeve bujqësore.

Nëse vlerësimi bazohet në qëllimet procesit të zhvillimit ekonomik lokal, ashtu siç e potencojnë autorët dhe studiuesit e kësaj fushe, ndër ata edhe studiuesi i njohur i fushës Bartik: Sipas këtij autori qëllimet bazë të cilat duhet të përmbushën nga mbështetja e programeve të zhvillimit ekonomik lokal janë: Përfitimet fiskale, përfitimet e punësimit, pastaj përfitimet indirekte që mund të përfitojë komuniteti në infrastrukturë dhe në fushën sociale (Bartik, 2003, 8, 10).

Nga kjo analizë mund të konkludojmë se subvencionimi dhe mbështetja e bizneseve në komunën e Rahovecit, ka sjellë përmbushje të qëllimeve bazë të ZHEL-it, d.m.th.: ka hapë vende të reja pune, ka shtuar të hyrat nga taksat dhe tatimet lokale, ka rritë vlerën e shtuar të aseteve komunale siç është Ndërmarrja “Frigostar” që bënë eksportin e

prodhimeve të veta dhe “Agro Celina” dhe “Eurofood” që grumbullojnë, ambalazhojnë dhe konservojnë perime për tregun e jashtëm dhe vendor, andaj edhe kanë rritë eksportin e disa produkteve.

Për më tepër prodhuesit e verës nga Rahoveci janë 72% e prodhimit të verës, ndërsa ashtu siç e pamë nga të dhënat e MBPZHR, mesatarisht 5 – 12 milion litra eksportohen në tregun e jashtëm, atëherë edhe subvencionimi i këtij sektori e rritë eksportin e prodhimeve në tregun Evropian dhe më gjerë.

Spektori civilë

Spektori civilë/shoqëria civile në komunën e Rahovecit është e organizuar dhe funksionon përmes shoqatave dhe organizatave joqeveritare. Nëse e bëjmë një ndarje të shoqërisë civile sipas interesave që ato përfaqësojnë, atëherë mundë të bëjmë një grupim të organizimit të shoqërisë civile në këto grupe:

Organizatat/shoqatat që përfaqësojnë interesat e biznesit.

Organizatat/shoqata që përfaqësojnë grupet e ndryshme shoqërore dhe

Organizatat/shoqatat që përfaqësojnë jetën kulturore-artistike dhe sportive.

Shoqatat që përfaqësojnë interesat e bizneseve në Rahovec; Interesat e bizneseve të sektorëve të ndryshëm përfaqësohen nga shoqata të ndryshme të cilat janë të organizuara në nivelin nacional dhe atë lokal.

Në nivelin nacional shoqatat që kanë shtrirje në tërë territorin e Kosovës janë: Oda ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit, të cilat aktivitetin e zhvillojnë në nivel vendi dhe përmes degëve nëpër shtatë qendrat rajonale, ndërsa nëpër komuna nuk kanë organizim.

Në nivelin lokal interesat e bizneseve përfaqësohen nga këto shoqata;

Shoqata e bizneseve të vogla – SHBV. “Zejtare Tregtare”; është e themeluar në vitin 1998, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të interesave të sektorit të zejtarëve dhe tregtarëve të vegjël para institucioneve lokale. Shoqata ka 480 anëtarë të regjistruar, udhëhiqet nga Kryetari dhe kryesia e cila përbëhet prej 11 anëtarëve (Intervistë, 2016) . *Shoqata e vreshtarëve të Rahovecit,* është e formuar në vitin 2010 me qëllim të mbrojtjes, promovimit dhe fuqizimit të sektorit të vreshtarisë para institucioneve lokale dhe qendrore. Kjo shoqatë grumbullon rreth vetës numrin më të madh të prodhuesve të rrushit të cilët janë të koncentruar kryesisht në qytetin e Rahovecit dhe në fshatrat për rreth.

Nënkryetari i Shoqatës z. Hysen Canziba, deklaroi se Shoqata e vreshtarëve është formuar në vitin 2010, pas lajmeve se bodrumet e Rahovecit nuk do të pranojnë rrushin, gjegjësisht djersën e fermerëve, ku pastaj me aktivitete është treguar uniteti i vreshtarëve për mbrojtjen e drejtave të tyre, <http://www.fermaime.com> (marrë me datë, 09.04.2017). *Shoqata e verëtarëve të Rahovecit-SHVK – SHVK*. “ENOLOGJIA” është shoqata e formatit kombëtar, me seli në rajonin vreshtar-verëtar të Rahovecit, e themeluar në tetor të vitit 2008, me iniciativën e disa prodhuesve entuziast të mëdhenj. Shoqata ka rol shumë të madh si avokate e tyre, bënë avokim dhe lobim, mbrojtjen e interesave të tyre karshi institucioneve lokale dhe qendrore, ndihmon në zhvillimet e tregut të brendshëm dhe të jashtëm, në respektimin e ligjit të verërave dhe dispozitave të ligjit, në luftimin e informalitetit prodhimit dhe shitjes të paautorizuar të verërave dhe rakisë, <http://enologjia.com/per-ne/> (marrë me datë.09.04. 2017).

Organizatata/shoqata që përfaqësojnë grupet e ndryshme shoqërore - këto organizata/shoqata përfaqësojnë grupe të ndryshme shoqërore siç janë: gruaja, rinia, personat me aftësi të kufizuar kategoritë e dala nga lufta etj.

Shoqata “Handikos” - është organizatë me nivel qendror, zyra e kësaj organizate vepron edhe në Rahovec. Objektivi kryesor e kësaj Shoqate ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar në Kosovë” përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit, <http://www.handi-kos.org>. (marrë me 09.04.2017).

Kryqi i kuq i Kosovës - është një organizatë me organizim në nivel vendi, dhe njëkohësisht dega e kësaj operon edhe në Komunën e Rahovecit. Qëllimi kryesor i KKK është që të sigurojë shërbime kualitative humanitare për popullatën e rrezikuar përmes mobilizimit dhe organizimit të burimeve njerëzore dhe materiale, <http://redcross-ks.org/neë/programet> (marrë me 09.04.2017).

Shoqatat që përfaqësojnë kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së - janë të organizuara në nivel vendi, njëherit nëpër të gjitha komunat veprojnë degët e tyre.

Organizata e veteranëve të luftës – OVL të UÇK-së - kjo organizatë është trashëgimtare e vlerave të luftës, njëherit mbron dhe promovon këto vlera.

Shoqata e familjeve të dëshmorëve- SHFD - kjo shoqatë përfaqëson interesat e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të rënë përgjatë luftës çlirimtarë.

Shoqata e invalidëve të luftës- SHIL të UÇK-së - kjo shoqatë përkujdeset dhe mbron interesat e të gjithë invalidëve të luftës së fundit kundër okupatorit.

Shoqata e pavarur e gruas “Hareja” - është një OJQ me seli në Rahovec e cila merret kryesisht me përkujdesjen për gratë e dhunuara, të marginalizuara, përmes të organizimit të kurseve në fusha të ndryshme si rrobaqepësi, frizere etj.

Qendra rinore SHL-Kosova në Rahovec - është organizatë jo profitabile e cila grumbullon të rinjtë nga mosha 15 deri në 25 vjeçare të gjitha komuniteteve. Kjo qendër organizon trajnime në fusha të ndryshme për të rinjë, organizon manifestime në promovimin dhe avancimin e të rinjve.

Këshilli i veprimit rinor lokal - KVRL i Rahovecit - është i themeluar në vitin 2014 dhe grumbullon rreth vetes organizatat rinore që veprojnë në komunën e Rahovecit me qëllim të fuqizimit të rolit të rinisë në procesin e vendimmarrjes të institucioneve lokale. Të fuqizoj organizatat rinore të komunës ku ato veprojnë për të ndërtuar një vizion të përbashkët për të rinjtë, (MKRS, 2010,14).

Në kudër të komunës veprojnë edhe disa shoqata-OJQ-ë, të cilat përfaqësojnë interesat e grupeve të ndryshme shoqërore siç janë: OJQ. “Buzë Drini” në fshatin Ratkofcë, e cila merret me aktivitete rinor, “Art Studio” në Rahovec që merret me aktivitete të artit figurativ, OJQ. “Arbëria” në fshatin Radostë, që merret me ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe Shoqata e enigmatëve “Labirinthi” në Rahovec, që merret me përpilim të fjalëkryqeve, (DKRS, 2016, 2).

Organizatat/shoqatat që përfaqësojnë jetën kulturore-artistike dhe sportive - Në këtë grupim të shoqatave përfshihen të gjitha shoqëritë që merren me aktivitete kulturore artistike dhe klubet e ndryshme që merren me aktivitete të ndryshme sportive.

Shoqëritë kulturore artistike – SHKA - jeta kulturore dhe artistike në komunën e Rahovecit, zhvillohet përmes shoqërive të ndryshme kulturore dhe artistike të cilat veprojnë me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e Drejtorisë për kulturë rini dhe sport. Në komunën e Rahovecit janë aktive dhe funksionale këto shoqëri kulturore artistike.

SHKA. “Rahoveci” në Rahovec, SHKA. “Bajram Curri” në Krushë të Madhe, SHKA. “Anadrinia” në Dejën, kjo shoqëri së bashku me komunën janë organizatore të festivalit “Anandrinia jehon” i cili organizohet çdo vit nga data 12-14 maj, SHKA. “Ganimete Tërbeshi” në Xërxe dhe Grupi muzikor “Magnituda” në Rahovec, (DKRS, 2016, 2).

Klubet që merren me aktivitete të ndryshme sportive - aktivitetet e ndryshme sportive zhvillohen përmes klubeve të cilët organizojnë njerëzit me afinitete për zhvillim të sporteve të veçanta.

Klubet futbolistike: “Rahoveci” në Rahovec, “18 Korriku” Bellacërkë-Fortesë, “Xërxa” në Xërxe, “Ratkovci” në Ratkovc. Shkollat e futbollit: “Rahoveci” në Rahovec, “Burimi” në Apterushë, “Dardanët” Hoçë e Vogël dhe “Drenoci” në Drenovc. Klubet të sporteve të tjera; Klubi i Basketbollit “Rahoveci” në Rahovec, Klubi i Shahut “Rahoveci” në Rahovec, Klubi i Peshkimit “Amur” në Rahovec, Klubi auto moto”Rahoveci” në Rahovec, (DKRS, 2016, 2).

Nga informata e DKRS-së, shihet se sektori civil në Rahovec është i organizuar në një numër të madh të shoqatave, përmes të cilëve organizojnë aktivitete të ndryshme, kulturore, sportive dhe artistike, vlen të theksohet se në disa prej fushave këto shoqata kanë arritur rezultate të mira si në rangë vendi ashtu edhe jashtë, p.sh. Klubi i shahistëve ka marrë pjesë edhe në garat me karakter ndërkombëtarë. Klubet e futbollit dhe basketbollit nga Rahoveci bëjnë gara me plotë sukses në super ligat e Kosovës.

KAPITULLI VI

3. Hulumtimi dhe analiza

Ky hulumtim ka për qëllim të shqyrtoj, kapacitetet ligjore, organizative, profesionale dhe shkallën e bashkëveprimit të partnerëve kyqë lokal (komunës, sektorit privat dhe sektorit civil) në arritjen e qëllimit të zhvillimit ekonomik lokal. Përmes këtij hulumtimi do të vlerësohet gjendja aktuale dhe mundësit e veprimit në të ardhmen të këtyre sektorëve bazuar në konceptin bazë të zhvillimit ekonomik lokal-ZHEL. Për të ardhur deri tek informatat e nevojshme lidhur me hipotezat të përcaktuara nga qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore është aplikuar metoda intervistës: Një intervistë është një diskutim i qëllimshëm në mes të dy ose më shumë personave (Kahn dhe Cannell 1957). Përdorimi i intervistave mund të ju ndihmojë për të mbledhur të dhëna të vlefshme dhe të besueshme që janë relevante për pyetjet tuaj të kërkimit dhe objektivat, (Saunders, Lewis & Thornhill, 2009,318). Gjatë procesit të hulumtimit janë aplikuar rregullat dhe parimet që përdorën gjatë grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave cilësore. Modeli i intervistave për grumbullimin e të dhënave janë marrë “Intervistat e strukturuar”, model i aplikuar nga autori, Josip Bošnjak, (Bošnjak, 2012, 90). Gjatë procesit të përgatitjes së formave të intervistës janë bërë modifikimet të cilat kanë qenë të nevojshme për të ju përshtatur natyrës së objektit të studimit.

Procesi i analizës, vlerësimit dhe grupimit i të dhënave të mbledhura gjatë intervistimit të respondentëve, pastaj vetë vlerësimi i pyetjeve është bërë duke u bazuar në parimet, e qartësisë, konfindencilitetit etj. Përshkrimi, kategorizimi dhe rregullimi i përgjigjeve të marra nga respondentët është bërë në bazë të autorëve,(Saunders, Lewis & Thornhill, 2009, kap.13).

Populacioni për intervistim ka përfshirë tre partnerët kyqë të përfshirë në procesin e zhvillimit ekonomik lokal. Përzgjedhja e kampionit për intervistim është bërë sipas metodës “përzgjedhje e qëllimshme”. në përputhje me rolin dhe rendësin që respondentet kanë përbrenda secilit partnerë (grup të interesit), në procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

3.1. Sektorit publik-Komuna e Rahovecit, si njësi bazë e qeverisjes lokale

3.1.1. Përshkrimi i hulumtimit

Për të marrë mendimin dhe qëndrimin e sektorit publik lidhur me kapacitetin institucional, profesional, kornizën ligjore, bashkëpunimin me sektorin privatë sektorin civil dhe komunitetin në territorin e komunës së Rahovecit është shfrytëzuar metoda e intervistës së strukturuar. Në intervistim janë përfshirë zyrtarët përgjegjës të qeverisë komunale në Rahovec.

Përzgjedhje i personave përgjegjës për përfshirje në intervistim është bërë në bazë të përgjegjësi që zyrtarët e caktuar kanë në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, bazuar në ligjet pozitive për vetëqeverisjen lokale dhe organogramin e komunës, kështu në intervistim janë përfshirë: Kryetari/Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive: DZHET, DFB, dhe DBPZHR.

Intervista e strukturuar ishte formuluar kryesisht me pyetje të hapura. Përmes intervistës ne jemi përparëkur të marrim përgjigjen nga zyrtarët komunal, nëse ata kanë hapësirë, njohuri dhe kapacitete të mjaftueshme për tu marrë me zhvillimin ekonomik lokal, përmes bashkëpunimit me sektorin privat dhe sektorin civil.

Hulumtimi është kryer në ambientet e komunës, duke e përdorur metodën e intervistimit individual me secilin respondent veç e veç, intervistimi ka zgjatë 3 ditë, për shkak të pamundësisë që zyrtarët komunal të jenë në të njëjtën ditë të lirë për intervistim. Intervista ka qenë të tipit të hapur ashtu siç është potencuar edhe më lartë, zyrtarët në fillim janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit, me përmbajtjen e intervistë dhe pastaj kanë dhënë përgjigjet dhe opinionin e tyre të pavaruar. Intervista është e përbërë nga katër pjesë, pjesa e parë përfshinë kornizën ligjore, pjesa e dytë, kapacitetet organizative dhe profesionale, pjesa e tretë bashkëpunimin me, qeverinë, qendrore agjencionet e ndryshme zhvillimore, sektorin privatë dhe sektorin civil dhe pjesa e katërt përfshinë, mekanizmat/politikat e aplikuara në mbështetje të ZHEL-it.

3.1.2. Analiza e hulumtimit

Zyrtarët e komunës së Rahovecit, përmes intervistimit kanë dhënë vlerësimin e tyre për fushat e përfshira në intervistim, kështu:

Në pjesën e kornizës ligjore - të gjithë të intervistuarit mendojnë se, korniza aktuale ligjore relativisht i përcakton qartë dhe mjaftueshëm përgjegjësitë e komunës, në fushat

e caktuara të qeverisjes lokale. Zyrtarët e intervistuar kanë bërë vërejtje tek një pjesë e legjislacionit, i cili nuk ju mundëson sa duhet të merren me zhvillimin ekonomik, me planifikimin e buxhetit dhe me menaxhimin e pronës publike komunale. Vërejtjet janë bërë konkretisht në Ligjin mbi dhënien me koncesion/në shfrytëzim të pronës komunale, ligjin mbi menaxhimin e pyjeve. Gjithashtu edhe sa i përket legjislacionit sekondarë, zyrtarët e intervistuar mendojnë se, ende nuk është i kompletuar nga ana e komunës së Rahovecit, shprehimisht theksohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve etj.

Kapacitetet organizative/institucionale dhe profesionale - Zyrtarët e përfshirë në hulumtim kanë dhënë këtë opinion: se struktura aktuale organizative e komunës nuk është në përputhje me nevojat që ka zhvillimi ekonomik, ka nevojë të bëhet një ristrukturimi, bashkëpunimi i brendshëm është relativisht i mirë por duhet të forcohet, në veçanti rreth implementimit të projekteve, kapacitetet profesionale nuk janë të mjaftueshme dhe kanë nevojë për ngritje dhe fuqizim. Komuna ka PZHK, një PZHU në draftim dhe SZHL, nuk ka strategji sektoriale zhvillimore, Është vlerësim i shprehur nga të gjithë, që komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme, financiare dhe profesionale për implementim të dokumenteve strategjike zhvillimore.

Pjesa e bashkëpunimit me sektori publik, privat dhe civil - Sa i përket bashkëpunimit me sektorin publik në nivel (regjioni, komunat fqinje dhe ministritë), zyrtarët e intervistuar, mendojnë se bashkëpunimi me qeverinë qendrore bëhet kryesisht me ministritë e linjës, ky bashkëpunim është i mirë në hartimin e planeve strategjike por jo sa duhet në implementimin e tyre. Bashkëpunim me komunat fqinje sipas tyre deri me tani kanë pasur me komunën e Prizrenit në fushën e turizmit, ndërsa një projekt i përbashkët me komunën e Suharekës për një zonë të përbashkët argo-industriale ka dështuar për shkak të pronës e cila menaxhohet nga APK. Komuna ka pasur një bashkëpunim në nivel regjioni me AZHR-Jugore, në përgatitjen e aplikacioneve për thithjen e fondeve nga sektori privat.

Bashkëpunimi me sektorin privat - sipas zyrtarëve të anketuar është kryesisht në raste individuale, dhe mbështetja e këtij sektori është bërë përmes disa subvencioneve për bujqësi dhe për artizanate. Problemet kryesore që kanë bizneset janë : energjia elektrike, tarifat e larta, mungesa e hapësirave publike për shfrytëzim, interesat e larta për kredi marrje, shitja e produkteve etj. Komuna nuk ka një formë të organizuar të bashkëpunimit me sektorin privat.

Bashkëpunimi me sektorin civil dhe komunitetin - Opinioni i zyrtarëve komunal është se shoqëria civile nuk është mjaftueshëm e organizuar dhe aktive në jetën publike. Bashkëpunimi me këtë sektor bëhet kryesisht në raste të veçanta dhe financimi bëhet përmes projekteve ku ata konkurrojnë. Drejtori i zhvillimit ekonomik potencon se qendra rinore ka organizuar ligjërata rreth zhvillimit ekonomik. Ndër problemet që ka ky sektor, sipas zyrtarëve komunal janë: mungesa e hapësirave për zhvillim të aktivitetit dhe mungesa e fondeve.

Në pjesën mekanizmat/politikat e aplikuara në mbështetje të sektorit privat - Zyrtarët e intervistuar janë shprehur se komuna e Rahovecit nuk ka zonë të ndërtuar për zhvillim të biznesit, zonë/industriale (përpos mini parkut në Xërxe të trashëguar nga ish sistemi), nuk ka akoma inkubatorë të biznesit, por sipas drejtorit për zhvillim ekonomik tani është një tentativë, komuna nuk ka asnjë rast të partneritetit publiko-privat. Komuna deri më tani ka ndërmarrë zbritjen 50% të taksës komunale dhe ka dhënë subvencione në fushën e bujqësisë dhe mikro bizneseve, si formë e mbështetjes.

3.2. Sektori privat

3.2.1. Përshkrimi i hulumtimit

Për të marrë mendimin dhe vlerësimin e sektorit privat lidhur me, bashkëpunimin me sektorin publikë, sektorin civil, komunitetin në territorin e komunës së Rahovecit dhe problemet me të cilat përballen është shfrytëzuar metoda e intervistës së strukturuar. Në intervistim janë përfshirë gjashtë biznese të sektorëve të ndryshëm që operojnë në territorin e komunës së Rahovecit.

Përzgjedhje e bizneseve për përfshirje në intervistim është bërë duke u bazuar kryesisht në: llojin e veprimtarisë, madhësinë e biznesit dhe kontributin në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, siç janë, punësimi, të ardhurat etj. Kështu janë intervistuar 6 biznese, prej tyre dy biznese që merren me prodhim dhe tregti të cilat mund të trajtohen si biznese të mëdha, pastaj një biznes që merret me prodhim për tregun e brendshëm dhe të jashtëm, një biznes që merret me tregtimin e mekanizmit bujqësor, një prodhuese dhe një përpunuese drurit si dhe, një kooperativë bujqësore që punëson kryesisht femra dhe merret me përpunimin e perimekulturës etj.

Intervista e strukturuar ishte formuluar kryesisht me pyetje të hapura. Përmes intervistës ne jemi përpjekur të marrim përgjigjen nga menaxheret/pronarët, lidhur me

bashkëpunimin dhe mbështetjen që marrin nga sektori publik me theks të veçantë nga komuna, llojin e bashkëpunimit, pengesat, nevojat që ata kanë, pastaj bashkëpunimi me sektorin civil, format dhe mundësitë për një punë të përbashkët në projekte të ndryshme. Intervistimi është kryer në ambientet/zyrat e bizneseve, duke e përdorur metodën e intervistimit individual me secilin respondent veç e veç/ballë për ballë. Intervistimi ka zgjatë 3 ditë, për shkak të pamundësisë që respondentët të ishin të lirë për intervistim në të njëjtën ditë. Respondentët në fillim janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit, me përmbajtjen e intervistës dhe pastaj kanë dhënë përgjigjet dhe opinionin e tyre të pavarur. Intervista është e përbërë nga katër pjesë, pjesa e parë përfshinë pyetjet rreth biznesit/kompanisë së intervistuar, pjesa e dytë, bashkëpunimin me sektorin publik, qeverinë lokale dhe agjencionet e tjera publike, pjesa e tretë bashkëpunimin me sektorin civil dhe pjesa e katërt përfshinë, bashkëpunimin me sektorin privat në nivel të komunës.

3.2.2. Analiza e hulumtimit

Të gjitha bizneset/ndërmarrjet e intervistuar operojnë në territorin e komunës së Rahovecit. Veprimtarinë biznese kryesisht e kanë të filluar pas viteve të 90-ta, në kohën kur ka filluar liberalizimi i tregut dhe kur është lejuar themelimi dhe operimi i bizneseve me kapital privatë. Është me interes të potencohet se këto biznese janë shkatërruar tërësisht në luftën e fundit të viteve 1998/99 dhe mund të themi se, fillimi me punë i këtyre bizneseve është nga pas lufta ose më mirë të themi nga viti 2000. Bizneset e përfshira në hulumtim aktivitetin e tyre e kanë zgjeruar, duke e pasuruar me programe të ndryshme kryesisht me prodhime. Po thuaj të gjitha bizneset e hulumtuara kanë një aktivitet ekonomik stabil, me një trend pozitiv, kuptohet kanë edhe sfida dhe probleme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Pjesa e parë informatat rreth biznesit - Bizneset e përfshira në hulumtim afarizmin e tyre e kanë të filluar në vitet 1990/92, me përjashtim të Kooperativës bujqësore “Krusha e Madhe” e cila veprimtarinë e ka filluar në vitin 2003 si OJQ “Gratë e veja” ndërsa nga viti 2005 si KB dhe “Osa Termosistemi” ka filluar nga viti 1986 si ndërmarrje shoqërore kurse nga viti 2003 si biznes privat.

Në këto biznese janë të punësuar gjithsejtë; 267 punëtorë, meshkuj 223, femra 44, struktura kualifikuese; kualifikim superior/lartë, 53, shkolla e mesme. 141, me shkollimin fillor 73 veta.

Të gjithë të intervistuarit, e vlerësojnë si të mirë dhe të suksesshëm punën dhe të arriturat e bizneseve të tyre, lidhur me problemet me të cilat përballën në punë bizneset e tyre, japin vlerësime deri diku të larmishme, një pjesë e paraqesin problem furnizimin me energji elektrike, procedurat e tepërta burokratike, normat e larta të interesit, ndërsa tre bizneset “Conning”, “Beha-N” dhe KB”Krusha e Madhe”, problem të tyre e paraqesin mungesën e hapësirës për zhvillim dhe zgjerim të biznesit. Prodhuesit e verës dhe pijeve të tjera alkoolike, potencojnë konkurrencën jo-lojale me të cilën përballën në treg nga prodhuesit klandestinë. Rreth njohurive për politikën fiskale dhe kreditore, pothuaj se të gjitha bizneset kanë njohuri por bizneset e vogla nuk kanë kapacitete profesionale, rreth fondeve të BE-së, nuk kanë njohuri me përjashtim të dy ndërmarrjeve më të mëdha por asnjëri biznes nuk kanë kapacitete profesionale për të aplikuar në këto fonde. Lidhur me ambientin e të bërit biznes, të gjithë vlerësojnë se ka një përmirësim, por është i pamjaftueshëm.

Pjesa bashkëpunimi me sektorin publik-qeverinë komunale - Puna e qeverisë komunale dhe administratës lokale, vlerësohet mesatare, jo sa duhet efikase dhe profesionale. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe angazhimi i këtij sektori në mbështetje të bizneseve nuk është i kënaqshëm. Po thuaj asnjëri nga bizneset e intervistuar nuk merr pjesë në ankandet apo konkurset e qeverisë lokale, disa prej tyre me arsyetimin se zyrtarët komunal nuk janë korrekt përgjatë procesit selektimit. Bizneset janë deklaruar se nuk kanë informata lidhur me dokumentet strategjike zhvillimore dhe as që kanë marrë pjesë në hartimin e ndonjë dokumenti zhvillimor. Lidhur me përgjegjësitë e komunës në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, deklarohen se kanë deri diku njohuri por pushteti lokal nuk po i shfrytëzon këto përgjegjësi. Rreth informimit për punën e qeverisë lokale kryesisht njoftohen përmes kontakteve të drejtpërdrejta shumë pak e shfrytëzojnë web-faqen e komunës, dhe mendojnë se komuna nuk është sa duhet transparente.

Bashkëpunimi me shoqatat - bashkëpunimi i bizneseve të hulumtuara me shoqatat që veprojnë në komunën e Rahovecit është shumë i ulët, të gjithë të intervistuarit, deklarohen se kanë njohuri se ka ekzistuar shoqata e afaristëve të Rahovecit-SHAR, por tani nuk kanë informatë se çfarë ka ndodhë me të, disa prej bizneseve kanë qenë edhe themelues të kësaj shoqate. Lidhur me punën e shoqatave të vreshtarëve dhe verëtarëve kanë të gjithë njohuri, ndërsa “Haxhijaha” ka edhe bashkëpunim me këto shoqata, këto dy shoqata vlerësohen mjaftë nga të gjithë të intervistuarit në përfaqësimin e interesave të

vreshtarëve dhe në veçanti në organizmin e festivalit të rrushit. Kooperativa bujqësore “Krusha e Madhe” ka një bashkëpunim me shoqatën “Hareja” në Rahovec edhe me shoqatat e vreshtarëve dhe verëtarëve. Është vlerësim i të gjithëve se puna e shoqatave do të ishte me interes për bizneset e tyre.

Bashkëpunimi me sektorin privatë - Të gjithë të intervistuarit vlerësojnë se ndërmarrjet e vogla kanë një perspektivë por kanë nevojë për mbështetje nga sektori publik nga të dy nivelet, përmes masave dhe politikave stimuluese. Bashkëpunimi në mes të sektorit privatë vlerësohet si i mirë në veçanti kjo shprehet tek dy biznese të cilat kanë kooperant në zhvillimin e aktivitetit të tyre. Pengesat në punën këtyre bizneseve janë të ndryshme duke filluar nga politika fiskale, procedurat burokratike, mungesa e politikave stimuluese, konkurrenca jo-lojale etj.

3.3. Sektori civil (shoqëria civile)

3.3.1. Përshkrimi i hulumtimit

Për të marrë mendimin dhe vlerësimin e sektorit civil lidhur me, bashkëpunimin me sektorin publikë, sektorin privatë, komunitetin në territorin e komunës së Rahovecit dhe për problemet me të cilat përballën është shfrytëzuar metoda e intervistës së strukturuar. Në intervistim janë përfshirë pesë organizata jo qeveritare-OJQ të ndryshëm, që operojnë në territorin e komunës së Rahovec.

Përzgjedhje e OJQ-ve për përfshirje në intervistim është bërë duke bazuar në : grupet shoqërore që ato përfaqësojnë. Kështu janë intervistuar 5 OJQ prej tyre, një që përfaqëson rininë e komunës, një që përfaqëson interesat e gruas, dy që përfaqësojnë interesat e bizneseve dhe një që përfaqëson njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.

Hulumtimi është kryer në ambientet/zyrat e OJQ-ve, duke e përdorur metodën e intervistimit individual me secilin respondent veç e veç/ballë për ballë, intervistimi ka zgjatë 2 ditë, për shkak të pamundësisë që respondentët të ishin të lirë për intervistim në të njëjtën ditë. Intervista ka qenë e tipit të hapur ashtu siç është potencuar edhe më lartë, respondentët në fillim janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit, me përmbajtjen e intervistës dhe pastaj kanë dhënë përgjigjet dhe opinionin e tyre të pavarur. Intervista është e përbërë nga katër pjesë, pjesa e parë përfshinë pyetjet rreth OJQ-së/shoqatës së intervistuar, pjesa e dytë, bashkëpunimi me sektorin publik qeverinë lokale, pjesa e tretë

bashkëpunimin me sektorin privat dhe pjesa e katërt përfshinë, bashkëpunimin me sektorin civilë/shoqërinë civile në nivel të komunës.

3.3.2. Analiza e hulumtimit

OJQ-të e përfshira në hulumtim operojnë në territorin e komunës së Rahovecit. Veprimtarinë e tyre e kanë filluar kryesisht pas luftës së fundit, respektivisht nga viti 2000, në kohën kur ka filluar ndërtimi i institucioneve publike dhe shoqërore. Është me interes të potencohet se disa prej OJQ-ve siç është qendra rinore dhe shoqata e gruas ‘Hareja’ në fillim janë të formuara dhe financuar nga shoqatat e huaja me qëllim që këto dy grupe shoqërore të lirohen nga traumat e luftës dhe të bëhen pjesë aktive e shoqërisë. Shoqata e verëtarëve dhe ajo e zejtarëve janë të formuara nga bizneset lokale me qëllim të prezantimit dhe mbrojtjes së interesit të tyre.

Informatat rreth aktivitetit të OJQ-ve; të përfshira në hulumtim veprimtarinë e tyre e kanë filluar në: Qendra rinore SHL-Kosova dhe shoqata e pavarur e gruas ‘Hareja’ në vitin 2000, SHVK ‘Enologjia’ në vitin 2008 dhe shoqata e zejtarëve në vitin 1998.

Qendra rinore dhe ‘Hareja’ menaxhohen nga bordet dhe menaxheri/drejtori, tek qendra rinore menaxheri dhe stafi profesional paguhet për punën e tyre ndërsa tek ‘Hareja’ puna është vullnetare, bordet në të dy organizatat nuk marrin pagesë për angazhim në shoqata. Qendra rinore anëtarësinë e ka nga të rinjtë prej moshës 15-25 vjeç, ndërsa ‘Hareja’ anëtarësinë e ka nga gratë e moshave të ndryshme. Këto dy organizata ofrojnë trajnime të llojeve të ndryshme për anëtarët e tyre dhe janë mjaftë aktive dhe të suksesshme në punën e tyre. Financimin e bëjnë përmes konkurrimit me projekte tek donatorë të ndryshëm vendorë edhe ndërkombëtarë. Punën e tyre e prezantojnë përmes web-faqës, fletëpalosjeve dhe formave të ndryshme. SHVK. ‘Enologjia’ është e formuar nga prodhuesit e verës, prezanton dhe përfaqëson interesat e këtij sektori në vend dhe jashtë vendit, menaxhohet nga kuvendi, bordi menaxhues, kryetari dhe ka një administrator, financohet nga anëtarët e shoqatës dhe projektet e përfituara. Shoqata e zejtarëve përfaqëson zejtarët ose mikro bizneset e komunës së Rahovecit ka diku rreth 480 anëtarë udhëhiqet nga Kryetari dhe Kryesia e shoqatës, financohet përmes vetëfinancimit. Të gjitha këto shoqata e vlerësojnë si të suksesshëm punën e tyre dhe mendojnë të vazhdojnë edhe më tej, qendra rinore dhe ‘Hareja’ kanë edhe programe konkrete për zgjerim të aktivitetit.

Bashkëpunimi me sektorin publik-qeverinë komunale; Puna e qeverisë komunale dhe administratës lokale, vlerësohet mesatare, sipas të intervistuarve ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe angazhimi i këtij sektori në mbështetje të shoqërisë civile nuk është i mjaftueshëm, në këtë çështje kemi përgjigje të ndryshme, derisa qendra rinore mendon se problemi qëndron tek mungesa e buxhetit, shoqata e zejtarëve mendon se është edhe mungesa e vullnetit të zyrtarëve komunal. Bashkëpunimi i shoqatave të intervistuar bëhet kryesisht me sektorët përgjegjës p.sh. Qendra rinore me sektorin e rinisë, ka një memorandum bashkëpunimi me komunën, “Hareja” me drejtorin e arsimit dhe të shëndetësisë, “Enologjia” me drejtorinë për zhvillim ekonomik dhe bujqësi, ndërsa shoqata e zejtarëve deklaroi se bashkëpunimi është i mangët. Nga shoqatat e intervistuar, qendra rinore dhe “Hareja” janë deklaruar se marrin pjesë në konkurset dhe shpalljet publike të komunës dhe ato qendrore. Qendra rinore dhe “Hareja” janë deklaruar se njoftohen nga komuna për përgatitjen e dokumenteve të ndryshme strategjike dhe se shpesh marrin pjesë, ndërsa “Enologjia” dhe shoqata e zejtarëve u deklaruan se nuk janë të njoftuar, në fakt shoqata “Enologjia” ka qenë pjesë e ekipit që ka draftuar “Strategjinë e verarisë dhe vreshtarisë” nga MBPZHR. Lidhur me kornizën ligjore rreth përgjegjësisë të komunës, qendra rinore dhe “Hareja” kanë njohuri ndërsa “Enologjia” dhe shoqata e zejtarëve deklarojnë se nuk kanë njohuri. Rreth informimit për punën e qeverisë lokale kryesisht njoftohen përmes kontakteve të drejtpërdrejta edhe përmes web-faqes së komunës, dhe mendojnë se komuna duhet të jetë edhe më shumë transparente ndaj shoqërisë dhe qytetarëve.

Bashkëpunimi me sektorin privatë - Të gjithë të intervistuarit vlerësojnë se ndërmarrjet vogla kanë një perspektivë por kanë nevojë për mbështetje nga sektori publik nga të dy nivelet, përmes masave stimuluese. Bashkëpunimi me sektorin privatë bëhet në formë të ndryshme; qendra rinore bënë trajnimin e të rinjve për punë, organizon vizita me karakter pune, organizon edhe ligjërata nga afaristë të ndryshëm me të rinjtë e qendrës etj. Shoqata “Hareja”, bënë trajnimin e grave në fusha të ndryshme siç janë rrobaqepësi, frizere dhe shpesh mbështet nga sektori privatë në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme etj. Ndërsa “Enologjia” dhe shoqata e zejtarëve janë direkt të lidhura me sektorët e tyre dhe i tërë aktiviteti i tyre lidhet me afirmimin dhe promovimin e interesave të sektorëve, përkatës, si në treg ashtu edhe para sektorit publik.

Bashkëpunimi me shoqatat - Qendra rinore është shumë aktive në zgjerimin e bashkëpunimit si në nivelin lokal ashtu edhe në atë nacional, me inicimin e qendrës rinore është formuar rrjeti i qendrave rinore në nivel vendi. Shoqata e gruas “Hareja” ka një bashkëpunim me shoqatën “Medika” nga Gjakova në përkujdesin për gratë e dhunuara gjatë luftës etj. Ndërsa shoqata “Enologjia” dhe ajo zejtare nuk kanë bashkëpunim me shoqata të tjera. Shoqata “Enologjia” arsyetohet se nuk ka shoqata të ngjajshme në nivel vendi. Të gjithë të intervistuarit mendojnë se korniza ligjore aktuale krijon një hapësirë të nevojshme për punë të shoqërisë civile, por ka nevojë të plotësohet edhe me ligje të tjera, p.sh. Ligjet për mbështetjen e OJQ-ve në fushat deficitare, pastaj tatimet që i paguan shoqata për aktivitete që i kryen etj. Është interesante të theksohet se të gjithë të intervistuarit kishin informacion se ka ekzistuar GLV- grupi lokal i veprimit, por asnjëri nga këta nuk kishte informacion se çfarë bënë tani ky grup.

3.4. Sektori civil (Banorët lokal)

3.4.1. Përshkrimi i hulumtimit

Për ta hulumtuar opinionin e banorëve të komunës së Rahovecit lidhur me bashkëpunimin, me qeverinë komunale, për punën e organeve komunale, për veprimtarinë e shoqatave që operojnë në territorin e komunës, pastaj për nivelin e zhvillimit dhe mundësitë zhvillimore të komunës është përdorë metoda e anketimit përmes pyetësorëve, në anketim janë përfshirë 114 anketues nga pjesë të ndryshme të komunës së Rahovecit.

Modeli i pyetësorët të cilët janë përdorur përgjatë anketimit, janë marrë nga autori Josip Bošnjak, të aplikuara përgjatë hulumtimit të tij me titull menaxhimi me zhvillimin ekonomik lokal në komunën e Hrvace të Kroacisë, (Bošnjak, 2012, 69).

Pyetësi për anketim përbëhet nga pyetje të tipit të mbyllur dhe hapura. Jemi përpjekur për të marrë informacion në lidhje me atë, nëse komunitetin lokal, në mënyrë specifike banorët e saj, janë të përgatitur për pjesëmarrje në procesin e zhvillimit të ekonomik lokal të komunës së tyre, pastaj se cili është opinionin e tyre në lidhje me situatën aktuale dhe të ardhmen rreth zhvillimit të komunës, marrëdhëniet e tyre me shoqata, dëshira e tyre për t'u përfshirë në proceset e vendim-marrjes, në lidhje me zhvillimin e komunës së tyre etj. Hulumtimi është kryer në shtatë lokacione/qendra lokale të ndryshme të komunës, së Rahovecit. Ndarja e lokacioneve/vendbanimeve të përfshira në hulumtim është bërë

bazuar në ndarjen territoriale administrative të komunës, ashtu që të shtatë qendrat të përfshira përfaqësojnë komunitetin e përbërë nga disa fshatra me një qendër lokale (Bashkësi lokale) dhe qyteti i Rahovecit si qendër komunale, qendrat e përfshira në hulumtim janë: Qyteti i Rahovecit, Xërxa, Krusha e Madhe, Ratkovci, Qifllaku, Drenoci dhe Apterusha. Përpunimi i të dhënave kualitative dhe kuantitative është bërë përmes programit statistikor SPSS-së (Statistical Package for Social Sciences).

Të dhënat janë mbledhur përmes pyetësorit për anketim. Mostra ka përfshirë 114 repondentë, paraprakisht të definuar sipas grup moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale dhe statusit shoqëror. Pyetësi përbëhet nga pyetje të tipit mbyllur dhe të hapura, ashtu që përgjigjet në pyetjet e hapura paraprakisht janë grupuar për përpunim. Pyetjet në pyetësor janë ndarë në katër pjesë, nga të cilat pjesa e parë përfshinte informacionet përgjithshme në lidhje me

respondentin/të anketuarin, pjesa e dytë e marrëdhëniet me sektorin publik, pjesën e tretë të marrëdhëniet me shoqatat, dhe pjesën e katërt ka të bëjë me të ardhmen, respektivisht mendimet, qëndrimet dhe dëshirat e banorëve të komunës së Rahovecit.

Ndarja e pyetësorit në katër pjesë, përfshirja e pyetjeve sipas grup moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale dhe statusit shoqërorë është bërë me qëllim të marrjes së opinionit nga të gjitha kategoritë shoqërore për procesin e tërësishëm të zhvillimit në Rahovec.


3.4.2. Rezultatet e hulumtimit

Informatat rreth të anketuarve, sipas moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale dhe sociale

Respondentët e përfshirë në procesin e anketimit, janë banorë të komunës së Rahovecit, të cilët jetojnë të shpërndarë në tërë territorin e komunës, pastaj janë të grup moshave të ndryshme të dy gjinive të përgatitjeve të ndryshme profesionale dhe me status të ndryshëm shoqërorë.


Struktura e të anketuarve sipas grup moshës - Në anketim numri më i madh i të anketuarve është i grup moshës nga 20-40 vjeç ose grup mosha e re dhe atë: 20-40 vjeç 48,20 %, pastaj 40-60 vjeç 36,80 % dhe 60-80 ve 15,00 %.

Grafiku nr. 5, Të anketuarit sipas grup moshës




Struktura e të anketuarve sipas gjinisë dhe grup moshave -. Struktura gjinore e të anketuarve është meshkuj 66,60 %, ndërsa femra 33,40 %. Struktura gjinore sipas grup moshave është si në vijim, grup mosha e re është në pjesëmarrje më të madhe tek dy gjinitë me një dominim më të madh tek femrat, pason me grup moshën e pjekur dhe në fund, është grup mosha e të vjetërve e cila ka një pjesëmarrje më të ulët.

Grafiku, nr. 6, Të anketuarit sipas gjinisë dhe moshës.





Struktura e të anketuarve sipas përgatitjes profesionale - Të anketuarit janë të katër niveleve të përgatitjes profesionale, numri i madh të anketuarve janë PLP me 28,90 %, pasuar nga PMP me 28,10 %, PSP me 23,70 %, PUP me 12,30 % dhe student me 7%.

Grafiku nr. 7, Struktura e të anketuarve sipas përgatitjes profesionale



Struktura e të anketuarve sipas statusit shoqëror/social - Të anketuarit janë të katër kategorive sociale, të punësuar janë me 57,90 %, të pa punë me 30,70 %, pensionistë me 4,40 % dhe studentë me 7 %. Të punësuarit në sektorin publik dominojnë me 62,10 %, në sektorin privatë me 33,30 % dhe në sektorin civil 4,60 %.

Grafiku, nr. 8, Struktura e të anketuarve sipas statusit social dhe sektorëve të punësimit



Informatat e të anketuarve rreth sektorit publik/qeverisë komunale;

Të anketuarit në pyetjet e parashtruara rreth çështjeve që lidhen me sektorin publik respektivisht me qeverisjen komunale dhe aktivitetet e sajë kanë dhënë këto përgjigje;

Pyetja se a e dini kush është Kryetar i komunës - të gjithë të anketuarit kanë dhënë përgjigje pozitive, pra kryetari i komunës është i njohur për të gjithë grup moshat, gjinitë etj.

Në pyetjen se a dini apo a keni njohuri për ndonjë dokument zhvillimor të komunës suaj? përgjigja ka qenë kështu; Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 30 veta ose

26,30 % janë përgjigjur me po ndërsa 84 veta ose 73,70 % me jo. Përgjigja sipas strukturës gjinorë është 28 meshkuj ose 36,40% janë përgjigje me po ndërsa vetëm 2 femra ose 5,40 %. Struktura profesionale ose PLP dhe PSP, kanë deklaruar në numër më të madh se kanë njohurive për dokumentet zhvillimore komunale dhe atë, PLP, 16 veta dhe PSP, 10 veta ose 43,20 % dhe 32,25 %.

Rreth pjesëmarrjes në debatet publike me rastin e bërjes së dokumenteve zhvillimore - të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje. Në numrin e përgjithshëm të anketuarve vetëm 18 veta ose 15,80 % kanë marrë pjesë në këto debate kurse 96 ose 84,20 % nuk kanë marrë pjesë. Sipas gjinive pjesëmarrje në debate vetëm gjinia mashkullore ka marrë pjesë dhe asnjë femër nuk ka dhënë përgjigje pozitive. Struktura profesionale e të anketuarve që kanë marrë pjesë në debate publike është PMP, 4, PLP, 7 dhe PSP, 7, pra vërehet PUP nuk ka marrë fare pjesë në këto debate. Ndërsa struktura sociale ka këtë pjesëmarrje: Të punësuarit 14 veta janë përgjigjur me po; të papunësuarit 1 dhe pensionistët 3 veta ose në përqindje është: të punësuarit 21,20 %, të papunësuarit 2,85 dhe pensionistët 60 %. Është me interes të shikohet se nga të punësuarit 11 veta ose 26,80 % janë të sektorit publik dhe vetëm 3 veta ose 13,60 % nga sektori privat dhe asnjë nga sektori civil.

Lidhur me atë nëse komuna jep informata të mjaftueshme për aktivitetet e saja - përgjigja e të anketuarve ka qenë si në vijim: 40 veta ose 35,10 % janë përgjigjur me po ndërsa 74 ose 64,90 % janë përgjigjur me jo. Sipas strukturës gjinore, 26 veta ose 33,80 % e meshkujve janë përgjigjur me po dhe 14 veta ose 37,80 % e femrave janë përgjigjur me po. Ndërsa nga struktura profesionale PLP dhe PSP, janë përgjigjur në përqindje më të lartë me po respektivisht PLP me 45,95 % dhe PSP me 32,25 % që është në fakt mbi ose baras me përqindjen totale.

Të anketuarit informohen për punën e organeve komunale nëpërmjet - 47 veta ose 51,00 % të përgjigjeve kanë deklaruar se informohen përmes internetit (web-faqës dhe portaleve), 23 veta ose 25,00 % kanë deklaruar se informohen përmes mjeteve të informimit (Radio, TV dhe gazetave), mjetet tjera kanë një pjesëmarrje të vogël.

Lidhur me kënaqshërinë me punën e komunës janë marrë këto përgjigje: 41 veta ose 36 % e të anketuarve kanë dhënë përgjigje pozitive kurse 73 veta ose 64 % kanë dhënë përgjigje negative. Sipas gjinive kemi këto rezultate, 29 meshkuj ose 37,70 % janë përgjigjur me po dhe 12 femra ose 32,40 % janë përgjigjur me po, të tjerët kanë dhënë përgjigje negative. Te struktura profesionale edhe në këtë çështje PLP dhe PSP janë dy

grupet që kanë përqindje më të lartë pozitive asht siç është çështja edhe te struktura sociale ku grupi i të punësuarve ka përqindje më të lartë pozitive.

Për atë se me çka janë të kënaqur dhe me çka nuk janë të kënaqur; Nga 50 përgjigje që janë dhënë për kënaqshmërinë me punën e komunës 27 kanë potencuar “investimet në infrastrukturën publike”, si punë të mirë të komunës, ndërsa nga 66 përgjigje për pakënaqësinë me punën e komunës 21 përgjigje ose 31,80 % kanë shprehur pakënaqësi të përgjithshme, 14 përgjigje ose 21,20 % kanë potencuar “papunësinë dhe zhvillimin ekonomik” dhe 9 përgjigje ose 13,65 % kanë deklaruar “mos transparencën dhe llogaridhënien” etj.

Informatat e të anketuarve rreth sektorit civil/shoqërisë civile;

Rreth aktivitetit të shoqatave në territorin e komunës, janë dhënë këto përgjigje: 69 veta ose 60,50 % janë përgjigjur se kanë njohuri për veprimtarinë e ndonjë shoqate, kurse 45 veta ose 39,50 % janë përgjigjur se nuk kanë njohuri rreth shoqatave. Nga ky numër 53 veta ose 68,80 % janë meshkuj të cilët janë përgjigjur me po ndërsa 16 veta ose 43,20 % janë femra që kanë deklaruar që kanë njohuri për punën e ndonjë shoqate në territorin e komunës.

Në pyetjen se a janë pjesë e ndonjë shoqate; vetëm 16 veta ose 14,05 % janë deklaruar me po se janë pjesë e ndonjë shoqate kurse 98 veta ose 85,95 % janë përgjigjur me jo. Nga përgjigjet pozitive 15 veta ose 19,50 % janë meshkuj dhe vetëm 1 ose 2,70 % është femër.

Rreth njohurive për shoqatat konkrete që veprojnë në komunë janë dhënë këto përgjigje; Nga përgjigjet pozitive për aktivitetin e shoqatave, 22 veta ose 18,80 % e a kanë përmendur emrin e

Shoqatës “Hareja” , pastaj shoqatën e “Vreshtarëve” 17 veta ose 14,55 %, shoqatën “Opfakos” 15 veta ose 12,85 % , ndërsa për Qendrën rinore dhe OVL e UÇK-së janë përgjigjur nga 13 veta ose 11,10 % etj.

Opinionit i të anketuarve se a ndikojnë shoqatat/OJQ-të në cilësinë e jetës në komunë është: 56 të anketuar ose 49,10 % mendojnë se ndikon pozitivisht ndërsa 58 veta ose 50,90 %, mendojnë se jo nuk ndikon në cilësinë e jetës në komunë. Lidhur me këtë pyetje grup moshë e re nga 20-40 vite është përgjigjur në numër më të madh duke dhënë 25 përgjigje me po dhe 30 me jo, është indikativë sepse kjo grup moshë pritet të ketë më shumë mundësi në zhvillimin e komunës.

Informatat e të anketuarve rreth gjendjes aktuale, mendimi dhe qëndrimi për të ardhmen; Mendimi i të anketuarve për nivelin e zhvillimit ekonomik të komunës është; Nga pesë klasifikime që ju janë ofruar të anketuarve opinioni i tyre është i ndarë në këtë mënyrë: 13 veta ose 11,40 % e konsiderojnë komunën si “e pazhvilluar”, 45 veta ose 39,50 % si “pak e zhvilluar”, 52 veta ose 45,60 % si “mesatarisht e zhvilluar”, 4 veta ose 3,50 % si “e zhvilluar”, ndërsa asnjëri nga të anketuarit nuk e konsideron si “shumë të zhvilluar”.

Mendimi e të anketuarve rreth aktivitetit ekonomik që mundë të zhvillohet në të ardhmen janë; veprimtaria ekonomike për të cilën janë shprehur numri më i madh i të anketuarve është, bujqësi (vreshtaria, perimtaria dhe perimekultura) 45 veta ose 54,20 % e atyre që kanë shpreh mendim rreth kësaj pyetje, duke vijuar me industrinë/prodhimin me bazë lëndët bujqësore 18 veta ose 21,70 %, bizneset e mesme dhe të vogla 5 veta ose 6,05 % e kështu me radhë.

Në pyetjen nëse ju dhe fëmijët tuaj e keni ndërmend të jetoni edhe më tej në komunën tuaj - shumica e të anketuarve janë përgjigjur me po ose 95 veta ose 83,30 % .

Ndërsa lidhur me atë se cilat janë arsyet se ata do të vazhdojnë të jetojnë në komunën e tyre - përgjigjet kanë qenë të ndryshme, ndër arsyet më dominuese janë: “shpresa për zhvillim dhe jetë më të mirë në të ardhmen” është cekur si arsye nga 26 veta ose 27,40 %, “vendlindja dhe dashuria për të” nga 18 veta ose 19 %, familja dhe rrethi shoqëror 8 veta ose 8,40 % e kështu me radhë.

Në pyetjen se nëse ju jepet shansi a do të përfshiheshin në proceset vendimmarrëse në lidhje me dokumentet zhvillimore komunale, janë dhënë këto përgjigje: 79 veta ose 69,30 % janë përgjigjur me po, ndërsa 63 nga të përgjigjurit me po janë meshkuj kurse vetëm 16 janë femra. Struktura profesionale e përgjigjeve është, PUP, 6 veta, PMP, 16 veta, PLP, 28 veta dhe PSP, 29 veta, janë përgjigjur pozitivisht.

Rreth pyetjes se a keni njohuri rreth BE-së, për mundësitë që i ofron sektorit privat dhe civil- të anketuarit kanë dhënë përgjigjet si në vijim: 40 veta ose 35,10 % janë përgjigjur me po, nga këta 30 meshkuj dhe 10 femra. Struktura profesionale e të përgjigjurve është, PUP, 1, PMP, 9 veta, PLP, 14 veta dhe PSP, 16 veta, edhe në këtë fushë, dy grupet profesionale PLP dhe PSP kanë dhënë numrin më të madh të përgjigjeve pozitive.

Pyetja e fundit që lidhej me mundësin e ndikimit në ndonjë projekt ose investim të komunës që ju e vlerësoni se do të ndikoj negativisht në cilësinë e jetës tuaj, janë përgjigje kështu: 45 veta ose 39,50 % janë përgjigjur me po, nga ky numër meshkuj janë 29 dhe

femra 16 veta. Edhe në këtë pyetje përgjigjet pozitive janë të dhëna më së shumti nga grupet profesionale PLP dhe PSP, respektivisht, nga 17 veta.

Nga analiza e hulumtimit të bërë në të gjitha grupet e interesit, sektorin publik, sektorin privat, sektorin civil dhe me qytetarë mund të konkludojmë se, sektori privat dhe komuniteti/qytetarët janë shumë pak aktivë në punën e organeve komunale dhe, kanë shumë pak informata për proceset në përgjithësi. Shoqëria civile është diçka më aktive por, edhe kjo, jo sa duhet.

3.4.3. Analiza e kornizës ligjore 2000-2016;

Korniza ligjore krijon mundësi që pushteti lokal përmes shfrytëzimit të mekanizmave që ka në dispozicion të mbështes sektorin privat, në hapjen e bizneseve të reja, fuqizimin e atyre ekzistuese, hapjen vendeve të reja të punës etj. Autor të ndryshëm në studimet e tyre për rolin e qeverive lokale në zhvillimin ekonomik, një rëndësi të veçantë i kushtojnë kornizës ligjor.

Jan Bucček, në studimin mbi rolin e qeverisë lokale në zhvillimin ekonomik në Sllovaki, rendësin e kornizës ligjore e përshkruan kështu: Vetëqeverisjet lokale mirë të ngritura dhe autonome dhe legjislacioni i përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme përcaktojnë kushtet themelore të funksionimit të vetëqeverisjes lokale në zhvillimin ekonomik lokal, (Bucček, 2005, 480).

Ndërsa profesori Kadmiel Wekwete, rendësin e kuadrit ligjor e përshkruan si njërin ndër katër veprimet kryesore që u mundëson qeverive vendore të luajnë rolin e tyre të plotë: Sigurimi i një kuadri të qartë kombëtar për zhvillimin ekonomik lokal përmes decentralizimit efektiv fiskal, politik dhe ligjor duke përfshirë njohjen e duhur kushtetuese dhe ligjore dhe qasjen në një pjesë të barabartë të burimeve kombëtare, (Wekwete, 2009, 7).

Kosova nga viti 2000, ka ndërtuar në vazhdimësi kuadrin ligjorë për funksionimin sa më të plotë dhe më të mirë të pushtetit lokal në të gjitha fushat e përgjegjësisë. Decentralizimi apo bartja e përgjegjësisë në nivelin lokal është përcjell përmes ndërtimit të kuadrit ligjor i cili në vazhdimësi ka pësuar përmirësime me qëllim të përshtatjes kërkesave për një zhvillim të qëndrueshëm. Në vazhdim do të prezantojmë ndryshimet e kornizës ligjore të bëra gjatë kësaj periudhe kohore:

Analiza është e koncentruar kryesisht në ligjet të cilat afektojnë zhvillimin ekonomik

Ligjet të cilat në mënyrë direkte pushtetin lokal e lidhin me zhvillimin ekonomik:

Ligji bazë i vetëqeverisjes lokale; Kosova fillimisht, përgjegjësit dhe të drejtat pushtetit lokal i ka rregulluar me, Rregulloren 2000/45, nga viti 2000 deri me 31.12.2007, nga 01.janari 2008 deri në korrik, 2008 me rregulloren 2007/30, kurse nga korriku 2008 dhe deri më tani me ligjin nr. 03/L-040, mbi vetëqeverisjen lokale të komunave të Kosovës i datës 22.02.2008.

Legjislacioni që rregullon qeshjet financiare/fiskale të komunave; Nga viti 2000 qeshjet e financave lokale janë rregulluar kryesisht me Rreg. 2000/45 dhe Udhëzimin administrativ mbi të hyrat vetanake të komunave. Ligji për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-49 i datës 13, mars 2008, ka bërë përcaktimin dhe zgjerimin e bazës fiskale me llojet e të hyrave që komunat grumbullojnë në buxhet, përfshirë të hyrat vetanake, garantët qeveritare dhe të hyrat e tjera.

Tatimit në pronë, është rregulluar me Rreg. 2003/29 , ka vazhduar me ligjin 2003/8 dhe më vonë ka pësuar ndryshime dhe tani rregullohet me ligjin nr. 03/ L – 204.

Administrimi pronës komunale. Baza ligjore e administrimit të pronës komunale ka pësuar tre herë ndryshime përgjatë kësaj periudhe në interes të zhvillimit ekonomik. Fillimisht administrimi është rregulluar me Rregulloren nr. 2005/13, mbi dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duke pësuar ndryshim më vonë përmes ligjit nr.03/L-226, i datës 28 tetor 2010 dhe ligjit nr. 03/L- 144 i datës 22 nëntor 2012.

Ligjet të cilët afektojnë zhvillimi ekonomik në nivelin lokal dhe nacional:

Ligji për partneriteti publiko privat; ka pësuar tre herë ndryshime, në interes të aplikimit në interes të zhvillimit, Ligji nr. 02/L – 44, për procedurën e dhënies së koncesioneve i datës 03 shtator 2005, pastaj është nxjerr ligji nr. 03/L- 090, për partneritet publiko privat dhe koncesionet në infrastrukturë i vitit 2009, ndërsa është ndryshuar me ligjin nr. 03/L – 045, për partneritet publiko privat i datës 21 tetor 2011.

Ligji për zonat ekonomike, ka pësuar dy herë ndryshime, Ligji nr. 03/L – 129, për zonat ekonomike i datës 13 prill 2009 , më vonë ky ligj është ndryshuar duke nxjerr ligjin nr. 04/ L – 159, për zonat ekonomike i datës 14 shkurt 2013. Qëllimi i nxjerrjes dhe ndryshimit të këtij ligji është krijimi i zonave ekonomike, zonave të lira për mbështetjen e zhvillimit ekonomik.

Ligji nr. 05/ L – 79, për investime strategjike i datës, 11. 10. 2016, i cili mbështet investime e rëndësisë së veçantë për zhvillimin e vendit.

Nga analiza e bërë ligjeve të cilët në një mënyrë apo tjetër afektojnë zhvillimin ekonomik lokal, mund të konkludojm se:

- Kuadri ligjorë nga viti 2000 deri më tani ka pësuar ndryshime, të cilat janë bërë me qëllim të përshtatjes për zhvillim të qëndrueshëm.
- Në veçanti ndryshimi më i theksuar ka ndodh me legjislacionin i cili është i lidhur më ngushtë me zhvillimin ekonomi, respektivisht me mbështetjen e sektorit privat, (ligjet: për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ligji mbi PPP dhe ai për zonat ekonomike).
- Ligji për investimet strategjike është një plotësim i legjislacionit i cili mundëson mbështetjen e programeve me rendësi strategjike zhvillimore.

Si pasoj e nxjerrjes dhe ndryshimit të ligjeve të cekura më lartë, kanë ndodhë zhvillime të projekteve të ndryshme siç janë:

Aprovimi dhe ndryshimet e Ligjit për PPP, kanë prodhuar disa partneritete në mes të sektorit publik dhe atij privat. Në nivel vendi në vitin 2010 është dhënë me koncesion aeroporti ndërkombëtar “Adem Jashari”, konsorciumit Limak - Aeroport de Lyon.

N nivelin lokal pames PPP-së janë trajtuar shërbimet komunale, Komuna e Pejës ka dhënë Transportin urban me autobus në vitin 2012 dhe Komuna e Suharekës, shërbimet Komunale menaxhimin e mbeturinave.

Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka mundësuar dhënien në shfrytëzim të pronës dhe aseteve komunale në shumë komuna, rasti konkret, “Mina Parku” në Rahovec.

Aprovimi dhe ndryshim i ligjit për zonat ekonomike, ka mundësuar ndërtimin e parkut të biznesit në Drenas, zonës ekonomike në Suharekë dhe zonat në ndërtim në disa komuna të tjera.

Konkluzion;

Analiza dëshmon se korniza ligjore e përshtatshme është parakushti bazë për zhvillimin ekonomik në tërësi gjithashtu edhe për zhvillimin ekonomik lokal. Ndryshimet e legjislacionit në interes të zhvillimit ekonomik krijojnë hapësirën e nevojshme për veprim të qeverisë lokale në mbështetje të sektorit privat.

KAPITULLI VII:

7. Vlerësimi i politikave/mekanismave komunal (Mini parkut të biznesit/ industria) të aplikuara në mbështetje të sektorit privat;

7.1. Përcaktimi grupit krahasues;

Përcaktimi i grupit-njesisë krahasuese, është njëri ndër hapat më të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të ndikimit të një programi apo politike të qeverisë lokale apo nacionale. Koncepti bazë i vlerësimit të ndikimit, është i lidhur me shkaktarin e rezultatit të përfituesit nga një program.

Vlerësimet e ndikimit përcaktojnë shkallën në të cilën një program - dhe vetëm ai program - shkakto një ndryshim në një rezultat, (Gertler. 2016, 47).

Në rastin konkret, vlerësimi i ndikimit të mbështetjes së bizneseve lokale përmes dhënies në shfrytëzim të hapësirave të urbanizuara (mini zonës ekonomike). Qëllimi i ofrimit të kësaj hapësire për shfrytëzim nga një numri i bizneseve ishte funksionalizimi i hapësirës, punësimi i punëtoreve lokal dhe rritja e të ardhurave në buxhetin e komunës.

Për ta vlerësuar nëse kjo ndërhyrje e komunës në zhvillimin e bizneseve lokale ka shkaktuar efektet e dëshiruara, duhet të vërtetohet përmes metodave të vlerësimit të ndikimit, duke e krahasuar me një grup me karakteristika të njëjta (komunë), e cila nuk ka aplikuar një politikë/ndërhyrje të tillë. Në këtë drejtim, çështja më delikate është gjetja e grupit të krahasimit i cili ka karakteristikat e njëjta me grupin e trajtimit, në rastin konkret, të gjendet komuna e cila ka karakteristika të njëjta me komunën e Rahovecit.

Një grup i vlefshëm i krahasimit (1) ka të njëjtat karakteristika, mesatarisht, si grupi i trajtimit në mungesë të programit; (2) mbetet i paprekur nga programi; dhe (3) do të reagojnë ndaj programit në të njëjtën mënyrë si grupi i trajtimit, nëse i jepet programi, (Gertler, 2016, 52).

Nisur nga kriteret që duhet të i plotësoj një grup krahasimi në rastin konkret dhe nga natyre e vet grupeve, kur është fjala për komuna është edhe më delikate gjetja e grupit identik pasi që komunat i kanë edhe specifikat e veçanta si në aspektin gjeografik, ekonomik dhe social, megjithatë grupet janë mesatarisht të ngjashme.

Si grup krahasimi në rastin konkret është përzgjedh komuna e Deçanit e cila ka karakteristika të ngjashme me komunën e Rahovecit dhe e njëjta për shkaqe të ndryshme kryesisht mungesës së këtyre hapësirave nuk e ka të aplikuar programin e njëjtë në mbështetje të bizneseve lokal.

7.2. Profili i grupit krahasues (karakteristikat e grupeve të trajtimit dhe krahasimit)

Karakteristikat e grupit të trajtimit, në rastin konkret të komunës së Rahovecit, e përcaktojnë se cili grup i krahasimit ose komunë ka karakteristika e njëjta dhe mundet të shërbej, për vlerësimin e politikave/intervenimit në zhvillimin e ekonomisë lokale.

Për ta bërë vlerësimin e ndikimit të programit, duhet bërë krahasimin e karakteristikave të dy komunave, respektivisht, të komunës së Rahovecit si grup në trajtim dhe komunës së Deçanit si grup kontrollues ose krahasues.

Komuna e Deçanit dhe karakteristikat e saj - Deçani ka një sipërfaqe prej 297 km², që gjendet në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës me një popullsi prej 40.019 banorë rezident dhe 11.650 jo rezident. Deçani ka 10-të Bashkësi Lokale me 37 fshatra, ka sipërfaqe të tokës bujqësore rreth 10.801 Ha, sipërfaqe pyjore 19.163 ha dhe 7.210 ha kullosa. Pozita gjeografike dhe resurset e natyrore dhe kulturore i mundësojnë kushte të favorshme për tërheqjen e investitorëve të ndryshëm, (Plani integruar, 2015, 4).

Ekonomia e komunës së Deçanit, është kryesisht e orientuar në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë me bazë lëndët nga pylltari dhe bujqësia. Pozita gjeografike, bukuritë e mëdha natyrore, peizazhet e bukura, trashëgimia në arkitekturë dhe objektet kulturore janë disa prej burimeve për zhvillim të turizmit malor, dimëror, rural shëndetësor etj.

Bujqësia është veprimtari kyç në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të komunës së Deçanit. Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë e Deçanit dhe prodhimin e rendimenteve të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkatar, (PZHK, 2008, 41).

Administrata komunale është e organizuar në 11 drejtori komunale dhe zyra komunale për komunitete, të cilat funksionojnë nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e Kryetar të komunës. Sipas faqes zyrtare të komunës së Deçanit, administrata është e organizuar në këto drejtori:

- Drejtoria për Administratë
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtoria për Arsim

- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
- Drejtoria për Inspektion
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
- Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte,

(<https://kk.rks-gov.net/decan/municipality/departmens>, 30.08.20017).

Karakteristikat e grupit të trajtuar-komunës së Rahovecit dhe grupit krahasues komuna e Deçanit

Aplikimi i metodës së krahasimit për ta vlerësuar aplikimin një programi apo ndërhyrje të caktuar në një fushë, në rastin konkret intervenimin e qeveris komunale në zhvillimin e sektorit privat është e domosdoshme. Ashtu siç e pamë nga teoritë e vlerësimit të ndikimit, ideja e kësaj qasje është për ta vlerësuar shkaktarin e një rezultati, i cili ka rrjedh nga aplikimi programit konkret. Gjetja e grupeve të tilla të krahasimit është thelbi i çdo vlerësimi të ndikimit, pavarësisht se çfarë lloji të programit po vlerësohet. Thjesht, pa një grup krahasimi që jep një vlerësim të saktë të kundërpërgjigjes, nuk mund të vërtetohet ndikimi i vërtetë i një programi, (Gertler, 2016, 52).

Komuna e Deçanit si grup i krahasimit me komunën e Rahovecit, kanë karakteristika të ngjashme por jo identike, për shkak se kemi të bëjmë me organizime politiko administrative të cilat kanë karakteristikat e veta që dallojnë nga njëra tjetra. Sido qoftë karakteristikat e grupeve janë të përafërta dhe mund të përdoren për krahasim në vlerësimin e ndikimit të programit konkret të komunës së Rahovecit.

Për ta bërë krahasimin e grupit të trajtimit komunës së Rahovecit dhe grupit të kontrollit komunës së Deçanit do të i përdorim disa prej karakteristikave që prezantojnë në mënyrë më të plot ngjashmërinë respektivisht pasqyrojnë gjendjen aktuale të tyre.

Tabela. Nr. 29, Karakteristikat e Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Deçanit;

Nr.	Karakteristikat	Rahovec	Deçan	Diferenca
1	Sipërfaqja	275,5 km ²	297 km ²	(21,5)
2	Popullsia	56208	40019	16189
3	Nr. Vendbanimeve	36	37	(1)
4	Buxheti komunal	11,908,739 €	8,176,265 €	3,732,474

5	Nr. i bizneseve aktive	2032	1222	810
6	Nr. i të punësuarve	2822	1183	1639
7	Nr. i Drejtorive Komunale	11	11	0

Tabela e më sipërme prezanton disa prej karakteristikave që kanë grupi i trajtimit komuna e Rahovecit dhe grupi i krahasimit komuna e Deçanit. Ashtu siç është vlerësuar edhe më lart përzgjedhja e grupit krahasues tek rastet kur kemi të bëjmë me njësi administrative është problematike të gjendet grupi i cili është identik me grupin trajtues, për shkak të veçorive dhe karakteristikave që zakonisht kanë njësit administrative. Kështu edhe rasti konkret i hulumtimit ka një diferencë në mes të dy grupeve, përpos në tri karakteristika ku të dy grupet kanë pozita të ngjashme. Sidoqoftë mendoj se edhe kështu siç janë këto grupe mund të përdoren për vlerësimin e ndikimit të programit në trajtim, meqë kemi të bëjmë me grupe të ngjashme të cilat kanë funksione dhe përgjegjësi të njëjta.

7.3. Vlerësimi i ndikimit të politikave/mekanizmave të aplikuar nga komuna

Për të bërë një vlerësim të ndikimit të një politike, programi apo intervenimi të ndërmarr nga një qeveri lokale, qeveri qendrore apo agjension publik, do të duhet fillimisht të përcaktohet pyetja e vlerësimit, e cila duhet të merr përgjigje nga procesi i vlerësimit.

Pyetja kryesore e vlerësimit të ndikimit është: cili është ndikimi (apo efekti shkakor) i një programi në një rezultat të interesit? Fokusi është në ndikimin: domethënë, ndryshimet që i atribuohen drejtpërdrejt një programi, modaliteti programesh ose inovacioni të dizajnit, (Gertler, 2016, 36). Pyetja kryesore lidhet me qëllimin e një programi, në rastin konkret pyetja është e lidhur me ndikimin që politika e komunës së Rahovecit në mbështetje të sektorit privat sa ka shkaktuar efektet në rezultatet e pritura?! Efekti i kësaj politike/intervenimi, në rritjen e të ardhurave për komunë dhe efekti në punësimin e punëtorëve lokal. Për ta vlerësuar këtë ndikim, do të duhet që përmes aplikimit të metodës së përzgjedhur dhe krahasimit me grupin kontrollues, të nxjerrim rezultatet konkretë të këtij intervenimi.

Metoda e aplikuar për vlerësim të ndikimit - Bazuar në qëllimin e vlerësimi i cili asht i lidhur me vërtetimin e teorisë, si dhe me specifikat e vet kohës dhe rastit të vlerësimit, metoda që më së miri i përshtatet këtij rasti asht ndryshimi në ndryshim. Natyra e programit që vlerësohet dhe koha kur ka filluar si dhe rrethanat e tjera përcjellëse nuk janë sa duhet të përshtatshme për një vlerësim të ndikimit, për më tepër kur kemi të bëjmë

me vlerësim të politikave lokale që aplikohen nga një komunë e cila do të krahasohet me një komunë tjetër që kanë rrethana dhe kushte të veta specifike.

Në të njëjtën kohë, krahasimi i rretheve që regjistroheshin dhe nuk regjistroheshin në programin e riparimit të rrugëve do të ishte problematik nëse ekzistojnë arsye të paparashikuara përse disa rrethe janë regjistruar në program dhe të tjerë nuk e kishin bere këtë, (Gertler, 2016, 130).

Sidoqoftë, matja vlerësimit të ndikimit të “Mini parkut te Biznesit” ne te ardhurat dhe punësim ne komunën e Rahovecit si grup i trajtimit është bërë përmes aplikimit te modelit të OLS- Katrorëve me te vegjël.

Në përdorimin e modelit ekonometrik OLS të punimit kemi përdorur modelin ekonometrik shumë variabël, në ndërtimin e modelit ekonometrik është përdorur bashkë dyzimi i modelit të përdorur nga David Neumark dhe Jed Kolko (2009) dhe Thad Dunning (2009), ku forma e regresionit për të mbështetur pohimet e punimit është:

a) Ndikimi i “Mini parkut i biznesit/industrial” në të hyrat vetanake të Rahovecit.

$$Y_t = C + \beta_{1t} + \beta_{2t} + \varepsilon$$

ku,

$$THR_t = C + \beta_1 NP_t + \beta_2 HP_t + \varepsilon$$

THR – Të hyrat vetanake të Rahovecit

NP – Numri i punëtorëve të Mini Parkut të Biznesit

HP – Të hyrat nga “Mini Parkut Industrial/Biznesit”

C – Konstantja për variabla

E – gabimi i rastësishëm për periudhën t

T – 2008 deri më 2010

Figura 14. Llojet e variablave

Variables Entered/Removed ^a			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punëtorët_K.Rahovecit ^b		Enter
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec			
b. All requested variables entered.			

Burimi: Output i SPSS v.20

Modeli i vendosur në programin statistikor SPSS v.20 tregon se çfarë variabla statistikore janë vendosur në modelin ekonometrik të trajtimit të problemit të temës së trajtuar.

Figura 15. Përmbledhja e modelit ekonometrik

Model Summary ^b										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.629 ^a	.395	.359	38884.13 20242	.395	10.790	2	33	.000	1.508
a. Predictors: (Constant), Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punetoret_KRahovec										
b. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec										

Burimi: Output i SPSS v.20

Për të kalkuluar të dhënat e modelit ekonometrik, kemi përdorur programin statistikor SPSS. Në bazë të kalkulimeve të bëra të modelit ekonometrik rezultatet e nxjerra nga të dhënat e modelit tregojnë se variabla e varur ka korrelacion të fort me variablat shpjeguese në nivel prej .629, respektivisht 62.9 për qind. Ndërsa R^2 në analizën tonë është .395, i cili tregon se 39.5% e variablës së varur shpjegohet nga variablat e pavarura. R^2 i rregulluar është i barabartë me .359, e që tregon se 35.9 për qind e variacionit të variablës së varur shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarura. Në analizën tonë për verifikimin e qëndrueshmërisë së modelit është përdorur korrelacioni serial. Vlera e korrelacionit të Durbin-Watson mund të jetë në interval prej 0 deri në 4. Nëse vlera e Durbin-Watson është e përafërt me zero, atëherë korrelacioni serial tregon se të dhënat në model kanë ndikim të lart pozitiv ndërmjet vlerës reziduale. Nëse korrelacioni Durbin-Watson i ofrohet vlerës katër (4), tregon se të dhënat kanë korrelacion negativ serial. Modeli mund të konsiderohet i qëndrueshëm kur rezultatet e Durbin-Watson janë afër intervalit të vlerës dy (2). Testi Durbin-Watson konsiderohet se nuk ka korrelacion serial në kuadër të intervalit prej 1.5 deri në 2.5, e që na tregon se vlera reziduale nuk ka korrelacion serial ose aty nuk ekziston auto korrelacion ndërmjet vlerës reziduale. Prandaj, bazuar në këtë interval, gjetjet në studimin tonë tregojnë se Durbin-Watson është në vlerë prej 1.508, e që është brenda vlerës së intervalit, e që nga kjo rrjedh se modeli është i qëndrueshëm.

Figura 16. ANOVA

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	32627698597.7 69	2	16313849298.8 84	10.790	.000 ^b
	Residual	49895198868.1 80	33	1511975723.27 8		
	Total	82522897465.9 48	35			
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec						
b. Predictors: (Constant), Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punetoret_KRahovec						

Burimi: Output i SPSS v.20

F-testi është i barabartë me .000 tregon se të gjitha koeficientet së bashku janë statistikisht signifikat dhe të ndryshëm prej zeros.

Figura 17. Përmbledhja e regresionit


Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	89168.563	25712.738		3.468	.001
	Punetoret_KRahovec	57.411	14.616	.571	3.928	.000
	Te_hyrat_Parku_Biznesit	1.213	1.384	.127	.876	.387
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec						

Burimi: Output i SPSS v.20

Rezultatet e modelit tregojnë se variabla numri i punëtorve të mini parkut ka ndikim në të hyrat vetanake të komunës së Rahovecit, ngase niveli i signifkancës është .000 apo në shkallën 1%, që mbështet pohimet tona, që zhvillimi i parkut industriale do të ndihmojë në rritjen e bizneseve dhe njëkohësisht në rritjen direkte të hyrave vetanake të komunave.

$$THR_t = 89,168.563 + \beta_1 57.41 + \beta_2 1.21 + \varepsilon$$

Figura 18. Scatterplot i modelit ekonometrik



Burimi: Output i SPSS v.20

Scatterplot të modelit ekonometrik tregon që kemi linjën lineare të modelit, pra vlerat e modelit kanë qëndrueshmëri ekonometrik, pra struktura e modelit është statistikisht e qëndrueshme dhe lineare.

Figura 19. Krahassimi me të hyrat e komunës së Deçanit

Runs Test	
	Te_hyrat_Kdeqan
Test Value ^a	114,346.45
Cases < Test Value	18
Cases >= Test Value	18
Total Cases	36
Number of Runs	18
Z	-.169
Asymp. Sig. (2-tailed)	.866
a. Median	

Burimi: Output i SPSS v.20

Përdorimi i testit ekonometrik “Run Test” tregon se komuna e Deçanit në krahasim me komunën e Rahovecit qëndron keq sa i përket parkut industrial, pasi që kjo komunë nuk posedon këtë lloj të tregut ekonomik, rezultatet e tabelës 19 tregojnë që krahasimi i këtyre dy komunave tregon që komuna e Deçanit ka efekt negativ -.169 Z raporti, pra mungesa e parkut ekonomik i sjellë komunës së Deçanit efekt negativ në të hyrat vetanake të kësaj komune.

b) *Ndikimi i “Mini parkut i biznesit/industrial” në punësim në komunën e Rahovecit;*

$$Y_t = C + \beta_{1t} + \varepsilon$$

ku

$$NPR_t = C + \beta_1 NP_t + \varepsilon$$

NPR – Numri i të punësuarve në Rahovec

NP – Numri i punëtorëve të Mini Parkut të Biznesit

C – Konstantja për variabla

E – gabimi i rastësishëm për periudhën t

T – 2008 deri më 2016

Figura 25. Llojet e variablave

Variables Entered/Removed ^a			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	NP ^b	.	Enter
a. Dependent Variable: NPR			
b. All requested variables entered.			

Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 26. Përmbledhja e modelit ekonometrik

Model Summary ^b										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.942 ^a	.888	.885	164.100	.888	269.168	1	34	.000	1.990
a. Predictors: (Constant), NP										
b. Dependent Variable: NPR										

Burimi: Output i SPSS v.20

Për të kalkuluar të dhënat e modelit ekonometrik, kemi përdorur programin statistikor SPSS. Në bazë të kalkulimeve të bëra të modelit ekonometrik rezultatet e nxjerra nga të dhënat e modelit tregojnë se variabla e varur ka korrelacion të fort me variablat shpjeguese në nivel prej .942, respektivisht 94.2 për qind. Ndërsa R^2 në analizën tonë është .888, i cili tregon se 88.8% e variablës së varur shpjegohet nga variablat e pavarura. R^2 i rregulluar është i barabartë me .885, e që tregon se 88.5 për qind e variacionit të variablës së varur shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarura. Në analizën tonë për verifikimin e qëndrueshmërisë së modelit është përdorur korrelacioni serial. Vlera e korrelacionit të Durbin-Watson mund të jetë në interval prej 0 deri në 4. Nëse vlera e Durbin-Watson është e përafërt me zero, atëherë korrelacioni serial tregon se të dhënat në model kanë ndikim të lart pozitiv ndërmjet vlerës reziduale. Nëse korrelacioni Durbin-Watson i ofrohet vlerës katër (4), tregon se të dhënat kanë korrelacion negativ serial. Modeli mund të konsiderohet i qëndrueshëm kur rezultatet e Durbin-Watson janë afër intervalit të vlerës dy (2). Testi Durbin-Watson konsiderohet se nuk ka korrelacion serial në kuadër të intervalit prej 1.5 deri në 2.5, e që na tregon se vlera reziduale nuk ka korrelacion serial ose aty nuk ekziston auto korrelacion ndërmjet vlerës reziduale. Prandaj, bazuar në këtë interval, gjetjet në studimin tonë tregojnë se Durbin-Watson është në vlerë prej 1.990, e që është brenda vlerës së intervalit, e që nga kjo rrjedh se modeli është i qëndrueshëm.

Figura 27. ANOVA

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	7248331.955	1	7248331.955	269.168	.000 ^b
	Residual	915575.017	34	26928.677		
	Total	8163906.972	35			
a. Dependent Variable: NPR						
b. Predictors: (Constant), NP						

Burimi: Output i SPSS v.20

F-testi është i barabartë me .000 tregon se të gjitha koeficientet së bashku janë statistikisht signifikat dhe të ndryshëm prej zeros.

Figura 28. Përmbledhja e regresionit

Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	845.957	62.586		13.517	.000
	NP	21.017	1.281	.942	16.406	.000
a. Dependent Variable: NPR						

Burimi: Output i SPSS v.20

Rezultatet e modelit tregojnë se variabla numri i punëtorëve të mini parkut ka ndikim në të numrin e të punësuarve në komunën e Rahovecit, ngase niveli i signifikancës është .000 apo në shkallën 1%, që mbështet pohimet tona

$$NPR_t = 845.957 + \beta_1 21.017 + \varepsilon$$

Analiza statistikore përmes aplikimit të modelit OLS- katëroreve me te vegjël, e vërteton një pjesë të hipotezës së ngritur që: aplikimi i mekanizmave/politikave në mbështetje të sektorit privat në rastin konkret shfrytëzimi i “Mini parkut të Biznesit “ ka ndikuar në rritjen e të ardhurave vetanake te komunës si dhe ndikimin korrelativ në numrin e përgjithshëm të punësuarve në komunën e Rahovecit.

*Sqarim: “Mini parku i biznesit/industrial”, është një hapësirë - lokacion me një sipërfaqe prej 36452 m² e kompletuar me infrastruktura publike (ujë, kanalizim, rrjetin elektrik me qasje në rrugën regjionale Xërxe-Rahovec-Malishevë-Prishtinë si dhe në vijën hekurudhore, Fushë Kosovë-Xërxe-Prizren). Nga sipërfaqja e përgjithshme 8000 m²

është hapësirë e mbuluar me objekte (depo). Kjo hapësirë kështu është trashëguar nga ish shteti Jugosllav i cili e ka shfrytëzuar si depo për rezerva federative. Komuna e Rahovecit me qëllim që kjo hapësirë të mos mbetet e pa mbikëqyrur e ka marrë në mbikëqyrje dhe të njëjtën ju ka ofruar bizneseve për zhvillimi të aktiviteteve biznesore.

“Mini Parku i Biznesit/Industrial”, në aspektin legal nuk e gëzon statusin e Parkut Industrial meqë Komuna nuk ka aplikuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për një gjë të tillë edhe pse nga viti 2009, është aprovuar ligji nr. 04/L-149 për zonat ekonomike. Po sipas këtij ligji ky lokacion i plotëson kriteret që i parasheh ligji për zonat ekonomike-Park industrial.

KAPITULLI VIII

8. Mënyra (Modeli) i organizimit të pushtetit lokal për ZHRL-in

8.1. Mënyrat (Modelet) e organizimit të ZHEL-it nëpër vende të ndryshme

Problemet zhvillimore janë brenga kryesore e qeverive të vendeve të ndryshme, proceset e globalizimit, shkalla e lartë e mobilitetit të njeriut, kapitalit, dijës, informatës etj. Kanë bërë që me këtë problem të merren sa më shumë partnerë si në nivelin global, rajonal, nacional dhe atë lokal. Mënyrat apo modelet e organizimit të kësaj fushe kanë pësuar ndryshime dhe modifikime të mëdha në veçanti në gjysmën e dytë të shekullit njëzet dhe në fillim shekullin njëzet e një. Për të qenë sa më të suksesshëm në zhvillimin e lokaliteteve dhe komuniteteve të tyre, shtetet e ndryshme kanë ndërtuar modele të ndryshme nëpër njësit e vetëqeverisjes lokale për të bërë sa më të lehtë hapjen dhe zhvillimin e bizneseve të reja, tërheqjen e investimeve nga jashtë, shfrytëzimin me efikasitet të burimeve natyrore, hapjen e vendeve të reja të punës etj.

Për ta pasur një pasqyrë më të plotë, mbi rendësin e mënyrës së organizimit të ZHEL-it, nëpër vende të ndryshme, ne do të elaborojmë, modelet e aplikuara nëpër disa vende të cilat do të mund të shërbenin si shembull i mirë edhe për Kosovën dhe komunën e Rahovecit.

Modeli Irlandez;

Irlanda ka të ndërtuar një model të organizimit në nivelin lokal, për të mbështetur hapjen e bizneseve të reja, zgjerimin dhe fuqizimin e atyre ekzistuese, tërheqjen e investimeve nga jashtë, promovimin e bizneseve, trajnimin dhe format të tjera të mbështetjes. Me qëllim të fuqizimit të rolit të qeverive lokale në fushën e zhvillimit ekonomik, qeveria e Irlandës ka bërë ndryshimin e Aktit të qeverisjes lokale në vitin 2014.

Reformë Aktit të Qeverisjes Vendore 2014 parashikon një rol më të fortë dhe më të qartë për qeverisjen vendore në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e komunitetit, i cili është një element kyç në arritjen e vizionit të përcaktuar në Programin e Veprimit për Qeverisje Lokale Efektive: "se qeveria lokale do të jetë mjeti kryesor i qeverisjes dhe shërbimit publik në nivel lokal, duke çuar drejt zhvillimit ekonomik, social dhe komunitar ", (MELG-CDDE, 2015, 2). Mekanizmi për implementimin e kësaj politike në nivelin lokal janë të ashtuquajturat Zyrrat lokale të ndërmarrjeve (LEO), të cilat janë të ngritura nëpër autoritetet e qeverisjes lokal dhe kanë një gamë të gjerë të përgjegjësisve në fushën e

zhvillimit ekonomik, njëkohësisht zyrat kanë në dispozicion edhe mekanizmat e nevojshme për operim.

Zyrat e Ndërmarrjeve Vendore (LEOs) - janë një instrument bazë i mbështetjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve vendore për NVM-të dhe mikro-ndërmarrjet me fokus në ofrimin e mbështetjes financiare, mentorimit, mbështetjes në rrjet, këshilla për biznesin dhe sipërmarrjen, trajnimin dhe informimin e biznesit dhe këshilla për autoritetet lokale, mbështetjet ose aktivitetet që ndikojnë në ndërmarrje duke përfshirë, normat, prokurimin ose planifikimin, (MELG-CDDE, 2015, 12).

Sipas vlerësimit të zyrtarëve të qeverisë së Irlandës, fuqizimi i rrjetit të ZNL (LEO) ka sjellë përfitime për komunitetin lokal dhe për vendin në tërësi.

"Qeveria dëshiron të bëjë rimëkëmbjen lokale, që do të thotë të mbështesim bizneset lokale dhe sipërmarrësit për të krijuar vende pune, do ta bëjmë përmes rrjetit të ri të LEO-ve. Punësimet janë prioritet i lartë i Qeverisë dhe ka pasur progres gjatë vitit të kaluar, me krijimin e më shumë se 1000 vendeve të punës gjatë javës në sektorin privat. Shumica dërmuese e këtyre vendeve të punës janë krijuar në kompani të vogla lokale. Janë këto kompani të reja, duke punësuar vetëm disa njerëz që bëjnë dallimin më të madh në ngasjen e një rimëkëmbjeje të vendeve të punës. LEO do të jenë në vijën e frontit për të bërë rimëkëmbjen lokale. "marrë nga <https://www.enterprise-ireland.com> (me datë 20.06.2016). Qeveria e Irlandës viteve të fundit ka ndërmarrë veprime konkrete në fuqizimin e këtyre zyrave, përmes ndarjes së një shume më të madhe të fondeve për ZNL/LEO, si dhe përmes përforsimit me kuadra/staf nëpër këto zyre.

Komiteti për Politika Strategjike SPC - Për të fuqizuar rolin e qeverive lokale në zhvillimin ekonomik dhe të ndërmarrjeve autoriteteve lokale, u rekomandohet edhe formimi i Komitetit për Politika Strategjike (SPC). Ligji kërkon krijimin e Komiteteve të Politikave Strategjike (SPC) për Zhvillim Ekonomik dhe Ndërmarrje do të marrë një rol udhëheqës në përgatitjen dhe zhvillimin e elementeve ekonomike zhvillimit të projekteve ekonomike lokale dhe të komunitetit- LECP, (MELG-CDDE, 2015, 16).

Modeli i organizimit në Serbi

Zhvillimet që kanë ndodhë me proceset e ndryshme shoqërore, pas fazës së tranzicionit në vendet e ndryshme dhe vetë procesi i globalizimit, ka nxitur nevojën për një angazhim të pushtetit lokal në fushën e ZHEL-it. Autorët Brklič dhe Hrnjez, përmes hulumtimit të formave më të mira organizimit të pushtetit lokal në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

kanë ndërtuar një model të organizimit i cili është burim i veprimit praktik në komuna dhe pasurimit i teorik në shpjegimet e procesit.

Kështu modeli i ofruar nga ky udhëzues përcakton formën mjaft precize, organizimin, funksionimin dhe aktivitetet e njësisë për zhvillimin ekonomik lokal që ata e quajnë “Zyra për zhvillim ekonomik lokal- ZHEL). Kjo zyrë duhet të jetë pjesë e administratës komunale, mundë të jetë pjesë e drejtorisë për ekonomi dhe financa ato mundë të jenë si njësi e veçantë në kuadër të skemës organizative, duke analizuar përparësitë dhe pasojat e secilës nga format e organizimit autorët rekomandojnë: Pra, një nga gjërat kryesore që duhet marrë parasysh është se si Zyra për ZHEL të sigurojë një vend në strukturën organizative të administratës, e cila është minimalisht e ndjeshme ndaj ndikimit politik dhe ndryshimet e qeverisë, se si qëndrueshmëria e saj dhe vazhdimësia e punës nuk do të vinin në pyetje, për shkak të punëve të rëndësishë që kryen për komunitetin lokal. Prandaj, ka disa arsye pse ne besojmë se është e leverdishme për të krijuar një Zyrë për ZHEL me vendim të këshillit komunal / të qytetit si një sektor i veçantë në kuadër të drejtorisë/ shërbimit ekzistues të administratës, më së miri Departamenti i Ekonomisë apo të ngjashme, (Belkić&Hrnjaz, 2010, 52).

Udhëzimi i tyre kanë bërë edhe përshkrimin e punëve dhe përgjegjësiave që Zyra për ZHEL, që duhet t’i ushtrojë, në procesin e zhvillimit si në kuadër të administratës komunale ashtu edhe me partnerët e tjerë, në veçanti me sektorin e biznesit.

Lista e mëposhtme e aktiviteteve duhet të jetë ajo që përmban minimumin e aktiviteteve të fushës të cilës do prej Zyrave për ZHEL, si më poshtë:

Pjesëmarrja në planifikimet strategjike të ZHEL-it,

Planifikimin e projektit të ZHEL-it,

Mbajtja e investimeve ekzistuese dhe tërheqja investimeve të reja,

Mbështetje ekonomisë lokale dhe sipërmarrësve,

Promovimin e vetëqeverisjes lokale,

Përmirësimin e komunikimit me organet që kanë të bëjnë me ZHEL-in në nivele më të larta të qeverisë, (Belkić&Hrnjaz, 2010, 60).

Në se cilën prej 6 aktiviteteve kryesore të cekura janë të specifikuara edhe shumë nën aktivitete që zyra duhet të kryej nëpër komuna. Përpos rekomandimeve për pozitën e zyrës për ZHEL në kuadër të administratës komune dhe përcaktimit të aktiviteteve që duhet të i ushtrojë kjo zyrë, autorët kanë specifikuar edhe resurset materiale dhe njerëzore,

të nevojshme për funksionim normal dhe të suksesshëm të zyrës. Duke analizuar mundësit dhe madhësinë e komunave, udhëzuesi rekomandon këto resurse njerëzore për zyrat e ZHEL-it. Duke pasur parasysh shtrirjen e propozuar dhe strukturën e punëve që Zyra për ZHEL duhet të ketë bërë, numri më i vogël i punonjësve të saj duhet të jenë tre zyrtarë. Nga ana tjetër, numri optimal i stafit në Zyrën për ZHEL duhet të jetë pesë zyrtarë, ((Belkić&Hrnjaz, 2010, 62).

Udhëzimi, ofron një përshkrim mjaftë të detajuar për, organizimin, strukturën profesionale, detyrat dhe përgjegjësit e zyrës dhe të pushtetit lokal në përgjithësi.

Modeli i organizimit në Kroaci dhe disa vende të Evropës juglindore

Kroacia është njëri ndër vendet e Ballkanit perëndimor, i cili në fushën e zhvillimit ekonomik lokal ka një avancim të dukshëm në veçanti në aplikimin e instrumentit të zhvillimit, partneritetin publiko privat-PPP. Edhe në ndërtimin e strukturës së përshtatshme për aplikim me sukses të konceptit të ZHEL-it, ky vend është në rrugë të mirë për të arritur sukses.

Kështu qendra për zhvillim ekonomik lokal, pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Rjekës, ka publikuar doracakun i cili është punuar për nevojat e Business Friendly Certificate South East Europe – BFC dhe qeverisjen lokale, për certifikimin e komunave dhe qyteteve me mjedis më të favorshme për zhvillim e bizneseve të Evropës Jug-lindore-SEE. Projekti është mbuluar nga USAID-i dhe ka arritur një reputacion të madh. Doracaku, ndër të tjera, përcakton kriteret që duhen të plotësohen nga qeveritë lokale për të arritur certifikimin.

Sipas këtij doracaku, njësia organizative përgjegjëse për zhvillimin ekonomik lokal është zyra për zhvillim ekonomik lokal-ZZHEL (KLER): Qyteti/Komuna ka të themeluar zyrën për zhvillim ekonomik lokal (KLER).

ZZHEL, aktivisht merr pjesë në hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik. Përgatitë dhe mbikëqyrë implementimin e projekteve zhvillimorë. Mban kontakte dhe ofron mbështetje komunitetit lokal të biznesit. Udhëheq me anketimet e sektorit afarist/hulumtimin e qëndrimeve të komunitetit të biznesit në vitin e fundit. Është e kyçur në komunikim me investitorët potencial (të jashtëm dhe vendor). Merret me përgatitjen e materialëve promovuese, (broshurave, udhëzuesve për investitor, prezantimet etj.). Posedon, mirëmban dhe shfrytëzon bazën vetanake të dhënave. Aktivisht bashkëpunon me institucionet e nivelit hierarkik më të lartë, (CLER, 2014, 8).

Përpos ZZHEL-it e cila do të duhej të ishte e themeluar dhe funksionale, sipas parimeve të zhvillimit ekonomik lokal. Doracaku i përgatitur nga qendra për zhvillim ekonomik lokal e Fakultetit ekonomik të Universitetit të Riekës, për certifikim ka kërkuar që komunat të kenë të formuar edhe Këshillin e përhershëm ekonomik, si organ këshillëdhënës.

Këshilli i përhershëm ekonomik, jep këshilla udhëheqjes së komunës/qytetit lidhur me çështjet dhe problemet e komunitetit të biznesit. Së paku 30% e anëtarëve të këshillit ekonomik përfaqësojnë komunitetin e biznesit. Sugjerimet e këshillit ekonomik merren parasysh me rastin e marrjes së vendimeve relevante në nivelin lokal. Mbledhje e këshillit mbahen më së paku njëherë në tre muaj, (BFC, CLER, 2014, 11).

Zyra për zhvillim ekonomik lokal, është njësia organizative e cila ushtron aktivitetet të cilat janë në interes të zhvillimit të bizneseve ekzistuese dhe në tërheqjen e investimeve të reja, si nga investitorët lokal ashtu edhe ata të jashtëm.

8.2. Mënyra aktuale e organizimit në Kosovë/Rahovec

Komunat e Kosovës me ligjin bazë të vetëqeverisjes lokale e kanë përgjegjësinë për procesin e zhvillimit ekonomik lokal dhe sektorëve të tjerë që janë të lidhur direkt me zhvillimin ekonomik. Mënyra e organizimit të këtij sektori në komuna nuk është e precizua me ligjet bazike po e njëjta gjë ju është lënë në kompetence komunave. Komunat kanë të organizuar në strukturën e tyre organizative, zhvillimin ekonomik lokal në forma të ndryshme, kryesisht kjo detyrë u është lënë drejtorive për zhvillim ekonomik, për ekonomi e financa dhe në disa raste është ndarë në disa drejtori.

Ashtu siç është elaboruar më lartë në kapitullin për Rahovecin edhe kjo komunë e ka të organizuar drejtorin për zhvillim ekonomik dhe turizëm si bartëse e kësaj fushe, për me tepër mund të shihet në faqen zyrtare të MAPL-së në linkun komunat e Kosovës. Nga një hulumtim i bërë kësaj fushe nëpër komunat e Kosovës, vërehet një laramani organizative, ku disa nga komunat kanë një strukturë më të organizuar, siç janë p.sh. Komuna e Gjilanit, Prishtinës, Suhareka etj. Nëse e vlerësojmë strukturën aktuale organizative të komunave dhe i nxjerrim përparësitë dhe mangësitë e kësaj strukture, atëherë mund të konkludojmë se:

Përparësitë: Legjislacioni bazë i vetëqeverisjes lokale, krijon mundësi për organizim të mirëfilltë të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, neni 17 i ligjit për

vetëqeverisje lokale, i cili përcakton kompetencat vetanake, në paragrafin e parë, përshkruan zhvillimin ekonomik lokal, si përgjegjësi burimore. Janë të krijuara struktura përgjegjëse për zhvillim ekonomik. Ka një përvojë të mjaftueshme në këtë fushë e marrë nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe nga përvoja vetanake etj.

Mangësitë: Struktura organizative përgjegjëse për ZHEL-in e shpërndarë në disa drejtori. Personeli i angazhuar në strukturë me mungesë të ekspertizës së nevojshme. Mungesa e bazës së të dhënave të nevojshme për bizneset dhe ambientin e të bërit biznes. Koordinimi i pa mjaftueshëm brenda strukturës dhe me partnerët e tjerë në nivelet e ndryshme etj. Për më tepër mangësitë e strukturës aktuale edhe nevojën për një fuqizim të këtij sektori është kërkuar edhe në dokumentet strategjike të Qeverisë së Kosovës “Strategjia për qeverisje lokale 2016-2026” dhe në “Strategjinë e bashkëpunimit për zhvillimin e vendit 2014-2018” e punuar nga USAID-i.

8.3. Modeli i organizimit të strukturës komunale i propozuar për të ardhmen

Nevoja për një zhvillim ekonomik më dinamik, punësim më të madh në veçanti për gjeneratat e reja, për investime më të mëdha nga jashtë dhe brenda. Objektivat strategjike 10 vjeçare të vetëqeverisjes lokale të vendosura në strategjinë e qeverisë, në të cilën objektivi parë është “Rrita e qëndrueshme ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar politika zhvillimore dhe financiare që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal”, (MAPL, 2016, 27).

Shtrojnë nevojën për të ndërtuar një model më të përshtatshëm, më kompetencë profesionale, me resurse të mjaftueshme materiale dhe njerëzore në komuna, për më tepër kjo kërkesë fuqizohet kur vlerësohet se aktualisht komunat nuk kanë model adekuat të organizimit.

Kosova ka një bazë ligjore e cila ja mundëson krijimin e një modeli, i cili do të ishte në përputhje me kërkesat që dalin nga komuniteti i biznesit, komuniteti lokal për një qasje më të mirë në trendin aktual zhvillimor. Nga analiza e modeleve të ndryshme nëpër vendet e caktuara me disa modifikime, propozojmë këtë model të organizimit të pushtetit lokal: Sektorin/Zyrën për zhvillim ekonomik lokal dhe Këshillin konsultativ për zhvillim ekonomik lokal.

Zyra/Spektori për zhvillim ekonomik lokal - Komuna duhet ta formojë një zyrë për zhvillim ekonomik lokal. Vendi se ku do të vendoset zyra është çështje e strukturës

organizative (organogramit) të komunës, propozojmë në kuadër të Drejtorisë për zhvillim ekonomik aty ku ekziston apo në atë për ekonomi dhe financa. Nuk e preferojë të jetë drejtori për shkak të ndikimit që do të kishte në punën e saj ndryshimet e shpeshta në stafin politik.

Zyra duhet të ketë lidhje vertikale me Drejtorin e drejtorisë, Kryetarin dhe lidhje horizontale koordinuese me drejtoritë dhe sektorët e tjerë në kuadër të administratës komunale. Pas vendosjes së zyrë/sektorit në kuadrin e strukturës organizative të komunës, duhet të përcaktohen përgjegjësitë dhe funksionet e zyrës/sektorit për zhvillim ekonomik lokal-SZHEL.

Përgjegjësitë dhe funksionet e SZHEL:

Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave;

Baza e të dhënave për ndërmarrjet lokale;

Bazën e të dhënave lidhur me investitorët e brendshëm dhe të jashtëm;

Bazën e të dhënave për pronën komunale të lirë e cila mund të shfrytëzohet për nevojat e biznesit;

Bazën e të dhënave lidhur me resurset njerëzore dhe profesionale në dispozicion;

Mban kontakte të rregullta me partnerët e tjerë të zhvillimit ekonomik në nivelin qendror dhe regional;

Mban kontakte me Ministrinë përgjegjëse për zhvillim ekonomik;

Mban kontakte me Agjencinë e statistikave të Kosovës, dhe agjencitë e tjera përgjegjëse për zhvillimi ekonomik, odat ekonomike etj.;

Mban kontakte me agjensionet e ndryshme zhvillimore në nivel të regjionit dhe bashkëpunon me Komunitat fqinje;

Mbështet dhe koordinon proceset e planifikimit strategjik në komunë;

Merë pjesë në grupet punuese për përgatitjen e strategjive zhvillimore;

Mbikëqyrë realizimin e projekteve të cilat dalin nga Strategjia për zhvillimi ekonomik lokal;

Koordinon aktivitetet ndërmjet drejtorive dhe sektorëve në përgatitjen dhe implementimin e projekteve zhvillimore;

Nxistë shfrytëzimin e burimeve financiare;

Vendosë kontakte me bankat, me qëllim të shfrytëzimit të informatave për tregun financiar;

Identifikon pakot më të përshtatshme financiare dhe të njëjtat ju propozon bizneseve me të cilat bashkëpunon;

Përgatit propozimin për krijimin e skemave garantuese mikro-financiare lokale;

Mbështet bizneset lokale në punën e tyre;

Ofron mbështetje teknike dhe ligjore bizneseve lokale për tejkalimin dhe adresimin e problemeve;

Informon me kohë për të gjitha aspektet e rëndësishme për punë e bizneseve (ndryshimet që ndodhin në ligjet dhe rregullat, shpalljet për financimet nga donacionet, mban trajnime për përgatitjen e biznes planeve dhe përgatitjen e dokumentacionit për tërheqjen kredive fillestare start-up etj);

Dizajnon programe për mbështetje të bizneseve lokale (mjete pa kthim, subvencionimi i normës së interesit, start-up kredi, etj);

Përgatitë programe për ngritjen profesionale të punëkërkesve, sipas kërkesës së komunitetit të biznesit lokal;

Promovon ekonomin lokale;

Përgatitë materiale promovuese për potencialet ekonomike të komunës (broshura, udhëzues për investitorët potencial, pako promovuese etj), dhe bënë shpërndarjen;

Përgatit buletin e komunës (së paku dy herë në vit), në disa gjuhën shqipe, angleze dhe gjermane;

Vendos kontakte me agjencitë promovuese dhe ambasadat e vendeve të ndryshme;

Mbështet organizimin e evenimenteve promovuese në nivelin lokale;

Përgatitë pjesëmarrjen nëpër panairot të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për kryerjen e këtyre aktiviteteve të përshkruara më lartë, do të duhej që të parashihen edhe resurset e nevojshme njerëzore dhe teknike me të cilat duhet të disponoj zyra/sektori për zhvillim ekonomik lokal. Zyra do të duhej të ketë kapacitetet njerëzore dhe teknike në përputhje me mundësit që kanë komunat e të cilat janë të kushtëzuar nga buxheti, kapacitetet njerëzore, resurset materiale etj.

Personel të nevojshëm për funksionim të zyrës/sektorit për zhvillim ekonomik lokal:

Komunat të ashtë quajtura të mëdha me mbi 90 mijë banor, më buxhet mbi 15 mil. euro të kenë të angazhuar 5 zyrtarë;

Komunat e mesme me mbi 50 mijë banorë, me buxhet mbi 10 mil. euro të kenë të angazhuar 3 zyrtarë;

Komunat e vogla me mbi 20 mijë banorë, me buxhet mbi 5 mil. euro të kenë të angazhuar 2 zyrtarë; dhe mini komunat ose me më pak se 20 mijë banorë, të kenë të angazhuar 1 zyrtarë;

Zyrtarët e angazhuar në sektorin për zhvillim ekonomik lokal duhet të kenë kapacitete të larta profesionale, të jenë Master të shkencave të ekonomisë, shkencave teknike dhe marketingut, të kenë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe me rëndësi, njohuri të shkëlqyeshme të punës me programe kompjuterike etj. Rekrutimi i stafit të bëhet nga një panel profesional, aty ku ka mundësi të rekrutohet nga stafi ekzistues, normalisht nëse i plotëson kriteret e përcaktuara paraprakisht ndërsa aty ky nuk ka mundësi të bëhet përmes konkursit publik me kriterë rigoroze.

Këshilli konsultativ për zhvillimi ekonomik lokal:

Komuna ta themeloj Këshillin konsultativ për zhvillim ekonomik, ky këshill do të kishte 15 anëtarë nga përfaqësues të tre sektorëve, sektorit publik, sektorit privat dhe sektorit civilë. Këshilli do të kryesohej nga Kryetari i komunës apo i deleguari i tij dhe të ketë së paku 30% anëtarëve nga komuniteti i biznesit. Vendimet e këshillit do të kishin karakter të sugjerimeve për Kryetarin dhe qeverinë komunale.

Funksionet e këshillit do të ishin si në vijim:

Përcjelljen e të gjitha çështjeve që janë me interes për zhvillimin ekonomik lokal dhe i propozon administratës komunale aktivitetet për përmirësim të ambientit biznesor;

Përcjell dhe vlerëson implementimin e projekteve dhe të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal;

Përcjell të gjitha çështjet që janë në interes për ekonominë dhe zhvillimit ekonomik lokal dhe propozon aktivitete të autoriteteve lokale dhe përmirësimin procedurave;

Monitoron dhe vlerëson zbatimin e projekteve dhe strategjive për zhvillim ekonomik lokal;

Kryen auditimin e dokumenteve strategjike dhe zbatimin e planeve;

Ofron ndihmë teknike kryetarit të komunës në rastin e vendimmarrjes në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe programet e zhvillimit;

Ofron mbështetje për Zyrën/Sektorin për Zhvillim Ekonomik Lokal;

Modeli i propozuar nuk pretendoj se është i përkryer dhe i njëjti sigurisht që do të pasurohet edhe me shumë elemente që praktika e aplikimit në komuna do të tregoj se duhet të shtohen dhe ndonjëri nga këto aktivitete edhe të përmirësohet. Ky model është

produkt i hulumtimit të përvojave të vendeve të cilat kanë situata të ngjashme me atë të Kosovës, siç janë vendet e regjionit dhe vendeve që tanimë kanë një nivel të lartë të zhvillimit siç është Irlanda.

KAPITULLI IX

9. Përfundimet dhe Rekomandimet

9.1. Përfundimet

Meqë qëllimi i këtij hulumtimi është që të shqyrtojë kornizën funksionimit të pushtetit lokal në fushën e zhvillimit ekonomik lokal në Kosovë, me theks të veçantë në komunën e Rahovecit, mënyrën e bashkëpunimit të partnerëve lokal dhe efektin e veprimit, është e nevojshme për të ardhur në përfundim lidhur me hipotezat e ngritura.

Analiza e bërë zhvillimit të kornizës ligjore, vlerësimet e marra nga intervistat e zyrtareve komunal dhe vlerësimet e strategjisë së qeverisë së Kosovës, mund të konstatojmë se:

Hipoteza kryesore vërtetohet, “Korniza e përshtatshme ligjore dhe institucionale krijon mundësi për zhvillim ekonomik lokal, përmes mbështetjes së bizneseve në hapjen e vendeve të punës dhe në rritjen e të hyrave lokale”.

Hipoteza 1, ndihmesë vërtetohet përmes, analiza statistikore të efektit që “Mini Parkut i Biznesit” ka në rritjen e punësimit dhe të ardhura lokale.

Hipoteza 2, ndihmëse vërtetohet pjesërisht në veprimin e përbashkët të partnerëve lokal në organizimin e “HARDHFEST-it”.

Sa i përket kornizës ligjore, qëndrimi i zyrtarëve komunalë dhe komunitetit lokal (sektorit privat dhe atij civil) është i ndryshëm.

Zyrtarët komunalë kanë potencuar nevojën për ndryshim të: “Ligjit mbi dhënie në shfrytëzim pronën komunale dhe ligjit për menaxhimin e pyjeve”. Si pasojë e ligjit mbi menaxhimin e pyjeve, komuna e Rahovecit ka dështuar ta ndërtojë “Zonën për zhvillim të agro-biznesit me komunën e Therandës”, përgjatë viteve 2015-2016. Kështu kanë deklaruar drejtorët e zhvillimit ekonomik dhe ai për financa dhe buxhet. Lidhur me legjislacionin mbi qeverisjen lokale, edhe strategjia e qeverisë së Kosovës parasheh përmirësimin dhe përshtatjen e këtij legjislacioni, me kriteret e BE-së për vetëqeverisjen lokale, duke potencuar edhe çështjet konkrete siç është: mundësia e marrjes së kredive dhe lehtësime për bizneset nga taksat lokale (Strategjia, 2016-2026, 2016), etj.

Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale - Është e rëndësishme së veçantë për të mundësuar veprimin e pushtetit lokal në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Nga hulumtimi i bërë mund të konstatohet se: Kosova ka një kornizë ligjore bazë të mirë dhe të përshtatshme, por ka në nevojë për plotësim në disa fusha të cilat do t'i mundësonin komunës që të ketë më shumë mundësi në mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat.

Rëndësia e kornizës ligjore është si faktorë me rëndësi në veprimin e pushtetit lokal është konstatuar nga: studiuesit e shumtë të fushës, nga zyrtarët komunal të përfshirë në anketim dhe nga rastet konkrete të hulumtuara.

Shfrytëzimi i instrumenteve/mekanizmave të pushtetit lokal në nxitjen e ZHEL-it; Aplikimi i mekanizmave të pushtetit lokal për nxitjen dhe mbështetjen e sektorit privat, ndikon në hapjen e vendeve të punës, hapjen e bizneseve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese dhe krijon të ardhura për komunën. Kjo vërtetohet pjesërisht nga studimet e shumta dhe në rastin konkret nga hulumtimi në rastin e “Mini Parkut të Biznesit” dhe “Hardhfest” në Rahovecit.

Komunat kanë një numër të instrumenteve që shfrytëzojnë në nxitjen e sektorit privat hulumtimi tregon se: Përpos investimeve kapitale mekanizmat e tjerë nuk janë shfrytëzuar sa duhet nga komunat në Kosovë përfshirë edhe komunën e Rahovecit.

Komuna e Rahovecit nuk ka ndërtuar zona industriale, inkubator të biznesit dhe mungon edhe mbështetja përmes të ashtuquajturës infrastrukturë e butë dhe format e tjera të mbështetjes.

Veprimi i përbashkët/koordinuar i partnerëve lokal (sektorit publik, privat dhe civil) - Është i rëndësishëm në raste të hartimit të strategjive zhvillimore, të promovimit të produkteve dhe bizneseve lokale dhe në mbështetje të shoqërisë përmes socializmit të grupeve të veçanta shoqërore. Kjo është konstatuar përmes hulumtimit të bërë në rastin e Rahovecit.

Organizimi i festivalit të rrushit “Hardhfest”, i cili është i organizuar nën patronatin e Komunës, MBPZHR, disa nga bizneset prodhuese dhe OJQ. “Enologjia”, dhe OJQ. “Vreshtari”, jep dëshmi se ky veprim i përbashkët ka rezultuar me afirmimin e festivalit të rrushit përmes rritjes së pjesëmarrësve nga viti në vit.

Qendra rinore SHL. “Kosova” dhe OJQ. “Hareja”, janë dy organizata të shoqërisë civile të cilat rreth veti grumbullojnë grup moshat e reja dhe femrat, këto dy OJQ, pos të tjerave organizojnë kurse dhe trajnime për këto grupe shoqërore për të qenë të afta për tregun e punës, kështu që ndihmojnë sektorin privat dhe atë publik.

Komuna dhe partnerët e tjerë lokal nuk kanë ndonjë veprim të përbashkët të organizuar në fushën e ZHEL-it, veprimet e përbashkëta janë të herë pas hershme dhe jo të institucionalizuara.

Kapacitetet organizative dhe profesionale të komunës për aplikim të konceptit të ZHEL-it - Është faktorë i domosdoshëm për zbatimin me sukses të konceptit të ZHEL-it. Hulumtimet e bëra në përvojat e vendeve të ndryshme dhe vlerësimet e zyrtarëve të intervistuar vërtetojnë se modeli i mirë organizuar dhe stafi me kompetencë profesionale janë të rëndësishë së veçantë në krijimin, koordinimin dhe implementimin e politikave zhvillimore.

Komuna ka një strukturë të organizuar për zhvillim ekonomik lokal e cila është e ndarë në tri drejtori komunale, me një staf jo mjaftë profesional për tu përballë me nevojat që dalin para komunës, në interes të zhvillimit ekonomik lokal. Komunës i mungojnë statistikat për ekonominë lokale, kapacitetet për hartimin dhe implementimin e planeve strategjike zhvillimore.

Hulumtimi i rasteve nëpër vende të ndryshme dhe vlerësimi i zyrtarëve komunalë lidhur me kapacitetet profesionale dhe organizative, dëshmojnë se komuna ka nevojë për një ristrukturim organizativ dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale, për të qenë më kompetente në përballje me kërkesat e sektorit privat. Komuna ka nevojë për një model/formë të organizimit dhe funksionimit të ZHEL-it, e cila siguron mundësi më të mëdha për ekonominë lokale.

Ekonomia e Rahovecit – I zhvilluar kryesisht është sektori i bujqësisë, në veçanti vreshtaria dhe perimekultura, në një masë është e zhvilluar edhe industria përpunuese me bazë të lëndës nga bujqësia por edhe disa industri të specializuara, të cilat prodhimet e tyre i shesin edhe në tregun e jashtëm. Sektorët e tjerë ekonomikë janë po ashtu të rëndësishëm në ekonominë lokale duke marrë pjesë në krijimin e të ardhurave dhe punësimin për banorët lokal. Edhe në ekonominë e Rahovecit dominojnë bizneset e vogla dhe mikro, ndërsa bizneset e mëdha janë një numër simbolik. Bizneset e mëdha dhe ato të mesme përballën kryesisht me problemet që shkaktohen nga tregu, si konkurrenca jo luajalë, politikat fiskale jo favorizuese, normat e larta interesit etj. Ndërsa bizneset e vogla dhe mikro-bizneset, pos problemeve me normat e larta të interesit, përballën edhe me probleme të hapësirave për zhvillim dhe zgjerim të veprimtarisë, në tre bizneset e përfshira në hulumtim njëra ndër brengat e paraqitura ishte edhe mungesa e hapësirës për

zhvillim dhe zgjerim të veprimtarisë. Problem në vete është edhe mungesa e kuadrit profesional, këtë më së shumti e ndiejnë bizneset që merren me prodhim, njëherit mungojnë edhe kuadri profesional për të aplikuar për fonde të ndryshme që ndahen nga BE-ja etj.

Shoqëria civile dhe komuniteti; Shoqëria civile si një faktor i rëndësishëm i shoqërisë ka një organizim dhe funksionim të mirë në komunën e Rahovecit. Sipas një informate të marrë nga DKRS, në territorin e komunës së Rahovecit operojnë 23 shoqata të ndryshme, përfshirë OJQ, shoqëri kulturore artistike, klube sportive etj. Por në këtë regjistër nuk janë edhe shoqatat profesionale të cilat përfaqësojnë interesat e grupeve të veçanta shoqërore në veçanti të bizneseve të ndryshme. Nga hulumtimi i bërë në këtë sektor të shoqërisë është vërejtur si disa nga shoqatat janë mjaftë aktive në veçanti shoqata “Hareja” e cila përfaqëson interesat e grave dhe qendra rinore SHL.”Kosova” e cila grumbullon të rinjtë nga mosha 15-25 vjeçare, janë ndër shoqatat më aktive në nivel të komunës dhe më gjerë. Këto dy organizata vazhdojnë të japin një kontribut të jashtëzakonshëm në mbështetjen e grupeve shoqërore si në trajtimin e problemeve të tyre ashtu edhe në ngritjen vetëdijes si dhe organizimin e kurseve të ndryshme profesionale. Edhe shoqatat të cilat përfaqësojnë interesat e bizneseve lokale kanë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e interesave të sektorëve të veçantë të ekonomisë lokale, si shoqata e verëtarëve “Enologjia”, shoqata e vreshtarëve, pastaj shoqata e zejtarëve dhe tregtarëve të vegjël, kanë një rolë të rëndësishëm në jetën shoqërore ekonomike të komunës.

Nga hulumtimi i bërë këtij sektori, sektorit publik dhe atij privatë, është vërejtur se bashkëpunimi ndërmjet sektorëve nuk është në nivelin e duhur, në veçanti mendoj se nuk mbështet sa duhet sektori civil i cili përmes punës që bënë me grupe të caktuara shoqërore (rininë, gratë e marginalizuara, personat me nevoja të veçanta, bizneset etj.), ndihmon mjaftë në zhvillim të komunitetit lokal. Këto shoqata do të duhej të ishin partnerët të fuqishëm në krijimin e politikave zhvillimore, në krijimin e strategjive sektoriale si dhe në implementimin e dokumenteve zhvillimore me rëndësi për komunitetin lokal. Një nga karakteristikat kryesore të procesit të hartimit të strategjisë zhvillimore lokale duhet të jetë pjesëmarrja e gjerë, d.m.th. sigurimin e kushteve për përfshirje aktive në procesin e konsultimit e të gjitha palëve të interesuara sektorin, (publike, private, OJQ-të), (Belkić&Hrnjaz, 2010, 28).

Dokumentet strategjike zhvillimore komunale - Komuna ka të punuar PZHK, dhe Strategjinë për zhvillim lokal-SZHL, draft plani për mobilitet i komunës, i punuar në vitin 2015, Draft Plani rregullues i hollësishëm, “Qendra e vjetër e qytetit”, i punuar në vitin 2015. Plani zhvillimor komunal është një dokument strategjik i cili i krijon mundësi të mirë komunës për nxjerrjen e dokumenteve strategjike sektoriale zhvillimore, të cilat komuna akoma nuk i ka të përgatitura dhe as që është në fazën e punimit të tyre. Komunës i mungojnë strategjitë zhvillimore sektoriale të cilat janë dokumente mjaftë të rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës.

Mënyra (Modeli) i organizimit të pushteti lokal në ZHEL-ë - Korniza aktuale ligjore, lejon që komunat si njësi bazë e qeverisjes lokale të krijojë strukturë të përshtatshme për kryerjen e përgjegjësi ndaj qytetarëve të vet, përfshirë edhe në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik lokal (Ligji VQL, Nr.03/L-040, neni 17), por, e njëjta nuk ofron model të veçantë të organizimit. Komunat kanë të krijuar një strukturë mjaft heterogjene organizative, përmes shpërndarjes së përgjegjësi të zhvillimit nëpër disa drejtori.

Mungon koordinimi i mirëfilltë në mesë të drejtorive të cilat merren me çështjet zhvillimore, mungon bashkëpunimi me sektorin privat, mungojnë informatat e nevojshme lidhur me bizneset e komunës, mungojnë të dhënat edhe për çështjet që komuna është përgjegjëse si p.sh., prona komunale që mund të shfrytëzohen për qëllime biznese etj. Mund të konkludojmë se modeli ekzistues nuk është organizuar në formën e duhur për të qenë në nivelin e përmbushjes së kërkesave të zhvillimit ekonomik lokal.

9.2. Rekomandimet

Nga përfundimet e nxjerra në hulumtimin e bërë, mund të nxjerrim rekomandimet për veprimet që duhen t’i ndërmarrin institucionet përgjegjëse si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendrorë, për të krijuar mundësi më të përshtatshme për zhvillimin ekonomik lokal. Meqë fushat të cilat kanë nevojë për veprime të institucioneve, përfshijnë te dy nivelet, atëherë edhe rekomandimet do të ndahen në dy grupe.

Grupi i parë përfshin veprimet që kërkojnë angazhimin e partnerëve lokal, dhe mund të kryhen për një kohë relativisht më të shkurtër.

Grup i dytë përfshin aktivitetet që kanë nevojë për veprim të partnerëve qendror dhe atyre lokal dhe kërkojnë një kohë më të gjatë veprimi:

Rekomandimet në grupin e I

- Të ristrukturohet struktura aktuale organizative e ZHEL-it, të formohet Sektori/Zyra për zhvillim ekonomik lokal ashtu siç është propozuar në Modelin e më sipërm;
- Të krijohen dhe shfrytëzohen më shumë mekanizma/instrumente të ZHEL-it, (inkubator biznesi, zona industriale, organizimi i trajnimeve për biznese të reja, promovim më i fuqishëm i bizneseve dhe burime zhvillimore etj.)
- Të krijohet Këshilli konsultativ për zhvillim ekonomik lokal, me përfaqësues nga (Komuna, komunitetit i biznesit dhe shoqëria civile);
- Të punohet në hartimin e Strategjive zhvillimore sektoriale, (ne veçanti strategjia për zhvillim ekonomik lokal dhe strategjia për zhvillimin e bujqësisë);

Rekomandimet në grupin e II

- Të punohet në plotësimin e legjislacionit i cili do të krijonte mundësi për një veprim më efikas të organeve të qeverisjes lokale në mbështetje të ZHEL-it, ligji mbi pylltarinë dhe Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe Ligjin mbi dhënien në shfrytëzim pronën komunale ;
- Të rishikohet ligji i cili Agjencisë së Privatizimit i jep të drejtën e menaxhimit të ish/pronave shoqërore të cilat më parë kanë qenë në pronësi të komunave;
- Të plotësohet me akte nënligjore Ligji mbi Financat Lokale në pjesën e huamarrjes për komunat dhe në atë të fondit për sigurimin e kredive të vogla për bizneset fillestare.

Rekomandimet e grupit të parë janë veprime që mund të ndërmerren, nga udhëheqja e komunës në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe atë civil dhe i njëjti nuk kërkon ndonjë shumë të madhe buxhetore apo materiale.

Ndërsa veprimet lidhur me plotësimin e legjislacionit, kërkojnë implikimin e Qeverisë qendrore dhe normalisht një analizë të mirëfilltë për ta parë saktë se çka në të vërtetë do të duhej të ndryshohej në interes të zhvillimit ekonomik lokal.

Shtojca

I. Analiza statistikore

Në përdorimin e modelit ekonometrik OLS të punimit kemi përdorur modelin ekonometrik shumë variabil, në ndërtimin e modelit ekonometrik është përdorur bashkë dyzimi i modelit të përdorur nga David Neumark dhe Jed Kolko (2009) dhe Dunning (2009), ku forma e regresionit për të mbështetur pohimet e punimit është:

$$Y_t = C + \beta_{1t} + \beta_{2t} + \varepsilon$$

ku,

$$THR_t = C + \beta_1 NP_t + \beta_2 HP_t + \varepsilon$$

THR – Të hyrat vetanake të Rahovecit

NP – Numri i punëtorëve të Mini Parkut të Biznesit

NB – Të hyrat nga Parku i Biznesit

C – Konstantja për variabla

E – gabimi i rastësishëm për periudhën t

T – 2008 deri më 2016

Sipas njohësve të ekonometrisë ka 7 supozime që duhen marrë në konsideratë me qëllim që vlerësuesit OLS të jenë statistikisht të mirë:

1. Modeli i regresionit është linear, është përcaktuar në mënyrë korrekte dhe ka një term gabimi shtesë
2. Termi i gabimit ka një pritje matematike zero të popullimit.
3. Të gjithë variablat shpjegues janë të pakorreluar me termin e gabimit
4. Vëzhgimet e termit të gabimit janë të palidhura me njëra-tjetrën (Nuk ka korrelacion serial).
5. Termi i gabimit ka një variancë konstante (nuk ka heteroskedicitet)
6. Asnjë variabël shpjegues nuk është funksion linear i përsosur i variablave të tjerë shpjegues (nuk ka multikolaritet perfekt)
7. Termi i gabimit ka shpërndarje normale (jo e detyrueshme)

Në studimet statistikore të realizuara më anë të dhënave parësore, për shkaqe të ndryshme, shpesh herë vërehen vlera të cilat janë dukshëm ekstremisht të pozicionuara kundrejt vlerave të tjera të njëjtit variabël. Këto vlera njihen si *outliers* dhe shpesh herë, sidomos në rastet kur ato janë pasqyrim i mos përgjegjësisë së individit të zgjedhur për t'u vrojtuar, sjellin anomali dhe paqartësi konkludime të rezultateve të studimit statistikor.


Figura 1. Përmbledhja e boxplot të hyrat vetanake të Rahovecit

Case Processing Summary						
	Cases					
	Valid		Missing		Total	
	N	Percent	N	Percent	N	Percent
Te_hyrat_Krahovec	36	100.0%	0	0.0%	36	100.0%

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të strukturës së tabelës shohim që nga 36 observime të dhënave 100% janë të paraqitur në formë ekonometrik, ku asnjëra nga të dhënat e variablës THR nuk mungon, apo ka vlerë 0.

Figura 2. Boxplot të hyrat vetanake të Rahovecit



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 2 tregon që asnjëra nga vlerat e variables THR-së nuk ka vlera “outliers”, pra praktikisht kjo variabël nuk ka vlera ekstreme të devijuara nga vlerat e përbashkëta të kësaj strukture.


Figura 3. Përmbledhja e boxplot numri i punëtorëve të Mini Parkut

Case Processing Summary						
	Cases					
	Valid		Missing		Total	
	N	Percent	N	Percent	N	Percent
Puntoret_Mini_Park	36	100.0%	0	0.0%	36	100.0%

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të strukturës së tabelës shohim që nga 36 observime të dhënave 100% janë të paraqitur në formë ekonometrik, ku asnjëra nga të dhënat e variablës NP nuk mungon, apo ka vlerë 0.

Figura 4. Boxplot të numrit të punëtorëve të Mini Parkut



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 5 tregon që asnjëra nga vlerat e variables HP-së nuk ka vlera “outliers”, pra praktikisht kjo variabël nuk ka vlera ekstreme të devijuara nga vlerat e përbashkëta të kësaj strukture.


Figura 5. Përmbledhja e boxplot HP-së

Case Processing Summary						
	Cases					
	Valid		Missing		Total	
	N	Percent	N	Percent	N	Percent
Te_hyrat_Parku_Biznesit	36	100.0%	0	0.0%	36	100.0%

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të strukturës së tabelës shohim që nga 36 observime të dhënave 100% janë të paraqitur në formë ekonometrik.


Figura 6. Boxplot të HP-së



Burimi: Output i SPSS v.20


Figura 6, tregon që nga vlerat e variables HP-së ka vlera “outliers” vlera 31 dhe 6, pra praktikisht kjo variabël nuk ka vlera ekstreme të devijuara nga vlerat e përbashkëta të kësaj strukture.

Figura 7. Multikolariteti i regresionit



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 8. Multikolariteti i regresioni



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 7 dhe 8, në rastin (a) paraqet sjelljet grafike të rasteve kur të dhënat nuk shfaqin tendenca heteroskedaticiteti (në këtë rast kemi homoskedaticitet) dhe në rastin (b) kemi të dukshëm fenomenin e heteroskedaticitetit.

Figura 9. Korrelacioni i modelit ekonometrik

Correlations				
		Punetoret_KRa hovec	Te_hyrat_Parku _Biznesit	Te_hyrat_Kraho vec
Punetoret_KRahovec	Pearson Correlation	1	.365*	.618**
	Sig. (2-tailed)		.029	.000
	N	36	36	36
Te_hyrat_Parku_Biznesit	Pearson Correlation	.365*	1	.336*
	Sig. (2-tailed)	.029		.045
	N	36	36	36
Te_hyrat_Krahovec	Pearson Correlation	.618**	.336*	1
	Sig. (2-tailed)	.000	.045	
	N	36	36	36
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).				
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).				

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të rezultateve të tabelës së korrelacionit shohim që variablat e regresionit kanë lidhje korrelative pozitive në mes tyre, duke na mundësuar një bazë ekonometrike të

qëndrueshme të modelit. Lidhja korrelative ndërmjet variablës THR-së dhe NP-së është 0.365 me lidhje signifikante .001, që tregon se rritja e numrit të punëtorëve në mini parkun do të ketë efekt pozitivë në rritjen e të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit, po ashtu THR-ja dhe HB-ja kanë lidhje pozitive korrelative 0.336 dhe nivel të signifkancës .000, pra me rritjen e numrit të punëtorëve në min parkut do të kemi rritje të hyrave vetanake të komunës së Rahovecit. Lidhja më e fortë dhe natyrale korrelative është ndërmjet THR-së dhe NP-së 0.618 dhe nivel signifikant .000, pra rritja e bizneseve në parkun industrial do të ngrit numrin e të punësuarave.


Figura 10. Analiza përshkruese e modelit ekonometrik

Statistics				
		Punetoret_KRahovec	Te_hyrat_Krahovec	Te_hyrat_Parku_Biznesit
N	Valid	36	36	36
	Missing	0	0	0
Mean		1769.53	204515.872222	11340.899167
Median		1804.00	196960.370000	10753.100000
Mode		2158 ^a	119939.9200 ^a	2929.0000 ^a
Std. Deviation		482.964	48557.1526189	5099.4557135
Variance		233254.485	2357797070.456	26004448.574
Range		1565	178940.5700	21145.7400
Minimum		1009	119939.9200	2929.0000
Maximum		2574	298880.4900	24074.7400
Sum		63703	7362571.4000	408272.3700
a. Multiple modes exist. The smallest value is shown				

Burimi: Output i SPSS v.20

Në tabelën lartë kemi një përshkrim të shkurtë të analizave qendrore statistikore, ku nga të dhënat e analizës qendrore statistikore, apo analizës përshkrues shohim që mesatarja e të hyrave vetanake është 204,515 euro, mesatarja e numrit të punëtorëve 1769, ndërsa e të hyrave nga parku 11,340 euro.


Figura 11. Histogrami i THR-së



Burimi: Output i SPSS v.20


Histogrami i THR-së paraqet vlerën mesatare të kësaj variable prej 204,515 dhe devijim standart 48,577 dhe numër të observimeve 36.

Figura 12. Histogrami i NP-së



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 13. Histogrami i HB-së



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 14. Llojet e variablave

Variables Entered/Removed ^a			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punetoret_KRahovec ^b	.	Enter
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec			
b. All requested variables entered.			

Burimi: Output i SPSS v.20

Modeli i vendosur në programin statistikor SPSS v.20 tregon se çfarë variabla statistikore janë vendosur në modelin ekonometrik të trajtimit të problemit të temës së trajtuar.

Figura 15. Përmbledhja e modelit ekonometrik

Model Summary ^b										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.629 ^a	.395	.359	38884.13 20242	.395	10.790	2	33	.000	1.508
a. Predictors: (Constant), Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punetoret_KRahovec										
b. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec										

Burimi: Output i SPSS v.20

Për të kalukluar të dhënat e modelit ekonometrik, kemi përdorur programin statistikor SPSS. Në bazë të kalkulimeve të bëra të modelit ekonometrik rezultatet e nxjerra nga të dhënat e modelit tregojnë se variabla e varur ka korrelacion të fort me variablat shpjeguese në nivel prej .629, respektivisht 62.9 përqind. Ndërsa R^2 në analizën tonë është .395, i cili tregon se 39.5% e variablës së varur shpjegohet nga variablat e pavarura. R^2 i rregulluar është i barabartë me .359, e që tregon se 35.9 përqind e variacionit të variablës së varur shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarura. Në analizën tonë për verifikimin e qëndrueshmërisë së modelit është përdorur korrelacioni serial. Vlera e korrelacionit të Durbin-Watson mund të jetë në interval prej 0 deri në 4. Nëse vlera e Durbin-Watson është e përafërt me zero, atëherë korrelacioni serial tregon se të dhënat

në model kanë ndikim të lart pozitiv ndërmjet vlerës reziduale. Nëse korrelacioni DurbinWatson i ofrohet vlerës katër (4), tregon se të dhënat kanë korrelacion negativ serial. Modeli mund të konsiderohet i qëndrueshëm kur rezultatet e Durbin-Watson janë afër intervalit të vlerës dy (2). Testi Durbin-Watson konsiderohet se nuk ka korrelacion serial në kuadër të intervalit prej 1.5 deri në 2.5, e që na tregon se vlera reziduale nuk ka korrelacion serial ose aty nuk ekziston autokorrelacion ndërmjet vlerës reziduale. Prandaj, bazuar në këtë interval, gjetjet në studimin tonë tregojnë se Durbin-Watson është në vlerë prej 1.508, e që është brenda vlerës së intervalit, e që nga kjo rjedh se modeli është i qëndrueshëm.

Figura 16. ANOVA

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	32627698597.769	2	16313849298.884	10.790	.000 ^b
	Residual	49895198868.180	33	1511975723.278		
	Total	82522897465.948	35			
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec						
b. Predictors: (Constant), Te_hyrat_Parku_Biznesit, Punetoret_KRahovec						

Burimi: Output i SPSS v.20

F-testi është i barabartë me .000 tregon se të gjitha koeficientet së bashku janë statistikisht signifikat dhe të ndryshëm prej zeros.

Figura 17. Përmbledhja e regresionit


Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	89168.563	25712.738		3.468	.001
	Punetoret_KRahovec	57.411	14.616	.571	3.928	.000
	Te_hyrat_Parku_Biznesit	1.213	1.384	.127	.876	.387
a. Dependent Variable: Te_hyrat_Krahovec						

Burimi: Output i SPSS v.20

Rezultatet e modelit tregojnë se variabla numri i punëtorve të mini parkut ka ndikim në të hyrat vetanake të komunës së Rahovecit, ngase niveli i signifikançës është .000 apo në shkallën 1%, që mbështet pohimet tona, që zhvillimi i parkut industriale do të ndihmojë në rritjen e bizneseve dhe njëkohësisht në rritjen direkte të hyrave vetanake të komunave.

$$THR_t = 89,168.563 + \beta_1 57.41 + \beta_2 1.21 + \varepsilon$$

Figura 18. Scatterplot i modelit ekonometrik



Burimi: Output i SPSS v.20

Scatterplot të modelit ekonometrik tregon që kemi linjën lineare të modelit, pra vlerat e modelit kanë qëndrueshmëri ekonometrik, pra struktura e modelit është statistikisht e qëndrueshme dhe lineare.

Figura 19. Krahassimi me të hyrat e komunës së Deçanit

Runs Test	
	Te_hyrat_Kdeqan
Test Value ^a	114,346.45
Cases < Test Value	18
Cases >= Test Value	18
Total Cases	36
Number of Runs	18
Z	-.169

Asymp. Sig. (2-tailed)	.866
a. Median	

Burimi: Output i SPSS v.20

Përdorimi i testit ekonometrik “Run Test” tregon se komuna e Deçanit në krahasim me komunën e Rahovecit qëndron keq sa i përket parkut industrial, pasi që kjo komunë nuk posedon këtë llojë të tregut ekonomik, rezultatet e tabelës 19 tregojnë që krahasimi i këtyre dy komunave tregon që komuna e Deçanit ka efekt negativ -.169 Z raporti, pra mungesa e parkut ekonomik i sjellë komunës së Deçanit efekt negativ në të hyrat vetanake të kësaj komune.

$$Y_t = C + \beta_{1t} + \varepsilon$$

ku,

$$NPR_t = C + \beta_1 NP_t + \varepsilon$$

NPR – Numri i të punësuarve në Rahovec

NP – Numri i punëtorëve të Mini Parkut të Biznesit

C – Konstantja për variabla

E – gabimi i rastësishëm për periudhën t

T – 2008 deri më 2016


Figura 20. Përmbledhja e boxplot numri i punëtorëve të Mini Parkut

Case Processing Summary						
	Cases					
	Valid		Missing		Total	
	N	Percent	N	Percent	N	Percent
Puntoret_Mini_Park	36	100.0%	0	0.0%	36	100.0%

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të strukturës së tabelës shohim që nga 36 observime të dhënave 100% janë të paraqitur në formë ekonometrik, ku asnjëra nga të dhënat e variablës NP nuk mungon, apo ka vlerë 0.

Figura 21. Boxplot të numrit të punëtorëve të Mini Parkut



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 21 tregon që asnjëra nga vlerat e variables HP-së nuk ka vlera “outliers”, pra praktikisht kjo variabël nuk ka vlera ekstreme të devijuara nga vlerat e përbashkëta të kësaj strukture.


Figura 22. Përmbledhja e boxplot numri i punëtorëve të Rahovecit

Case Processing Summary						
	Cases					
	Valid		Missing		Total	
	N	Percent	N	Percent	N	Percent
NPR	36	100.0%	0	0.0%	36	100.0%

Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të strukturës së tabelës shohim që nga 36 observime të dhënave 100% janë të paraqitur në formë ekonometrik, ku asnjëra nga të dhënat e variablës NPR nuk mungon, apo ka vlerë 0.


Figura 23. Boxplot të numrit të punëtorëve të Rahovecit



Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 23 tregon që asnjëra nga vlerat e variables NPR-së nuk ka vlera “outliers”, pra praktikisht kjo variabël nuk ka vlera ekstreme të devijuara nga vlerat e përbashkëta të kësaj strukture.

Figura 24. Histogrami i NPR-së



Burimi: Output i SPSS v.20

Në bazë të histogramit mesatarja e NPR-së është 1769, me devijim standar 482 dhe me numër të përgjithshëm të observimeve 36.

Figura 25. Llojet e variablave

Variables Entered/Removed ^a			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	NP ^b	.	Enter
a. Dependent Variable: NPR			
b. All requested variables entered.			

Burimi: Output i SPSS v.20

Figura 26. Përmbledhja e modelit ekonometrik

Model Summary ^b										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.942 ^a	.888	.885	164.100	.888	269.168	1	34	.000	1.990
a. Predictors: (Constant), NP										
b. Dependent Variable: NPR										

Burimi: Output i SPSS v.20

Për të kalukluar të dhënat e modelit ekonometrik, kemi përdorur programin statistikor SPSS. Në bazë të kalkulimeve të bëra të modelit ekonometrik rezultatet e nxjerra nga të dhënat e modelit tregojnë se variabla e varur ka korrelacion të fort me variablat shpjeguese në nivel prej .942, respektivisht 94.2 përqind. Ndërsa R^2 në analizën tonë është .888, i cili tregon se 88.8% e variablës së varur shpjegohet nga variablat e pavarura. R^2 i rregulluar është i barabartë me .885, e që tregon se 88.5 përqind e variacionit të variablës së varur shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarura. Në analizën tonë për verifikimin e qëndrueshmërisë së modelit është përdorur korrelacioni serial. Vlera e korrelacionit të Durbin-Watson mund të jetë në interval prej 0 deri në 4. Nëse vlera e Durbin-Watson është e përafërt me zero, atëherë korrelacioni serial tregon se të dhënat në model kanë ndikim të lart pozitiv ndërmjet vlerës reziduale. Nëse korrelacioni Durbin-Watson i ofrohet vlerës katër (4), tregon se të dhënat kanë korrelacion negativ serial. Modeli mund të konsiderohet i qëndrueshëm kur rezultatet e Durbin-Watson janë afër intervalit të vlerës dy (2). Testi Durbin-Watson konsiderohet se nuk ka korrelacion serial në kuadër të intervalit prej 1.5 deri në 2.5, e që na tregon se vlera reziduale nuk ka korrelacion serial ose aty nuk ekziston autokorrelacion ndërmjet vlerës reziduale. Prandaj, bazuar në këtë interval, gjetjet në studimin tonë tregojnë se Durbin-Watson është në vlerë prej 1.990, e që është brenda vlerës së intervalit, e që nga kjo rrjedh se modeli është i qëndrueshëm.

Figura 27. ANOVA

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	7248331.955	1	7248331.955	269.168	.000 ^b
	Residual	915575.017	34	26928.677		
	Total	8163906.972	35			
a. Dependent Variable: NPR						
b. Predictors: (Constant), NP						

Burimi: Output i SPSS v.20

F-testi është i barabartë me .000 tregon se të gjitha koeficientet së bashku janë statistikisht signifikat dhe të ndryshëm prej zeros.

Figura 28. Përmbledhja e regresionit

Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	845.957	62.586		13.517	.000
	NP	21.017	1.281	.942	16.406	.000
a. Dependent Variable: NPR						

Burimi: Output i SPSS v.20

Rezultatet e modelit tregojnë se variabla numri i punëtorve të mini parkut ka ndikim në të numrin e të punësuarve në komunën e Rahovecit, ngase niveli i signifkancës është .000 apo në shkallën 1%, që mbështet pohimet tona.

$$NPR_t = 845.957 + \beta_1 21.017 + \varepsilon$$

II. Të dhënat për numrin e bizneseve, punëtorëve për Komunitat Rahovec dhe Deçan;

1. Tabelat me numrat e punëtorëve në komunat Rahovec dhe Deçan, për periudhën 2008-2016.

Numri i punëtorëve të regjistruar në Komunën e Rahovecit, në periudha tremujore (TM)

Nr.	Viti	Punëtorët	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008		1,009	1,050	1,068	1,093	1,077
2	2009		1,177	1,204	1,242	1,258	1,245
3	2010		1,320	1,385	1,401	1,416	1,405
4	2011		1,527	1,604	1,630	1,621	1,595
5	2012		1,571	1,795	1,927	1,894	1,797
6	2013		1,813	2,015	2,126	2,016	1,992
7	2014		1,923	2,069	2,238	2,100	2,082
8	2015		2,158	2,376	2,574	2,546	2,414
9	2016		2,158	2,376	2,574	2,449	2,495
10							

Numri i punëtorëve të regjistruar në Komunën e Deçanit, në periudha tremujore (TM)

Nr.	Viti	Punëtorët	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008		607	620	658	645	625
2	2009		630	638	705	682	655
3	2010		675	725	784	765	742
4	2011		750	1,385	1,027	1,062	1,056
5	2012		908	768	966	939	895

6	2013		933	1.000	1.016	1.050	999
7	2014		1.055	1.122	1.149	1.166	1.123
8	2015		1.075	1.130	1.262	1.212	1.170
9	2016		1.103	1.129	1.155	1.173	1.140
10							

Tabelat me numrin e bizneseve aktive në komunat Rahovec dhe Deçan, për periudhën 2008-2016.

Numri i bizneseve aktive në Komunën e Rahovecit sipas periudhave tremujore (TM)

Nr.	Viti	Bizneset	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008	Aktive në vitin	848	869	882	902	903
2	2009		922	948	966	989	990
3	2010		1.012	1.035	1.050	1.067	1.068
4	2011		1.108	1.130	1.161	1.187	1.187
5	2012		1.222	1.252	1.276	1.312	1.312
6	2013		1.372	1.415	1.453	1.485	1.485
7	2014		1.523	1.561	1.601	1.630	1.630
8	2015		1.672	1.714	1.739	1.793	1.793
9	2016		1.849	1.888	1.949	2.026	2.026
10							

Numri i bizneseve aktive në Komunën e Deçanit sipas periudhave tremujore (TM)

Nr.	Viti	Bizneset	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008	Aktive në vitin	472	476	478	485	487
2	2009		491	506	509	515	517
3	2010		532	543	553	560	562
4	2011		570	576	584	590	594
5	2012		599	616	625	633	637
6	2013		665	690	712	728	734
7	2014		754	770	784	809	815
8	2015		840	878	915	1.011	1.017
9	2016		1.067	1.117	1.169	1.201	1.208
10							

Tabelat me të hyrat vetanake për komunat e Rahovecit dhe Deçanit, për periudhën 2008-2016.

Të hyrat vetanake në Komunën e Rahovecit sipas periudhave tremujore (TM)

Nr	Viti	TM1	TM2	TM3	TM4	Realizimi	Planifikimi
1	2008	160,906.78	221,811.48	222,288.88	227,593.37	832,600.51	719,000.00
2	2009	119,939.92	155,856.55	156,826.98	154,825.53	587,448.98	709,000.00
3	2010	156,682.07	166,056.81	189,786.82	149,503.52	662,029.22	913,729.00
4	2011	145,553.46	167,111.24	198,138.47	246,665.18	757,468.35	715,500.00

5	201 2	156,682.4 5	167,586.5 2	225,627.3 3	250,508.4 2	800,404.72	814,000.00
6	201 3	207,112.4 4	174,914.5 8	195,139.1 4	149,587.2 5	726,753.41	950,000.00
7	201 4	195,782.2 7	240,745.3 4	298,880.4 9	281,675.6 2	1,017,083.7 2	950,000.00
8	201 5	214,109.3 8	189,727.1 5	283,137.4 2	281,790.0 9	968,764.04	1,099,014.0 0
9	201 6	269,242.9 8	244,909.1 9	286,683.7 8	209,182.5 0	1,010,018.4 5	1,158,014.0 0
10							

Të hyrat vetanake në Komunën e Deçanit sipas periudhave tremujore (TM)

Nr.	Viti	TM1	TM2	TM3	TM4	Realizimi	Planifikimi
1	2008	86,549.20	114,234.56	120,576.34	149,620.46	470,980.56	
2	2009	70,396.69	105,375.15	125,245.30	121,205.11	427,222.25	
3	2010	64,765.34	99,897.54	126,457.31	130,795.74	421,915.93	500,641.00
4	2011	87,765.45	102,957.28	128,594.73	123,044.02	442,361.48	513,400.00
5	2012	65,286.92	112,707.55	155,829.11	131,409.80	465,215.38	531,535.00
6	2013	105,636.49	100,424.48	137,248.60	81,768.92	425,078.49	564,435.00
7	2014	99,117.02	114,458.34	130,069.65	90,800.00	434,445.01	607,435.00
8	2015	86,620.12	95,669.59	238,708.34	195,405.53	616,403.58	636,892.00
9	2016	101,254.15	125,545.36	198,756.23	200,324.02	625,879.76	642,835.00
10							

Tabela me numrin e punëtorëve në “Mini Parkun e Biznesit” në Xërxe – Rahovec

Numri i punëtorëve të regjistruar në “Mini Parkun e Biznesit” në Xërxe – Rahovec në periudha tremujore (TM)

Nr.	Viti	Punëtorët	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008	Nr. Në vitin	7	7	7	7	
2	2009		7	7	7+25=32	32	
3	2010		32	32	32	32	
4	2011		32	32	32+5=37	37	
5	2012		37	37	57+23=60	60	
6	2013		60	60	60	60	
7	2014		60	60	60	60	
8	2015		60	60+8=68	68	68	
9	2016		68	68	68	68	
10							

Numri i bizneseve të vendosura në “Mini Parkun e Biznesit” në Xërxe – Rahovec në periudha tremujore (TM)

Nr.	Viti	Bizneset e vendosura	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsejtë
1	2008	Nr. Në vitin	0	0	0	0	
2	2009		0	0	2	2	

3	2010		2	2	2	2	
4	2011		2	2	2	2	
5	2012		2		2+2=4	4	
6	2013		4	4	4	4	
7	2014		4	4	4	4	
8	2015		4	4+2=6	6	6	
9	2016		6	6	6	6	
10							

“Mini parku i biznesit” është dhënë në shfrytëzim për bizneset në përputhje me ligjin par dhënë në shfrytëzim të pronës komunale.

Bizneset janë përzgjedh pames ankandit publik dhe kana kontrata shumë vjeçare.

Kapitulli i 7; Është zhvilluar vlerësimi i ndikimit të “Mini parkut” në punësim dhe në zhvillimin e Komunës.

Të dhënat për numrin e bizneseve dhe të punësuarve në komunitet e Rahovecit dhe të Deçanit janë marrë nga ATK-ja, përmes informatës zyrtare elektronike.

Të dhënat për të hyrat vetanake të komunave Rahovec dhe Deçan janë siguruar nga Drejtorit për Financa dhe Buxhet të komunave respektive,

III. Shënimet nga hulumtimi i opinionit;

Forma e intervistës - Sektori privat

Komuniteti lokalë/Sektori privat

1. Për kompaninë/biznesin tuaj:

- Kur e keni filluar këtë biznes ? Sa është numri i të punësuarve, mosha, kualifikimi dhe struktura gjinore ? Kush udhëheq me kompaninë/biznesin ?
- Si e vlerësoni punën/të arriturat e kompanisë suaj ? Cilat janë problemet bazë me të cilat përballeni në punë ?
- Si e shihni të ardhmen e kompanisë/biznesit tuaj ? A mendoni ta zgjeroni kapacitetin ekzistues dhe si, apo mendoni të vazhdoni kështu me këto kapacitete ?
- Cilat janë problemet apo pengesat me të cilat përballeni në punën tuaj dhe kush mendoni se mundet dhe duhet të ju ndihmoj ?
- A keni njohuri të nevojshme lidhur rregullativën ligjore mbi politikën fiskale (taksat dhe tatimet)? A jeni të njohur me politikën kreditore e cila aplikohet në tregun bankar aktual ?

- Sa jeni të njoftuar me fondet e financimit nga BE-ja ? A keni ndërmarrë diçka në këtë qështje ? A keni personel të përgatitur për aplikim në këta fonde apo i bëni përmes angazhimit të eksperteve nga jashtë ?
- Si vlerësoni klimën/ambientin e të bërit biznes momentalisht, a ka përmirësim , është i njëjtë apo është përkeqësuar nga koha kur keni filluar me këtë biznes ?

2. Bashkëpunimi me sektorin publik,(Qeverinë lokale/Qeverinë qendrore dhe Agjencitë e ndryshme);

- Si e vlerësoni punën e qeveris komunale (administratës komunale) ?
- Çfarë është komunikimi/bashkëpunimi juaj me sektorin publik në tërësi, me qeverinë komunale në veçanti ? A ka një interes të vërtetë për bashkëpunim?
- A është mjedisi/ambienti në përgjithësi mbështetës për zhvillimin e sektorit privat? A aplikoni në konkursset/tenderët e komunës dhe nëse ata janë të përshtatura për nevojat reale të sektorit privat?
- A keni marrë pjesë si kompani në krijim apo implementim planeve të ndryshme ? Në cilën mënyrë ? A është marrë parasysh zëri i sektorit privatë me atë rast ? (Nëse për shembull, planin zhvillimor në diskutim publik, a është marrë parasysh mendimi i juaj si sektor privat?)
- A mendoni se puna në sektorin publik/ administratën komunale është transparente ? (A shërbeu kryesisht me internetë, a kërkon njohuri për projekt dokumentet ; a është kjo e mjaftueshme ?; çka sipas juve do të duhej bërë?)
- A keni njohuri për ndonjë dokument zhvillimor të komunës, (p.sh. PZHK, PZHU, PRRU, SZHL, ndonjë strategji zhvillimore sektoriale ? Nëse keni marrë pjesë në hartimin e ndonjërës prej këtyre dokumenteve zhvillimore ?
- A jeni të njoftuar me përgjegjësitë e pushtetit lokal në sferën e zhvillimit ekonomik ? Sa është
- Cilat janë format e bashkëpunimit tuaj me sektorin publik, qeverinë lokal/ qeverinë qendrore, në rritjen dhe forcimin e biznesit tuaj ?

Forma e Intervistës - Sektori Civil

Intervistë: Sektori Civil – OJQ ose Shoqatë:

Rreth shoqatës tuaj

1. Sa anëtarë ka shoqata juaj? Nga janë anëtarët, mosha, kualifikimi? Sa është e vjetër shoqata ?
2. Kush e menaxhon me shoqatën ? Nëse janë të paguar apo vullnetarë ?
3. Si e vlerësoni punën e organizatës/shoqatës suaj ? Cilat janë problemet kryesore në punën ?
4. Sa jeni transparent, d.m.th. Si e njoftoni publikun për punën tuaj (vetën) ?

5. Si e shihni të ardhmen e shoqatës tuaj ? A mendoj edhe për të ardhmen, ose jeni të kënaqur me gjendjen aktuale të shoqatës ? Çfarë jeni duke bërë për të tërhequr anëtarë ?

Bashkëpunimi me sektorin publik

6. Sipas mendimit tuaj, korniza aktuale ligjore a i përcakton qartë detyrat SPL (Sektorit publik lokal) dhe nëse ato mund të përmbushen? Cilat janë problemet ?
7. Si e shihni/vlerësoni punën e administratës?
8. Cili është komunikimi juaj me sektorin publik? A ka një interes të vërtetë për bashkëpunim?
9. A është mjedisi i përgjithshëm inkurajues për zhvillimin e shoqërisë civile? (A paraqiteni në konkurset (shpalljet) e komunës apo qendrore dhe sa ato kanë qenë të përshtatura për nevojat reale të shoqërisë civile ?)
10. Nëse, si shoqatë, merrni pjesë në krijimin e politikave zhvillimore? Në çfarë mënyre? Nëse zëri i shoqatave atëherë respektuar ?
- (Nëse ka qenë p.sh. plani zhvillimor në diskutim publikë, nëse mendimi i shoqatë është është marrë parasysh?)
11. A mendoni se puna në sektorin publik është transparente ? (A e shërbeheni vetëm me internet , nëse kërkonin njohuri në dokumentacionin e projektit, nëse ajo është e mjaftueshme;? Çfarë sipas mendimit duhet ?)
12. A jeni në dijeni për ndonjë dokument të zhvillimit të komunës tuaj ?
13. A jeni të njohur me reformat e ardhshme në sektorin publik? Si e shihni të ardhmen e komunës tuaj në këtë kontekst ?
14. Cila është forma e bashkëpunimit të shoqatës me qeverinë komunale ? A mendoni se duhet me ndryshuara forma e bashkëpunimit në mes të komunës dhe shoqatave dhe si ?.

Bashkëpunimi me sektorin privat

15. Si do ta përshkruanit sektorin privat në zonën e tuaj? A mendoni se sektori privat në përgjithësi mund të mbijetojë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe zejtarët? Cilat janë mundësitë për mbijetesë dhe zhvillim?
16. Cila është marrëdhënia juaj me sektorin privat? A ekziston komunikimi dhe kush i inkurajon ? (Sektori privat apo civil, ndoshta ju ka bashkua atij civile ?)

Bashkëpunimi me shoqatat e tjera

17. A mendoni se legjislacioni ekzistues është i kënaqshëm? (I referohet punës së OJQ-ve, çka në përgjithësi dini në lidhje me të, nëse ju mundëson atë që ju dëshironi ?)

18. Çfarë është financimi i shoqatave? (Nëse si shoqatë paraqiti në konkurse/shpallje me aktivitete të përhershme, a keni projektet tuaja, a përpiqeni që në aktivitetet tuaja për të përfshirë sektorët publikë dhe private, nëse burimet e financimit janë ekskluzivisht mbështetjet, A keni konkurruar për fonde të BE-së; A ka qenë në atë suksesshëm? Pse ?)
19. Çfarë është bashkëpunimi me shoqatat e tjera në fushën e aktiviteteve tuaja? Cilat janë rezultatet e bashkëpunimit ?
20. Pse njerëzit bashkohen me shoqatën? (Për shkak të interesit në ndryshimin ose nga monotonia ?)
21. A jeni në dijeni për ekzistencën e GLV? Çfarë dini ju për të? Si e shihni se do të GLV mund të shfrytëzoni në të ardhmen ?

Forma e intervistës - Sektori publik

Intervistë: Sektori publik – ;Komuna e Rahovecit si njësi të qeverisjes vendore:

1. Korniza Ligjore (LEGJISLACIONI):

- A mendoni se detyrat e qeverisjes lokale janë të përcaktuara qartë dhe mjaftueshëm me legjislacionin aktual ?
- Korniza ligjore egzistuese në aspektin e definimit të mënyrës së financimit, a mundëson plotësimin e përgjegjësi të Komunës?
- A mendoni se legjislacioni ekzistues ju mundëson Komunës të merret mjaftueshëm me procesin e zhvillimit ekonomik ?
- Ku mendoni se duhet të bëhen ndryshime/plotësime të legjislacionit ekzistues, për të fuqizuar rolin e Komunës në procesin e ZHEL-it.
- A e keni të kompletuar legjislacionin sekondar/ të Komunës në fushën zhvillimore ?

2. Kapacitetet Organizative/Profesionale;

- Si e vlerësoni strukturën organizative/institucionale, në administratën komunale ?
- A mendoni se struktura organizative komunale është në përputhje me nevojat për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal ?
- A kanë Drejtoritë përgjegjëse, shkallën e duhur të bashkëpunimit në hartimin dhe implementimin e programeve zhvillimore ?
- A kanë Drejtoritë përgjegjëse Komunale kapacitete të nevojshme profesionale?
- A ka komuna plan strategjik në aftësimin profesional të stafit, në përputhje me nevojat dhe sfidat të zhvillimit të qëndrueshëm lokal ?

- Cilat dokumente strategjike zhvillimore i ka komuna (PZHK, PZHU, SZHEL-it, Strategjitë Sektoriale etj.) ?
- A ka komuna kapacitete organizative, buxhetore dhe profesionale për implementimin e këtyre dokumenteve strategjike zhvillimore ?

3. Bashkëpunimi;

Bashkëpunimi i sektorit publik (Regjionin/Qeverinë e Kosovës):

- Cili është bashkëpunimi, me Qeverinë e Kosovës, respektivisht me Ministrinë e linjës ?
- A ka komuna mbështetje të mjaftueshme nga Ministrinë përgjegjëse në implementimin e projekteve/programeve konkrete zhvillimore ?
- A ka bashkëpunim në mes të komunës dhe Ministrive në hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike zhvillimore ?
- A keni bashkëpunim me komunat fqinje në realizimin e projekteve të përbashkëta ?
- Si e vlerësoni punën AZHR-së jugor, në mbështetjen e programeve/projekteve të ndryshme zhvillimore të komunës?
- Në cilat fusha kryesisht ju mbështet AZHR-ja jugore komunën tuaj ?

Bashkëpunimi me sektorin privat:

- A keni bashkëpunim me sektorin privat (komunitetin e biznesit) ?
- Cilat janë format e bashkëpunimit, a keni një bashkëpunim të organizuar dhe të përhershëm apo ai bëhet mbi bazën e çështjeve të veçanta?
- Cilat janë problemet e sektorit privat dhe sa jeni aktiv në trajtimin e tyre?
- Çka keni ndërmarrë si komunë në mbështetje e zhvillimit të sektorit privat (ZHEL-it) ?
- A keni një formë të organizuar të bashkëpunimit Komunë-sektori privat dhe sektori civil, në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve zhvillimore lokale ?

Bashkëpunimi me sektorin civil (Shoqërinë civile):

- Sa është e organizuar dhe funksionale shoqëria civile në komunën tuaj ?
- A keni bashkëpunim me sektorin civil (shoqërinë civile) ?
- Cilat janë format e bashkëpunimit me shoqërinë civile ?
- Cilat janë problemet e shoqërisë civile dhe sa është komuna e aktive në tejkalimin e tyre ?

- A e mbështet dhe si komuna punën e sektorit civil, përmes projekteve, granteve apo formave të tjera ?
- Sa është aktive shoqëria civile në hartimin dhe implementimin e politikave të ndryshme lokale veçanërisht të atyre zhvillimore dhe buxhetin ?
- A merr pjesë sektori civil/shoqëria civile në hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike (Planeve, programeve dhe projekteve të ndryshme) ?

4. Format(mekanizmat) e aplikuara në mbështetje të ZHEL-it;

- A i parasheh strategjia e zhvillimit ekonomik lokal (SZHEL), format/instrumentet e implementimit, respektivisht të mbështetjes së sektorit privat ?
- Cilat instrumente/mekanizma janë aplikuar nga komuna në mbështetje të sektorit privatë (në hapjen e bizneseve të reja, në ruajtjen dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, në hapjen e vendeve të reja të punës, tërheqjen e investimeve etj.) ?
- A keni rast të aplikimit të partneritetit publiko privatë në mes të komunës dhe sektorit privatë, si një formë e ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe uljes së shpenzimeve buxhetore ?
- A ka komuna të ndërtuar/ urbanizuar zonë industriale/biznesore, për të i ofruar sektorit privat ?
- A ka ngritur komuna inkubatorë të biznesit, për të i ndihmuar bizneset fillestare në procesin e afarizmit ?
- A ka të organizuar ndonjë zyrë në nivelin komunal që i ndihmon ndërmarrjeve të vogla dhe atyre fillestare në njohjen me procedurat administrative, politikat fiskale, legjislacionin, njohjen me tregun financiar (me rregullat e marrjes së kredive) etj.?
- A ka krijuar komuna ndonjë fond për subvencionin të bizneseve fillestare, apo ndonjë formë të stimulimit përmes politikës lokale fiskale (lirim nga taksat, tatimi në pronë etj.) ?

3. Bashkëpunimi me shoqatat;

- A keni bashkëpunim me shoqatat në territorin e komunës tuaj? Çfarë është bashkëpunimi. Cilët janë rezultatet e bashkëpunimit ? Me cilat shoqata bashkëpunoni ?
- A jeni në dijeni për SHAR ? Çka dini për këtë ? Si e shihni a mundet SHAR, të ju ndihmoj në të ardhmen ?
- A jeni në dijeni për Shoqatën e vreshtarëve dhe verëtarëve ? Si e vlerësoni punën e kësaj shoqate ? Sa keni bashkëpunim me këtë shoqatë ?

4. Bashkëpunimi me sektorin privat;

- Si do ta përshkruanit sektorin privatë në territorin e komunës tuaj ? A mendoni se sektori privatë në veçanti NV mundën të mbijetojnë dhe të prosperojnë ? Cilat janë mundësitë e mbijetesës dhe të zhvillimit?
- Cilët janë raportet e juaja me sektorin privatë ? A keni komunikim dhe si zhvillohet ai ?
- A bashkëpunoni me privatët e tjerë në territorin e komunës tuaj, dhe si ecën ky bashkëpunim, ndonjë shembull ?
- Cilët janë problemet kryesore të sektorit privat/ komunitetit të biznesit në teritorin e komunës tuaj ?

Pyetësi anketues: Komuniteti lokal - Sektori civil - Popullsia

PYETËSORI ANKETUES

Pyetësi Anketues synon për të mësuar pikëpamjet dhe opinionet e komunitetit lokal (të popullsisë) të komunës së Rahovecit, mbi bashkëpunimin, kapacitetin profesional, sinkronizimin dhe ndërvlerësinë/bashkëveprimin me shoqatat, sektorin publik dhe privat në territorin e komunës.

1. Mosha: 20-40 40-60 60-80

2. Gjinia: M F

3. Përgatitja profesionale: përgatitja e ulët profesionale, përgatitja e mesme profesionale, përgatitja e lartë profesionale, përgatitja superior profesionale:

4. Statusi shoqërorë: I punësuar/ I papunësuar, nxënës, student, pensionist:

5. Ku punoni: Sektorin publik, sektorin privat, shoqata:

Në territorin e komunës, në territorin e komunave fqinje, në territorin e ndonjë komune tjetër:

6. A e dini emrin e Kryetarit të komunës tuaj? PO JO

7. A dini/keni njohuri për ndonjë dokument zhvillimor të komunës suaj? PO JO

8. Cilët janë ato?

9. A keni marrë pjesë ndonjëherë në debate publike me rastin e bërjes së dokumenteve afariste dhe dokumenteve të tjera zhvillimore? PO JO

10. Nëse po, sa herë dhe është vlerësuar/marrë parasysh mendimi juaj ?

11. A mendoni se komuna juaj jep informata të mjaftueshme në lidhje me aktivitetet e saja? PO JO

12. Në ç 'mënyre arrin deri tek ato/informatat?

13. A jeni të kënaqur me punën e komunës tuaj? PO JO

14. Me çfarë jeni të kënaqur / me çfarë nuk jeni të kënaqur?

15. A dini për ndonjë shoqatë në territorin e komunës tuaj? PO JO

16. Nëse dini, a mundeni t'i numëroni ato?

17. A jeni ju anëtar i ndonjë shoqate/organizate?

18. Nëse po, përse jeni anëtarësuar?

19. A mendoni se këto shoqata/organizata kontribuojnë në cilësinë e jetës në komunën tuaj ? Si dhe pse?

20. Si do ta vlerësonit nivelin e zhvillimit të komunës tuaj?

- E pazhvilluar
- Dobët/pak e zhvilluar
- Mesatarisht e zhvilluar
- E zhvilluar
- Shumë të zhvilluar

21. Sipas mendimit tuaj, cilat janë aktivitetet ekonomike që mund të zhvillohen në të ardhmen në territorin e komunës tuaj?

22. Nëse ju ose fëmijët tuaj e keni ndërmend edhe më tej të jetoni apo të ktheheni në këtë komunë? PO JO

23. Përse?

24. Nëse ju jepet shansi, a do të ishit përfshirë në proceset e vendimmarrjes në lidhje me zhvillimin dhe dokumentet zhvillimore të komunës tuaj? PO JO

25. A e dini ndonjë gjë rreth BE / mënyrat dhe mundësitë të cilat u hapen edhe sektorit privat dhe civil pas hyrjes? Cilat janë?

26. Nëse ju, si banorë të kësaj komune mendoni se mund të ndikoni në cilën do projekt apo investim që ju mendoni, i cili në ndonjë mënyrë mund të ndikojë negativisht në cilësinë e jetës në këtë territor ? PO JO

27. Nëse besoni se mundeni, si?

Rezultatet e anketimit hulumtues të banorëve të Rahovecit:

Shtojca; 5, Rezultatet e anketës;

Tabela 5.1. - Struktura e mostrës së testimit sipas moshës dhe gjinisë;

Shpërndarja Sipas viteve	Gjinia		Gjithsej	Përqindja %		Gjithsej:%
	M	F		M	F	
20 – 40	33	22	55	42.85	59.50	48.20
40 – 60	29	13	42	37.65	35.10	36.80
60 – 80	15	2	17	19.50	5.40	15.00
Gjithsej:	77	37	114	66.60	33.40	100.00

Tabela 5.2. - Niveli i arsimit

Kualifikim profesional	Numri i përgjigjeve	Përqindja (%)
Përgatitja e ulët profesionale (PUP)	14	12.30
Përgatitja e profesionale e mesme (PMP)	32	28.10
Përgatitja e lartë profesionale (PLP)	33	28.90
Përgatitja e superiore profesionale (PSP)	27	23.70
Student	8	7.00
Gjithsej:	114	100.00

Tabela 5.3. - Statusi shoqëror

Statusi	Numri i përgjigjeve	Përqindja (%)
I Punësuar)	66	57.90
I Papunë	35	30.70
Pensionist	5	4.40
Student	8	7.00
Gjithsej:	114	100.00

Tabela 5.4. – Sektori (Vendi} i punësimit

Sektori (Vendi} i punësimit	Numri i përgjigjeve	Përqindja (%)
Sektori publik	41	62.10

Sektori privat	22	33.30
Sektori civil (shoqëria civile)	3	4.60
Gjithsej:	66	100.00

Tabela 5.5. - Njohuritë për dokumentet zhvillimore të komunës së Rahovecit sipas, moshës, gjinisë, Përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit.

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	9	15	6		30	%	Po	16.40	35.70	35.30		26.30
Përgj	Jo	46	27	11		84	Përgj	Jo	83.60	64.30	64.70		73.70
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	28	2			30	%	Po	36.40	5.40			26.30
Përgj	Jo	49	35			84	Përgj	Jo	63.60	94.60			73.70
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	1	3	16	10	30	%	Po	7.15	9.40	43.20	32.25	26.30
Përgj	Jo	13	29	21	21	84	Përgj	Jo	92.85	90.60	56.80	67.75	73.70
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	25	1	3	1	30	%	Po	37.90	2.85	60.00	12.50	26.30
Përgj	Jo	41	34	2	7	84	Përgj	Jo	62.10	97.15	40.00	87.50	73.70
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													

Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	20	5	0		25	%	Po	48.80	22.70	0		37.90
Përgj	Jo	21	17	3		41	Përgj	Jo	51.20	77.30	100.00		62.10
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.6. – Pjesëmarrja në debatet publike me rastin e përgatitjes së dokumenteve zhvillimore sipas, moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit.

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	4	8	6		18	%	Po	7.30	19.05	35.30		15.80
Përgj	Jo	51	34	11		96	Përgj	Jo	92.70	80.95	64.70		84.20
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	18	0			18	%	Po	23.40	0.00			15.80
Përgj	Jo	59	37			96	Përgj	Jo	76.60	100.00			84.20
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	0	4	7	7	18	%	Po	0.00	12.50	18.90	22.60	15.80
Përgj	Jo	14	28	30	24	96	Përgj	Jo	100.00	87.50	81.10	77.40	84.20
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	14	1	3	0	18	%	Po	21.20	2.85	60.00	0.00	15.80
Përgj	Jo	52	34	2	8	96	Përgj	Jo	78.80	97.15	40.00	100.00	84,20
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													

Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	11	3	0		14	%	Po	26.80	13.60	0		21.20
Përgj	Jo	30	19	3		52	Përgj	Jo	73.20	86.40	100.00		78.80
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.7.- Mendimi i banorëve të komunës së Rahovecit, nëse komuna jep informata të mjaftueshme sipas, moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit.

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	20	16	4		40	%	Po	36,40	38,10	23,50		35,10
Përgj	Jo	35	26	13		74	Përgj	Jo	63,60	61,90	76,50		64,90
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	26	14			40	%	Po	33,80	37,80			35,10
Përgj	Jo	51	23			74	Përgj	Jo	66,20	62,20			64,90
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	7	6	17	10	40	%	Po	50,00	18,75	45,95	32,25	35,10
Përgj	Jo	7	26	20	21	74	Përgj	Jo	50,00	81,25	54,05	67,75	64,90
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	26	10	2	2	40	%	Po	39,40	28,60	40,00	25,00	35,10
Përgj	Jo	40	25	3	6	74	Përgj	Jo	60,60	71,40	60,00	75,00	64,90
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%

Nr.	Po	19	7	0		26	%	Po	46,35	31,80	0,00		35,10
Përgj	Jo	22	15	3		40	Përgj	Jo	53,65	68,20	100,00		64,90
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.8.- Mendimi i banorëve të komunës së Rahovecit, se si informohen rreth aktivitetet e komunës.

Si informoheni lidhur me aktivitetet e komunës së Rahovecit		
Si informoheni/përmes;	Numri i përgjigjeve	Përqindja (%)
Komunikimit me qytetar	2	2.20
Komunikimit me zyrtar të komunës	7	7.60
Internetit (Web-faqës dhe portaleve).	47	51.00
Mjeteve të informimit (shtypit dhe RTV).	23	25.00
Njoftimeve publike	2	2.20
Debateve publike	9	9.80
Informatorëve/Buletineve	2	2.2
Gjithsej: Përgjigjet;	92	100

Tabela 5.9.- Mendimi i banorëve të komunës së Rahovecit, sa janë të kënaqur me punën e komunës së tyre sipas, moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit.

MOSHA												
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80	%
Nr.	Po	22	11	8		41	%	Po	40.00	26.20	47.10	36.00
Përgj	Jo	33	31	9		73	Përgj	Jo	60.00	73.80	52.90	64.00
		55	42	17		114			100	100	100	100
GJINIA												
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F		%
Nr.	Po	29	12			41	%	Po	37.70	32.40		36.00
Përgj	Jo	48	25			73	Përgj	Jo	62.30	67.60		64.00
		77	37			114			100	100		100

PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	3	9	14	15	41	%	Po	21.40	28.10	37.80	48.40	36.00
Përgj	Jo	11	23	23	16	73	Përgj	Jo	78.60	71.90	62.20	51.60	64.00
		14	32	37	31	14			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	27	6	5	3	41	%	Po	40.90	17.15	100.00	37.50	36.00
Përgj	Jo	39	29	0	5	73	Përgj	Jo	59.10	82.85	0.00	62.50	64.00
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	18	9	0		27	%	Po	43.90	40.90	0		40.90
Përgj	Jo	23	13	3		39	Përgj	Jo	56.10	59.10	100.00		59.10
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5,10.- Mendimi i banorëve të komunës së Rahovecit, me çka janë të kënaqur dhe me çka nuk janë të kënaqur lidhur me punën e komunës së tyre.

Me çka janë të kënaqur dhe më çka nuk janë të kënaqur, lidhur me punën e komunës					
Të kënaqur	Përgjigja	Përqindja %	Të pakënaqur	Përgjigja	Përqindja %
Investimet kapitale në infrast. Publike & shkolla etj.	27	54.00	Mungesë e planeve dhe strategjive zhvillimore	2	3.05
Subvencionet, grandet në bujqësi.	8	16.00	Mungesa e hapësirave të gjelbërua dhe ndriçimi publik në fshatra.	1	1.55
Shërbimet administrative dhe publike.	6	12.00	Në përgjithësi (me asgjë) me punën e komunës.	21	31.80
Transparencë, llogaridhënies,	4	8.00	Transparencë, llogaridhënie,	9	13.65
Shërbimet publike. Ndriçimi publik dhe pastërtia e qytetit	4	8.00	Papunësia dhe zhvillimi ekonomik	14	21.20

Renovimi dhe pajisja me mjete konkretizuese	1	2.00	Ndarja jo e drejtë e buxhetit	3	4.50
			Palestra e sportit dhe investimet në arsim	2	3.05
			Mungesa e prezencës së të rinjve në vendimmarrje	3	4.50
			Menaxhimi dobët i projekteve dhe korrupsioni	2	3.05
			Cilësia e punës në arsimi dhe në shëndetësi	4	6.10
			Nepotizmi dhe ndërhyrja e politikës në punësim në sektorin publik	2	3.05
			Implementimin e projekteve dhe selektimi negativ.	3	4.50
	50	100		66	100

Tabela 5. 11.- Njohurit lidhur me Shoqatat/OJQ-të në komunën e Rahovecit, nga banorët sipas, moshës, gjinisë, statusit shoqërorë, përgatitjes profesionale dhe sektorit të punësimit;

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	31	24	14		69	%	Po	56.40	57.15	82.35		60.50
Përgj	Jo	24	18	3		45	Përgj	Jo	43.60	42.85	17.65		39.50
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	53	16			69	%	Po	68.80	43.20			60.50
Përgj	Jo	24	21			45	Përgj	Jo	31.20	56.80			39.50
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%

Nr.	Po	6	23	17	23	69	%	Po	42.85	71.90	45.95	74.20	60.50
Përgj	Jo	8	9	20	8	45	Përgj	Jo	57.15	28.10	54.05	25.80	39.50
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	42	19	5	3	69	%	Po	63.60	54.30	100.00	37.50	60.50
Përgj	Jo	24	16	0	5	45	Përgj	Jo	36.40	45.70	0.00	62.50	39.50
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	25	14	3		42	%	Po	61.00	63.60	100.00		63.60
Përgj	Jo	16	8	0		24	Përgj	Jo	39.00	36.40	0.00		36.40
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5. 12.- Njohuritë për Shoqatat/OJQ-të konkrete në territorin e komunës së Rahovecit;

Për cilën shoqatë/OJQ keni njohuri që vepron në territorin e komunës së Rahovec?		
Shoqata/OJQ	Nr. i Përgjigjeve	Përqindja %
OJQ. "HAREJA"	22	18.80
Shoqata e Vreshtarëve	17	14.55
OPFAKOS	15	12.85
Qendra Rinore SLH"KSOVA"	13	11.10
OVL e UÇK-së	13	11.10
Shoqata e venarve "ENOLOGJIA"	6	5.10
Iniciativa pozitive	6	5.10
FEKT-Fondacioni për edukim kulturor dhe trashëgimi.	5	4.30
SHKA "Bajram Curri"	4	3.40
Shoqata e bizneseve-Zejtare dhe tregtare	4	3.40
SBASHK-u	3	2.60
Këshilli rinor	3	2.60

Agrocelina	2	1.70
Shoqata e gjuetarëve	1	0.85
Shoqata e peshkatarëve	1	0.85
Handikos	1	0.85
OJQ. "Anadrini"	1	0.85
Gjithsej:	117	100

Tabela 5.13. - Anëtarësia e banorëve të komunës së Rahovecit në shoqata/OJQ, shpërndarjen sipas gjinisë moshës, arsimimit, statusit shoqëror, përgatitjes profesionale dhe sektorit të punësimit;

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	4	9	3		16	%	Po	7.30	21.40	17.65		14.05
Përgj	Jo	51	33	14		98	Përgj	Jo	92.70	78.60	82.35		85.95
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	15	1			16	%	Po	19.50	2.70			14.05
Përgj	Jo	62	36			98	Përgj	Jo	80.50	97.30			85.95
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	1	3	5	7	16	%	Po	7.15	9.40	13.50	22.60	14.05
Përgj	Jo	13	29	32	24	98	Përgj	Jo	92.85	90.60	86.50	77.40	85.95
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	12	1	2	1	16	%	Po	18,20	2,85	40,00	12,50	14,05
Përgj	Jo	54	34	3	7	98	Përgj	Jo	81,80	97,15	60,00	87,50	85,95
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100

SEKTORI I PUNËSIMIT												
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.	%
Nr.	Po	8	3	1		12	%	Po				
Përgj	Jo	33	19	2		54	Përgj	Jo				
		41	22	3		66						

Tabela 5.14. - Mendimi e banorëve të komunës së Rahovecit, nëse shoqatat/OJQ-të kontribuojnë në cilësinë e jetës në territorin e komunës së tyre, shpërndarjes sipas moshës;

Sipas viteve	Përgjigje		Gjithsejtë	Përqindja %		Përqindja %
	PO	JO		PO	JO	
20 – 40	25	30	55	44,65	51,70	48,25
40 – 60	20	22	42	35,70	37,95	36,85
60 – 80	11	6	17	19,65	10,35	14,90
Gjithsej:	56	58	114	100	100	100

Tabela 5.15. - Vlerësimi i shkallës së zhvillimit të komunës së Rahovecit nga banorët e saj, shpërndarja sipas moshës;

Shkalla e zhvillimit	MOSHA			Gjithsej	Përqindja %	Përqindja %		
	20-40	40-60	60-80			20-40	40-60	60-80
E Pazhvilluar	7	3	3	13	11,40	12,70	7,15	17,60
Pak e zhvilluar	19	19	7	45	39,50	34,50	45,25	41,20
Mesatarisht e zhvilluar	25	20	7	52	45,60	45,50	47,60	41,20
E Zhvilluar	4	0	0	4	3,50	7,30	0,00	0,00
Shumë e zhvilluar	0	0	0	0	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej:	55	42	17	114	100	100	100	100

Tabela 5.16. - Vlerësimi i shkallës së zhvillimit të komunës së Rahovecit nga banorët e saj, shpërndarja sipas gjinisë;

Shkalla e zhvillimit	Gjinia		Gjithsej	Përqindja %	Përqindja %	
	M	F			M	F

E Pa zhvilluar	8	5	13	11,40	10,40	13,50
Pak e zhvilluar	33	12	45	39,50	42,90	32,45
Mesatarisht e zhvilluar	32	20	52	45,60	41,50	54,05
E zhvilluar	4	0	4	3,50	5,20	0,00
Shumë e zhvilluar	0	0	0	0,00	0,00	0,00
Gjithsej:	77	37	114	100	100	100

Tabela 5.17. - Vlerësimi i shkallës së zhvillimit të komunës së Rahovecit nga banorët e saj, të shpërndarjes sipas përgatitjes profesionale;

Shkalla e zhvillimit	Përgatitja profesionale				Gjithsej	%	Përqindja %			
	PUP	PMP	PLP	PSP			PUP	PMP	PLP	PSP
E pazhvilluar	1	6	3	3	13	11,40	7,10	18,75	8,30	9,40
Pak zhvilluar	9	12	14	10	45	39,50	64,30	37,50	38,90	31,25
Mesatarisht e zhvilluar	4	14	17	17	52	45,60	28,60	43,75	47,20	53,10
E zhvilluar	0	0	2	2	4	3,50	0,00	0,00	5,60	6,25
Shumë e zhvilluar	0	0	0	0	0	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej:	14	32	36	32	114	100	100	100	100	100

Tabela 5.18. - Mendimet e banorëve të komunës së Rahovecit mbi llojet e aktiviteteve ekonomike që mund të zhvillohen në të ardhmen në komunën e Rahovecit;

Cilat janë aktivitetet ekonomike që mund të zhvillohen në të ardhmen në territorin e komunës së Rahovecit?		
Veprimtaritë	Numri i përgjigjeve	Përqindja %
Bujqësia (Vreshtaria, perimekultura dhe pemëtaria)	45	54,20
Industria/prodhimi me bazë lëndën bujqësore	18	21,70
Bujqësia dhe arsimi	8	9,65
Bizneset e vogla dhe të mesme	5	6,05
Blegtoria	3	3,60
Artizanatit e grave	1	1,20

Zonë industrial	1	1,20
Pika për grumbullim dhe ruajtje të produkteve bujqësore	2	2,40
	83	100

Tabela 5.19. - Qëllimi i e banorëve dhe fëmijëve të tyre që të vazhdojnë të jetojnë apo të kthehen për të jetuar në komunën e tyre, shpërndarjes sipas moshës, arsimimit, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit;

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	45	36	14		95	%	Po	81,80	85,70	82,35		83,30
Përgj	Jo	10	6	3		19	Përgj	Jo	18,20	14,30	17,65		16,70
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	65	30			95	%	Po	84,40	81,10			83,30
Përgj	Jo	12	7			19	Përgj	Jo	15,60	18,90			16,70
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	12	25	31	27	95	%	Po	85,70	78,10	83,80	87,10	83,30
Përgj	Jo	2	7	6	4	19	Përgj	Jo	14,30	21,90	16,20	12,90	16,70
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	54	29	4	8	95	%	Po	81,80	82,85	80,00	100,00	83,30
Përgj	Jo	12	6	1	0	19	Përgj	Jo	18,20	17,15	20,00	0,00	16,70
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%

Nr.	Po	34	17	3		54	%	Po	82,90	77,30	100,00		81,80
Përgj	Jo	7	5	0		12	Përgj	Jo	17,10	22,70	0,00		18,0
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.20. - Arsyet për vazhdimin e jetës në të ardhmen në Komunën e Rahovecit;

Pse ju dhe fëmijët tuaj mendoni për të jetuar dhe më tutje në komunën e Rahovecit?		
Arsyeja	Numri i përgjigjeve	Përqindja %
Posedoj pasuri të mjaftueshme	2	2,10
Familja dhe rrethi shoqëror	8	8,40
Jetoj këtu	4	4,20
Puna, prona dhe rrethi shoqëror	6	6,30
Shpresoj në zhvillim dhe jetë më të mirë në të ardhmen	26	27,40
Cilësia e mirë jetesës	2	2,10
Skam zgjidhje më të mirë	4	4,20
Vendi i lindjes dhe dashuria për të	18	19,00
Mosha e shtyrë	1	1,10
Ushtrij biznes familjar	4	4,20
Qyteti i bukur dhe i dashur	8	8,40
Bujqësia e zhvilluar	2	2,10
Të tjera	10	10,50
Gjithsej:	95	100

Tabela 5.21. - Qëllimi i banorëve të komunës së Rahovecit për përfshirjen në procesin e vendimmarrjes në përgatitjen e dokumenteve zhvillimore, nëse u jepet mundësi, shpërndarja sipas moshës, përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit;

MOSHA												
Mosha	20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha	20-40	40-60	60-80			%
Nr.	Po	37	27	15		79	%	Po	67,30	64,30	88,25	69,30

Përgj	Jo	18	15	2		35	Përgj	Jo	32,70	35,70	11,75		30,70
		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	63	16			79	%	Po	81,80	43,25			69,30
Përgj	Jo	14	21			35	Përgj	Jo	18,20	56,75			30,70
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	6	16	28	29	79	%	Po	42,85	50,00	75,70	93,55	69,30
Përgj	Jo	8	16	9	2	35	Përgj	Jo	57,15	50,00	24,30	6,45	30,70
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	53	14	5	7	79	%	Po	80,30	40,00	100,00	87,50	69,30
Përgj	Jo	13	21	0	1	35	Përgj	Jo	19,70	60,00	0,00	12,50	30,70
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	32	19	2		53	%	Po	78,05	86,40	66,70		80,30
Përgj	Jo	9	3	1		13	Përgj	Jo	21,95	13,60	33,30		19,70
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.22. - Nëse banorët e komunës së Rahovecit dinë diçka në lidhje me BE-në, mënyrat dhe mundësitë që janë të hapura për sektorin privat dhe civil pas anëtarësimit në BE, të shpërndara sipas moshës, arsimimit, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit;

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	19	16	5		40	%	Po	34,55	38,10	29,40		35,10
Përgj	Jo	36	26	12		74	Përgj	Jo	65,45	61,90	70,60		64,90

		55	42	17		114			100	100	100		100
GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	30	10			40	%	Po	39,00	27,00			35,10
Përgj	Jo	47	27			74	Përgj	Jo	61,00	73,00			64,90
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	1	9	14	16	40	%	Po	7,15	28,10	37,80	51,60	35,10
Përgj	Jo	13	23	23	15	74	Përgj	Jo	92,85	71,90	62,20	48,40	64,90
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	27	9	2	2	40	%	Po	40,90	25,70	40,00	25,00	35,10
Përgj	Jo	39	26	3	6	74	Përgj	Jo	59,10	74,30	60,00	75,00	64,90
		66	35	5	8	114			100	100	100	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	18	7	2		27	%	Po	43,90	31,80	66,70		40,90
Përgj	Jo	23	15	1		39	Përgj	Jo	56,10	68,20	33,30		59,10
		41	22	3		66			100	100	100		100

Tabela 5.23. - Nëse banorët e komunës së Rahovecit besojnë se ata mund të ndikojnë në çdo lloj projekti apo investimi për të cilat konsiderojnë se në ndonjë mënyrë mund të ketë ndikim negativ në cilësinë e jetës së tyre në zonën ku ata jetojnë, shpërndarja sipas moshës, gjinisë, përgatitjes profesionale, statusit shoqëror dhe sektorit të punësimit;

MOSHA													
Mosha		20-40	40-60	60-80		Σ	Mosha		20-40	40-60	60-80		%
Nr.	Po	24	16	5		45	%	Po	43,60	38,10	29,40		39,50
Përgj	Jo	31	26	12		69	Përgj	Jo	56,40	61,90	70,60		60,50
		55	42	17		114			100	100	100		100

GJINIA													
Gjinia		M	F			Σ	Gjinia		M	F			%
Nr.	Po	29	16			45	%	Po	37,70	43,25			39,50
Përgj	Jo	48	21			69	Përgj	Jo	62,30	56,75			60,50
		77	37			114			100	100			100
PËRGATITJA PROFESIONALE													
Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	Σ	Përgatitja		PUP	PMP	PLP	PSP	%
Nr.	Po	3	8	17	17	45	%	Po	21,40	25,00	45,95	54,80	39,50
Përgj	Jo	11	24	20	14	69	Përgj	Jo	78,60	75,00	54,05	45,20	60,50
		14	32	37	31	114			100	100	100	100	100
STATUSI SHOQËROR													
Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	Σ	Statusi		Punës.	Papun.	Pens.	Stud.	%
Nr.	Po	29	11	1	4	45	%	Po	43,90	31,40	20,00	50,00	39,50
Përgj	Jo	37	24	4	4	69	Përgj	Jo	56,10	68,60	80,00	50,00	60,50
		66	35	5	8	114			100	100	100,00	100	100
SEKTORI I PUNËSIMIT													
Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		Σ	Sektori		Pub.	Priv.	Civil.		%
Nr.	Po	17	10	2		29	%	Po	41,50	45,45	66,70		43,90
Përgj	Jo	24	12	1		37	Përgj	Jo	58,50	54,55	33,30		56,10
		41	22	3		66			100	100	100		100

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Botimet

1. Blakely, E. Bradshaw, T., *Planning Local Economic Development – Theory and Practice*, SAGE Publications, Thousand Oaks, 2002,
2. Tood G. Buchholz, Ide të gjalla të ekonomistëve të vdekur, Dita 2000, Tiranë, 2007,
3. Todaro, P., M., Smith, C. S.: „*Ekonomski Razvoj*“, Šahinpašić, Sarajevo, BIH, 2006.,
4. Todaro, M., Smith, S, “Economic Development-11th”, Pearson, USA, 2012,
5. Civici Adrian, Globalizimi ...Ante Portas, UET/PRESS, Tiranë, 2009,
6. Timothy J. Bartik, Local Economic Development Policies, Upjohn Institute Working Paper, USA, 2003,
7. Timothy J Bartik, Bringing Jobs to People: How Federal Policy Can Target Job Creation for Economically Distressed Areas, The Hamilton Project, Washington, 2010,
8. Ratko Zelenik & Saša Zelenik, “Klasifikacija znanosti u fokusu metodologije i tehnologije znanstvenoga istraživanja”, znanstveni rad, Pomorski zbornik 44, Rijeka, Kroacia, 2007,
9. Soňa Čapáková, Local Government and Economic Development, LGPP-Open Society Institute Budapest, Hungary, 2005,
10. Dušan Vasiljević, Lokalni Ekonomski Razvoj, zašto su jedne Opštine Dobitnici a druge gubitnici Tranzicije, Beograd, Serbia, 2012,
11. Boris B, Zoran V, Gordana M i Boško M, Lokalni Ekonomski Razvoj, SKGO, Beograd, Serbia, 2006,
12. Ratko Zelenik, Metodologija e Tehnologija izrade Znanstvenog i Stručnog Djela, Rijeka, Hrvatska, 2000,
13. Francisco Alburquerque, Local ekonomik development and decentralization in Latin America, Institute of Economics and Geography, Spain 2004,
14. Timothy J. Bartik, Federal Policy Towards State and Local Economic Development in the 1990s, Upjohn Institute Working Paper, USA, 1993.
15. K. KOLLÁR, The examination of the instruments of local economic development, particularly in consideration of Vienna, HJICH, Veszprém, Hungaria, vol, 39(1), pp-21-25 (2011),

16. Vesna Belikć&Milica Hrnjaz, Lokalni ekonomski razvoj, Evropski putokaz, Beograd, Srbia, 2010,
17. Oliver Jeans Schmitt, Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Prishtinë, Kosovë, 2012,
18. Kurtesh Salihu, Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste, Prishtinë,1984,
19. Mujë Gjonbalaj, Ndikimi i faktorëve ekonomik dhe demografik në zhvillimin e popullsisë së Kosovës, Prishtinë, 1997,
20. Ali Jakupi, Finalizimi dimension i strategjisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës, Prishtinë, 1985,
21. Nuri Bashota, Ekenomia e Kosovës dhe potenciali Industrial i saj, Revista ekonomia, Prishtinë, 2003,
22. Haki Shatri, Disertacioni i doktoratws, Privatizimet dhe roli I tyre nw ndwrtimin e politikave sociale efiqente, rasti Kosovws (1999-2008), Tiranë, 2016,
23. C.R. Kothari, Researchs Methodology-Methods&Techniques, New Delhi, India, 2004,
24. Mic Ukaj&Blerim Dragusha, Unemployment and labour force market in Republic of Kosova, IJSBR, Volum-3, No-2, 2013,
25. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Rahoveci 2, Prishtinë 2003,
26. Krsta Vitošević, Orahovac Antropogeografsko Istraživanje na Teritorije Orahovačke Opštine, Prizren,1996,
27. Janet M Rives, Michael T Heaney, Infrastucure and local economic development, Regional Science Perspectives, Vol. 25, No. 1, 1995.
28. Paul J. Gertler, Sebastian Martinez, Impact Evution in Practice, Secon Edition, Washington, D.C. World Bank, 2016,
29. Chris Roche&Linda Kelly, The Evulation of Politics and Politics of Evulation, DLP, www.dlprog.org., 2012,
30. Howard White, Theory-Based Impact Evaluation: Priciples and Practice, 3ie, New Delhi, India, 2009,

31. Sibisi, S. *Brushing against the grains of history: Making local economic development work in South Africa*. Development Planning Division Working Paper Series No.5, DBSA: Midrand, 2009,
32. Josp Bošnjak, Upravljanje lokalnom razvojom općine Hrvace, modelom dobrog upravljanja, Split, Hrvatska, 2012,
33. Thad Dunning, Model Specification Instrumental-Variables Regression, New Haven, 2009,
34. David Neumark & Jed Kolko, Do Enterprise Zones Create the Jobs, 2009,
35. Milat Josip, Osnove Metodologije Istraživanja, Školska knjiga Zagreb, 2005.
36. Kadimel Wekwete, Local Government and Local Economic Development in Southern Africa, Malawi, 2009.

Revista, Studime, Konferenca

1. World Bank, <http://web.worldbank.org/>, 25.08.2015,
2. European Union, Cohesion Policy Support For Local Development: Best Practice and Future Policy Options, Final Report, 2010,
3. Federal Urban Planning Institute, Local economic development strategy manual, Addis Ababa, 2006,
4. World Bank, A Brief History of LED, <http://www.worldbank.org/>, 01.09.2015,
5. World Bank, <http://www.worldbank.org/urban/local/toolkit/pages/organizing-led-strategy.htm/>, 09.09.2015,
6. World Bank, Gwen Swinburn, Soraya Goga & Fergus Murphy, Local Economic Development: A Primer Developing and Implementing Local Economic Development Strategies and Action Plans, Washington DC, 2006,
7. Kako potaknuti razvoj na lokalnoj razini, Friedrich Ebert Stiftung, Ured u Zagrebu, 2005,
8. Instituti Riinvest, Aktivitetet ekeonomike dhe zhvillimi demokratik, studim, Prishtinw, 1998,
9. Instituti pwr planifikim hapsinor, Profili I Kosovws, Prishtinw, 2004,

10. Instituti Ekonomik, Gjendja e ekonomisë së Kosovës në vitin 1988 dhe mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm, Prishtinë, 1997,
11. Instituti Ekonomik, Gjendja e ekonomisë së Kosovës në vitin 1988 dhe mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm, Prishtinë, 1997,
12. Faqja zyrtare e Republikës së Kosovës <https://sq.wikipedia.org/wiki/Kosova>, , marrë me, 15.12.2016,
13. USAID / Kosovo Country Development Cooperation Strategy 2014-2018,
14. MTI, Strategjia e zhvillimit të NVM-ve, 2012-2016 me vision 2020, Prishtinë, 2011,
15. GLPS & BIRN, The Privatization process in Kosovo: An assessment of the main challenges and problems, Prishtinë, 2016,
16. ASK, Seria 3: Statistikat ekonomike, Bitor produkti vendor, 2008-2015, Prishtinë, 2016,
17. MMPH, Plani hapsiror i Kosovës, Prishtinë, 2010,
18. MAPL, Manuali, Organizimi dhe funksionimi i vetqeverisjes lokale në Kosovë, Prishtinë, gushtë, 2013,
19. GISconsulting & Komuna e Rahovecit, Plani Zhvillimor Komunal-PZHK, 2013,
20. Rahoveci, <https://sq.Wikipedia.org/wiki/Rahoveci>, 07.03.2016,
21. Budget, <https://en.wikipedia.org/wiki/Budget>, (28.06.2016),
22. Komuna e Rahovecit, Agjenda e zhvillimit Komunal-AZHK , Rahovec, 2002,
23. BDPA & HCL & Komuna e Rahovecit, Strategjia zhvillimore komunale, Rahovec, 2009,
24. LEADER, (https://en.wikipedia.org/wiki/LEADER_programme, me datë 24.11.2016,
25. MBPZHR, Strategjia e sektorit të vreshtarisë, verëtarisë dhe rrushit të tryezës, 2016-2021, Prishtinë, 2016
26. Agjensioni Kosovar i Mirebesimit-AKM, <http://kta-kosovo.org/>, (marrë me, 03.11.2016,
27. M&Silloi, faqja zyrtare, <http://msilloi.com/rreth-nesh/> (marrë me datë, 30.12.2016),
28. NPT. "Fetoshi", faqja zyrtare, <http://fetoshi.com/per-ne/>, marrë me datë 30.12.2016,

29. Portali lokal informativ, <http://rahovecpress.com/kooperativa-bujqesore-e-grave-krusha>, (marrë me datë, 04.01,2016,
30. MBPZHR, Plani për bujqësi dhe zhvillim rural, 2010-2013, Prishtinë, 2010,
31. MBPZHR, Programi për pagesat direkte, Prishtinë, 2015,
32. Grupi organizativ Hradhfest”, Komunikatë për Hardhfest, <http://www.kosovapress.com/sq/>, marrë me 10.10.2017,
33. Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe turizëm-DEZHT, Vendimi, nr. datë;10.12.2014,
34. Komuna e Rahovecit, DEZHT, Komisioni për ndarjen e grandeve për ekonomi familjare, bizneset e vogla dhe të mesme, Raporti, nr. 4606, datë 09.12.2014,
35. Komuna e Rahovecit, DBPZHR, Plani i punës për vitin, Rahovec, 2017,
36. Agjencia e Statistikave të Kosovës-ASK, Raporti statistikor, Prishtinë, 2016,
37. Minister for the Environment, Community and Local Government, Community Division the Department of the Environment-CDDE, Communti and Local Government-CLG, Irland, 2015,
38. Centar za lokalni ekonomska razvoj-Cler, ”Priručnik namijenjen lokalnim samoupravama”, Ekonomski Fakultet, Rijeka, Hrvatska, 2014,
39. Qeveria e Republikës së Kosovës, MAPL, Strategjia për vetqwerisje lokale 2016-2026, Prishtinë, 2016.

Ligje, Rregullore, Raporte

1. Këshilli i Sigurimit të KB, Rezoluta, S/RES/1244 (1999), New York, 10 qershor 1999,
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Kapitulli i X, neni 123, 124, fq 47,
3. Ligji Nr, 03/L-040, për vetqëverisjen lokale, Prishtinë, 2008,
4. DKA, Informatë zyrtare, nr.807 e datës 22.03.2016,
5. Ligji Nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, Prishtinë, 2008,
6. Drejtoria për Financa dhe Buxhet-DBF, KAB, 2016-2018, Rahovec, 2015,
7. Ligji për tatimin në pronën e palujtshme-Ligji Nr.03/L-204, Prishtinë, 2010,
8. Komuna e Rahovecit, Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, Rahovec, 2015,

9. Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë,
Prishtinë 2008,
10. Ligji, Nr. 04/L-174, Për planifikim hapsinor, Prishtinë, 2013,
Statuti i Komuns së Rahovecit, 01 Nr. 569/1, 2010